



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Programi Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028

Tetor 2024
Prishtinë

Faqe e zbrahtë

Përmbajtja

<i>Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e PKIE 2024-2028</i>	5
<i>Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e PKIE 2024-2028</i>	6
Lista e shkurtesave dhe akronimeve	7
HYRJE	9
Marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.....	11
1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE	13
1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit	13
1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor	13
1.1.2. Administrata publike	15
1.1.3. Avokati i Popullit	18
1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë	19
1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare	20
2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE	21
2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut.....	21
2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit	35
3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË	45
3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së	45
3.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave	46
3.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punonjësve	49
3.3. Kapitulli 3: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve	50
3.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit	52
3.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik	54
3.6. Kapitulli 6: E drejta e kompanive	56
3.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale.....	57
3.8. Kapitulli 8: Politikat e konkurrencës	60
3.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare	62
3.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe mediat.....	64
3.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural	67
3.12. Kapitulli 12: Politikat e sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë	68
3.13. Kapitulli 13: Peshkataria	70
3.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit	71
3.15. Kapitulli 15: Energjia	72
3.16. Kapitulli 16: Tatimet	75
3.17. Kapitulli 17: Politikat ekonomike dhe monetare	76
3.18. Kapitulli 18: Statistikat	77
3.19. Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi	80
3.20. Kapitulli 20: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë	81
3.21. Kapitulli 21: Rrjetet trans-evropiane	82
3.22. Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	83
3.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore	85
3.24. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria	91
3.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimet shkencore	98
3.26. Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura	99
3.27. Kapitulli 27: Mjedisi	101
3.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit.....	103

3.29. Kapitulli 29: Unioni Doganor	105
3.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë	107
3.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes	107
3.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar	108
3.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore.....	110
3.34. Kapitulli 34: Institucionet	110
3.35. Kapitulli 35: Çështjet e tjera	110
<i>Shtojcë: Projektet aktuale mbështetëse relevante për zbatimin e PKIE 2024-2028.....</i>	<i>111</i>
MATRICA E MASAVE AFATSHKURTA	114



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 3 paragrafi 1.4 dhe nenit 103 të Rregullores së Kuvendit, në Seancën plenare të mbajtur më 30 tetor 2024, pasi e shqyrtoi Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Programi Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028.

Nr. 08-V- 786
Prishtinë, 30.10.2024

Glauk Konjufca

Kryetar i Kuvendit

Kopja e Vendimit u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Drejtorisë për Mbështetjen e Komisioneve Parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024 – 2028.
2. Buxheti për zbatimin e këtij Programi është brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2024 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, sipas Programit, që të zbatojnë këtë Vendim.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit që Programin nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim përfundimtar.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Lista e shkurtesave dhe akronimeve

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil	EUROPOL	Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim për Zbatimin e Ligjit
AD	Akademia e Drejtësisë		
AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi	Eurostat	Agjencia e statistikave të Bashkimit Evropian
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim		
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
AKK	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
AKKVP	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	Frontex	Agjencia e BE-së e Kufirit dhe Rojeve Bregdetare
AKP	Agjencia e Kosovës për Privatizim	FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
ANJF	Agjencia për Ndhimë Juridike Falas	GPSIE	Grup Punues Sektorial për Integrim Evropian
ANP	Aerporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"		
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës	GV	Grup i veçantë i stabilizim-asociimit
APK	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	GV RAP	Grupi i Veçantë i Stabilizim-Asociimit për Reformën e Administratës Publike
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit	GZ	Gazeta Zyrtare
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	IAL	Institucion i arsimit të lartë
ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
ARrU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	IFN	Institucion financiar ndërkombëtar
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës	IHD	Investime të huaja direkte
ASHNA	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës	IKShP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	Interpol	Organizata Ndërkombëtare Policore kundër Krimit
BB	Banka Botërore	IP	Inspektorati i Punës
BE	Bashkimi Evropian	IPA	Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit
BEI	Banka Evropiane e Investimeve	IRRrE/RGF	Instrumenti për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor
BERZh	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	KASh	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimeve	KHAIA	Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike
BP	Ballkani Perëndimor	KBR/ RCC	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
BPV	Bruto Prodhimi Vendor	KE	Komisioni Evropian
BQE	Banka Qendrore Evropiane	KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	KGjK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore	KiE	Këshilli i Evropës
COREPER	Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm në BE	KIESA	Agjencia Kosovare për Investime dhe Mbështetjen e Ndërmarrjeve
DIE	Departamentet për integrim evropian, Zyra e Kryeministrit	KMIE	Këshilli Ministror për Integrim Evropian
DIEKP	Departament për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave	KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
DK	Dogana e Kosovës	KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
DL	Departament Ligjor	KPIE	Komiteti Punues për Integrim Evropian
DNSh	Departamenti për Ndhimë Shtetërore	KpIE	Komisioni parlamentar për Integrim Evropian
EJL	Evropa Juglindore	KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
ENQA	Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë	KPSA	Komisioni Parlamentar i Stabilizim-Asociimit
ERA	Agjenda për Reforma Evropiane	KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRrPP	Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik	PK	Policia e Kosovës
KSA	Këshilli i Stabilizim-Asociimit	PKIE	Programi Kombëtar për Integrim Evropian

MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	PKK	Pikë-kalim kufitar
MAShTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	PKZh	Plani Kombëtar për Zhvillim
MCC/KSM	Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit	PLQ	Programi Legjislativ i Qeverisë
MD	Ministria e Drejtësisë	PQ	Programi i Qeverisë
ME	Ministria e Ekonomisë	PRE	Programi për Reforma në Ekonomi
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	PSA	Procesi i Stabilizim-Asociimit
MIK	Menaxhimi i integruar i kufirit	PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	PV	Plan veprimi
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim	PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit
MM	Ministria e Mbrojtjes	RAP	Reforma e Administratës Publike
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	PRrE/NGP	Plani i ri për Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme	SDGs/OZhQ	Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	SIGMA/OECD	<i>Përkrahje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit (OECD)</i>
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit	SKZh	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
MSh	Ministria e Shëndetësisë	ShBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
MZhR	Ministria e Zhvillimit Rajonal	TC	Termocentral
NK	Nënkomiteti i stabilizim-asociimit	TFBE	Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian
NP	Ndërmarrje Publike	TI	Teknologji informative
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
NjIF	Njësia e Inteligjencës Financiare	TPR/CRM	Tregu i Përbashkët Rajonal
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë	UA	Udhëzim administrativ
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim	WBIF	Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor
OShC	Organizatë e shoqërisë civile	ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit	ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
PE	Parlamenti Evropian	ZKM	Zyra e Kryeministrit
PEI/EIP	Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor	ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

HYRJE

Programi Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) është dokumenti kryesor strategjik i Republikës së Kosovës për zbatimin e reformave për integrim në Bashkimin Evropian (BE), i orientuar kah adoptimi i *acquis*-së së BE-së në legjislacionin kombëtar dhe zbatimi i legjislacionit të përafuar. PKIE 2024-2028 është programi i dytë me radhë me këtë titull, dhe i nënti me radhë që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës.¹ Ai është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 2 prill 2024 dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 30 tetor 2024.

Ky program është në harmoni me Programin e Qeverisë 2021-2025 dhe Planin Kombëtar për Zhvillim (PKZh) 2024-2026, i cili zbaton Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SkZh) 2030, përfshirë me Programin Legjislativ të Qeverisë (PLQ) për vitin 2024. Ai gjithashtu reflekton përmbajtjen e dokumenteve kryesore sektoriale. Gjatë hartimit të tij i është dhënë prioritet edhe adresimit të konkluzioneve të dakorduara me BE-në në kuadër të strukturave të përbashkëta institucionale të stabilizim-asociimit me BE-në dhe gjetjeve e rekomandimeve të *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*.

PKIE 2024-2028 është hartuar gjatë periudhës tetor – dhjetor 2023 dhe konsultimet publike janë zhvilluar në janar 2024. Bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 06/22, të 3 prillit 2015², ky proces është udhëhequr nga departamentet për integrim evropian në Zyrën e Kryeministrit (ZKM/DIE), si institucioni kryesor koordinues, në bashkëpunim me institucionet e linjës (IL) përgjegjës për secilin kapitull, përkatësisht me ministrinë dhe institucionet e tjera. Puna brenda IL-ve është koordinuar nga Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP-të) / strukturat ekuivalente. Në këtë proces gjithashtu kanë marrë pjesë Departamentet Ligjore (DL) dhe strukturat e tjera të IL-ve të mandatuara për zhvillimin dhe zbatimin e politikave në fushat përkatëse. ZKM/DIE gjithashtu kanë qenë pjesë aktive e punës gjatë tërë këtij procesi.

Sa i përket ndarjes së përgjegjësisë, fillimisht IL-të kanë propozuar masat afatshkurtra, bazuar në reformat e dakorduara në mbledhjet e raundit më të fundit të strukturave të përbashkëta institucionale të stabilizim-asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës, përkatësisht nënkomiteteve dhe grupeve të veçantë dhe gjetjet e *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*. Më pas, masat e propozuara janë analizuar nga ZKM/DIE në aspektin e cilësisë, adresimit të reformave prioritare dhe zbatueshmërisë së tyre (bazuar në kapacitetet, kohën e nevojshme, etj.).

Programi është gjithëpërfshirës për kah fushëveprimi, Ai parasheh reforma afatshkurtra për vitin 2024 dhe objektiva prioritare afatmesme për përmbushjen e detyrimeve të dala nga MSA dhe nga mekanizma të tjerë për integrim në BE, përmes përfarimit të legjislacionit kombëtar me *acquis*-në e BE-së dhe zbatimit të legjislacionit të përafuar. Bazuar në strukturën e Kriterëve të Kopenhagës, ai është i ndarë në tri blloqe: *Kriteret politike, Kriteret ekonomike, dhe Standardet evropiane – përafrimi i legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së*.

Blloku 1: Kriteret politike mbulon këto fusha: legjislativi, kushtetuta, sistemi zgjedhor, administrata publike, avokati i popullit, mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë dhe bashkëpunimi rajonal. Ai ndërlidhet me kapitujt 23 dhe 24 të *acquis*-së (të bllokut të tretë), dhe përmban pesë kapituj: *Kushtetuta, Parlamenti dhe sistemi zgjedhor; Administrata publike; Avokati i Popullit; Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë; dhe Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare*.

Blloku 2: Kriteret ekonomike është në harmoni me Programin për Reforma Ekonomike (PRE). Ai gjithashtu reflekton prioritete dhe aktivitete të dalë nga mekanizma të tjerë të dialogut me BE-në, si prioritetet vjetore, konkluzionet e strukturave të MSA-së, ose nga mekanizmat multilateralë, si marrëveshjet me FMN, etj. Ky bllok përmban dy kapituj: *Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut, dhe Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit*.

¹ Ligji nr. 05/L-069 për ratifikimin e MSA-së, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239>.

² Vendimi i Qeverisë nr. 06/22, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62226>, fq. 5.

Bloku 3: Standardet evropiane - përafrimi i legjislacionit të Kosovës me *acquis*-në e BE-së përfshin të gjitha fushat e *acquis*-së së BE-së me të cilën duhet të përafrohet legjislacioni vendor dhe të zbatohet ky i fundit, gjë që gjithashtu kërkon kapacitete administrative. Ky bllok përmban 33 kapituj të *acquis*-së dhe një kapitull mbi kornizën ligjore për përafrimin e legjislacionit vendor me *acquis*.

Secili kapitull përmban pjesën tekstuale dhe matricën e masave afatshkurtra. Pjesa tekstuale përmbledh gjendjen aktuale³ (kornizën legjislative, të politikave dhe atë institucionale) dhe objektivat prioritare afatmesme. Gjendja aktuale pasqyron zhvillimet kryesore në fushat përkatëse në kohën e finalizimit të dokumentit, përkatësisht në periudhën nga fundi i nëntorit deri në fund të dhjetorit 2023. Programi gjithashtu përmban një shtojcë të projekteve kryesore relevante të asistencës për zhvillim të financuar nga BE, donatorë bilateralë, institucione financiare ndërkombëtare (IFN) e banka zhvillimore që janë në zbatim e sipër gjatë periudhës së zbatimit të tij.

Matrica e masave afatshkurtra përmban masat e planifikuara për vitin 2024 për zbatimin e reformave, përkatësisht masat legjislative (legjislacionin kornizë dhe aktet nënligjore e aktet e tjera rregullative) dhe ato zbatuese (të kornizës së politikave, reformave institucionale e ngritjes së kapaciteteve institucionale, dhe për zbatim në praktikë).

Përgjegjëse për zbatimin e PKIE-së dhe monitorimin e zbatimit të tij janë organet e administratës shtetërore, brenda fushëveprimit të mandatit të tyre ligjor. Si mekanizmi qendror qeverisës për përmbushjen e detyrimeve të dala nga MSA dhe mekanizmat e tjerë për integrim në BE, përgjegjës në nivelin më të lartë është Kabineti i Qeverisë, përkatësisht ministrat, dhe udhëheqësit e institucioneve të tjera të administratës shtetërore përgjegjës për fushat përkatëse të politikave. Zbatimi i PKIE-së gjithashtu monitorohet përmes strukturave të përbashkëta institucionale të stabilizim-asociimit ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës të themeluara me MSA, përkatësisht Këshillit të Stabilizim-Asociimit (KSA), Komitetit dhe nënkomiteteve (NK) e grupeve të veçantë (GV). Një instancë tjetër institucionale që monitoron zbatimin e këtij programi janë strukturat koordinuese kombëtare për integrim evropian, përkatësisht Këshilli Ministror për Integrim Evropian (KMIE), Komiteti Punues për Integrim Evropian (KPIE) dhe Grupet Punuese Sektoriale për Integrim Evropian (GPSIE). Përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm në nivel punues është ZKM/DIE, në bashkëpunim me IL-të (përmes DIEKP-ve / njëjstive ekuivalente, përgjegjëse për koordinim në nivel të IL-ve), përfshirë përmes monitorimit dhe raportimit të rregullt.

Masat që parashohin miratimin e projektligjeve vlerësohen si të zbatuara me miratimin e projektligjeve përkatëse nga Qeveria.

Kuvendi është një nga shtyllat kryesore institucionale për zbatimin e këtij programi, në veçanti përmes miratimit të ligjeve, përfshirë përmes Komisionit parlamentar për Integrim Evropian (KpIE) dhe Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit (KPSA).

Në emër të BE-së, rol të rëndësishëm në përmbushjen e detyrimeve të dala nga MSA dhe mekanizmat e tjerë për integrim në BE, dhe rrjedhimisht në zbatimin e këtij programi, luan edhe Komisioni Evropian (KE), përfshirë përmes Zyrës së BE-së (ZBE) në Kosovë.

Rolin e tyre në zbatimin e këtij programi e luan edhe shoqëria civile dhe palët e tjera të interesuara. ZKM, si institucioni kryesor përgjegjës për integrim evropian, bashkëpunon me akterë jashtë institucioneve publike në zbatimin e këtij programi, përfshirë përmes konsultimeve me OShC dhe akterë të tjerë në kuadër të strukturave të përbashkëta institucionale të stabilizim-asociimit BE - Kosovë.

³ Për një pasqyrë të hollësishme të obligimeve të MSA-së në të gjithë kapitujt, shihni PKIE 2022-2026 dhe Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), <https://integrim evropian.rks-gov.net/msa/programi-kombetar-per-zbatimin-e-marreshjes-se-stabilizim-asociimit-pkzmsa/>.

Marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Procesi i Stabilizim-Asociimit (PSA), si kornizë për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE është iniciuar nga ana e BE-së më 1999 dhe është lansuar në nëntor 2000, në Samitin e Zagrebit. Bazuar në kriteret e Kopenhagës dhe kriteret e Madridit për anëtarësim në BE, PSA përcakton se perspektiva evropiane e këtyre vendeve varet nga përparimet në vendosjen e demokracisë së qëndrueshme, shtetit ligjor, ekonomisë së tregut dhe bashkëpunimit rajonal. Kjo perspektivë është rikonfirmuar në Këshillin Evropian të Selanikut, në qershor 2003, sikur edhe në Samitin BE – Ballkan Perëndimor, të mbajtur në Tiranë më 6 dhjetor 2022, i pari i mbajtur në rajon që nga anëtarësimi i Kroacisë në BE. Perspektiva e anëtarësimit të rajonit të Ballkanit Perëndimor në BE u riafirmua më së fundmi në samitin e katërt vjetor BE – Ballkan Perëndimor të mbajtur më 13 dhjetor 2023, në Bruksel.

Sa i përket Kosovës, në prill 2005 KE kishte publikuar komunikatën *E ardhmja evropiane për Kosovën*, kurse më 2006 Këshilli kishte miratuar Partneritetin e parë Evropian për Kosovën, e më pas të dytin, më 2008. Si përgjigje ndaj Partneritetit Evropian, gjatë periudhës 2008-2012 Kosova ka zbatuar Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE), gjatë periudhës 2013-2015 Planin e Veprimit për MSA (PVMSA) dhe Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit (PVRP). Pas hyrjes në fuqi të MSA-së, gjatë periudhës 2016-2022 ka zbatuar Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), e nga viti 2023 Programin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE).

Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Republika e Kosovës deri më tani është njohur nga njëqindëshestatëmbëdhjetë (117) shtete⁴, përfshirë 22 shtete anëtare të BE-së.

Deri në fund të vitit 2009 dialogu i reformave ndërmjet Kosovës dhe BE-së është zhvilluar përmes Mekanizmit Përcjellës të procesit të Stabilizim-Asociimit (MPSA). Më pas, bazuar në komunikatën e KE-së *Kosova – përmbushja e perspektivës së saj evropiane*, të tetorit 2009, dialogu i reformave ishte avancuar në kornizën e Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA), ndërsa gjithashtu ishte iniciuar procesi për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e BE-së.

Procesi drejt MSA-së ka filluar në tetor 2011, me rekomandimin e KE-së për iniciimin e *Studimit të Fizibilitetit për MSA*. Ky studim, i publikuar në tetor 2012, ka konstatuar se Kosova është e gatshme të negociojë MSA-në. Negociatat janë zhvilluar nga tetori 2013 deri në korrik 2014. Më pas, MSA është miratuar nga Qeveritë e Shteteve Anëtare të BE-së, është nënshkruar më 27 tetor 2015, në Strasburg. Ajo është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (më 30 tetor 2015) dhe ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (më 2 nëntor 2015). Përfundimisht, MSA ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Gjatë vitit 2016 gjithashtu janë funksionalizuar strukturat e përbashkëta institucionale BE – Kosovë të krijuara me MSA për mbikëqyrjen e zbatimit të saj: Këshilli i Stabilizim-Asociimit, Komiteti, nënkomitetet (NK) dhe grupet e veçantë (GV), si dhe Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit (KPSA). Këto struktura mblidhen rregullisht.

Zhvillim tjetër me rëndësi përbën përmbujlla e zbatimit të fazës së dytë të prioritetëve politike të dakorduar ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës për zbatimin e MSA-së – Agjendës për Reforma Evropiane (ERA II), përkatësisht 15 prioritetëve të zbatuar përmes Planit të Veprimit për zbatimin e këtyre prioritetëve (PV ERA II). Në kuadër të ERA II, nga mesi i vitit 2021 deri në fund të vitit 2023 Kosova ka zbatuar reforma kyçe ekonomike, për fuqizimin e sundimit të ligjit, konsolidimin e qeverisjes së mirë, si dhe përafrimin me standardet e BE-së në fushat e punësimit, arsimit e shëndetësisë. Kjo e ka sjellë Kosovën më afër BE-së dhe tani ajo është e përgatitur – politikisht, ekonomikisht, ligjrisht dhe institucionalisht – për fazën e ardhshme drejt anëtarësimit në BE.

Më 15 dhjetor 2022, Republika e Kosovës zyrtarisht ka aplikuar për anëtarësim në BE. Aplikimi i është dorëzuar Qeverisë së Çekisë, në kapacitetin e Presidencës së radhës së Këshillit Evropian, përkatësisht Ministrin për Çështje Evropiane, Mikulaš Bek, nga Kryeministri Albin Kurti. Më 20 dhjetor 2022, Këshilli i BE-së (COREPER II) është informuar nga ana e Presidencës së Çekisë për aplikimin. Republika e Kosovës

⁴ Lista e njohjeve, <https://mfa-ks.net/lista-e-njohjeve/>.

është në pritje të marrjes së statusit të vendit kandidat për anëtarësim, në mënyrë që pastaj së bashku me BE-në të fillojë përgatitjet për të nisur negociatat e anëtarësimit.

Pas shuarjes së Ministrisë së Integritimit Evropian (në qershor 2020), kompetencat e institucionit kryesor koordinues kombëtar për integrim evropian, së bashku me departamentet politikëbërëse të saj, janë transferuar në ZKM, ndërsa autoriteti më i lartë politik i Qeverisë përgjegjës për integrim evropian është Zëvendëskryeministri i Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog.

Sa i përket *liberalizimit të vizave*, vendimmarrja është përmbyllur gjatë vitit 2023 me publikimin në Gazetën Zyrtare të BE-së, më 25 prill 2023, të *Rregullores së BE-së nr. 2023/850*⁵ dhe hyrjen e saj në fuqi, më 15 maj 2023. Nga 1 janari 2024 shtetasit e Republikës së Kosovës udhëtojnë pa viza në Zonën Schengen, për udhëtime afatshkurtra. Qeveria dhe Zyra e BE-së kanë zhvilluar fushata komunikimi me publikun për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet dhe rregullat e udhëtimit pa viza.

Në një tjetër zhvillim të rëndësishëm për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor, më 8 nëntor 2023 – me rastin e publikimit të pakos vjetore të zgjerimit (*Komunikatës për Zgjerimin e BE-së dhe raporteve për vendet*)⁶ – Komisioni Evropian miratoi propozimin për një *Instrument për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor (MRRrE/RGF)*. Duke e avancuar përkrahjet për reforma evropiane në rajon nga Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (PEI/EIP) 2021-2027, ky mekanizëm, pasi të dakordohet nga institucionet bashkë-ligjvënëse, do të realizohet përmes *Planit të ri për Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor (PRrE/NGP)*⁷ dhe *Rregullores së Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Themelimin e Mekanizmit për Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor*⁸. Në përgjigje të këtij plani, më 22 janar 2024 Qeveria e Republikës së Kosovës i ka dorëzuar KE-së listën e përditësuar të reformave. Dialogu me Drejtorinë e Përgjithshme të KE-së për Negociata të Zgjerimit po vazhdon për ta finalizuar listën e reformave në një plan konkret e të zbatueshëm brenda katër viteve të ardhshëm.

Sa i përket pjesëmarrjes në Programet e BE-së, Kosova aktualisht përfiton nga *Evropa Kreative, ERASMUS+, Customs, Fiscalis* dhe *Horizon*, ndërsa është në proces të anëtarësimit edhe në programe të tjerë.

⁵ *Rregullorja (BE) nr. 2023/850 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 19 prill 2023, për plotësim-ndryshimin e Rregullores (BE) nr. 2018/1806 me listën e vendeve shtetasit e të cilëve duhet të posedojnë viza për kalimin e kufijve të jashtëm dhe shtetasit e të cilëve janë të përgjithshëm nga një kërkesë e tillë (Kosova)*, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32023R0850>.

⁶ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/strategy-and-reports_en.

⁷ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/COM_2023_691_Neë%20Groëth%20Plan%20Ëestern%20Balkans.pdf.

⁸ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/COM_2023_692_Proposal%20Regulation%20Reform%20Groëth%20Facility%20Ëestern%20Balkans%20%2B%20annex.pdf.

1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE

1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit

1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor

Kushtetuta

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në fuqi nga 15 qershori 2008, është në përputhje me vlerat dhe parimet evropiane. Në bazë të kritereve të Kopenhagës, rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mos-diskriminimit, të së drejtës pronësore, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushteteve shtetërore dhe ekonomisë së tregut. Kushtetuta e Republikës së Kosovës gjithashtu ngërthen në vete instrumentet ndërkombëtare, duke përfshirë ato për të drejtat themelore të njeriut dhe mbrojtjen e personave që u përkasin komuniteteve pakicë dhe mos-diskriminimin. Kjo përfshin pajtueshmërinë me parimet e Deklaratës Universale të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, si dhe me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Aktin Final të Helsinkit.

Parlamenti

Kjo fushë mbulon fushëveprimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës si organ ligjvënës që miraton ligje, rezoluta e marrëveshje ndërkombëtare, dhe përfshin funksionin mbikëqyrës të Kuvendit, përkatësisht mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe institucioneve të tjera publike të cilat sipas Kushtetutës dhe ligjeve i raportojnë atij, si dhe rolin e tij në procesin e integritimit evropian. Siç kërkon MSA, më 2016 është themeluar Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës (KPSA), i përbërë nga deputetë të PE-së dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku zhvillohet dialogu politik parlamentar në kuadër të MSA-së.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se mungesa e kuorumit për vendimmarrje dhe e përpjekjeve për të ndërtuar konsensus ndërpartiak vazhdon të ndikojë negativisht në punën e Kuvendit. Kuvendi ka rritur numrin e procedurave të përshpejtuara për miratimin e ligjeve kyçe. Mungesa, vonesat dhe largimi i hershëm nga seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve janë bërë praktikë e zakonshme. Ndonëse është miratuar Rregullorja e re e Punës së Kuvendit, aty mungojnë masat për shqiptimin e masave financiare (ose të tjera) për mungesë të paarsyeshme në seancat parlamentare. Raporti rekomandon që Kuvendi të përforcojë rolin e tij mbikëqyrës, të përmirësojë menaxhimin e brendshëm, të miratohet një plan vjetor pune dhe të krijohet një sistem votimi elektronik dhe sistem elektronik i regjistrimit të prezencës.

Në kuadër të strukturave të stabilizim-asociimit, nga Kuvendi kërkohet të sigurojë emërimin e anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura në kompetencë e tij. Ky proces duhet të përfundohet duke u bazuar në parim të meritës dhe profesionalizmit, si dhe duke shmangur politizimin për këto emërimë. Kuvendi, bazuar në Memorandumin e bashkëpunimit me Mbretërinë e Bashkuar, duhet të angazhohet që të sigurojë emërimin e anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura të cilat janë në kompetencë të tij përmes një procesi transparent dhe meritot. Ky prioritet vazhdon të mbetet ndër më të rëndësishmit edhe për Qeverinë e Kosovës, prandaj reflektohet në të gjitha dokumentet kryesore planifikuese të saj.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: përbërja dhe struktura e Kuvendit përcaktohet në kapitullin IV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Organizmi dhe funksionimi i Kuvendit dhe trupave të punës së tij, si dhe të drejtat dhe detyrat e deputetëve, janë përcaktuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, të miratuar më 28 korrik 2022. Për të zbatuar nenin 132 të MSA-së, është themeluar KPSA, si forum i përbashkët i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian përgjegjës për të shkëmbyer mendime rreth zbatimit të MSA-së. KPSA është funksional dhe mban takime të rregullta, dy herë në vit. *Politikat*: sipas Rregullores së tij të Punës, Kuvendi funksionon bazuar kryesisht në PLQ dhe Planet e Punës së komisioneve parlamentare, ndërsa lidhur me MSA-në aktualisht gjithashtu zbaton reforma të parapara në PKIE.

Korniza institucionale: Kuvendi i Republikës së Kosovës ka 120 deputetë, përfshirë vendet e garantuara për komunitetet jo-shumicë. Funksionet e tij, të parapara në nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përfshijnë atë ligjvënës, zgjedhjen e Qeverisë e të Presidentit të Republikës, si dhe emërimin e udhëheqësve të organeve mbikëqyrëse të institucioneve të pavarura dhe mbikëqyrjen e punës së tyre. Përveç këtyre, Kuvendi, kryesisht përmes komisioneve të tij, mbikëqyr zbatimin e ligjeve dhe rekomandon ndërmarrjen e masave në rast të moszbatimit apo zbatimit joadekuat të tyre. Funksionimi i brendshëm i Kuvendit rregullohet nga Rregullorja e tij e Punës. Për funksionimin e tij Kuvendi zgjedh, nga radhët e veta, Kryesinë (Kryetarin dhe Nënkryetarët), dhe emëron komisionet e përhershme, ato funksionale dhe ato *ad hoc*. Administrata e Kuvendit përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga Kryesia e Kuvendit, dhe tri Drejtorit të Përgjithshme (DP): DP për Shërbime Legjislative, DP për Media dhe Marrëdhënie me Publikun dhe DP e Administratës. Funksionet kyçe në kontekst të zbatimit të MSA-së përfshirë përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit, i ushtron DP për Shërbime Legjislative.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Ngritja e kapaciteteve ligjvënëse të Kuvendit, posaçërisht të DP për Shërbime Legjislative, përmes plotësimit të pozitive të lira gjatë vitit 2024;
- Përmirësimi i mbikëqyrjes së ekzekutivit, përfshirë sektorin e sigurisë, përmes monitorimit të zbatimit të politikave dhe ligjeve;
- Mbikëqyrja e shpenzimeve buxhetore të Kuvendit gjatë vitit fiskal, përfshirë përmes analizave dhe zbatimit të monitorimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor;
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të administratës së Kuvendit në përputhje me Rregulloren e re të Kuvendit, përmes Planit të Trajnimeve, trajnimeve sipas marrëveshjeve ndërmjet Kuvendit dhe donatorëve, shkëmbimeve me parlamentet e tjera, dhe Strategjisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Marrëdhënie Ndër-parlamentare.

Sistemi zgjedhor

Republika e Kosovës është republikë demokratike parlamentare me një sistem përfaqësues shumë-partiak. Kushtetuta dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ky i fundit në fuqi nga korriku 2023, rregullojnë sistemin zgjedhor në Kosovë. Sipas Kushtetutës dhe këtij ligji, Kosova është një zonë zgjedhore me shumë kandidatë. Duke ushtruar të drejtën e tij/saj të votës, votuesi voton për një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votojë deri në dhjetë (10) kandidatë nga lista e kandidatëve të atij subjekti politik, e nëse voton për më tepër se dhjetë (10) kandidatë numërohet vetëm vota për subjektin politik. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka njëqindnjëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura, njëzet (20) prej të cilave janë vende të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në vend. Legjislacioni zgjedhor garanton edhe barazinë gjinore në sistemin zgjedhor.

Gjendja aktuale

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova ka bërë progres të rëndësishëm rreth reformës zgjedhore, me miratimin e Ligjit të plotësuar-ndryshuar për Financimin e Subjekteve Politike dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Korniza e re ligjore adreson rekomandimet e kamotshme të misioneve vëzhguese të zgjedhjeve të BE-së dhe OSBE. Zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale në katër komunat në pjesën veriore të vendit, që u mbajtën më 23 prill 2023, ishin në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës dhe janë bërë përpjekje që ato të zhvillohen në mënyrë të qetë dhe të rregullt. Mirëpo, për shkak të pjesëmarrjes shumë të ulët (3.47% të votuesve), veçanërisht të qytetarëve serbë të Kosovës, këto zgjedhje nuk ofrojnë zgjidhje politike afatgjatë për këto komuna. Raporti ka vlerësuar themelimin e Komisionit *Ad-hoc* të Kuvendit për t'i adresuar rekomandimet e BE-së lidhur me procesin zgjedhor.

Megjithatë, *rekomandohet* miratimi i Ligjit për KPM-në. KQZ duhet të zbatojë kornizën e re ligjore para organizimit të zgjedhjeve të ardhshme të përgjithshme, dhe ka nevojë për më shumë burime financiare e njerëzore për të kryer detyrat shtesë sipas legjislacionit të amendamentuar. Zgjedhjet e parakohshme lokale duhet të mbahen sa më shpejt në katër komunat në pjesën veriore të vendit, të organizuara në mënyrë plotësisht gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrjen e pakushtëzuar të serbëve kosovarë.

Korniza legjislativë, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislativë dhe politikë: zgjedhjet në Republikën e Kosovës rregullohen nga Ligji i ri për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji për Zgjedhjet Lokale dhe Ligji për Financimin e Subjekteve Politike (në fuqi nga gushti 2022, në harmoni me rekomandimet e Komisionit të Venedikut), aktet nënligjore të KQZ-së që rregullojnë procesin zgjedhor dhe Plani Strategjik i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2023-2026.

Institucionet: Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Paneli Zgjedhor për Parashtresa dhe Ankesa, dhe Trupat Menaxhuese Zgjedhore siç janë: Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillat e Vendvotimeve (KVV). Një institucion tjetër relevant në kuadër të reformës në vazhdim e sipër për ndërlidhjen e sistemit të adresave me regjistrat civilë është Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) në kudër të MPB-së, përgjegjëse për komponentin e regjistrave civilë në kuadër të kësaj reforme.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Zbatimi i rekomandimeve të Misioneve të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve;
- Ndërlidhja e sistemit të adresave me sistemin e regjistrat qendror të gjendjes civile, për saktësimin e listës së votuesve;
- Përmirësimi i objektivit (ambienteve të punës) së KQZ-së dhe sigurimi i burimeve për edukim, trajnim dhe ngritje të kapaciteteve për pjesëmarrësit në procese zgjedhore (subjektet politike, organet drejtuese të zgjedhjeve, votuesit dhe shoqërinë civile);
- Aplikimi i teknologjisë në proceset zgjedhore, për të siguruar saktësi, transparencë dhe efikasitet.

1.1.2. Administrata publike

Ky kapitull mbulon funksionimin e të gjitha institucioneve publike për zbatimin e politikave publike të ndërmarra nga Qeveria, e cila përbëhet nga njësitë institucionale qeveritare që rregullojnë funksionimin e shoqërisë. Një administratë publike efektive është vendimtare për zhvillimin e vendit, përmes procedurave administrative transparente, të qarta dhe të thjeshta, ofrimin të shërbimeve publike të orientuar kah qytetari dhe për të ndihmuar bizneset në ushtrimin e veprimtarisë së tyre duke lehtësuar procedurat dhe hequr barrierat. Reforma e Administratës Publike (RAP) është njëra nga tri shtyllat themelore për integrim në BE. Obligimet e Kosovës në këtë fushë, sipas nenit 120 të MSA-së, fokusohen në konsolidimin e zbatimit e legjislativës dhe politikave, dhe përmirësimin e efikasitetit, efektivitetit, llogaridhënies e transparencës.

Gjendja aktuale

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova ka njëfarë niveli të përgatitjes dhe ka arritur progres të kufizuar në fushën e reformës së administratës publike. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Përmirësimin e funksionimit dhe llogaridhënies së administratës publike, përfshirë përmes racionalizimit të agjencive dhe vënies në zbatim të menaxhimit të performancës nëpër agjenci; të forcohen kapacitetet administrative; të plotësohen vendet vakante rregullisht dhe në përputhje me parimin e rekrutimit meritot;
- Amendamentimin e Ligjit të ri për Zyrarët Publikë, në përputhje me parimet e një administrate publike moderne;
- Sigurimin e funksionimit efikas të sistemit të ri të pagave përmes zbatimit të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura dhe finalizimit të proceseve të (i) rregullimit të organizimit të brendshëm të organeve publike; (ii) klasifikimit të vendeve të punës; dhe (iii) sistematizimit të pozitive në nivelin qendror sipas përshkrimeve të vendeve të punës;
- Përmirësimin e sigurisë juridike, reduktimin e barrës administrative dhe rritjen e numrit të shërbimeve online në administratën publike për bizneset dhe publikun.

Në anën tjetër, sipas vlerësimit të MPB-së, për herë të parë që nga viti 2012 ndikimi politik nuk përmendet në raportin e KE-së për Kosovën. Më konkretisht, në vitin 2022 është miratuar Strategjia gjithëpërfshirëse për Reformën e Administratës Publike 2022-2027 dhe Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave

Publike 2022-2026, dhe kanë filluar të zbatohen. Problemet e hasura nga burimet njerëzore në zbatimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese kanë shtyrë drejt rishikimit substancial të këtij ligji dhe në hartimin e tërësishëm të ligjit për paga në sektorin publik. Rrjedhimisht, më 23 dhjetor 2023 Kuvendi ka miratuar Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili është duke u zbatuar nga 5 shkurti 2023, dhe Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Vlen të theksohet se për herë të parë në Republikën e Kosovës po zbatohet një ligj i njëtrajtshëm i pagave në sektorin publik. Ndërsa ligji për zyrtarët publikë është duke sjellë agjilitet në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe një dinamikë të re në tërheqjen e kapaciteteve njerëzore nga jashtë administrata publike. Më tej, pas tri përpjekjeve për të përfunduar klasifikimin të vendeve të punës dhe sistematizimin e pozitave, ai është miratuar nga Qeveria më 16 shkurt 2023, dhe është në zbatim e sipër, me një hapësirë disamujore për korrigjimin e gabimeve të mundshme. Qeveria ka në fokus profesionalizimin e administratës publike përmes forcimit të kapaciteteve njerëzore të Ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe të gjitha institucioneve publike.

Më tej, akoma ka sfida në zbatimin e Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, pra zbatimi i tij nuk ka qenë i kënaqshëm për shkak të problemeve që burojnë nga mospërputhja në mes ligjit dhe kontekstit real në administratën shtetërore. Kjo çështje është duke u trajtuar nga institucionet përgjegjëse. Adresimi i problemeve në administratën shtetërore dhe agjencitë e pavarura është prioritet, dhe për këtë qëllim në vitin 2022 Kuvendi ka miratuar ligjin për valën e parë dhe atë për valën e dytë të racionalizimit të agjencive, proces ky që kishte ngecur që nga viti 2015. Lidhur me këtë reformë, gjithashtu është miratuar metodologjia për krijimin, shuarjen apo bashkimin e agjencive, dhe bazuar në të është duke u hartuar PV i ri për valët e tjera të racionalizimit të agjencive. Sa i përket zvogëlimit të barrës administrative në ofrimin e shërbimeve publike dhe digjitalizimit të këtyre shërbimeve, në shtator 2022 Kuvendi ka miratuar Ligjin për plotësim-ndryshimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili do të zbatohet valën e parë të harmonizimit të ligjeve me LPPA. Në vazhdimësi të kësaj reforme, Qeveria ka miratuar PV për dy valët vijuese të harmonizimit të ligjeve të mbetura me LPPA. Vala e dytë është tashmë në lexim të dytë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ndërsa vala e tretë është në analizë e sipër dhe së shpejti fillon hartimi i projektligjit. Sa u përket zhvillimeve të tjera kyçe në kuadër të kësaj shtylle, në shtator 2022 Qeveria ka miratuar Programin për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027, Strategjinë për E-qeverisje, si dhe deri më tani janë digjitalizuar mbi 150 shërbime publike që ofrohen përmes platformës e-Kosova, ndërsa disa shërbime të tjera publike janë në digjitalizim e sipër.

Më tej, në kontekst të *GV për Reformën e Administratës Publike*, Kosova trajton me prioritet këto reforma kryesore në këtë fushë:

- Të sigurojë që Strategjia e re për RAP të zbatohet me kohë dhe në mënyrë të duhur;
- Të harmonizojë Strategjinë e re për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike;
- Të përmirësojë funksionimin e shërbimit civil dhe të përfundojë procesin e klasifikimit të vendeve të punës;
- Të përmirësojë kapacitetet e Zyrës për Planifikim Strategjik për koordinimin e Programit për Zvogëlimin e Barrës Administrative;
- Të sigurojë që projektligjet, para miratimit nga Qeveria, të jenë në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe me parimet për zvogëlimin e barrës administrative.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: Ligjet kryesore në këtë kapitull janë: Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligji i ri për Zyrtarët Publikë dhe Ligji për Pagat në Sektorin Publik. Ligjet për plotësim-ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, vala e parë (miratuar në gusht 2022) dhe vala e dytë (miratuar në prill 2023) që racionalizojnë agjencitë ekzistuese; Ligji për plotësim-ndryshimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me LPPA, me qëllim plotësim-ndryshimin e ligjeve të veçanta me të cilat rregullohen procedurat e veçanta administrative duke siguruar respektimin e parimeve të përgjithshme dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ligjore të palëve.

Politikat: korniza e politikave në këtë kapitull përbëhet nga dy komponentë: politikat dhe planifikimi buxhetor. Komponenti i politikave përbëhet nga Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2022-2027 dhe PV 2022-2024, ku janë integruar të tri strategjitë paraprake, Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2022-2026 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj (përfshirë shtyllën e prokurimit publik dhe atë të kontrollit të brendshëm të financave publike), dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZh) 2030 dhe Plani Kombëtar për Zhvillim (përfshirë Programin Legjislativ të Qeverisë). Komponenti i planifikimit buxhetor përbëhet nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025 dhe buxheti vjetor. Një dokument tjetër i rëndësishëm politikash në këtë fushë është Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027, i miratuar nga Qeveria në shtator 2022.

Institucionet: institucioni kryesor në këtë kapitull është Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), përfshirë Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) dhe Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Më tej, ZKM është përgjegjëse për komponentin e politikave në kuadër të sistemit të 'Qendrës së Qeverisë' (QQ) (përmes Zyrës për Planifikim Strategjik, Sekretariatit Koordinues të Qeverisë dhe Zyrës Ligjore), për procesin e integritit evropian dhe bashkëpunimit për zhvillim (përmes katër zyrave për integrim evropian dhe Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim), si dhe për koordinimin e konsultimeve publike përmes *Platformës Online për Konsultime me Publikun* (përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë). Përgjegjëse për komponentin e planifikimit buxhetor në kuadër të QQ është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Krijimi i një shërbimi civil profesional, apolitik, meritohet dhe të menaxhuar mirë përmes riorganizimit të ministrive dhe organeve vartëse të tyre, finalizimit të procesit të klasifikimit të vendeve të punës dhe zbatimit të sistemit të ri të pagave;
- Rritja e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies si dhe përmirësimi i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset përmes avancimit të qeverisjes elektronike, duke zbatuar strategjinë për e-qeverisje;
- Reduktimi i barrës administrative përmes harmonizimit me LPPA të ligjeve të veçanta dhe akteve nënligjore që përmbajnë procedura të veçanta administrative;
- Vazhdimi i zbatimit të procesit të racionalizimit të agjencive;
- Përmirësimi i sistemit për menaxhim të burimeve njerëzore përmes ndërlidhjes së tij me sistemin e pagave;
- Forcimi i mëtejshëm i administratës publike përmes zhvillimit të kapaciteteve për planifikim, analizim, zhvillim e zbatim të politikave, për të krijuar politika substanciale, ekonomikisht efikase dhe financiarisht të përballueshme;
- Përmirësimin e trajnimeve të ofruara për shërbyesit civil duke u bazuar në vlerësime adekuate të nivelit të tyre si dhe të nevojave për trajnime;
- Kompletimi i kornizës ligjore dhe operative të RAP-it dhe finalizimi i reformave të kostimit, duke formuar bazën për përcaktimin e fushëveprimit e përgjithshëm e financiar të përkrahjes buxhetore sektoriale;
- Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së konsultimeve publike, në përputhje me Rregulloren për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik;
- Sigurimi i fondeve të mjaftueshme për zbatimin e pakos ligjore për RAP;
- Ngritja e transparencës ndaj publikut përmes avancimit të Portalit për hapjen e të dhënave, ku do të publikohen të dhënat nga institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal.

Vetëqeverisja lokale

E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet me Kushtetutë dhe rregullohet me ligj. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nga organe përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje lokale të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta, dhe me votim të fshehtë. Republika e Kosovës zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, në masën e kërkuar nga vendi nënshkruar. Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, barazisë gjinore, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, me

kujdes të veçantë për nevojat e brengat specifike, përfshirë ato të personave me aftësi të kufizuara si dhe të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Gjendja aktuale

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, edhe më tej ka pabarazi ndërmjet Komunave në performancë dhe ofrimin e shërbimeve, dhe mbikëqyrja efektive e organeve komunale ekzekutive nga ato legjislative mbetet sfidë. Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet Qeverisë dhe Komunave duhet përmirësuar. Sa u përket praktikave të auditimit, është bërë progres drejt mbikëqyrjes më efektive dhe qeverisjes transparente. Komunitat nuk i shfrytëzojnë mjaftueshëm mekanizmat ekzistues të bashkëpunimit ndër-komunal.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: Korniza legjislative për vetëqeverisje lokale përbëhet nga Ligji për Vetëqeverisjen lokale, Ligji për Zgjedhjet Lokale, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë, si dhe UA-të dhe rregulloret e MAPL-së për organizimin dhe funksionimin e Komunave. *Politikat:* Strategjia e Vetëqeverisjes Lokale 2016-2026 vendos politikat prioritare të Qeverisë për avancimin e vetëqeverisjen lokale duke ndërlidhur politikat afatshkurtra me ato afatgjata të MAPL-së dhe sektorëve të tjerë qeveritarë e lokalë për aspektet kryesore të zhvillimit të kësaj fushe. Gjithashtu është duke u zbatuar Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal, që ka për qëllim përmirësimin e mirëqenies ekonomiko-sociale dhe decentralizimit të pushtetit lokal, dhe PV Kombëtar 2023-2025 për Partneritetin për Qeverisje të Hapur. *Institucionet:* institucionet kryesore në fushën e vetëqeverisjes lokale janë Komunitat dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Objektivat prioritare afatmesme:

- Zhvillimi i infrastrukturës socio-ekonomike dhe rritja bashkëpunimi ndër komunal;
- Zgjerimi i infrastrukturës orientuar për komunitete;
- Avancimi i politikave dhe legjislacionit të qeverisjes lokale;
- Thjeshtimi i shërbimeve administrative në nivelin lokal;
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në zhvillimin e politikave lokale;
- Zbatimi i Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar financuar nga IPA.

1.1.3. Avokati i Popullit⁹

Ky kapitull mbulon fushëveprimin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) si institucion i pavarur kushtetues që mbron, mbikëqyr dhe promovon të drejtat dhe liritë e njeriut. Ai përfshin kriteret e procesit të integritetit të Republikës së Kosovës në BE, gjendjen aktuale të përmbushjes së mandatit, sfidat me të cilat përballët IAP dhe planet e prioritetet për të ardhmen.

Gjendja aktuale

IAP ka vazhduar të punojë në përmbushjen e misionit të tij kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Kosovës ndaj veprimeve të autoriteteve publike. Kjo ka ndikuar në ngritjen e besimit të qytetarëve në IAP dhe rritjen e përgjegjshmërisë nga ana e autoriteteve publike sa i përket përmbushjes së obligimeve të tyre kushtetuese dhe ligjore në shërbim të qytetarit.

Sipas konkluzioneve të *NK VI për Drejtësi, Liri dhe Siguri*, institucionet e vendit duhet të sigurojnë monitorim të duhur të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, për të rritur më tej shkallën e zbatimit të tyre. Gjithashtu është finalizuar procesi i përzgjedhjes së zëvendësve të Avokatit të Popullit për funksionalizimin e plotë të këtij institucioni.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: Mandati i Avokatit të Popullit është përcaktuar me Kushtetutë dhe pakon ligjore për të drejtat e njeriut (Ligjin për Avokatin e Popullit, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjin për Barazi Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës). Gjithashtu ka kompetenca të veçanta të përcaktuara me ligje të tjera, si

⁹ Ky kapitull lidhet me Kapitullin 23: *Gjyqësori dhe të drejtat themelore*.

Ligji për mbrojtjen e fëmijës, Ligji për qasje në dokumente publike, Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji për Konfliktet Administrative, Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes, Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, Ligji për Procedurën Kontestimore etj.

Sa i përket përafrimit me *acquis* në këtë fushë, deri më tani janë transpozuar në masë të konsiderueshme (pjesërisht) aktet përkatëse në Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjin për Barazi Gjinore. Dokumenti i *politikave* në këtë kapitull është Strategjia dhe Plan Zhvillimor i IAP-së 2021-2025.

Institucionet: IAP është institucion i pavarur kushtetues që mbron, mbikëqyr dhe promovon të drejtat e liritë e njeriut. Në kuadër të tij funksionon edhe Mekanizimi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, që monitoron vendet ku mbahen persona të privuar nga liria kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave e lirive të njeriut. Ai si udhërrëfyes për punën e tij në përbushjen e misionit ka *Parimet e Parisit*¹⁰ dhe *Parimet e Venedikut*¹¹, si kritere minimale ndërkombëtare për çdo institucion kombëtar për të drejtat e njeriut që të mund të konsiderohet i besueshëm dhe i denjë për të ushtuar mandatin e tij.

Objektivat prioritare afatmesme:

- Mbrojtja dhe mbikëqyrja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përmes ndikimit të shtuar të IAP-së në përbushjen e mandatit të tij;
- Promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- Promovimi i Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ);
- Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore të IAP-së;
- Vazhdimi i përpjekjeve dhe bashkëpunimit e koordinimit institucional në përcjelljen dhe rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë

Ky kapitull mbulon mbikëqyrjen demokratike civile të institucioneve të sigurisë, përkatësisht kontrollin nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes komisioneve parlamentare (Komisionit për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë), Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes. MSA nuk përmban ndonjë dispozitë specifike lidhur me këtë fushë, por Kosova zbaton kërkesa të ndërlidhura të dala nga mekanizmat e të tjerë të aderimit në BE.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: korniza ligjore në këtë fushë përbëhet nga Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes, Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës të plotësuar-ndryshuar dhe në fuqi nga nëntori 2022. Korniza ligjore në këtë fushë është avancuar në vitin 2022 me Ligjin për Policinë Ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjin për Komisionerin Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Kjo fushë rregullohet edhe nga Ligji për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë dhe Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. *Politikat*: dokumenti kryesor i politikave në këtë fushë është Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022-2027. *Institucionet*: sipas legjislacionit relevant, zinxhiri i kontrollit demokratik civil fillon nga Kuvendi (përmes komisioneve përkatëse), Presidenti i Republikës si Komandant Suprem i FSK-së, Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes, funksionet e të cilëve ushtrohen në thirrjen për raportim, emërimin, gradimin dhe mbikëqyrjen e financave. Pra, institucionet përgjegjëse në këtë fushë janë: Presidenti i Republikës, Kuvendi, Komisioni për Mbikëqyrje dhe Qeveria, përkatësisht Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes.

¹⁰ Parimet e Parisit janë kriteret minimale të përcaktuara nga OKB që duhet të ketë një institucion kombëtar për të drejtat e njeriut që të konsiderohet kredibil, i pavarur dhe efektiv në arenën ndërkombëtare.

¹¹ Parimet për Mbrojtjen dhe Promovimin e Institucioneve të Avokatit të Popullit (Parimet e Venedikut), Komisioni i Venedikut, [https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)005-e)

1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare¹²

Në kuadër të kriterëve politike të Kopenhagës, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal janë thelbësore për integrim në BE, pasi që krijojnë klimë të favorshme për stabilitet e integrim politik e ekonomik të rajonit. Në këtë fushë Kosova mbetet e përkushtuar, konstruktive dhe pragmatike për të rritur bashkëpunimin rajonal, me qëllim të forcimit të marrëdhënieve me shtetet fqinje, ngritjes së nivelit të shkëmbimeve të gjithanshme dhe avancimit të bashkëpunimit në fushat e interesit të përbashkët. Kosova gjithashtu mban marrëdhënie të fqinjësisë së mirë dhe është e përkushtuar për zgjerimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat dhe nivelet, bazuar në parimet e respektit të ndërsjellë, barazisë dhe gjithëpërfshirjes, në kuadër të agjendës së integritimit në BE dhe me përfshirjen e drejtpërdrejtë të saj.

Gjendja aktuale

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova përgjithësisht ka marrëdhënie të mira bilaterale me shtetet e tjera aderuese në rajon dhe shtetet fqinje anëtare të BE-së.

Sa u përket marrëdhënieve bilaterale në rajon, Kosova ruan marrëdhënie të ngushta me Shqipërinë, me të cilën zhvillon partneritet strategjik. Të dy shtetet gjithashtu mbajnë rregullisht mbledhje të përbashkëta të Qeverive, kurse në nëntor 2022 është mbajtur takimi i parë i përbashkët i parlamenteve të të dy shteteve.

Marrëdhëniet me Bosnjën dhe Hercegovinën nuk kanë ndryshuar. Kjo e fundit nuk e njeh shtetësinë e Kosovës dhe regjimi të rreptë i vizave ndërmjet dy vendeve mbetet në fuqi, kurse iniciativa për të lehtësuar procedurën e vizave për qytetarët e Kosovës akoma është pezull. Kosova ka ratifikuar Marrëveshjen për Lëvizje të Lirë me Letërnjoftime, e cila ishte nënshkruar në kuadër të Procesit të Berlinit në nëntor 2022. Mirëpo, qytetarët e Kosovës dhe të Bosnjës dhe Hercegovinës akoma nuk mund të përfitojnë nga kjo marrëveshje pasi që BeH nuk e ka ratifikuar atë. Kosova bën thirrje që marrëveshja e nënshkruar të ratifikohet dhe qytetarët të fillojnë të përfitojnë nga ajo.

Kosova ka marrëdhënie të mira me Malin e Zi, të cilat janë përmirësuar me vizitën zyrtare të Presidentes së Kosovës në Mal të Zi, në shkurt 2023, dhe vizitën e Kryeministrit të Malit të Zi në Prishtinë, në prill 2023. Kosova gjithashtu ka marrëdhënie të mira me Maqedoninë e Veriut. Kosova ka marrëdhënie të mira edhe me Turqinë, përfshirë në sektorin politik, ekonomik dhe atë kulturor. Kosova ka dërguar 36 pjesëtarë të FSK-së në Turqi gjatë intervenimit humanitar pas tërmetit të 6 shkurtit 2023.

Sa i përket normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, Republika e Kosovës është e përkushtuar të kontribuojë në mënyrë konstruktive në krijimin e kushteve të domosdoshme për zbatim të marrëveshjes së 27 shkurtit, së bashku me aneksin e miratuar me 18 mars 2023, me synim ndërtimin e marrëdhënieve fqinjësore dhe përfundimin e procesit të anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Kosova është e interesuar që sa më shpejt të përmyllet zbatimi i marrëveshjes së fundit për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, dhe të punohet drejt një të ardhmeje të qartë të anëtarësimit në BE.

Kosova është dëshmuar se është partner kredibil, konstruktiv dhe kontribuues në kuadër të organizatave dhe iniciativave rajonale. Sfidë për Kosovën mbetet përfaqësimi i barabartë dhe pa diskriminime të nivele të ndryshme në këto organizata dhe iniciativa. Kosova synon që të udhëheqë me të paktën një organizatë/iniciativë rajonale. Shpërndarja momentale e pozitave udhëheqëse në mes të shteteve anëtare nuk është e balancuar dhe Kosova synon që këtë çështje ta ngritë edhe me shtetet e tjera të rajonit.

Korniza ligjore, e politikave dhe ajo institucionale: Ligji kryesor në këtë fushë është Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, ndërsa lidhur me personat e pagjetur është në fuqi Ligji nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur. *Politikat shtetërore* në këtë fushë janë paraparë në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, përkatësisht në kapitullin për politikën e jashtme dhe diasporën. *Institucionet* përgjegjëse në këtë fushë janë MPJD dhe ZKM, kjo e fundit përgjegjëse për dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, Tregun e Përbashkët Rajonal (TPR/CRM) dhe Procesin e Berlinit.

¹² Ky kapitull lidhet me *Kapitullin 31: Politika e jashtme, e mbrojtjes dhe e sigurisë*.

2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE

2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Plotësimi i kriterëve ekonomike për anëtarësim në BE bazohet në kërkesat që dalin nga konkluzionet e Këshillit Evropian të vitit 1993, ose Kriteret e Kopenhagës. Ekonomia funksionale e tregut është kriteri i parë ekonomik i Kopenhagës, i cili përfshin:

- Ekzistimin e një konsensusi të gjerë për politikën thelbësore ekonomike;
- Arritjen e stabilitetit makroekonomik, përfshirë stabilitetin dhe qëndrueshmërinë adekuate të çmimeve në aspektin e financave publike dhe bilancit të jashtëm të pagesave;
- Ndërveprimin e lirë të forcave të tregut bazuar në mekanizmat e ofertës dhe kërkesës, përfshirë vendosjen e çmimeve dhe liberalizimin e tregtisë;
- Eliminimin e barrierave thelbësore ndaj inputit dhe outputit në treg (për ngritjen e ndërmarrjeve të reja ose falimentimin e atyre ekzistuese);
- Ekzistimin e një sistemi ligjor, përfshirë rregullimin e të drejtave pronësore dhe zbatimin e ligjeve dhe kontratave;
- Një sektor financiar të zhvilluar mjaftueshëm për të kanalizuar kursimet në investime produktive.

Kriteret e Mastrohtit, ose kriteret ekonomike të konvergencës, kanë të bëjnë me integrimin monetar në Eurozonë, ndërsa vendet që synojnë të adoptojnë monedhën e përbashkët Euro duhet të plotësojnë tregues të shumtë ekonomikë që matin: stabilitetin e çmimeve (IÇK); qëndrueshmërinë dhe përshtatshmërinë e financave publike, nëpërmjet kufizimit të deficitit buxhetor (në 3% të BPV-së) dhe borxhit të qeverisë në raport me BPV-në; stabilitetin në normat afatgjata të interesit; dhe stabilitetin në kursin e këmbimit.

Bazuar në konkluzionet e Këshillit, KE kohëve të ka filluar me në qasje të re, të ngjashme me instrumentet e mekanizmat e përdorur në shtetet anëtare, për të promovuar zhvillimin ekonomik e politik në Kosovë. Në këtë kontekst, Strategjia e Zgjerimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor bazohet në tri shtylla, njëra prej të cilave është qeverisja ekonomike. Një nga instrumentet kryesore për forcimin e qeverisjes ekonomike është dialogu i politikave me BE-në, përfshirë Programin për Reforma në Ekonomi (PRE). Ngjashëm, metodologjia e re e zgjerimit vendos gjashtë grupime të kapitujve të negociatave të anëtarësimit. Kriteret ekonomike janë pjesë e grupimit të parë, për reformat themelore (qasja 'së pari bazat'), së bashku me sundimin e ligjit dhe RAP. KE monitoron progresin në qeverisjen ekonomike bazuar në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve ekonomike dhe mekanizmin e PRE-së. Për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, PRE-të janë bazë për udhëzimet e politikave të KE-së të cilat miratohen në nivel ministrash për vendet e BP dhe Turqinë.

Gjendja aktuale

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova është në fazë të hershme dhe ka arritur progres të pjesshëm në zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut. Sipas KE-së, përkundër qëndrueshmërisë që ka treguar ekonomia gjatë pandemisë dhe ballafaqimit me pasojat e pushtimit të Ukrainës nga Rusia, sfidat afatgjatë strukturore, si shkalla e lartë e ekonomisë joformale, korrupsioni dhe përgjithësisht sundimi i dobët i ligjit, vazhdojnë të pengojnë sektorin privat. Sektori financiar ka mbetur stabil dhe kreditimi ka vazhduar të zgjerohet. Sipas tij, ndonëse rimëkëmbja ekonomike ka krijuar vende të reja pune, mungesa e të dhënave pengon një vlerësim të duhur të gjendjes së tregut të punës. Për të përmirësuar funksionimin e ekonomisë së tregut, BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Lehtësimin e ndikimit të krizës energjetike përmes masave të mbështetjes së përkohshme me objektiva të qartë nëse duhet, duke qëndruar brenda rregullave fiskale për të mbajtur deficitin tavan brenda kufijve prej 2% të BPV;
- Përgatitjen e një rishikimi të sistemit të sigurimeve sociale, përfshirë pensionet e veteranëve të luftës, me qëllim të përmirësimit të ekonomizimit dhe drejtësisë së skemave të sigurimeve sociale, dhe rishikimin e shpenzimeve tatimore, duke përcaktuar masën e të ardhurave të pritshme nga të gjitha përjashtimet dhe tarifën e reduktuar;
- Përmirësimin e cilësisë së shpenzimeve publike përmes reformimit të sistemit të sigurimit shoqëror dhe adresimit të dobësive në menaxhimin e investimeve publike;

- Zbatimin e masave relevante për përmirësimin e mjedisit afarist, me fokus në luftimin e ekonomisë jo formale dhe thjeshtësimin dhe digjitalizimin e lejeve e licencave.

Më tej, në konkluzionet e *NK për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika* janë identifikuar çështjet që kërkojnë vëmendje, si stabiliteti makro-fiskal, përgatitja e buxhetit 2023 bazuar në supozime realiste, zbatimi i PRE, transparenca e shpenzimeve publike, përmirësimi i ekzekutimit të shpenzimeve kapitale dhe përmbajtja nga miratimi i iniciativave të reja pensionale dhe sociale, në harmoni me rekomandimet në udhëzimet e PRE. Në sektorin financiar, rekomandohet miratimi dhe zbatimi i Ligjit për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe Ligjit për Bankat, si dhe zbatimi i rekomandimeve të analizës së thellë për staf dhe kompetenca për politika kyçe, në veçanti lidhur me funksionet për stabilitetin financiar. Lidhur me mjedisin afarist, reformat strukturore dhe zhvillimin e sektorit privat, kërkohet ristrukturimi i KIESA-s, miratimi i legjislacionit për investimet e qëndrueshme, vazhdimi i reformës për qasjen në financa dhe zgjerimi i garantimit të kredive, miratimi dhe zbatimi i Strategjisë dhe PV për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare, si dhe vazhdimi i digjitalizimit e thjeshtëzimit të lejeve e licencave.

Stabiliteti makroekonomik

Viti 2022 u karakterizua me një rritje të qëndrueshme ekonomike prej 4.3% në terma real dhe 12.3% në terma nominal, ndërsa inflacioni arriti në 11.6%. Sipas të dhënave nga ASK, rritja e aktivitetit ekonomik ka vazhduar edhe në pjesën e parë të vitit 2023. Kjo rritje u ndikua kryesisht nga konsumi i cili shënoi rritje prej 2.2% në terma realë dhe kontribuoi me 2.35 p.p. në rritjen e BPV-së.

Investimet totale (private dhe publike) në gjashtëmujorin e parë të 2023-ës u rritën me 1.6% krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2022, duke dhënë një kontribut pozitiv prej 0.6 p.p në rritjen e BPV-së, në masë të konsiderueshme edhe për shkak të efektit bazë.

Në anën tjetër, eksportet neto në gjashtëmujorin e parë të 2023-së mbajtën nivelin e njëjtë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Përderisa eksportet e mallrave shënuan një rënie reale prej 6.6%, dhe kontribut negativ prej 0.8 p.p eksportet e shërbimeve u rritën për 18.3% në terma realë dhe me kontribut në rritje prej 4.0 p.p.

Importi i mallrave shënoi rritje prej 1.6% dhe kontribut prej 1 p.p, ndërsa importi i shërbimeve shënoi rritje prej 19.7% dhe me kontribut prej 2.3 p.p.

Inflacioni – indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit u rrit mesatarisht me 5% në vitin 2023, duke shfaqur një prirje të fortë rënëse. Kategoritë që kishin më së shumti rritje ishin ushqimi dhe pijet joalkoolike me rritje prej 10.3%, kategoria “Furnizimi, pajisjet e ekonomive shtëpiake dhe mirëmbajtja rutinë e shtëpive” me rritje prej 8.2%, kategoria “Strehimi, uji, rryma, gazi dhe derivatet tjera” me rritje prej 7.3%, ndërsa kategoria “transporti” shënoi rënie prej 2.0%, duke reflektuar uljen e çmimeve ndërkombëtare të naftës gjatë kësaj periudhe.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse gjatë periudhës janar-korrik 2023 shënoi vlerën prej €-450.2 milionë, një zbutje e ndjeshme prej rreth 23.0% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Tregtia e mallrave edhe gjatë vitit 2023 pasqyroi efektet e rritjes së çmimeve. Deficiti tregtar i mallrave gjatë kësaj periudhe vazhdoi zgjerimin me rreth 3.8%, ndërsa suficiti i shërbimeve shënoi rritje vjetore prej 24.9%.

Eksporti i mallrave shënoi rënie prej 6.2% në vitin 2023, ndërsa eksporti i shërbimeve shënoi një rritje vjetore prej 20.7% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje erdhi kryesisht nga rritja e shërbimeve të udhëtimit me kontribut 12.6 p.p., shërbimeve kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit me 4.2 p.p. dhe shërbimet tjera të biznesit me kontribut 1.8 p.p.

Importi i mallrave shënoi një rritje prej 2.0% krahasuar me vitin e kaluar, ndikuar kryesisht nga kategoria ‘mjetet e transportit’ 3.1 p.p., importin e tekstilit dhe artikujt e tij, me kontribut 1.6 p.p. dhe importin e makinerive, veglat, pajisjeve elektrike, me 1.1 p.p., e kundërvepruar nga kontributi negativ i kategorisë ‘produkte minerale’, me 4.4 p.p., dhe kategoria ‘plastika, goma dhe artikujt e tyre’, me kontribut negativ

prej 1.3 p.p. Importi i shërbimeve shënoi rritje prej 16.1%, shtyrë kryesisht nga një rritje e theksuar në importin e shërbimeve të udhëtimit, me kontribut 14.1 p.p., dhe kategoria ‘shërbimet kompjuterike informative dhe të telekomunikacionit’, me 2.9 p.p.

Bilanci i të ardhurave parësore gjatë periudhës Janar-korrik 2023 shënoi rënie prej 24.6% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ndërkaq bilanci nga të ardhurat dytësore kishte një rritje vjetore prej 7.4% për periudhën e njëjtë.

Zhvillimet e këtij viti dhe vitit të kaluar në aktivitetin ekonomik janë pasqyruar edhe në tregun e punës.

Kredia bankare ka vazhduar të jetë një burim i qëndrueshëm financimi për ekonominë. Në fund të muajit gusht 2023, stoku i kredive arriti vlerën prej rreth €4.7 miliardë, duke shënuar kështu një rritje prej 13.2% në krahasim me vitin paraprak. Stoku i kredive të korporatave është rritur me 11.1%, ndërsa stoku i kredive të ekonomive familjare me 16.9%.

Depozitat vazhduan rritjen e tyre, me kontribut kryesor nga ekonomitë familjare. Në fund të muajit gusht 2023, stoku i depozitave totale arriti vlerën prej rreth €5.8 miliardë, duke shënuar kështu një rritje vjetore prej 12.2%. Stoku i depozitave të korporatave u rrit për 17.6% ndërsa ai i ekonomive familjare me 9.8%. Sa i përket llojit të depozitave, depozitat e transferueshme shënuan rritje vjetore prej 6.6% dhe kontribuuan në rritjen e depozitave totale me 4.4 p.p. Niveli i kredive joperformuese (KJP) ka arritur në 2.0% në fund të gushtit 2023, një përmirësim i lehtë nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Mesatarja e normës së peshuar të interesit të kredive gjatë periudhës janar-gusht 2023 ishte 6.7%, ose me rreth 0.7 p.p. më e lartë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Më tej, mesatarja e peshuar e normës së interesit në depozita është sjellë mesatarisht rreth vlerës 2.5%, nga 1.8% sa ishte mesatarja gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Sa i përket borxhit shtetëror, korniza ligjore për menaxhimin e borxhit shtetëror konsiston në Ligjin 08/L-099 për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, miratuar më 20 dhjetor 2022. Ai i jep të drejtë Republikës së Kosovës për të marrë hua, për të dhënë garanci për hua, për të paguar shpenzimet për marrjen e borxhit dhe për të paguar kryegjënë dhe interesin e Borxheve të saja Shtetërore. Për më tepër, përderisa nuk rregullohet ndryshe me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, sipas tij shuma e papaguar e borxhit të përgjithshëm në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë 40% të BPV. Si rrjedhojë e pandemisë COVID-19, Qeveria vendosi të ndryshojë rregullin fiskal, deficiti fiskal si përqindje e BPV-së është ndryshuar përkohësisht nga 2% në 6.5% dhe bilanci bankar si përqindje e BPV-së nga 4.5% në 3%.

Portofoli i përgjithshëm i borxhit përbëhet nga borxhi i brendshëm dhe ai i jashtëm. Sipas tabelës së mëposhtme, borxhi shtetëror deri më 30 shtator 2023 është afërsisht €1.621 miliardë, që përfaqëson 16.76% të BPV-së (përfshirë garancitë e Qeverisë). Nga shuma e përgjithshme e borxhit shtetëror, €655.68 milionë janë borxh i jashtëm.

Tabela 1. Gjithsej borxhi i Qeverisë (në milionë € dhe si përqindje e BPV-së)

	2018	2019	2020	2021	2022	janar - shtator 2023
Borxhi i jashtëm	416.43	409.10	525.80	576.75	641.20	655.68
Borxhi i brendshëm	676.62	791.94	961.90	1,106.14	1,112.00	965.10
Borxhi shtetëror	1,093.05	1,201.05	1,487.69	1,682.89	1,753.20	1,620.78
Garancitë shtetërore	43.70	42.68	31.65	30.63	29.61	28.59
Borxhi dhe garancitë shtetërore (% e BPV-së)	17.04%	17.63%	22.44%	21.53%	19.95%	16.76%

Nga viti 2021 ka pasur një rënie të nivelit të përgjithshëm të borxhit si përqindje e BPV-së.

Të dhënat për periudhën janar-shtator 2023 tregojnë se të hyrat dhe shpenzimet buxhetore shënuan rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Më konkretisht, të hyrat buxhetore arritën vlerën prej €2,114.7 milionë, duke shënuar një rritje prej 14.3% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Në anën tjetër shpenzimet buxhetore arritën vlerën prej €1,826.3 milionë, duke u rritur për 15.2%. Megjithatë, të hyrat arritën një normë më të lartë të realizimit se sa shpenzimet krahasuar me projeksionet në fillim të vitit. Marr parasysh rrjedhën e të hyrave dhe shpenzimeve, bilanci përgjithshëm buxhetor shënoi suficit prej €288.4 milionë për këtë periudhë.

Të hyrat nga tatimet direkte shënuan një rritje prej rreth 19.8% në terma vjetorë për periudhën janar-shtator 2023, duke arritur vlerën prej €376.1 milionë. Kjo rritje u realizua, mes tjerash, edhe si rezultat i rritjes së numrit të të punësuarave në sektorin privat. Sipas kategorive të të hyrave direkte, të hyrat nga tatimi në të ardhurat personale shënuan rritje me rreth 19.3% krahasuar me periudhën paraprahe, ndërkaq tatimi në të ardhurat e korporatave u rrit për 15.6%. Vlen të theksohet se tatimi në pronë, pas rivlerësimit të fundit, shënoi rritjen më të lartë nga kategoritë e tatimeve direkte me një normë prej 46.8%.

Të hyrat nga tatimet indirekte kanë shënuar rritje të theksuar, pasi që ndërlidhen drejtpërdrejtë me rritjen e vlerës të importit të mallrave. Sipas të dhënave nga DK, për periudhën janar-shtator 2023 importi i rregullt shënoi rritje prej 2.5%. Të hyrat nga tatimet indirekte gjatë kësaj periudhe shënuan rritje prej 9.4% krahasuar me periudhën janar-shtator 2022, duke arritur vlerën prej €1,506.7 milionë. Përderisa të hyrat nga detyrimi doganor u rritën me një normë vjetore prej 15.7%, rritja vjetore e të hyrave nga TVSH-ja kufitare ishte 6.5% për periudhën janar-shtator 2023. Trend rritës shënoi edhe akciza si një ndër kontribuuesit më të mëdhenj të të hyrave indirekte, duke u rritur me një normë prej 5.5% për periudhën raportuese.

Të hyrat jo-tatimore gjatë kësaj periudhe arritën vlerën prej €197.4 milionë, apo një rritje prej 4.2% në terma vjetorë. Rritjen më të lartë nga kategoritë e të hyrave jo-tatimore e shënoi taksa koncesionare me rreth 39.3% kjo për shkak të trendit rritës të numrit të udhëtareve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Nga analiza e të hyrave jo-tatimore sipas niveleve të qeverisjes vërejmë se përderisa niveli lokal shënoi rritje prej 19.1%, niveli qendror u karakterizua me rënie prej 3.0% të të hyrave jo-tatimore.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, të gjitha kategoritë patën kontribut pozitiv në rritjen e tyre për periudhën janar-shtator 2023. Kategoria e pagave dhe shtesave ka shënuar një rritje vjetore prej 18.5% krahasuar me vitin e kaluar për shkak të implementimit të ligjit të ri për pagat në sektorin publik nga muaji shkurt 2023. Rritje dyshifrore (17.7%) shënuan edhe shpenzimet për mallra dhe shërbime duke arritur vlerën €257.2 milionë, apo 38.8 më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Në anën tjetër, subvencionet dhe transferet nuk u karakterizuan me ndonjë lëvizje të konsiderueshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Kjo për shkak të rritjes së lartë në vitin e kaluar edhe nga implementimi i masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, të cilat kanë vazhduar implementimin edhe për periudhën janar-shtator 2023. Struktura e shpenzimeve të pakos së ringjalljes vazhdon të dominohet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve edhe për periudhën raportuese.

Shpenzimet kapitale në periudhën janar-shtator 2023 shënuan rritje të konsiderueshme prej 66.9% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Vlen të theksohet se një pjesë e kësaj rritjeje mund t'i atribuohet efektit bazë, pasi që në të njëjtën periudhë të vitit 2022, shpenzimet kapitale ishin ulur me rreth 28.7%. Struktura e financimit të shpenzimeve kapitale për periudhën janar-shtator 2023 dominohet nga buxheti i rregullt me rreth 82.6%, pasuar nga të hyrat vetanake (13.6%), huamarrja e jashtme financuar nga klauzola e investimeve (3.2%), dhe huamarrja e jashtme e rregullt (0.7%).

Shpenzimet e interesit gjatë periudhës janar-shtator arritën vlerën prej €32.9 milionë, duke shënuar një rritje vjetore prej 21.0%. Shpenzimet tatimore, janë mjete alternative fiskale që ofrojnë lehtësime tatimore ose stimuj për individë dhe biznese për qëllime të caktuara, që zakonisht kanë ndikim substancial buxhetor. Momentalisht, po vlerësohen shpenzimet tatimore duke përdorur metodën e "*të ardhurave të humbura*", me një fokus të veçantë tek lirimet doganore për prodhuesit vendorë në Kosovë. Këto lirime përfshijnë:

- Lirimin nga tatimi i Akcizës për importin e burimeve të energjisë për qëllime të prodhimit;
- Lirimet nga detyrimet doganore për importin e produkteve specifike (lëndë të para, gjysmë produkte, pajisje IT, etj.).

Në vitin 2021, shpenzimet tatimore kishin vlerën e €151.06 milionë, paraqitur në tabelën 2, një rritje prej 56.90% krahasuar me vitin 2020, që reflekton rimëkëmbjen ekonomike pas pandemisë globale. Në vitin 2022 shpenzimet tatimore u shënuan në €151.06 milionë, rritje prej 6.51%, tregues i stabilitetit dhe konsolidimit në sektorin e prodhimit vendor lokal. Gjatë një periudhe 5-vjeçare nga viti 2018 deri në vitin 2022, humbjet kumulative të të ardhurave nga këto shpenzime tatimore arritën në €520.6 milionë, që përfaqëson rreth 20% të të ardhurave totale të buxhetit për vitin 2022 ose një humbje mesatare buxhetore

vjetore prej rreth 4.17%. Këto shifra theksojnë ndikimin e konsiderueshëm të këtyre shpenzimeve tatimore në buxhetin e shtetit.

Tabela 2. Shpenzimet tatimore nga lirimet doganore për prodhuesit vendorë, në milionë euro

	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
Lirim Doganë	9.3	8.02	6.78	17.54	17.59	59.23
Lirim Akcizë	11.7	10.24	12.4	11.63	8.11	54.08
Lirim TVSH	53.3	55.39	61.17	112.06	125.36	407.28
Total Lirime	74.3	73.65	80.35	141.23	151.06	520.59

Burimi: Dogana e Kosovës; Kalkulimet: DPFTF

Funksionimi i tregut të punës

Të dhënat e punësimit të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ofrojnë informacione vetëm deri në vitin 2022. Në bazë të këtyre të dhënave, shkalla e papunësisë në vitin 2022 kishte një mesatare prej 12.6% (në krahasim me 20.7% sa ishte në vitin paraprak), ndërsa shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore kishte një mesatare prej 38.6% (në krahasim me 39.3% sa ishte në vitin 2021).

Pasi që të dhënat zyrtare të ASK-së për tregun e punës janë deri në fund të vitit 2022, në këtë pjesë paraqiten edhe të dhënat e ATK-së, të cilat janë të dhëna administrative mbi tregun e punës. Sipas këtyre të dhënave të agreguara për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, një mesatare prej 403,476 personash ishin të punësuar që paraqet një rritje vjetore prej rreth 4.3%.

Niveli i lartë i ekonomisë joformale vazhdon të mbetet një ndër sfidat kryesore të Qeverisë. Një ndër dokumentet kryesore në këtë fushë është Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2024-2028, e cila është në fazat e fundit të hartimit. Kjo Strategji paraqet vizionin dhe objektivat strategjike e specifike të Qeverisë së Republikës së Kosovës për të luftuar ekonominë joformale në përgjithësi dhe parandaluar shfaqjet ekstreme të veprimeve ilegale që favorizohen nga ekonomia joformale dhe kanë pasoja për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe kohezionit shoqëror, si korrupsioni, pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit etj. Në kuadër të Strategjisë është përgatitur edhe PV 2024-2026, i cili përfshin aktivitetet që duhen të zbatohen nga institucionet përgjegjëse me qëllim të luftimit të këtyre fenomeneve.

Strategjia paraprake, e periudhës 2019-2023, ka pasur ndikim pozitiv në parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, duke rezultuar me rritje të vazhdueshme të të hyrave tatimore dhe formalizim të ekonomisë dhe tregut të punës.

Sa i përket vlerësimit të ekonomisë joformale në tregun e punës/punësimit joformal, ASK në kuadër të Projektit IPA 2017 *Metodologjia e Llogarive Kombëtare* ka zbatuar metodologjinë ndërkombëtare të Eurostatit për vlerësimin e ekonomisë joformale sipas Metodës së Inputit të Punës, e cila është zbatuar për periudhën 2017-2019 sipas aktiviteteve ekonomike. Megjithatë, ka rezultuar se ka mospërputhje ndërmjet të dhënave të ATK-së dhe Anketës së Fuqisë Punëtore, pasi që nuk ka qenë e mundur të përpilohen të dhënat për të gjitha aktivitetet ekonomike. Prandaj ASK ka kërkuar mbështetje teknike nga Zyra Çeke e Statistikave për vazhdimin e përpilimit të këtyre të dhënave.

ASK në tri vitet e fundit ka zbatuar metodologjinë ndërkombëtare edhe për komponentët në vijim:

- Vlerësimi i ekonomisë joformale në bazë të auditimit fiskal 2017-2019;
- Vlerësimi i trafikimit të drogës 2017-2019;
- N1 – prodhuesit që nuk regjistrohen qëllimisht për personat e vetëpunësuar për periudhën 2011-2023;
- N6 – prodhuesit që keq-raportojnë qëllimisht për personat e vetëpunësuar 2011-2023;
- Vlerësimi i ekonomisë joformale në sektorin e shëndetësisë 2019-2021, në proces.

Tabela 3. Të punësuar dhe raporti punësim ndaj popullsisë - shkalla e punësimit, sipas gjinisë dhe grup-moshës

Kosovë	2020			2021			2022		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PUNËSIMI (NË MIJËRA)									
15-24	28.113	10.296	38.409	31.183	12.664	43.847	32.054	14.062	46.116
25-34	65.864	23.442	89.306	70.720	29.711	100.431	74.493	32.159	106.652
35-44	58.071	22.832	80.903	64.448	24.723	89.171	69.671	27.893	97.564
45-54	62.996	18.801	81.797	67.689	21.772	89.461	70.275	23.043	93.318
55-64	45.548	11.109	56.656	47.411	12.983	60.394	46.792	13.371	60.163
15-64	260.591	86.480	347.072	281.451	101.853	383.304	293.285	110.528	403.813
Raporti punësim ndaj popullsisë (%)									
15-24	16.1	6.4	11.4	18.4	8.0	13.4	20.8	9.7	15.4
25-34	47.9	19.2	34.4	52.3	24.1	38.8	56.3	26.5	42.1
35-44	58.7	20.3	38.2	61.9	21.2	40.4	67.0	24.5	44.8
45-54	58.2	15.3	35.3	59.6	17.6	37.7	62.1	18.6	39.3
55-64	51.1	11.8	30.9	51.8	13.5	32.1	52.2	13.7	32.1
15-64	42.8	14.1	28.4	45.9	16.5	31.1	49.4	18.4	33.8
Kosovë	2020			2021			2022		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
PAPUNËSIA (NË MIJËRA)									
15-24	23.232	13.782	37.013	15.868	11.000	26.868	7.338	5.204	12.542
25-34	24.595	16.273	40.868	22.745	12.413	35.158	13.975	7.766	21.741
35-44	13.980	6.331	20.311	12.350	6.285	18.635	7.500	4.624	12.124
45-54	12.878	4.124	17.002	11.104	3.350	14.454	5.433	3.035	8.468
55-64	5.488	0.697	6.185	4.087	0.959	5.046	1.938	1.268	3.206
15-64	80.173	41.206	121.379	66.154	34.007	100.161	36.184	21.897	58.081
SHKALLA E PAPUNËSISË (%)									
15-24	45.2	57.2	49.1	33.7	46.5	38.0	18.6	27.0	21.4
25-34	27.2	41.0	31.4	24.3	29.5	25.9	15.8	19.5	16.9
35-44	19.4	21.7	20.1	16.1	20.3	17.3	9.7	14.2	11.1
45-54	17.0	18.0	17.2	14.1	13.3	13.9	7.2	11.6	8.3
55-64	10.8	5.9	9.8	7.9	6.9	7.7	4.0	8.7	5.1
15-64	23.5	32.3	25.9	19.0	25.0	20.7	11.0	16.5	12.6

Zhvillimet dhe trendët në tregun e punës

Sipas të dhënave administrative për kontributet e pensioneve, punësimi formal është rritur për 4,9% krahasuar me vitin 2021. Në të njëjtën kohë, në dhjetor 2022 është ulur për 1.5% numri i punëkërkuessve të regjistruar nga dhjetori 2021. Zhvillime pozitive janë vërejtur në rënien e ndjeshme të papunësisë nga 20.7% në vitin 2020, në 11.8% në vitin 2022. Megjithatë shkalla e inaktivitetit - veçanërisht në mesin e grave (78%), mbetet tejet e lartë me 61.4%. Të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore dokumentojnë një trend në rritje të shkallës së punësimit krahasuar me vitet e kaluar. Të dhënat e AFP-së tregojnë gjithashtu se tregu i punës vazhdon të karakterizohet nga disbalanca të konsiderueshme gjinore në punësim (një normë punësimi 49,4% për meshkujt dhe 18,4% për femrat në 2022) dhe për pasivitetin (78% për femrat dhe 44,5% meshkujt).

Fuqia punëtore në Kosovë ka probleme edhe me shkallën e shkathtësive dhe kompatibilitetin me tregun e punës. Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, statistikat tregojnë një kalueshmëri shumë të vështirë nga shkolla në punësim. Ekonomia është kryesisht e bazuar në shërbime hoteliere, bujqësi, tregti dhe ndërtim. Papunësia e të rinjve mbetet e lartë (21.4%), ndonëse në trendin e rënies së papunësisë e njëjta ka pësuar një rënie nga vitet paraprake. Presionet demografike, modeli i rritjes së papunësisë, prirja drejt emigrimit dhe arsimimi i dobët janë faktorët kyç në pozitën e pasigurt të të rinjve. Një publikim i fundit sipas raportit të KE-së, tregon se nga viti 2018 ka pasur ndryshime të dukshme në kategoritë e të rinjve që nuk janë të përfshirë në punësim, arsim apo trajnim, për sa i përket arritjeve arsimore. Normat për ata me arsim fillor ishin nën 30%, normat e të rinjve me arsim të mesëm u rritën, me një ritëm të moderuar, në pak më shumë se 40%, ndërsa normat për të rinjtë me arsim universitar u rritën nga rreth 30% në mbi 50%.

Sfidë në tregun e punës mbetet harmonizimi i ofertës dhe kërkesës në tregun e punës gjegjësisht mospërputhja e shkathtësive profesionale në tregun e punës. Oferta është disproporcionalisht më e lartë se sa kërkesa në tregun e punës që shpie në numër të lartë të të papunëve dhe personave jo-aktiv. Situa

evidentohet edhe kur merren parasysh studimet të cilat paraqesin një situatë ku punëdhënësit shprehin se kanë vështirësi në gjetjen e punëtorëve. Nga ana e punëdhënësit, rreth 50% e firmave raportojnë se arsimit dhe aftësimi profesional nuk i përgatit nxënësit në mënyrë adekuate për vendin e punës, qoftë në drejtim të njohurive të përditësuara apo shkathtësive të buta (Banka Botërore, 2019). Sipas sondazhit STEP, 75% e kompanive kanë hasur në vështirësi në punësimin e menaxherëve, profesionistëve dhe teknikëve.

Punësimi i të rinjve do të përkrahët përmes zbatimit të Skemës për Garantimin e Punësimit të të Rinjve, si politikë strukturore ndërministrorë me synim luftimin e inaktivitetit dhe papunësinë tek ky grup. Përveç kësaj, Qeveria synon të vazhdojë punësimin e të rinjve përmes platformës 'Superpuna' dhe Programit 'Kosovo Generation Unlimited', me afro 11,000 përfitues deri tani. Efektiviteti i masave aktive të tregut të punës synohet të përmirësohet përmes ndryshimeve rregullative. Shërbimet publike të punësimit dhe arsimit e aftësimit profesional do të përmirësohen përmes rishikimit të politikave, me synim ngritjen e efektshmërisë së masave aktive të tregut të punës dhe shërbimeve të punësimit. Për më tepër, është duke u pilotuar nën-kontraktimi i programeve të arsimit dhe aftësimit profesional përmes ofruesve privatë, ndërsa gjithashtu janë duke u rishikuar kurrikulat ekzistuese dhe duke u hartuar të reja në harmoni me kërkesat e tregut të punës. Qeveria është duke ndërmarrë veprime për ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të përfshira në fushën e punësimit përmes instrumenteve të ndryshme të politikave. Ngjashëm, Qeveria ka zbatuar masa me fokus të veçantë punësimin, përfshirë incentivizimin e punësimit në mesin e grupeve të cenueshme.

Sa u përket zhvillimeve të fundit të kornizës legjislative dhe strategjike, është miratuar nga Qeveria koncepti dokumenti për rregullimin e kornizës ligjore të fushës së punësimit. Bazuar në analizat të kryera nga ky Koncept Dokument, opsioni që adreson problemet përkatëse në fushën e shërbimeve të punësimit dhe politikave aktive të tregut të punës është hartimi i projektligjit për rregullimin e fushës së punësimit dhe akteve nënligjore përcjellëse në këtë fushë, duke zëvendësuar dhe përditësuar në tërësi kuadrin ligjor në këtë fushë. Ministria ka filluar hartimin e Ligjit të ri për promovimin e punësimit.

Në kohën e përgatitjes së këtij dokumenti është finalizuar Strategjia e Punësimit dhe Tregut të Punës 2023-2028. Ai është dokument ndër-institucional dhe ndër-sektorial i hartuar në përputhje me Konventën e ILO-së për Politikën Nacionale të Punësimit që adreson problemet thelbësore të tregut të punës në Kosovë.

Sa i përket luftimit të joformalitetit, një ndër dokumentet kryesore është Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2024-2028. Strategjia është në fazat e fundit të miratimit dhe paraqet vizionin dhe objektivat strategjike dhe specifike të Qeverisë së Kosovës për të luftuar ekonominë joformale në përgjithësi dhe parandaluar shfaqjet ekstreme të veprimeve ilegale që favorizohen nga ekonomia joformale dhe kanë pasoja për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe kohezionit shoqëror, si korrupsioni, radikalizmi e ekstremizmi i dhunshëm, pastrimi i parave e financimi i terrorizmit. Në kuadër të Strategjisë është hartuar edhe Plani i Veprimit nga të gjitha institucionet relevante kyçe të përfshira.

Funksionimi i tregut të produkteve

Mjedisi afarist, sistemi gjyqësor dhe kapacitetet administrative

Republika e Kosovës ka vazhduar me reformat në funksion të një mjedisi afarist të favorshëm për të themeluar biznese dhe operuar në treg.

Ligji nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare përcakton llojet e shoqërive tregtare përmes së cilave mund të zhvillohen veprimtaritë ekonomike në Kosovë, subjekteve të tjera që kërkohet të regjistrohen në ARBK, organizimin, kompetencat dhe funksionet e ARBK-së, kërkesat, kushtet dhe procedurat e regjistrimit dhe çregjistrimit për të gjitha llojet e shoqërive tregtare, organizimin e shoqërive tregtare dhe të drejtat e detyrimit e aksionarëve, përfaqësuesve të autorizuar, pronarëve, drejtorëve, menaxherëve dhe palëve të treta në lidhje me shoqëritë tregtare. Ky ligj përmirëson të bërit biznes në Kosovë duke lehtësuar procedurat për regjistrim të bizneseve, dhe përcakton qartë të gjitha kompetencat dhe funksionet e ARBK-së. Nevojitet harmonizim i mëtejshëm i këtij ligji me legjislacionin e BE-së, veçanërisht në lidhje me kërkesat minimale

të kapitalit, përvetësimin e kompanive, bashkimet ndërkufitare dhe kërkesat e zbulimit të kompanive dhe degëve të huaja, si dhe Direktivat e BE-së për përdorimin e mjeteve digjitale dhe operacionet ndërkufitare.

Sa i përket *kornizës institucionale*, institucioni bartës për këtë fushë është ARBK në MINT. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Investime të Qëndrueshme, kjo strukturë institucionale pritet të pësojë ndryshime pasi që funksionet e investimeve të jashtme do të kalojnë në një agjenci të re në kuadër të ZKM-së. ARBK kryen regjistrimin e të gjitha shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, në përputhje me Ligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare. ARBK ofron informata dhe bashkëpunon me ASK-në, ATK-në, DK-në, PK-në dhe agjenci të tjera. Më tej, ajo regjistron të gjitha bizneset e reja, modifikimet e të dhënave të biznesit, mbylljen e bizneseve, lëshimin e certifikatës së regjistrimit me numër fiskal e certifikatës së TVSh-së, certifikatës së import-eksportit, si dhe ofron informata dhe formularë falas.

Sa u përket *politikave* dhe reformave, është miratuar Strategjia për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Biznesit 2030 dhe PV për Politika Industriale 2023-2025. Ajo ofron një kornizë strategjike për politikë-bërësit, partneritetin e dialogut me komunitetin e biznesit dhe koordinimin me partnerët zhvillimorë në Kosovë, për të lehtësuar zhvillimin e sektorit të prodhimit në vend. Më tej, Politika Industriale është hartuar duke përdorur një metodologji të njohur si Rritja e Cilësisë së Politikave Industriale, e cila është krijuar për të mbështetur vendet në zhvillimin e politikave industriale gjithëpërfshirëse të bazuara në diagnostikime të fuqishme. Objektivat kryesore të strategjisë përfshijnë zgjerimin e prodhimit industrial, zvogëlimin e deficitit industrial, gjenerimin e punësimit më të mirë dhe më gjithëpërfshirës, maksimizimin e rritjes së vlerës së brendshme dhe facilitimin e industrisë së gjelbër.

Procedurat për hapjen e bizneseve përmes konceptit '*one-stop shop*' janë të thjeshta dhe të shpejta dhe kjo mund të bëhet në cilëndo qendër komunale të ARBK-së, varësisht nga lokacioni i ushtrimit të aktivitetit të entitetit aplikues. Regjistrimi i bizneseve individuale dhe ortakërive bëhet brenda një dite, ndërsa i shoqërive aksionare dhe atyre me përgjegjësi të kufizuar brenda dy ditëve.

Aktualisht institucionet janë të angazhuara edhe në digjitalizimin e shërbimeve publike dhe thjeshtësimin e bazës ligjore për lejet dhe licencat. Në këtë drejtim, deri në shtator të 2023, në Platformë eKosova janë lansuar mbi 150 shërbime publike administrative të nivelit qëndron dhe lokal, të ofruara për qytetarët, bizneset dhe OJQ-të. Këto shërbime janë kryesisht në fushat e gjendjes civile, pronës, arsimit, komunalive, policisë, gjyqësorit, tatimeve, shëndetësisë, automjeteve, punës, familjes, kontributeve pensionale, granteve dhe subvencioneve, eKomuna, auditorët ligjorë, shërbimet konsullore, etj.

Deri në fund shtatorit 2023, në Platformë janë krijuar mbi 800,000 llogari të qytetarëve, të cilët deri tani kanë marrë me miliona shërbime elektronike, duke kursyer kohën dhe koston.

Sistemi gjyqësor është faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit dhe luan rol kyç në lehtësimin e investimeve, mbrojtjen adekuate të të drejtave kontraktuale të bizneseve dhe rritjen e sektorit privat. Ky sistem është i rregulluar me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatat, Ligjin për KGJK-në, etj. Sipas Ligjit për Gjykatat, Gjykata e Apelit është gjykata e shkallës së dytë me juridiksion territorial në tërë vendin, ndërsa Gjykata Supreme, si instanca më e lartë gjyqësore, përfshin edhe kolegjin e apelit të Agjencisë së Pronës dhe Dhomën e Posaçme për Çështjet lidhur me Agjencinë e Privatizimit.

Me qëllim të reformimit të sistemit gjyqësor në fushën komerciale, në fillim të vitit 2022, është miratuar Ligji për Gjykatën Komerciale, i cili ka themeluar Gjykatën Komerciale, si gjykatë e specializuar me detyrë primare që të ofrojë një drejtësi efikase për bizneset. Qëllimi është nxitja e një ambienti stabil afarist përmes forcimit të sigurisë juridike, duke ndikuar kështu pozitivisht në inkurajimin e investimeve të huaja dhe rritjes ekonomike në vend.

Në funksion të kësaj, Gjykata Komerciale pas themelimit ka përzgjedhur gjyqtarë të profilizuar në fushën ekonomike të cilët me ekspertizën e tyre, kanë mundur që të ofrohet drejtësi efikase në kontestet e natyrës komerciale, të cilat kanë ndërlikueshmëri të theksuar për dallim nga kontestet tjera të natyrës civile.

Përgjatë një viti që nga themelimi i saj, Gjykata, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, ka ofruar trajnime lidhur me tema specifike në fushën e të drejtës komerciale, krejt kjo me qëllim të specializimit të

mëttutjeshëm të gjyqtarëve dhe sigurimit të njohurive të nevojshme që shërbejnë gjatë trajtimit të kontesteve të natyrës tregtare. Në anën tjetër, Gjykata, vazhdimisht ka mbajtur kolegji me të dy dhomave, me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore në këtë Gjykatë, e cila do të shërbente në ofrimin e drejtësisë së parashikueshme për bizneset.

Me qëllim të zvogëlimit të numrit të madh të lëndëve që i janë bartur kësaj gjykate të re, më 2023 është miratuar PV me objektiv primar reduktimin e lëndëve të natyrës përmbartimore të cilat gëzojnë prioritet edhe me Ligjin për Gjykatën Komerciale, ndërsa në vitin 2024 pritet që prioritet të gëzojnë lëndët e natyrës ekonomike, sidomos rastet e kthyer në rigjykim. Në këto dy vitet e para të funksionimit gjykata ka treguar performancë të mirë në shqyrtimin e lëndëve si shihet edhe nga të dhënat në tabelën e mëposhtme.

Në aspektin administrativ, Gjykata ka filluar me funksionalizimin e sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve SMIL, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të lëndëve dhe shpejtësisë së administrimit të një procesi gjyqësor. Gjykata është edhe në proces të funksionalizimit të lëshimit të certifikatave elektronike të cilat pasqyrojnë informacione se a janë bizneset përkatëse në procedurë të falimentimit pranë kësaj Gjykate.

Sa i përket organizimit, Gjykata Komerciale është e organizuar në dy dhoma, Dhoma e Shkallës së Parë, e cila përfshin Departamentin e Përgjithshëm, Departamentin për Çështje Ekonomike, Departamentin Administrativ dhe Departamentin Fiskal, dhe Dhoma e Shkallës së Dytë, e cila vendos lidhur me mjetet juridike ndaj vendimeve të dhomave të shkallës së parë.

Emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale është bërë përmes konkursit të shpallur pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale, ndërsa përzgjedhjes së gjyqtarëve i ka paraprirë një proces transparent dhe objektiv i rekrutimit, i monitoruar nga organizata vendore e ndërkombëtare. Gjykata aktualisht ka 18 gjyqtarë në të dy shkallët.

Tabela 4. Gjendja numerike e lëndëve në Gjykatën Komerciale Dhoma e shkallës së parë (01.01.2023-30.09.2023)

Nr. rendor	LLOJI I LËNDËVE	Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese	Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	Gjithsej në punë	Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	Lëndët në pritje në periudhën raportuese	Struktura e lëndëve të pranuar e shprehur në %	Norma e zgjidhjes	(+) më shumë ose (-) më pak Lëndët e pazgjidhura: Nëntëmuajori 2023 krahasuar me fundin 2022	
									Total	%
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	Ekonomike	2802	736	3538	195	3343	22.34	26.49	541	19.31
2	Përmbartimore	2444	1569	4013	1946	2067	47.63	124.03	-377	-15.43
3	Kontestet Lidhur me Investitorët e Huaj	10	4	14	1	13	0.12	25.00	3	30.00
4	Fiskale	983	508	1491	205	1286	15.42	40.35	303	30.82
5	Administrative	1393	429	1822	210	1612	13.02	48.95	219	15.72
6	Të përgjithshme	91	48	139	68	71	1.46	141.67	-20	-21.98
7	Falimentimet	11	0	11	4	7	0.00	#DIV/0!	-4	-36.36
I	GJITHSEJ	7734	3294	11028	2629	8399	100.0	79.81	665	8.60
II	Dhoma e shkallës së dytë	1272	1281	2553	1555	998		121.39	-274	-21.54
	GJITHSEJ (I+II)	9006	4575	13581	4184	9397	100.0	91.45	391	4.34

Sa i përket të drejtës së pronës, neni 119, pika 1, e Kushtetutës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktiviteteve ekonomike dhe sigurinë e pronës publike e private, duke njohur pronën publike dhe pronën private si kategori kushtetuese. Me Kushtetutë garantohet e drejta e pronësisë dhe ofrohen garanci të cilat përjashtojnë mundësinë e privimit në mënyrë arbitrare nga prona. Meqë llojet e pronës janë përcaktuar me Kushtetutë, rregullimi i përmbajtjes së tyre i delegohet legjislativitetit. Kuvendi ka miratuar Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, i cili rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen e shuarjen e të drejtave sendore, si dhe pronësinë dhe të drejtat sendore të kufizuara si posedimin,

të drejtat sendore të sigurimit dhe të shfrytëzimit. Akoma nuk ka një ligj që rregullon pronën publike në përgjithësi. Në vitin 2022 është miratuar edhe Ligji nr. 08/L-014 për të Drejtat pronësore të Shtetasve të Huaj, i cili rregullon të drejtat e pronës për shtetasit e BE-së, në përputhje me MSA-në.

Krijimi i një sistemi efektiv dhe të barabartë të drejtash pronësore krijon siguri ligjore për investitorët dhe rrjedhimisht rrit mundësitë për investime. Kjo gjithashtu u krijon shtetasve më shumë mundësi për të përdorur pronën si kolateral dhe kështu përmirëson qasjen në financa dhe kontribuon në pavarësimin financiar të grave në vend. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i të drejtës pronësore ka ndikim edhe në të bërit biznes.

Më 2018 është miratuar Ligji për Trashëgiminë dhe Noterinë. Më tej, në nëntor 2019 është miratuar UA nr. 10/19 për matjet kadastrale për regjistrim në kadastër dhe UA nr. 09/19 për ndarjen e zonave kadastrale. Me qëllim të thjeshtësimit të procedurave të regjistrimit dhe uljes së kostos, më 2019 është miratuar UA nr. 08/2019 për tarifën e produkteve dhe shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Ndërmjetësimi rregullohet nga Ligji nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim. Praktika e deritanishme e zbatimit të formave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ka rezultuar shumë e mirë. Megjithatë, nga analizat dhe rekomandimet është konkluduar se nevojitet koordinim më i mirë ndërmjet qendrës së ndërmjetësimimit dhe Gjykatës e Prokurorisë dhe të sqarohet roli e rëndësia e kësaj qendre, tarifën e administrimit të rasteve të ndërmjetësuar nga ajo, si dhe mbulimi i kostos financiare nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Një ndër inovacionet e *procedurës përmbarimore*, dhe e cila ndikon në zbatimin e vendimeve, është arritur me anë të Ligjit nr. 05/L-118 për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, i cili zhvendosi përmbarimin prej gjykatave tek përmbaruesit privatë, të cilët emërohen nga Ministria e Drejtësisë (MD) për kryerjen e autorizimeve publike të besuara, në përjashtim të kompetencës për të vendosur në procedurën e përmbarimit dhe të zbatojnë përmbarimin në të gjitha çështjet nga e drejta familjare dhe kthimin e punëtorëve dhe shërbësve civilë në punë dhe kompensimet e tjera.

Agjencia Kadastrale Kosovës (AKK) është institucion publik për regjistrimin, mbajtjen dhe përditësimin e të drejtave të pronarëve mbi pronën e paluajtshme. Ajo është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, regjistrave pronësorë, për hartografi, GIS, dhe për infrastrukturën e të dhënave gjeo-hapësinore. Ajo është përgjegjëse edhe për certifikimin e personave në Zyrat Komunale Kadastrale (ZKK) dhe licencimin e kompanive e gjeodetëve për kryerjen e matjeve kadastrale. Regjistrimi i të drejtave të pronës së paluajtshme bëhet në ZKK dhe monitorohet dhe publikohet çdo ditë në ueb faqen e AKK-së. Afati ligjor për aplikim nëpër ZKK për transaksionet e shitblerjes, trashëgimisë dhe pengut është 30 ditë, ndërsa bazuar në të dhënat e fundit të ZKK-ve ky proces kryhet mesatarisht për 10 ditë.

Ndikimi i shtetit në tregun e produkteve

Që nga nënshkrimi i MSA-së, Republika e Kosovës ka ndërmarrë hapa thelbësorë për të harmonizuar sistemin e saj rregullator të ndihmës shtetërore me standardet e BE-së siç kërkohet nga MSA.

Këta hapa përfshijnë kornizën ligjore, krijimin e organeve rregullative, dhe masat e transparencës dhe pajtueshmërinë me parimet e BE-së për kontrollin e ndihmës shtetërore. Përpjekjet e Kosovës demonstronë përkushtim për përmbushjen e obligimeve të saj sipas MSA-së në këtë fushë specifike.

Një ligj i ri për Ndihmën Shtetërore u miratua në dhjetor 2016 dhe u zbatua në shkurt 2017, dhe kjo pasqyron angazhimin e vendit për krijimin e një kuadri ligjor për kontrollin e ndihmës shtetërore.

Ligji i ri për Ndihmën Shtetërore është gjerësisht në përputhje me sistemin rregullator të BE-së për ndihmën shtetërore. Ai përgjithësisht ndalon ndihmën shtetërore, përveç kur njoftohet dhe miratohet paraprakisht nga autoritetet e ndihmës shtetërore. Ai i detyron ofruesit e ndihmës shtetërore, përfshirë ministrinë, komunat dhe organizatat e tjera publike, t'i paraqesin informacion mbi ndihmën shtetërore autoriteteve të zbatimit të ndihmës shtetërore. Ky përafrim demonstron përpjekjet e Kosovës për të harmonizuar legjislacionin e saj për ndihmën shtetërore me rregullat dhe standardet e BE-së, siç kërkohet nga MSA-ja.

Kosova ka bërë gjithashtu përparim thelbësor në zhvillimin e legjislacionit dytësor për të mbështetur zbatimin e kornizës rregullative të ndihmës shtetërore. Miratimi i rregulloreve të ndryshme që mbulojnë

aspekte të tilla si njoftimi, ndihma de minimis dhe kompensimi për Shërbimet e Interesit të Përgjithshëm Ekonomik (SGEI) demonstroi një angazhim për të përafuar me standardet e BE-së dhe për të promovuar transparencën në kontrollin e ndihmës shtetërore. Fokusi në zhvillimin e rregullore të ardhshme, duke përfshirë ato që lidhen me ndihmën horizontale dhe sektoriale, tregon një qasje proaktive për përmbushjen e kërkesave të MSA-së me BE-në.

Sa i përket strukturës institucionale, janë krijuar organet e nevojshme rregullatore për të mbikëqyrur dhe zbatuar kontrollin e ndihmës shtetërore. Veçanërisht, janë krijuar Komisioni i Ndihmës Shtetërore dhe Departamenti i Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Financave të Punës dhe Transfereve. Komisioni i Ndihmës Shtetërore është një organ i pavarur vendimmarrës i përbërë nga pesë anëtarë, ekspertë të pavarur në fushën e ndihmës shtetërore. Ligji dhe rregullorja shoqëruese ofrojnë një kuadër të qartë rregullator, duke detajuar funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat e punës të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, e cila është e nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të kontrollit të ndihmës shtetërore. Komisionit të Ndihmës Shtetërore i janë caktuar funksione të ndryshme, duke përfshirë përcaktimin nëse një masë përbën ndihmë shtetërore, marrjen e vendimeve për pajtueshmërinë ose papajtueshmërinë, lëshimin e urdhrave për pezullimin, urdhërimin e rikuperimit të ndihmës shtetërore të paligjshme, fillimin e hetimeve, miratimin e raporteve dhe monitorimin e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore.

Kosova ka bërë përparime edhe në krijimin e një inventari bazë të ndihmës shtetërore (shihni kapitullin 8).

Privatizimi dhe ristrukturimi

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën - 2023*, Kosova ka ndërmarrë hapa për të shpërbërë Agjencinë e Privatizimit dhe për të krijuar fondin sovran. Në qershor 2022, Qeveria ka miratuar një koncept dokument për fondin sovran. Në dhjetor të 2023, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Fondin Sovran. Fondi sovran pritet të marrë përsipër disa ndërmarrje shoqërore (NSH) dhe asete të menaxhuara nga AKP. Raporti i KE rekomandon që në të ardhmen të ndryshohet korniza ligjore për qeverisjen dhe mbikëqyrjen e NP-ve, në mënyrë që të adresohen çështjet e performancës së dobët dhe keq-menaxhimit.

Sa i përket kornizës institucionale, Agjencia e Kosovës për Privatizim (AKP) është themeluar si organ i pavarur publik i cili e ushtron funksionin dhe përgjegjësitë e saj në mënyrë të plotë sipas Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, të plotësuar ndryshuar me ligjet nr. 04/L-115, nr. 05/L-080 dhe nr. 06/L-023 mbi AKP-në. Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-34, privatizimi bëhet përmes tre metodave kryesore: metodës *spin-off*, metodës së likuidimit dhe shitjes përmes shitjes direkte. Gjatë vitit 2023 janë realizuar tre valë të shitjes me gjithsej 63 asete të tenderuara, ku prej tyre janë shitur 9 asete përmes likuidimit dhe 26 asete përmes shitjes direkte në shumën totale prej €1,781.915.96. Gjatë vitit 2023, dy ndërmarrje shoqërore (NSH) janë vendosur në likuidim, ndërsa për vitin 2024 është planifikuar të vendosen 15 NSH në likuidim. Shuma e përgjithshme e 20% që është shpërndarë për vitin 2023 është €3,145,675,71.

Për vitin 2024 janë paraparë të mbahen gjithsej 7 valë të shitjes me 210 asete.

Funksionimi i tregut financiar

Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar, me 12 banka komerciale, të cilat përbëjnë rreth 67.6% të aseteve totale të sistemit (10 me pronësi të huaj), sektori i sigurimeve, me 12 kompani sigurimesh (7 me pronësi të huaj), fondet pensionale (2 fonde), ndihmësit financiarë (60), sektori mikrofinanciar, me 32 IMF/IFJB (14 me pronësi të huaj) dhe tregu i letrave me vlerë. Sistemi financiar ka vazhduar të zgjerohet ndër vite, duke arritur shkallën e ndërmjetësimit financiar në 109.9% të BPV-së në fund të shtatorit 2022 kundrejt nivelit prej 79.8% dhjetë vite më parë. Bankat janë ndërmjetësuesit kryesorë të sektorit financiar, pasuar nga fondet pensionale (24.7% të tregut financiar), IMF/IFJB-të (4.5% të tregut), kompanitë e sigurimeve (2.8% të tregut) dhe pjesa e mbetur përbëhet nga ndihmësit financiar (0.4%).

Asetet e sistemit financiar në fund të shtatorit 2023 arritën vlerën prej €10.60 miliardë, e që paraqet një rritje vjetore prej 12.2%, duke sinjalizuar trend të ngjashëm të rritjes me vitet paraprake (në 14 vitet e fundit kemi rritje vjetore mesatare prej 10.5%). Kontributin kryesor në këtë rritje vazhdojnë të ketë sektori bankar, asetet e të cilës në fund të shtatorit 2023 arritën vlerën prej €7.16 miliardë (74.3% të BPV-së), financiar kryesisht

nga depozitat e qytetarëve. Pasuar nga fondet pensionale, asetete e të cilave arritën vlerën në €2.62 miliardë në fund të shtatorit 2023 (27.1% të BPV-së), zgjeruar kryesisht prej arkëtimeve nga kontributdhënësit dhe kthimit pozitiv nga investimet. Asetete e IMF/IFJB-ve në fund të shtatorit 2023 arritën vlerën prej €479.0 milionë dhe përfaqësojnë rreth 5.0% të BPV-së, dhe financohen kryesisht nga huazimet jashtë vendit. Asetet e sektorit të sigurimeve arritën vlerën në €300.7 milionë në fund të shtatorit 2023, duke përfaqësuar 3.1% të BPV-së, duke u zgjeruar kryesisht prej kapitalit vetanak dhe të hyrave prej primeve të arkëtuara. Kurse, vlera e aseteteve të ndihmësve financiar përbëjnë rreth 0.4% të BPV-së, dhe arritën vlerën prej €39.4 milionë në fund të shtatorit 2023, që përbëhen kryesisht nga zyrat për transfer parash dhe këmbimoret.

Sistemi financiar është karakterizuar me qëndrueshmëri dhe pa ndonjë rrezik të materializuar pavarësisht luhatjeve në tregjet financiare ndërkombëtare si rezultat i dështimit të disa bankave të kategorisë së mesme në SHBA dhe një banke me rëndësi të përgjithshme sistemike globale në Evropë në gjysmën e parë të vitit 2023. Më tej, përkundër sfidave nga rreziqet më të larta me të cilat u përballë ekonomia, si inflacioni i rritur dhe perspektiva më e dobët ekonomike, sistemi financiar është zgjeruar me ritëm të përshpejtuar. Pra, përkundër të gjitha këtyre zhvillimeve, sistemi financiar vazhdon të jetë stabil, i qëndrueshëm dhe likuid. Pra, bankat dhe institucionet financiare arritën të jenë fitimprurëse, likuide dhe mirë të kapitalizuara.

Sektori bankar dominohet nga bankat me pronësi të huaj (84.4% të aseteteve) dhe pjesa e mbetur përbëhet nga tri bankat vendore. Shkalla e koncentrimin në sektor ndër vite është reduktuar si rezultat i shtimit të bankave të reja në treg. Tri bankat më të mëdha në vend përfaqësojnë rreth 52.4% të aseteteve të sektorit kundrejt 66.7% para dhjetë vitesh. Për më tepër, rënia vërehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (HHI), i cili ka rënë në 1395 pikë nga 1,862 pikë sa ishte para dhjetë vitesh. Aktiviteti kredi-dhënës i sektorit bankar ka vazhduar të shënojë rritje dyshifrore për të tretin vit me radhë, por me ritëm më të ngadalësuar. Në shtator 2023, stoku i kreditimit arriti në €4.79 miliardë (49.7% të BPV-së), duke shënuar një rritje vjetore prej 13.3% (18.4% në shtator 2022). Ky ngadalësim i rritjes ishte i evidentuar tek segmenti i korporatave jofinanciar, që përfaqësojnë 60.8% të kreditimit dhe arritën vlerën në €2.91 miliardë, duke shënuar rritje vjetore prej 10.8% (18.4% në shtator 2022). Kreditimi ndaj sektorit të tregtisë vazhdo të ketë peshën më të lartë në kuadër të korporatave jofinanciare (41.9%), pasuar nga ato për prodhimtari (19.6%), ndërtimtari (14.1%), shërbime financiare (8.3%), përderisa kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë ka pjesëmarrje të ulët (2.1%). Kreditimi ndaj ekonomive familjare që përbëjnë rreth 38.6% të gjithsej kredive, shënoi rritje vjetore prej 17.3% në shtator 2023, ngjashëm me vitin e kaluar, dhe arritën vlerën prej €1.85 miliardë.

Depozitat përbëjnë rreth 81.7% të detyrimeve dhe janë burimi kryesor financues për bankat, në të njëjtën kohë përcaktuese të drejtimit të zgjerimit/tkurrjes së aseteteve të sektorit. Në shtator 2023 vlera e depozitave në sektorin bankar arriti vlerën prej €5.85 miliardë (60.7% të BPV-së), duke vazhduar trendin e rritjes vjetore dyshifrore për të tretin vit me radhë, por me ritëm më të ngadalësuar, prej 11.3% (12.7% rritje vjetore në shtator 2022). Depozitat prej ekonomive familjare përbëjnë rreth 66.4% të gjithsej portofolit të depozitave duke arritur në vlerë prej €3.90 miliardë në fund të shtatorit 2023, kurse stoku i depozitave prej korporatave jo-financiare ka arritur në €1.22 miliardë (20.8% të tërë portofolit të depozitave). Rritja e normave bazë të interesit (depozita dhe financim) nga bankat qendrore për të frenuar inflacionin në rritje që nga shtatori i vitit të kaluar është reflektuar edhe në sektorin bankar në vend, përkatësisht rritje më të theksuar të normave në depozita, përderisa në kredi rritje më të ulët. Rritja e normave të interesit në depozita kanë ndikuar edhe në strukturën e gjithsej depozitave të bankave, ku kemi një zhvendosje më të madhe drejt depozitave të afatizuara (pjesëmarrje prej 25.7% në gjithsej depozita nga 21.5% një vit më parë), kundrejt rënies së peshës në depozitat e transferueshme (63.9% në shtator 2023 prej 66.9% në shtator 2022) dhe të kursimit (10.4% në shtator 2023 nga 11.6% në shtator 2022).

Sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë likuiditeti. Raporti i aseteteve likuide (të gjera) ndaj detyrimeve afatshkurtra në shtator 2023 u zvogëlua me 2.6 p.p. krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraparak, në 32.6%, e që pavarësisht rënies është dukshëm mbi nivelin minimal të rekomanduar (25.0%). Kjo rënie krahasuar me një vit më parë është rezultat i zvogëlimit të mjeteve likuide, si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit (kanalizim i mjeteve likuide-paraja e gatshme në kreditim dhe letrat me vlerë joqeveritare), përderisa detyrimet afatshkurtra shënuan rritje (ndikuar nga ecuria e depozitave). Treguesi tjetër i

likuiditetit, i cili ka filluar të raportohet që nga fillimi i vitit 2023, Treguesi i Mbulimit me Likuiditetet është në nivel 260.5% nga 228.2% sa ishte në janar 2023, e që duhet të jetë mbi nivelin prej 100%.

Sektori bankar regjistroi fitime neto në vlerë rekorde prej €123.7 milion deri në fund të shtatorit 2023, që paraqet një rritje vjetore prej 14.8% (€16.0 milionë më tepër se një vit më parë). Të hyrat arritën vlerën në €317.1 milionë, që paraqet një rritje vjetore prej 17.2%: €234.7 milionë të hyra nga interesi, kryesisht nga kreditë (84.8%), dhe pjesa e mbetur të hyra prej plasmanëve me bankat (8.4%) dhe interesit të arkëtuara prej investimeve në letrat me vlerë (6.8%). Të ardhurat nga jointerеси gjatë kësaj periudhe arritën vlerën €71.6 milionë, që përbëhen kryesisht nga të hyrat prej tarifave dhe komisioneve. Shpenzimet e sektorit arritën €193.4 milionë në fund të shtatorit 2023, duke shënuar një rritje vjetore prej 18.8%. Kontributin më të lartë në rritjen e shpenzimeve kishin shpenzimet për interesa në depozita, në kuadër të shpenzimeve të interesit, vlera e të cilave në fund të shtatorit 2023 arriti €21.5 milionë, pasuar nga shpenzimet për personelit në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, vlera e të cilave në fund të shtatorit 2023 arriti në €49.5 milionë. Fitimi më i lartë gjithashtu ndikoi në përmirësim të treguesve të performancës financiare, siç është ROA (kthimi në asete) dhe ROE (kthimi në kapital), të cilët qëndruan në 2.6% (2.5% në shtator 2022) dhe ROE në 20.9% (19.8% në shtator 2022).

Normat e interesit në kredi dhe depozita të reja kanë shënuar rritje graduale, që nga fillimi i vitit të kaluar, të implikuara nga aplikimi i politikave të shtrënguara monetare nga bankat qendrore në luftën kundër. Rritja është në mesterë ishte më e lartë në normat e interesit në kredi sesa ato për depozita duke rritur margjinën e interesit kredi-depozitë. Në shtator 2023 norma e interesit në kredi ishte 6.4% (5.9% një vit më parë), me normë më të favorshme për korporata jofinanciare (6.2%) krahasuar me normën e interesit për ekonomitë familjare (6.2%). Ngjashëm, edhe për depozita, normë më të favorshme të interesit kishin korporatat jofinanciare (1.7%) krahasuar me atë të ekonomive familjare (1.4%), përderisa norma e përgjithshme e interesit në depozita ishte 1.5% (1.4% në shtator 2023). Margjina e interesit kredi-depozitë u zgjerua në 4.9 pikë përqindje në shtator 2023 nga 4.5 pikë përqindje në shtator 2022, si rrjedhojë e rritjes më të lartë të interesit në kredi sesa për depozita.

Sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar, dukshëm mbi nivelin e kërkuar rregullator minimal prej 12%, në 15.3%, në shtator 2023 (15.8% në shtator 2022). Rënia e nivelit të kapitalizimit krahasuar me një vit më parë erdhi si rezultat i rritjes më të ngadalësuar të kapitalit (shpërndarjes së dividendëve) krahasuar me rritjen më të larët të mjeteve të peshuara ndaj rrezikut (kreditimit dhe letrave me vlerë).

Kreditë me probleme (KJP-të) në fund të shtatorit 2023 arritën vlerën prej €94.1 milionë, që paraqet një rritje vjetore prej 8.4%, kurse gjithsej kreditë janë rritur me ritëm prej 13.3%. Pra, kreditë me probleme janë rritur me ritëm më të ngadalësuar sesa stoku i kredive aktive.. Si rrjedhojë, niveli i KJP-ve në shtator 2023 ishte më i ulët, në 2.0% nga 2.1% sa ishin në shtator 2023. Mbulueshmëria e kredive me probleme është në nivel të lartë, prej 143.5% (150.6% një vit më parë). Kurse, vetëm mbulueshmëria e KJP-ve për fazën 3 në shtator 2023 ishte 71.2%, kurse për fazën 2 ishte 8.1%, e për fazën 1 ishte 0.9%. Sipas sektorëve ekonomik, KJP-të për agrikulturë ishin në nivel prej 5.0%, kurse vlera e tyre arriti në €3.4 milionë. KJP-të për prodhimtari ishin në nivel prej 1.9%, kurse vlera e tyre arriti në €11.3 milionë. KJP-të për tregti ishin në nivel prej 1.8%, kurse vlera e tyre arriti në €23.0 milionë. KJP-të për ekonomitë familjare ishin në nivel prej 1.4%, kurse vlera e tyre arriti në €25.3 milionë.

Sa u përket sektorëve të tjerë, asetet e sektorit pensional në fund të shtatorit 2023 arritën vlerën prej €2.62 miliardë, që paraqet një rritje vjetore prej 12.8% (4.2% një vit më parë). Rreth 99.7% e mjeteve janë në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), kurse 0.3% janë mjete të Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP). Rritja e përshpejtuar e aseteve të fondeve reflekton ecurinë pozitive të kthimit nga investimet këtë vit për dallim nga viti i kaluar, ku në të njëjtën periudhe kishte shënuar humbje, si dhe kontributeve stabile dhe në rritje prej kontributdhënësve. FKPK-ja deri në shtator 2023 shënoi kthimi në investime prej €47.6 milionë (humbje prej €170.5 milionë një vit më parë, si rezultat i përkeqësimit të situatës gjeopolitike në Evropën Lindore, ku preku dhe tregjet financiare globale pas sanksioneve që pasuan ndaj Rusisë). FKPK-a deri në shtator 2023 arkëtoi kontribute në vlerë prej €212.3 milionë (€177.1 milionë një vit më parë). Rritja më e theksuar e kontributeve të arkëtuara të FKPK-së (19.9% këtë vit nga 13.0% një vit më

parë) është edhe si rezultat i rritjes së pagave të punonjësve të sektorit publik në vend. FSKP-ja deri në shtator 2023 shënoi kthimi pozitiv në investime në vlerë €0.41 milionë, kurse kontributet e arkëtuara arritën vlerën prej €0.49 milion.

Sektori i sigurime është më pak i koncentruar ase ai bankar. Rreth 53.6% e aseteve përfaqësohen nga sigurues të huaj, dhe pjesa e mbetur nga sigurues vendor. Tri kompanitë më të mëdha në fushën e sigurimit përbëjnë 36.5% të sektorit (35.1% në shtator 2022). Asetet e sektorit të sigurimeve arritën vlerën prej €300.7 milionë në fund të shtatorit 2023, rritje vjetore prej 16.1% (9.9% një vit më parë), që reflekton kryesisht ecurinë e primeve të arkëtuara gjatë një harku njëvjeçar. Deri në shtator 2023, vlera e primeve të shkruara arrit në €110.1 milionë (€98.2 milionë një vit më parë). Rreth €5.1 milionë janë prime të segmentit 'jetë' (€4.9 milionë një vit më parë), kurse €105.0 milionë janë prime të segmentit 'jo-jetë' (€93.3 milionë një vit më parë). Deri në shtator 2023 vlera e dëmeve të paguara nga sektori i sigurimeve ka arritur në €53.1 milionë (€46.6 milionë një vit më parë). Rreth €48.7 milionë janë dëme të paguara nga kompanitë e sigurimit (€40.0 milionë një vit më parë), ndërsa €4.4 milionë dëme të paguara nga BKS (€6.6 milionë një vit më parë). Fitimi neto i sektorit ka arritur në €9.4 milionë (€2.8 milionë një vit më parë), ndërsa raporti dëme/prime është rritur lehtësisht në 48.2% (47.4% një vit më parë).

Sektor mikrofinanciar, ngjashëm me atë bankar dominohet nga institucionet me pronësi të huaj. Institucionet mikrofinanciare të huaja përbëjnë rreth 78.8% të aseteve të sektorit (78.5% një vit më parë). Kurse, tri institucionet më të mëdha përfaqësojnë 53.5% të gjithsej aseteve të sektorit (55.9% një vit më parë). Sektori mikrofinanciar ka një pjesëmarrje prej 4.5% në gjithsej asetet e sistemit financiar, kurse vetëm dhjetë vite më parë kishte një përfaqësim prej 2.8%, e që tregon për rritje të theksuar në vitet e fundit. Sektori mikrofinanciar ka rikthyer ritmin e rritjes parapandemike këtë vit, duke shënuar rritje vjetore prej 25.1% në shtator 2023, dhe vlera e aseteve në fund të kësaj periudhe ka arritur në €479.0 milionë. Kjo rritje kryesisht është rezultat i huamarrjeve nga sektori i jashtëm, vlera e të cilave përbën rreth 62.6% të gjithsej detyrimeve të IMF-ve, kurse pjesa tjetër financohet kryesisht nga kapitali vetanak (rreth 26.2% të detyrimeve) dhe detyrimeve tjera që arrijnë në 8.8% të detyrimeve të sektorit.

Stoku i kredive përbënë rreth 70.9% të gjithsej aseteve të sektorit, dhe arritën vlerën prej €339.7 milionë në fund të shtatorit 2023, duke shënuar rritje vjetore prej 25.0% (17.5% një vit më parë). Kreditimi ndaj ekonomive familjare kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kredive. Ky segment shënoi rritje vjetore prej 20.5% (14.8% një vit më parë), dhe kanë një përfaqësim prej 62.4% në gjithsej kreditë. Stoku i kredive për këtë segment në fund të shtatorit 2023 arri në €212.0 milionë. Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare u rrit për 33.3% (22.7% një vit më parë) dhe përfaqësojnë 37.6% të gjithsej kredive. Kreditë për korporatat jofinanciare në fund të shtatorit 2023 arritën vlerën prej €127.7 milionë. Kategoria e dytë për nga rëndësia dhe pesha, ajo e lizingjeve (19.4% të aseteve), në fund të shtatorit arriti vlerën prej €92.8 milionë, që paraqet një rritje vjetore prej 29.6% (12.7% një vit më parë). Lizingjet ndaj ekonomive familjare kanë një përfaqësim prej 31.3% në gjithsej lizingjet, dhe shënuan rritje vjetore prej 4.1% (4.7%). Ky segment në fund të shtatorit 2023 arriti vlerën prej €29.0 milionë. Për dallim prej kreditimit, tek lizingjet, financimi ndaj korporatave jofinanciare ka peshë mjaftë të madhe (68.7%), dhe shënuan rritje vjetore prej 45.9% (18.4% një vit më parë) duke përcaktuar dhe trendin e rritjes. Lizingjet ndaj këtij segment arritën vlerën prej €63.8 milionë në fund të shtatorit 2023.

Sektori mikrofinanciar pothuajse ruajti nivelit e fitimit të vitit kaluar, duke shënuar fitim neto në vlerë prej €12.8 milionë deri në shtator 2023 (€13.5 milionë një vit më parë). Rënia e fitimit të realizuar gjatë kësaj periudhe për 5.1% është si rezultat i rritjes më të ngadalësuar të të hyrave (19.1%) krahasuar me atë të shpenzimeve (30.8%). Të hyrat deri në shtator 2023 arritën vlerën prej €49.4 milionë, prej të cilave €44.6 milionë janë të hyra nga interesi në kredi dhe lizing, rritje vjetore prej 20.6% krahasuar me një vit më parë (nga 16.3%). Shpenzimet e sektorit arritën vlerën prej €36.6 milionë (€28.0 milionë një vit më parë), e që reflekton kryesisht rritjen e shpenzimeve të interesit (rritje për €3.5 milionë krahasuar me një vit më parë, duke arritur vlerën €9.6 milionë në fund të shtatorit 2023) dhe shpenzimeve të personelit (rritje për €3.2 milionë krahasuar me një vit më parë, duke arritur vlerën në €19.6 milionë në fund të shtatorit 2023).

Sektori mikrofinanciar vazhdon të ketë norma të larta të interesit në kredi krahasuar me normat e ofruara nga bankat, ndikuar edhe prej mënyrës së financimit (kryesisht nga linjat kreditore) për dallim nga bankat që financohen kryesisht nga depozitat e klientëve. Në shtator 2023 norma e interesit në kredi ishte 18.9% nga 19.1%, e njëjtë me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Norma më të favorshme kishin korporatat jofinanciare (15.7%, 16.1% një vit më parë) sesa ekonomitë familjare (21.8%, 20.9% një vit më parë).

Niveli i kredive me probleme (KJP-ve) të institucioneve mikrofinanciare në fund të shtatorit 2023 ishte 1.9% (2.1% një vit më parë). KJP-të vetëm për IMF-të ishin 1.6% (1.8% një vit më parë), kurse KJP-të vetëm për IFJB-të ishin 3.1% (3.2% një vit më parë). Mbulueshmëria e KJP-ve me provizione vazhdon të jetë optimale, prej 145.1% (144.0% një vit më parë). Mbulueshmëria e KJP-ve me provizione për IMF-të ishte 165.7%, kurës për IFJB-të ishte rreth 110.2%.

Autoriteti i vetëm mbikëqyrës e rregullativ i institucioneve financiare është BQK, e themeluar me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Objektivi parësor i saj është nxitja dhe ruajtja e një sistemi të qëndrueshëm financiar, përfshirë një sistemi të sigurt e efikas pagesash. Përgjegjës në BQK për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare janë këto njësi të vendosura në pjesën e Mbikëqyrjes Financiare: Departamenti për Mbikëqyrjen e Bankave, Departamenti për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, Departamenti për Licencim dhe Standardizim, Divizioni për Mbikëqyrjen e Fondeve Pensionale dhe Tregut të Letrave me Vlerë, dhe Divizioni për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit.

Objektivat prioritarë afatmesme

Në planin afatmesëm, prioritetet kryesore në këtë kapitull janë si në vijim:

- Zbatimi i Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2022-2026;
- Zhvillimi i kornizës ligjore për financat publike përfshirë edhe përmes ligjit të ri dhe legjislacionit dytësor për këtë fushë.
- Vazhdimi i luftimit të ekonomisë jo-formale;
- Shqyrtimi efektiv i lëndëve në Gjykatën Komerciale
- Avancimi i vazhdueshëm i kornizës rregullative për sistemin bankar, në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së.

2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit

Ky kapitull mbulon pjesën e dytë të kriterëve ekonomike, që ka të bëjë me kapacitetin e vendit për të përballuar dhe qenë konkurrues në tregun e BE-së. Faktorët kyçë për të arritur këtë dhe në bazë të të cilëve KE monitoron dhe vlerëson progresin drejt anëtarësimit përfshijnë:

- Zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe fizik në nivel të kënaqshëm, ku vlerësohen aspekte të zhvillimit të arsimit, hulumtimeve dhe infrastrukturës;
- Strukturën adekuate sektoriale dhe të ndërmarrjeve, përfshirë kompozicionin sektorial, zhvillimin e NVM-ve dhe çështjet e ristrukturimit të ndërmarrjeve;
- Integrimin e mjaftueshëm tregtar të ekonomisë me vendet e BE-së.

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova është në fazën fillestare dhe ka arritur progres të kufizuar në kapacitetin për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut në BE. Cilësia e pamjaftueshme e arsimit dhe mospërputhjet e shkathtësive vështirësojnë kalimin nga shkolla në tregun e punës. Është arritur njëfarë progresi në përmirësimin e infrastrukturës së transportit. Kriza e fundit energjetike theksoi urgjencën për të siguruar furnizim të besueshëm dhe të pastër me energji dhe diversifikimin e burimeve të saj. Kosova ka arritur njëfarë progresi sa i përket digjitalizimit të ekonomisë. Ndryshimet strukturore po përparojnë ngadalë pasi ekonomia mbetet shumë e varur nga firmat e vogla dhe mikro të cilat nuk mund të konkurrojnë ndërkombëtarisht. Struktura e eksportit mbetet e dominuar nga metalet bazë me përqindje lehtësisht në rritje të produkteve minerale, të plastikes dhe tekstilit. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, veçanërisht programet e arsimit të lartë dhe programet e aftësisë dhe trajnimit profesional me nevojat e tregut të punës përmes bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin afarist;
- Forcimin e sigurisë energjetike dhe stimulimin e efikasitetit të energjisë në sektorin rezidencial dhe atë privat dhe të rrisë kontributin e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme me kosto efektive;
- Avancimin e mbështetjes së përshtatur financiare dhe jo-financiare për NVM-të për të përmirësuar kapacitetin e tyre konkurrues dhe eksportin.

Më tej, konkluzionet e NK përkatës kërkojnë riorganizimin e KIESA-s dhe zbatimin e Strategjisë dhe PV për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimit Financiare. Kosova gjithashtu duhet të përmirësojë mjedisin afarist duke rritur digjitalizimin, thjeshtësimin dhe heqjen e licencave e lejeve.

Në kontekstin e bashkëpunimit rajonal dhe integritit në BE, Republika e Kosovës është e përkushtuar të zbatojë obligimet që dalin nga PV për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Agjendën e Gjellbër të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të Procesit të Berlinit.

Arsimi dhe inovacioni

Sipas vlerësimit të BE-se, përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe përafrimi i tij me nevojat e tregut të punës mbetet sfida kryesore në Kosovë. Shpenzimet publike për arsim në vitin 2021 ishin 4.1% e BPV që është në linjë me mesataren në BE por Kosova nuk performon aq mirë sa u përket rezultateve në arsim. ndërsa është arritur pak progres në përmirësimin e sistemit të kërkimeve shkencore, zhvillimit dhe inovacionit. *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023* thekson se performanca e Kosovës në fushën e kërkimeve shkencore dhe inovacionit ngec pas vendeve të rajonit sa i përket qeverisjes së përgjithshme në këtë fushë, sistemit të hulumtimeve publike, lidhjeve mes sektorit publik dhe privat, inovacionit në kompani dhe kapacitetit të përgjithshëm të inovacionit. Pavarësisht dispozitës ligjore për ndarjen e 0.7% të BPV-së për shkencën dhe inovacionin, buxheti i ndarë mbetet rreth 0.1% e BPV-së, dukshëm më ulët se kërkesa ligjore.

Prioritetet e Qeverisë mbeten të orientuara në zhvillimin e kapitalit fizik përkatësisht të infrastrukturës dhe të kapitalit njerëzor përmes reformave në arsim dhe masave për mbështetje të sektorit privat. Korniza strategjike me masat dhe objektivat prioritare përbëhet nga Programi i Qeverisë 2022-2023, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 dhe dokumente strategjike sektoriale si Strategjia e Arsimit në Kosovë 2022-2026. Zhvillimi i sektorëve me rëndësi ekonomike si energjia, infrastruktura, telekomunikacioni e shoqëria e informacionit, dhe turizmi janë objektiva prioritare.

Kosova përfiton nga një sërë mundësish financimi nga jashtë. Në Asociacionin COST, gjatë vitit 2022, hulumtuesit kosovarë janë përfshirë në 48 veprime të reja COST, krahasuar me vitin 2021 ku ishin përfshirë në vetëm 18. Presim të shohim se ka pasur rritje të ngjashme të pjesëmarrjes edhe në vitin 2023. Sa i përket Programit *Horizon Europe* ka rritje të konsiderueshme të performancës. Deri tani komuniteti i kërkimeve shkencore dhe inovacionit ka marrë pjesë me 81 projekt-propozime, 11 prej të cilave janë financuar, në vlerë prej gjithsej €1.08 milion. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) promovon në mënyrë aktive këto programe dhe mbështet hulumtuesit në aplikimet e tyre. Edhe numri i publikimeve që u atribuohen institucioneve të Kosovës në bazën e të dhënave Scopus ka vazhduar të rritet. Në vitin 2022 kishte 1,027 botime, rritje e konsiderueshme nga vetëm 786 botime gjithsej vitin paraprak (2021).

Këtë vit MASHTI ka përgatitë Programin Kombëtar të Shkencës 2023-2028, një strategji kombëtare e cila drejton kahjet e zhvillimit shkencor në vend. Po ashtu këtë vit kemi finalizuar edhe fuzionimin e dy ligjeve për shkencë dhe për inovacion, dhe është përfunduar koncepti i cili do të shërbejë për plotësim ndryshim të ligji për veprimtari kërkimore shkencore. Kurse për këtë vit janë planifikuar investimet për kërkim-hulumtim shkencor prej €2,4 milionë.

Edukimi në fëmijërinë e hershme, është një fushë prioritare në Strategjinë e Arsimit 2022-2026. Ky nivel edukimi, ofrohet nga institucionet parashkollore publike, private, institucionet e partneritetit publiko-privat, dhe institucionet me bazë në komunitet. Zhvillimi i edukimit në fëmijërinë e hershme, tani

rregullohet me Ligjin e ri të miratuar këtë vit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, i cili ka për qëllim ofrimin e edukimit cilësor gjithëpërfshirës në të gjitha format e organizimit të kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme për fëmijët prej lindjes deri në moshën 6 vjeçare, si dhe përcakton normat për organizimin, funksionimin, mbikëqyrjen, përgjegjësitë institucionale dhe profesionale të të gjithë akterëve për edukimin në fëmijërinë e hershme.

Në arsimin profesional, përveç shkollave profesionale, ekzistojnë edhe 6 Qendra të Kompetencës. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) deri me tani ka akredituar 104 institucione dhe ka validuar 270 kualifikime. Për fëmijët me nevoja të veçanta funksionojnë pesë (5) Qendra Burimore për mësim dhe këshillim dhe dy (2) shkolla speciale. Shkalla bruto e regjistrimit në arsimin para-universitar është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Aktualisht në Kosovë funksionojnë shtate (7) universitete publike dhe dymbëdhjetë (12) kolegje private.

Tabela 5. Regjistrimi bruto në nivelin para-universitar, në përqindje

Niveli/Viti	2020/2021	2021/22
Parashkollor (mosha 3, 4, 5 vjeç)	36.40%	37.8%
Para-fillor (mosha-5 vjeç)	88.10%	89.1%
Fillor	101.20%	101.1%
Shkolla e mesme e ulët	90.90%	91.4%
Shkolla e mesme e lartë	81.10%	79.6%

Burimi: Raport Vjetor Statistikor me Tregues Arsimor, 2021/22, SMIA, MASHTI.

Tabela 6. Numri i nxënësve dhe studentëve në të gjitha nivelet e arsimit në sektorin publik dhe privat 2022/2023

Niveli	Privat	Publik	Gjithsej	
Universitar	Bachelor	27,851	33,235	61,086
	Master	3,101	7,594	10,695
	Doktoratë		167	167
	Gjithsej	30,952	40,996	71,948
*Arsimi special (1+2+3)	111	3792	3903	
I mesëm i lartë (3)	4,344	63,029	67,373	
Fillor/mesëm i ultë (1+2)	7,611	212,967	220,578	
Parashkollor dhe parafillor (0-5)	6,630	24,366	30,996	

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2022/2023, SMIA/MASHTI dhe ASK

Më 2022 ENQA ia ka rikthyer statusin e anëtarit të asociuar Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), si autoritet i pavarur që garanton cilësinë e punës arsimore dhe kërkimore shkencore në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL). MASHTI është organi politik-bërës në fushën e arsimit, shkencës dhe kërkimeve shkencore, ndërsa veprimtarinë shkencore e kërkimore e ushtrojnë IAL, akademitë dhe institutet, si institucione vartëse të MASHTI-t, përfshirë Akademinë e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Institutin Albanologjik, Institutin e Historisë, universitetet e institucionet e tjera që merren me kërkime shkencore. Më tej, Qendra Kombëtare për Njohjen e Diplomave (NARIC), që funksionon në kuadër të MASHTI-t, bën barasvlerën e diplomave të arsimit të lartë të fituara jashtë vendit. Me kërkesë të disa shteteve ajo bën validimin/vulosjen e diplomave të fituara në IAL-të në Kosovë me qëllim të përdorimit për punësim ose vazhdim të studimeve jashtë vendit. NARIC gjithashtu kryen informimin akademik lidhur me sistemin e arsimit në Kosovë dhe sistemin e arsimit në vende të tjera.

Ndonëse Kosova zyrtarisht akoma nuk i është bashkuar Procesit të Bolonjës¹³, baza ligjore është në harmoni të plotë me praktikat aktuale arsimore dhe prioritetet e Deklaratës së Bolonjës, sidomos dispozita të caktuara të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe për lehtësimin e njohjes së mësimin paraprak dhe kualifikimeve të fituara në vende të tjera.

Kapitali fizik

Infrastruktura rrugore

¹³ Aplikimi për praninë formale është dorëzuar më 2014.

* Ky numër i nxënësve në arsimin profesional është në Qendra Burimore dhe shkolla të rregullta.

Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për të përmirësuar infrastrukturën rrugore dhe atë hekurudhore, me fokus në përfundimin e akteve rrugore kryesore ndërkombëtare e rajonale dhe linjave ndërkombëtare hekurudhore, për të mundësuar lëvizje më të shpejtë e më të lirë të qytetarëve e mallrave, dhe zvogëlim të kostos dhe distancës së transportit të njerëzve e mallrave. Kjo do t' u lehtësojë bizneseve të plasojnë mallra në tregjet vendore e ndërkombëtare, e modernizimi i rrjetit hekurudhor ndërkombëtar do të ndihmojë transportin e mallrave dhe ekonominë në tërësi. Në kontekst të dinamikës së përgjithshme të komponentëve të BPV, investimet private në vitin 2022 ishin rreth 30% e BPV dhe pritet të mbeten në nivel të njëjtë edhe në 2023 dhe 2024¹⁴. Gjatë vitit 2023, investimet publike priten të ketë një dinamikë më të shpejtë të ekzekutimit jo vetëm si rezultat i projekteve të reja të planifikuara por 32 edhe për shkak të funksionalizimit të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit në gjysmën e dytë të vitit 2022 (pas një mungese prej rreth një viti), si dhe zbatimin e kontratave bazuar në Ligjin për Përkrahjen e Punëve Publike, i cili mundëson kompensimin e rritjes së çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe punimeve vijuese. Sipas projeksioneve të KASH 2024-2026, investimet publike pritet të vazhdojnë të rriten në periudhën afatmesme.

Rrugët nacionale dhe autostradat që lidhin vendin me vendet fqinje dhe korridoret ndërkombëtare janë lidhje rrugore me rëndësi. Në këtë kontekst, ka vazhduar puna në segmentet si në vijim:

- Autostrada Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë: faza e parë nga Banulla deri në Bresalc në gjatësi prej 22.31 km është në realizim e sipër dhe pritet të përfundoj gjatë vitit të ardhshëm.
- Ndërsa sa i përket segmentit të dytë nga Bresalci deri tek Dheu i Bardhë (Kufiri me Serbinë), ndërtimi i këtij segmenti pritet të filloj gjatë vitit të ardhshëm.
- Zgjerimi i rrugës Nacionale N25 Prishtinë – Podujeve: Projekti është në realizim dhe pritet të përfundoj gjatë vitit të ardhshëm.
- Zgjerimi i rrugës nacionale N9 Prishtinë – Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq në gjatësi prej 33 km: Gjatë këtij viti janë iniciuar procedurat e prokurimit për segmentin Kijevë – Dollc në gjatësi prej 13.5 km dhe gjatë vitit të ardhshëm pritet të iniciohen procedurat e prokurimit edhe për segmentin Dollc – Zahaq.
- Zgjerimi i rrugës Nacionale N9.1 Dollc – Gjakovë: Ky projekt është në realizim e sipër dhe pritet të përfundoj gjatë vitit të ardhshëm. Me përfundimin e zgjerimit të rrugës Dollc – Gjakovë dhe Kijevë – Zahaq do të shkurtohet koha e udhëtimit nga Gjakova, Peja, Klina, Deçani dhe Istogu drejt lidhjes me Autoudhët R6 dhe R7.
- Ndërtimi i rrugës nga kycja në auto udhën “Ibrahim Rugova”, në Prizren - deri në fshatin Struzhë L=20 km: Ky projekt është në procedurë të prokurimit dhe punimet pritet të fillojnë gjatë vitit të ardhshëm, po ashtu në bashkëpunim me Maqedoninë e veriut do të ndërtohet edhe tuneli dhe kësisoj dukshëm do të shkurtohej rruga e cila lidhë Prizrenin me Tetovën.
- Në kuadër të projektit ‘Sinjalizimi i Pajisjeve Rrugore në rrugët Nacionale dhe Rajonale dhe Rrugëve Lidhëse’ në Republikën e Kosovës për periudhën 2023-2026, janë nënshkruar tetë (8) lote shtatë (7) prej tyre janë sinjalizim horizontal dhe vertikal në shtatë (7) regjione dhe një lot vendosja e pahive elastike në gjithë territorin e vendit ndërsa një (1) lot (ndriçimi publik dhe semaforët) është ende në procedura të prokurimit pasi që ka ankesë. Kontratat janë tri (3) vjeçare, dhe vlera totale e kontratave të nënshkruara deri më tani për tetë (8) lote është 1,865,502.12 €.

Gjatë vitit 2024 do të vazhdohet me projekte në fushën e sigurisë në rrugë për sinjalizim horizontal dhe vertikal, në veçanti për sinjalizimin e auto udhës R6 dhe R7.

Infrakos ShA, NP me 100% të aksioneve në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, menaxhon infrastrukturën hekurudhore në pronësi të shtetit. Rrjeti hekurudhor i Kosovës përbëhet nga 335,079 km të linjave hekurudhore. Katër linjat hekurudhore kanë nevojë për nivele të ndryshme rehabilitimi, për t' i sjellë hekurudhat në standardet moderne të shpejtësisë dhe sigurisë. Gjatë vitit të kaluar ka pasur rritje të konsiderueshme në transportin e pasagjerëve dhe të mallrave. Rrejtji hekurudhor ka një mirëmbajtje e cila garanton sigurinë e nevojshme të qarkullimit të trenave. Infrastruktura hekurudhore përbëhet nga:

¹⁴ Sipas KASH 2024-2026.

- Linja hekurudhore 10 (kufiri me Serbinë - Leshak - Mitrovicë - Fushë Kosovë - Hani i Elezit - Kufiri me Maqedoninë e Veriut), me gjatësi prej 149.110 km, njëbinarëshe, e pa elektrifikuar, me gjerësi 1435 mm, Kategoria D3, masë boshtore 22.5 ton dhe masë longitudinale 7.2 ton/m;
- Linja hekurudhore lindore (kufi me Serbinë - Podujevë - Prishtinë - Fushë Kosovë), me gjatësi prej 45.198 km, vetëm një palë binarë, e pa elektrifikuar, me gjerësi të binarëve 1435 mm, kategoria D3, masa e boshtit 22.5 ton dhe 16 ton, dhe masa longitudinale 7.2 ton/m dhe 5 ton/m.
- Linja hekurudhore perëndimore (Fushë Kosovë-Pejë) me gjatësi 81.940 km, me një palë binarë, jo e elektrifikuar, me gjerësi 1435 mm, Kategoria C2, masa e boshtit 20 ton dhe masa longitudinale 6.4 ton/ m;
- Linja hekurudhore jugperëndimore (Klinë-Xërxë-Prizren) me gjatësi 58.831 km, me vetëm një palë binarë, jo e elektrizuar, me gjatësi 1.435 mm, Kategoria D3 dhe B1, masa e boshtit 22.5 tonë dhe 18 tonë, dhe masa longitudinale 7.2 ton/m dhe 5 ton/m.

Lidhur me investimet aktuale në infrastrukturën hekurudhore, NP Infrakos ShA është duke zhvilluar projektin e modernizimit të linjës hekurudhore 10, i cili është pjesë e rrjetit kyç ballkanik dhe vazhdim i rrjeteve Trans-Evropiane të transportit. Projekti është i ndarë në tri faza: (i) punimet në fazën e parë kanë vazhduar dhe deri më tani kanë përfunduar 72,3% të punëve në linjë. Deri më tani janë ndërtuar gjithsej 57.52 km, prej tyre 49.18 km binarë në linjë të hapur dhe 8.34 km binarë në stacione; (ii) në fazën e dytë të punimeve janë zhvilluar bisedime për të shmangur pretendimet e njoftimet për shkaputjen e kontratës nga të dy palët, nga të cilat ka dalë si përfundim që të bëhet korigjimi i çmimit që aplikohet sipas Indeksit të Ndërtimit të publikuar nga ASK dhe është dhënë urdhri i ri për fillimin e punimeve. Nga 10 tetori 2022 këto rregullohen me amendamentin A1 për kontratën e projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore të fazës së dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë) dhe punët për këtë fazë parashihet të përfundojnë më 8 janar 2024; (iii) për fazën e tretë, Mitrovicë – Leshak – kufiri me Serbinë, ka filluar hartimi i projekt dizajnit.

Kanë nisur përgatitjet për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe dizajnit konceptual për projektin e linjës hekurudhore Kosovë-Shqipëri. Më 20.06.2022 dy Qeveritë kanë nënshkruar marrëveshjen për financimin e studimit të fizibilitetit dhe dizajnit konceptual. Hapi i radhës është që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë të publikojë tenderin., ndërsa vlerësimi i ofertave dhe përzgjedhja e kompanisë fituese pritet të bëhet nga grupi i përbashkët i ekspertëve.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) është themeluar me Ligjin nr. 03/L-076 dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës. ARH është institucioni i pavarur për rregullimin, mbikëqyrjen dhe organizimin e sektorit hekurudhor në Kosovë, dhe gjithashtu vepron si organ licencues, për çështjet e inter-operabilitetit dhe entiteteve të njoftimit, për rregullimin e tregut hekurudhor dhe për sigurinë e hekurudhave. Organi për hetimin e aksidenteve/incidenteve hekurudhore funksionon në kuadër të ZKM-së, pra është i pavarur nga ARH.

Në janar 2023 Qeveria ka miratuar Strategjinë Sektoriale të Transportit Multimodal 2023-2030, e cila përfshin sektorin e hekurudhave, dhe gjithashtu reflekton interoperabilitetin e sistemit hekurudhor, sigurinë dhe standardet e sistemin hekurudhor evropian, dhe strategjitë e zhvilluara sipas Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Transportit për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Transporti ajror

Kosova ka Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) “Adem Jashari”, që operon me shërbime të kombinuara civile dhe ushtarake. Në prill 2010 ka hyrë në fuqi Kontrata e partneritetit publiko-privat ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe konsorciumit Turko-Francez Limak-Aeroport de Lyon për dhënie me koncesion të ANP-së, dhe ky është një nga projektet e suksesshëm të koncesionimit në EJJL.

Terminali lëshuar në operim më 23 tetor 2013 është një investim prej rreth €100 milionë dhe ofron më shumë komoditet për udhëtarët, shërbime të nivelit të parë si dhe hapësirë të mjaftueshme dhe një mjedis social e relaksues për pasagjerët gra dhe burra. Terminali ka 44,000 m² dhe kapacitet që mundëson pritjen e rreth 4 milionë pasagjerëve në vit. Si pjesë e rrjetit themelor rajonal dhe ndërkombëtar, mbetet si synim zgjerimi dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të këtij aeroporti.

Në fillim të vitit 2022 ka përfunduar projekti i financuar nga MMPHI, me vlerën mbi €33 milionë, *Zgjatja e pistës, ngritjes së sistemit instrumental të aterimit dhe sistemit të radiokomunikimeve në ANP "Adem Jashari"*. Pista është zgjatur nga 2,500 metra në 3,040 metra, ndërsa janë ngritur edhe kapacitetet teknike të ASHNa.

ANP "Adem Jashari" tash operon në kategorinë IIIb të aeroportëve dhe ofron nivelin më të lartë të kushteve të sigurisë së operimeve për të gjitha kategoritë e aeroplanëve.

Këto investime e kanë mundësuar edhe rritjen e numrit të udhëtarëve dhe këtë vit pritet që numri i udhëtarëve të arrijë shifrën rekorde prej rreth 3.3 milion udhëtarëve.

Energjia

Sistemi i energjisë elektrike në Kosovë përbëhet nga gjenerimi, transmissioni, shpërndarja, konsumatorët e parregulluar, si dhe konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal. Pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike janë edhe furnizuesit dhe tregtarët me shumicë.

Gjithashtu funksionojnë dy sisteme të ngrohjes qendrore. Ngrohja e hapësirave në Kosovë realizohet në masën dërmuese nga biomasa (kryesisht dru zjarri), nga energjia elektrike, në masë të vogël nga thëngjilli dhe lëndët e tjera, si dhe ngrohja qendrore në Prishtinë dhe Gjakovë. Sektori i ngrohjes së përqendruar në Kosovë përbëhet nga 4 ngrohjet (Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan). Ngrohjet e Prishtinës, Termokos, është e kyçur në sistemin e kogjenerimit në TC *Kosova B*. Kjo ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e cilësisë së furnizimit me ngrohje dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit. Ngrohjet e Re në Gjakovë, me biomasa, ka filluar operimin duke furnizuar 40% të qytetarëve me ngrohje të cilësisë së lartë.

Në mungesë të sistemit të gazit natyror dhe marrë parasysh sistemin tejte të kufizuar të ngrohjes qendrore, aktualisht barra kryesore e sigurimit të furnizimit të konsumatorëve me burime energjetike bie mbi sistemin e energjisë elektrike.

Kosova ka siguruar pavarësinë energjetike me Marrëveshjen e re për kyçe ndërmjet KOSTT-it dhe ENTSO-E-së. Nga dhjetori 2020 KOSTT operon si zonë rregulluese e pavarur brenda bllokut AK (Shqipëri-Kosovë) në kuadër të zonës sinkrone të Evropës kontinentale. Alokimi i kapaciteteve të interkonjeksionit dhe menaxhimi i kongjestionëve të rrjetit ndërlidhës realizohet brenda strukturës së këtij blloku. Kjo i ka hapur rrugë KOSTT-it për integrimin në tregun rajonal të energjisë, pjesëmarrjes në bursën shqiptare të energjisë (ALPEX) si dhe vënies në operim të linjës 400 KV Kosovë-Shqipëri.

Gjenerimi është kryesisht i bazuar në termocentralet me linjit (TC *Kosova A* dhe TC *Kosova B*) dhe BRE-të (energji ujore, të erës dhe të diellit). *Transmetimi i energjisë elektrike*: KOSTT, 100% në pronësi të Republikës Kosovës, ku të drejtat e aksionarit i ushtron Kuvendi, është operator i vetëm i transmetimit dhe tregut. Ai operon me dy licenca të ndara: për operim të sistemit të transmissioinit dhe për operim të tregut. Operatori i tregut ka përgjegjësi organizimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike, ndërsa ai i transmissioinit transmetimin e energjisë elektrike, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit, si dhe balancimin e sistemit. *Shpërndarja e energjisë elektrike*: KEDS, në pronësi private, është operator i vetëm i sistemit të shpërndarjes. Ai është përgjegjës për operimin e mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes dhe menaxhimin e gjeneratorëve të kyçur në të. KESCO është furnizues që ka licencë për furnizim me energji elektrike, përfshirë *Obligimin e Shërbimit Publik* të përcaktuar nga rregullatori për të furnizuar konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal.

Sipas të dhënave të vitit 2021, barra e gjenerimit të energjisë elektrike bie mbi termocentralet me bazë thëngjillin/linjtin. Ato mbulojnë rreth 93% të gjithë prodhimit të energjisë elektrike, ndërsa pjesa tjetër sigurohet nga centralet me energji nga BRE (në masën më të madhe nga hidrocentralet, kryesisht të vogla) dhe nga importi. Prodhimi i energjisë elektrike bëhet kryesisht nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK ShA), pjesë e së cilës janë dy TC (*Kosova A* dhe *Kosova B*) dhe minierat e qymyrit. Këto TC kane filluar së operuari në vitet 1970, përkatësisht 1980, dhe si të tilla janë të vjetruara dhe vazhdimi i operimit të tyre kërkon investime në përputhje me kushtet mjedisore të bazuar në parametrat e BE-së. Prandaj, gjatë viteve në vazhdim planifikohet të zhvillohen investime në TC *Kosova B*.

Kosova, si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, është dakorduar në korrik 2022 për caqet e dekarbonizimit, të cilët janë reflektuar edhe në Strategjinë e Energjisë 2022-2031, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në mars 2023. Ky dokument themelor politikash ka 5 objektiva strategjike: përmirësimi i besueshmërisë së sistemit energjetik; dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme; rritja e efikasitetit të energjisë; (iv) forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut; dhe mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve.

Ministria e Ekonomisë, më 12.05.2023, ka shpallur hapjen e procesit konkurrues për dhënien e çmimit të garantuar të blerjes për energjinë e prodhuar nga një central solar fotovoltaik (FË) prej 100 MË, i cili do të ndërtohet në pronë publike. Centrali solar fotovoltaik do të ndërtohet në zonën kadastrale të Kramovikut dhe Petkoviqit në Komunën e Rahovecit, e cila do t'i jepet me qira ofertuesit të përzgjedhur për një periudhë jo më të shkurtër se 30 vjet.

Krahas kësaj, me mbështetjen e donatorëve Kosova do të zhvillojë një projekt me kapacitet prej 100 MË, në kuadër të KEK-ut, si dhe një me kapacitet prej 50 MË depozitë të energjisë së ngrohjes me furnizim nga BRE-të, që do të furnizojë Termokosin me energji për ngrohje.

Me qëllim të rritjes së fleksibilitetit të sistemit dhe arritjes së objektivave strategjike, Kosova ka nënshkruar Marrëveshje me MCC për zhvillimin e një projekti të depozitimit të energjisë elektrike, me kapacitet 170 MË (340 MËH), i cili do të lehtësojë integrimin e BRE në sistemin e energjisë elektrike.

Institucionet kryesore përgjegjëse në fushën e energjisë janë: Ministria e Ekonomisë (ME); Fondi i Kosovës për Efikasitetin e Energjisë (FKEE); Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRË) si agjenci e pavarur rregullative përgjegjëse për rregullimin e tregut të energjisë (energjisë elektrike, gazit natyror dhe energjisë së ngrohjes); Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), agjenci e pavarur rregullative përgjegjëse rregullimin e aktiviteteve minerare, ku bën pjesë edhe thëngjilli; dhe KOSTT ShA, ndërmarrje publike që menaxhon rrjetin e transmissioinit dhe është operator i sistemit të transmissioinit dhe tregut. Institucionet e tjera qeveritare, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Komisioni i Konkurrencës, kanë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e përgjegjësiave sociale, ekonomike dhe mjedisore në sektorin e energjisë. Në zhvillimin e politikave në këtë fushë ka rol edhe Kuvendi, i cili miraton ligjet dhe Strategjinë e Energjisë.

Tregu i komunikimeve elektronike

Në Kosovë sektori i komunikimeve elektronike dhe TI-së ka rëndësi të madhe ekonomike. Në vitet e fundit pjesëmarrja e tij në BPV arrin rreth 2.2%. Sa u përket zhvillimeve në treg, telefonia fikse historikisht është pak e zhvilluar. Në treg aktualisht janë këta operatorë aktivë për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese fikse: (1) Telekom i Kosovës ShA (ish PTK), e licencuar më 30.07.2004; (2) IPKO Telecommunications ShPK, e licencuar më 08.09.2006; (3) Kujtesa.net, e licencuar më 07.01.2014; (4) Fiberlink (Vendimin nr. 607, nr. prot. 013/B/15, ka caktuar bllokun numerik nga seria e numeracionit gjeografik për përdorim nga 'FiberLink' ShPK.); (5) Mts d.o.o., me autorizim të përgjithshëm sipas marrëveshjes së telekomunikacionit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e BE-së.

Trendi në rënie i *telefonisë fikse* ka vazhduar nga vitet e kaluar. Norma e penetritimit të telefonisë fikse në Kosovë vazhdon të jetë shumë e ulët krahasuar me vendet e rajonit, e edhe me shtetet e BE-së. Pjesëmarrjen më të lartë në treg e ka kompania publike Telekom i Kosovës, e ndjekur nga kompania IPKO dhe pastaj MTS D.O.O dhe Kujtesa. Sidoqoftë, të gjithë indikatorët e telefonisë fikse tregojnë për një zhvillim shumë të ngadalshëm dhe në rënie. Në tremujorin e tretë të vitit 2023, numri i përdoruesve të telefonisë fikse ishte 67,287 dhe kishte një rënie prej 5.5% nga periudha e njëjtë e vitit paraprak.

Lidhur me *shërbimet postare*, Ligji nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare vendos rregullat për sigurimin e ofrimit të shërbimit postar dhe shërbimit universal postar në tërë territorin e vendit, përcakton standardet për shërbimin universal postar dhe vendos një sistem për të siguruar respektimin e këtyre standardeve. Ai është pjesërisht në harmoni me Direktivën 97/67/KE të PE dhe Këshillit. Sipas të dhënave të ARKEP-it, kemi një rënie të theksuar të numrit të përgjithshëm të dërgesave postare. NP Posta e Kosovës ShA mbulon

tregun e përgjithshëm të shërbimeve postare me 86.9% kurse operatorët privatë janë të përfaqësuar në vlerën 13.10% të tregut të përgjithshëm.

Tregu i telefonisë mobile ka shtrirjen më të gjerë në gjithë komunikimet elektronike. Shërbimet e telefonisë mobile në Kosovë ofrohen nga tre operatorë në brezin frekuencor 900/1800 MHz përfshirë operatorin me autorizim të përkohshëm dhe të kufizuar në infrastrukturë mts D.O.O.: (1) Telekom i Kosovës Sh.a/Vala licencuar më 30.07.2004, për 15 vjet, ndërsa me Vendimin nr. 1419, në 30.07.2019, ARKEP ka ripërtërirë të drejtën e shfrytëzimit të resurseve frekuencore për 20 vjet; (2) IPKO Telecommunications LLC e licencuar më 06.03.2007, për 15 vjet, ndërsa me Vendimin nr. 1420, më 30.07.2019, ka ripërtërirë të drejtën së shfrytëzimit të resurseve frekuencore për 20 vjet; dhe (3) Mts D.O.O., me autorizim të përkohshëm bazuar në marrëveshjen e telekomunikacionit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga BE (kjo ndërmarrje ofron shërbime përmes infrastrukturës së kufizuar vetëm në lokacione të caktuara dhe nuk ka të drejtën e shtrirjes). Krahas këtyre tre operatorëve të autorizuar të rrjeteve të telefonisë mobile, në Kosovë operon edhe një operator mobil virtual: Dukagjini Telecommunications ShA (D3 mobile), i licencuar më 24.06.2008, i cili ofron kryesisht shërbime M2M. Numri total i përdoruesve të telefonisë mobile në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023 ishte 1,949,961, me një rritje prej 0.3% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Numri i linjave të internetit me qasje fikse brezgjere deri në tremujorin e dytë të vitit 2022, i raportuar nga operatorët, kap shifrën prej 399,132 parapaguesish. Nga kjo vihet re një rritje prej 0.4% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Penetrimi i internetit sipas banorëve (për 100 banorë) rezulton të jetë 21.98%. Shkala e shpërndarjes së internetit përmes qasjes fikse brezgjere në internet për ekonomi familjare është 134.3%. Numri i përdoruesve të shërbimeve të internetit mobil (Mobile Broadband) apo qasja në internet përmes rrjetit mobil 3G dhe 4G në periudhën TM3 2023 ka arritur në 1,734,558 përdoruesish e që shënon një rritje prej 14.0% krahasuar me TM2 2023, dhe një rritje prej 5.2% krahasuar me TM3 2022. Sa i përket ndarjes së tregut të shërbimeve të internetit sipas përdoruesve për operator, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023, Telekom i Kosovës kishte 6.11%, IPKO 27.75%, Kujtesa 15.18%, Artmotion 28.43% dhe të tjerët pjesën e mbetur.

Korniza rregullative dhe ajo e politikave: Ligji për Komunikimet Elektronike dhe legjislacioni zbatues vendosin një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore në harmoni me direktivat e BE-së (pakon e direktivave të vitit 2009 për komunikimet elektronike, plotësim-ndryshim i pakos së direktivave të vitit 2002). Ky ligj, ndër të tjera, ka krijuar bazën ligjore për kalimin nga regjimi i licencave në atë të autorizimeve të përgjithshme për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike. Kjo nënkupton më tepër mundësi dhe përmirësim cilësor të ambientit për investime të reja dhe konkurrencë të drejtë, gjë që është një nga synimet (prioritetet) kryesore të Qeverisë. Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike (Direktiva (BE) 2018/1972) është në proces transpozimi. Më 10.05.2023 Qeveria ka miratuar Koncept Dokumentin për Kodin e Komunikimeve Elektronike, dhe do të vazhdohet me hartimin e kodit të komunikimeve elektronike, i cili synohet të miratohet deri në mesin e vitit 2024. Më 29.06.2023 Qeveria ka miratuar Agjendën Digjitale të Kosovës, e cila reflekton objektivat strategjike të Agjendës Digjitale për Evropën, si dhe merr parasysh dhe i përshtatet realitetit dhe gjendjes së sektorit të TI-së në vend.

Struktura sektoriale dhe ajo e ndërmarrjeve

Struktura e ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik dominohet nga sektori i tregtisë. Sipas të dhënave të ARBK-së (tetor 2023), shpërndarja e tyre në sektorë është si në vijim: tregtia 2,309 sosh (23.8%); aktivitetet profesionale shkencore dhe teknike 1,026 sosh (10.6%); industria përpunuese/prodhimi 998 sosh (10.3%); ndërtimtaria, 994 sosh (10.2%) hoteleria dhe akomodimi, 935 sosh (9.6%); aktivitetet tjera shërbyese, 656 sosh (6.7%) etj..

Numri total i bizneseve të reja të regjistruara në ARBK deri në tetor 2023 është 9704. në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2022 (9243), ka afërsisht 2.4% më shumë biznese të regjistruara. Numri i bizneseve të mbyllura është 1,325, rreth 4.2% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 (1,441). Numri i bizneseve të regjistruara me pronarë të huaj është 688, krahasuar me 742 në të njëjtën periudhë të vitit 2022.

Numri i bizneseve të regjistruara në pronësi të grave është 2,578, rreth 3.26% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2022 (2,415).

Tabela 7. Numri i bizneseve të regjistruara, 2015 – tetor 2023

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	janar – tetor 2023
Të regjistruara	9,833	10,553	9,335	9,966	10,054	9,805	9,854	11044	9704
Të shuara	2,205	2,378	1,589	1,892	1,766	1,356	1,412	1768	1325
Me pronare gra	2,020	2,332	2,096	2,443	3,016	1,764	2,534	2844	2578

Burimi: Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK)

Sektori i industrisë në Kosovë është i dominuar nga mikro ndërmarrje, me rreth 86%. Kosova ka një bazë të vogël industriale të përqendruar në aktivitetet me vlerë të shtuar të ulët me konkurrencë të kufizuar të eksportit dhe të përqendruar në pak produkte dhe tregje të eksportit. Kosova nuk ka treguar ndonjë ndryshim strukturor në përbërjen e ekonomisë së saj. Sektori i prodhimit merr pjesë me rreth 13=14% të vlerës së shtuar në BPV, dhe renditet në vendin e tretë pas shërbimeve dhe ndërtimit/minierave.

Sektori i Industrisë përpunuese (Sektori C) në Kosovë, në vitin 2022 ka marr pjesë në punësim me rreth 12%, në qarkullim me 13.74%, me numrin e ndërmarrjeve me 12.9%, si dhe pjesëmarrja në BPV është rritur për 2.32%, krahasuar me vitin 2021. Sektori C, në eksportin e përgjithshëm është rreth 83% në vitin 2022, kurse në importin e përgjithshëm është 93%, në të njëjtin vit.

Tabela 8. Statistikat vjetore të tregtisë së industrisë përpunuese (2020 – 2022¹⁵ Vitet (në €)

	2020	2021	2022
Eksporti i produkteve të industrisë përpunuese	398,461,079	626,341,608	763,936,150
Importi i produkteve të industrisë përpunuese	3,061,352,367	4,338,794,494	5,244,635,490

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Sa i përket mbështetjes së NVM-ve, MINT gjatë 2023 ka subvencionuar NVM-të për blerjen e makinerive prodhuese. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve prodhuese si dhe rritjes së aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve tona në tregun vendor dhe të jashtëm, gjatë vitit 2023 janë nënshkruar 36 marrëveshje me biznese, në vlerë prej €700,000 sipas thirrjet publike, të cilat kanë qenë përfituese të vitit 2022, por janë nënshkruar në 2023. Derisa në tremujorin e fundit kemi mbështetur edhe 35 ndërmarrje tjera përfituese, në vlerë prej €1 milion sipas thirrjes dhe aktualisht janë në fazën e implementimit.

Me qëllim të nxitjes së bizneseve vendore për rritjen e kapaciteteve prodhuese, në veçanti përmirësimin e cilësisë së produkteve me qëllim të rritjes së eksportit, KIESA është duke i përkrahë financiarisht 8 kompani për certifikimin e produkteve, të cilët përmes kësaj skeme do të rrisin standardin e cilësisë së produkteve.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka ndërtuar portofol i cili deri në shtator 2023 ka arritur vlerën kumulative të kredive të garantuara në €586,1 milionë, €309,2 milionë garancione të miratuara dhe 13,613 kredi të shpërndara deri më tani.

Përmes garantimit të kredive, Fondi ka ndikuar në përmirësimin e performancës së NMVM-ve me investimet e bëra nga kreditë e garantuara. Përmes zhvillimit të biznesit, kreativitetit e inovacionit FKKGK ka lehtësuar qasjen në financa duke ndihmuar kështu zhvillimin e ekonomisë.

Integrimi ekonomik me BE-në dhe konkurrueshmëria e çmimeve

Deficiti tregtar i Kosovës gjatë nëntëmujorit të vitit 2023 ka arritur shifrën prej €3.6 miliardë. Mbulimi i eksportit me import rezulton me rënie në janar-shtator 2023 është 15%, 17% në periudhën e njëjtë të vitit 2022 dhe 16% në atë të vitit 2021. Deri në shtator 2023 shkëmbimet tregtare në mallra kanë shënuar vlerën e përafërt prej €4.9 miliardë, rritje prej €48 milionë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Mallrat e eksportuar janë në vlerë prej €640.8 milionë, rënie për €47.1 milionë ose 7% krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2022. Pjesëmarrja e eksporteve në BPV gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 është 10%, 11% në 2022 dhe 9.4% 2021. Importet janë në vlerë prej mbi €4.2 miliardë rritje për €95.3 milionë me e lartë për 2%.

¹⁵ Të dhënat për eksportin dhe importin për industrinë përpunuese, për vitin 2022 janë preliminare, gjatë kalkulimit është marrë për bazë përqindja e industrisë përpunuese e vitit 2021 dhe është kalkuluar me vlerën totale të eksportit dhe importit të viti 2022.

Mallrat e eksportuara në BE-27 janë në vlerë prej €203.6 milionë, ose 32% të totalit të eksporteve, rënie për 11% krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2022.

Importet nga BE janë në vlerë prej mbi €1.8 miliard, rritje për 3.5% si dhe pjesëmarrje në importin e përgjithshëm prej 43%. Eksportet në CEFTA janë në vlerën prej €256.8 milionë, mbulojnë 40% të gjithsej eksporteve, rritje për 3%. Mallrat e importuar në CEFTA kane arritur vlerën prej €700 milionë ose 16% të totalit të importeve, rënie për 5% krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2022. Presionet inflacioniste në vendet e Eurozonës, me të cilën Kosova realizon pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare, u reflektuan në ekonominë e vendit. Andaj, zhvillimet në nivelin e çmimeve në vend vazhdojnë të përcaktohen nga lëvizja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, për shkak të varësisë së lartë të ekonomisë së vendit në importe, gjë që konfirmohet edhe me sjelljen e ngjashme të indeksit të çmimeve të konsumit me indeksin e çmimeve të importit.¹⁶

Investimet e Huaja Direkte në Kosovë (IHD-të), në vitin 2022 ishin €778.2 milionë, një rritje për 85% krahasuar me vitin paraprak, ndërsa në nëntë muajt e parë të vitit 2023 IHD në Kosovë kanë arritur në €612.7 milionë, sipas Bankës Qendrore (rreth €200,000 më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Harmonizimi i arsimit dhe aftësisë profesionale me kërkesat e tregut të punës dhe zbatimi i Kornizës së Kurrikulës;
- Menaxhimi efektiv i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet;
- Përmirësimi i cilësisë dhe integritetit të arsimit të lartë, në harmoni me standardet ndërkombëtare;
- Zbatimi i punësimit të garantuar, dhe ndërlidhur me këtë edhe forcimi i kapaciteteve të qendrave të punësimit dhe reforma e arsimit dhe aftësisë profesionale (AAP);
- Zbatimi i strategjisë për zhvillim industrial dhe mbështetje të bizneseve 2030
- Mbështetja e bizneseve në certifikimin e produkteve sipas standardet evropiane e ndërkombëtare përmes granteve të vogla për NMVM-të dhe subvencioneve për NMVM për blerjen e makinerive prodhuese /përpunuese, duke siguruar, aty ku është e mundur, përfaqësim të barabartë gjinor;
- Promovimi i eksportit përmes përgatitjes së NVM-ve për eksport dhe identifikimit/zhvillimit të tregjeve potenciale;
- Hartimi i Politikave të NMVM-ve përmes zhvillimit të instrumenteve të reja për mbështetjen e NMVM-ve dhe bizneseve fillestare (skema për start-up, skema për zejtarin).

¹⁶ Indeksi i çmimeve të importit në tremujorin e dytë 2023 pati rritje vjetore prej 5% që përbën ngadalësim krahasuar me rritjen prej 8.6% në tremujorin e parë.

3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË

3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së

Përafrimi dhe zbatimi i legjislacionit kombëtar me *acquis*-në e BE-së është parakusht për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në BE. Ky parakusht është i përcaktuar në nenin 74 të MSA-së. Përafrimi nënkupton pajtueshmërinë e legjislacionit kombëtar me *acquis* dhe përban dy komponentë: marrjen përsipër të detyrimeve që rrjedhin nga *acquis*, dhe zbatimin e saj në praktikë. Përafrimi i legjislacionit të bëhet sipas një programi të akorduar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe KE-së, i njohur PKIE, që parashihet prioritetet dhe modalitetet për monitorimin e përputhshmërisë së përafrimit të legjislacionit dhe zbatimit në praktikë.

Korniza legjislative dhe ajo institucionale

Prioritetet dhe reformat për përafrim të legjislacionit janë të përcaktuara në PKIE. Zbatimi i *acquis* kërkon kapacitete administrative, mekanizma ligjorë dhe udhëzues për përafrimin e legjislacionit. Përafrimi i legjislacionit rregullohet nga këto akte nënligjore dhe udhëzues/manuale ndihmës:

- Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Rregullorja për Shërbimin Ligjor Qeveritar;
- UA për Standardet e Hartimit të Akteve Normative;
- Udhëzuesi Praktik për Përafrimin e Legjislacionit të Republikës së Kosovës me atë të BE-së;
- Manuali Praktik për Plotësimin e Tabelave e Deklaratës së Përputhshmërisë me Acquis të BE-së.

Vlerësimi i përafrimit të legjislacionit kalon nëpër disa hapa proceduralë. Hapi fillestar nis nga institucioni përgjegjës që harton projekt-aktin juridik, i cili përmes përpilimit të Deklaratës së Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelave të Përputhshmërisë (TeP) me *acquis* të BE-së paraprakisht vlerëson nivelin e përafrimit. Hapi tjetër është Opinioni Ligjor i Pajtueshmërisë (OLP) me *acquis* të BE-së, i cili përmbledh dy lloje gjetjesh: pjesën substanciale dhe materiale të *acquis* së BE-së brenda projekt-aktit normativ. Pas pranimit të OLP, institucioni përgjegjës që ka hartuar projekt-aktin juridik e përcjell në ZKM për miratim në ZKM. Pas miratimit nga Qeveria, projektligjet në pako dorëzohen në Kuvend për miratim, përkatësisht komisioneve relevante, të cilët bëjnë analizën dhe rishikimin e projektligjit përkatës. Pas miratimit nga komisioni PL dërgohet për miratim përfundimtar nga Kuvendi në seancë plenare.

I tërë procesi i përafrimit të legjislacionit ndërlihet me përkthimin e *acquis*-së në gjuhët zyrtare të Kosovës (gjuhën shqipe dhe atë serbe), i cili është pjesë integrale e procesit të përafrimit. Ky proces është i rregulluar me Rregulloren për Procesin e Përkthimit të Legjislacionit të BE-së në Gjuhët Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila përcakton procedurat e përkthimit, koordinimin e procesit dhe unifikimin e terminologjisë së *acquis* në gjuhët zyrtare nacionale. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, më 2015 është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi për krijimin e Komisionit Teknik për Përkthimin e Legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe dhe bashkëpunimit në sferën e përafrimit të legjislacionit, për koordinimin e agjendës së përbashkët të përkthimit të akteve të BE-së dhe shkëmbimin e *acquis*-së së përkthyer. Ky komision gjithashtu ka krijuar platformën elektronike 'albterm.net', ku azhurnohen aktet e *acquis* të përkthyer në gjuhën shqipe në bazë të kalendarit vjetor të përkthimit, i cili miratohet nga Qeveria. Gjithashtu ekziston një Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" për përkthimin e *acquis*-së.

Zyra Ligjore e ZKM-së, përmes Divizionit për të Drejtën e BE-së, është institucioni koordinues përgjegjës për vlerësimin e përafrimit të legjislacionit, ndërsa përgjegjës në nivel të institucioneve të linjës janë Departamentet Ligjore dhe njësitë ekuivalente të institucioneve të pavarura. Në Kuvend në procesin e përafrimit përfshihet DP për Çështje Ligjore dhe Procedurale dhe komisionet parlamentare.

Objektivat e prioritare afatmesme:

Përafrimi i legjislacionit:

- Rishikimi i UA për Standardet e Hartimit të Akteve Normative;
- Funksionalizimi i Sistemit online për Përafrimin e Legjislacionit;

- Trajnimet profesionale për përafrimin e legjislacionit në fushat prioritare: Liria e lëvizjes së mallrave; E drejta e themelimit të ndërmarrjeve dhe liria e ofrimit të shërbimeve; Prokurimi publik, E drejta e kompanive; E drejta e pronësisë intelektuale; Konkurrenca; Gjyqësori dhe të drejtat themelore; dhe Drejtësia, liria dhe siguria.

Përkthimi i legjislacionit:

- Rritja e numrit të akteve të *acquis* së BE-së të përkthyer në gjuhët zyrtare të Kosovës;
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesit (ministrive të linjës) në Kosovë dhe me vendet e rajonit për përkthimin e akteve të *acquis* së BE-së;
- Hartimi i udhëzuesit për certifikimin e *acquis* së BE-së në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës;
- Azhurnimi i vazhdueshëm të platformës elektronike 'albterm.net' për publikimin e akteve të BE-së të përkthyer në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

3.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Ky kapitull siguron zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë për të mundësuar tregtimin e produkteve në tregun e brendshëm të BE-në sipas rregullave e procedura të përbashkëta. Ky parim i përgjithshëm plotësohet nga një kornizë rregullatore e harmonizuar, sipas 'qasjes së vjetër' (me specifikime për produkte) ose 'qasjes së re' (me kërkesa të përgjithshme për produkte). Kur produktet rregullohen nga rregullat kombëtare, parimi i lëvizjes së lirë të mallrave i pengon këto të krijojnë barriera të pajustificueshme ndaj tregtisë. Pjesa më e madhe a *acquis*-së që duhet transpozuar në këtë kapitull përbëhet nga ajo për produktet, ndërsa kapacitetet e mjaftueshme administrativ janë thelbësore për të njoftuar kufizimet në tregti dhe aplikuar masa horizontale e procedurale në fusha si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 thekson se Kosova është në mes të një niveli të moderuar të përgatitjes në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Është arritur progres i pjesshëm me miratimin e Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve dhe me përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së për mbikëqyrjen e tregut dhe për njohjen reciproke. Nevojitet harmonizim i mëtejshëm me *acquis* të BE-së në këtë fushë dhe Kosova duhet të rrisë numrin e stafit dhe të përmirësojë aftësitë e stafit në fushën e infrastrukturës së cilësisë (veçanërisht vlerësimi i konformitetit dhe mbikëqyrja e tregut). BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Të ngrit kapacitetet zbatuese për vlerësimin e konformitetit dhe trupave të mbikëqyrjes së tregut;
- Të filloj zbatimin e Ligjit të ri për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe Ligjit për inspektimet dhe të miratoj legjislacionit përkatës sekondar;
- Të filloj zbatimin e kërkesave të Rregullores Evropiane për regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH).

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni horizontal

Akti kryesor legjislativ për standardizim është Ligji nr. 06/L-019 për Standardizim, në fuqi nga shkurti 2018. Në harmoni me kërkesat e *acquis*-së së BE, ai përcaktohen rregullat dhe parimet për zhvillimin e aktiviteteve të standardizimit në Republikën e Kosovës, si dhe organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kosovare të Standardizimit. Gjithashtu janë në fuqi 6 akte nënligjore, të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante.

Akti kryesor legjislativ për akreditim është Ligji nr. 05/L-117 për Akreditim. Në harmoni me kërkesat e *acquis*-së së BE, ky ligj përcakton parimet e akreditimit dhe rregullat për akreditimin e trupave të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit në Kosovë. Gjithashtu janë në fuqi 4 akte nënligjore, të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante.

Akti kryesor legjislativ për vlerësim të konformitetit është Ligji nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit. Në harmoni me kërkesat e *acquis*-së, ai rregullon mënyrën e

përcaktimit të kërkesave teknike për produkte dhe miratimin e rregulloreve teknike, vlerësimin e konformitetit të produkteve me kërkesat e përcaktuara teknike, detyrimet e operatorëve ekonomikë të produkteve e pronarëve të produkteve në përdorim, vlefshmërinë e dokumenteve të huaja të konformitetit dhe shenjave të konformitetit, notifikimin e rregulloreve teknike e procedurave për vlerësimin e konformitetit, si dhe mbikëqyrjen inspektuese në zbatimin e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve teknike që kanë të bëjnë me përputhshmërinë dhe sigurinë e produkteve jo-ushqimore. Gjithashtu janë në fuqi 11 akte nënligjore vertikale, të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante.

Akti kryesor legjislativ për metrologji është Ligji nr. 06/L-037 për Metrologjinë. Në harmoni me kërkesat e *acquis*-së, ai rregullon sistemin e njësisve dhe etalonëve për matje, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e parapaketuara, autorizimet për metrologjinë, mbrojtjen e konsumatorëve dhe sigurisë së përgjithshme nga rezultatet e pasakta të matjeve. Gjithashtu janë në fuqi 17 akte nënligjore, të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante.

Aktet kryesore legjislative për mbikëqyrjen e tregut janë: Ligji nr. 06/L-041 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit (për hollësi, shihni pjesën për vlerësimin e konformitetit), Ligji nr. 08/L-172 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, dhe Ligji nr. 03/L-181 mbi Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese. Ligji 08/L-172 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve është miratuar nga Kuvendi dhe publikuar në Gazetën Zyrtare me 03.04.2023, është plotësisht në përputhje me Direktivën 2001/95/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 3 dhjetor 2001, për sigurinë e përgjithshme të produkteve, dhe Direktivën 357/87/KE, të datës 25 qershor 1987, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për imitimin e produkteve ushqimor dhe përcakton kërkesat për sigurinë e përgjithshme të produkteve, detyrimet e prodhuesve dhe shpërndarësve, informimin e publikut, nxitjen e masave vullnetare si dhe mbikëqyrjen ndaj përmbushjes së kërkesave të përcaktuara me këtë ligj. Ligji mbi Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese, në harmoni me kërkesat e *acquis*-së, përcakton parimet, organizimin, kompetencat e procedurat e mbikëqyrjes inspektuese të tregut në territorin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu janë në fuqi katër (4) akte nënligjore, të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante.

Qasja e re dhe ajo globale

Në kuadër të qasjes së re dhe asaj globale bëjnë pjesë këto fusha: Pajisjet e tensionit të ulët (LVD), Përputhshmëria elektromagnetike (EMC), Siguria e lodrave, Makineritë, Emetimet e zhurmës nga pajisjet që përdoren jashtë objekteve, Ashensorët, Pajisjet personale mbrojtëse (PPE), Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes (ATEX), Pajisjet me gaz dhe bojlerët me ujë të nxehtë, Pajisjet e thjeshta nën presion (SPVD), Aerosolët dispensave, Teleferikët, Produktet ndërtimore, Barkat rekreative, Kërkesat e eko-dizajnit për produktet e ndërlidhura me energjinë (ErP) dhe etiketimi energjetik i produkteve, Radio-pajisjet dhe pajisjet terminale tel komunikuese (R&TTE) Rregulloren teknike për radio-pajisjet, Eksplozivët për përdorim civil dhe të artikujve piroteknikë, Produktet dhe pajisjet mjekësore.

Qasja e vjetër

Sa i përket qasjes së vjetër, përveç prodhuesve të produkteve përkatëse, shteti është gjithashtu përgjegjës për sigurinë e produkteve dhe për këtë arsye duhet krijuar dhe fuqizuar autoritetet përkatës shtetërore për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit (p.sh. regjistrimin, vlerësimin dhe miratimin). Në kuadër të qasjes së vjetër bëjnë pjesë fushat si në vijim: automjetet motorike, emetimet të ndotësve nga motorët e makinerive të lëvizshme jo-rrugore, kimikatet (Regjistrimi, Vlerësimi, Autorizimi dhe Kufizimi i Kimikateve, RVAK), klasifikimi, etiketimi dhe paketimi (KEP) e kimikateve, automjetet motorike, praktikatat e mira laboratorike (GLP), detergjentet, plehrat dhe prekursorët dhe barërave.

Masat procedurale

Në kuadër të masave procedurale bëjnë pjesë fushat si në vijim: Procedurat e njoftimit, Kontrollat e kufirit të jashtëm, Mallrat kulturore, Qelqi i kristaltë dhe Etiketimi i tekstilit dhe Produktet mbrojtëse. *Politikat*: Korniza e planifikimit të politikave përfshirë Programin për Reforma në Ekonomi 2023-2025 janë definuar

masat që synojnë përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes përmes lehtësimit të tregtisë dhe zhvillimit të infrastrukturës së cilësisë.

Institucionet përgjegjëse në këtë kapitull janë si në vijim:

Çështjet horizontale:

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Divizioni i Infrastrukturës së Cilësisë në Departamentin e Industrisë;
- Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) në kuadër të MINT-it, i vetmi Trup Kombëtar i Akreditimit i njohur me ligj, për të vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare kompetencën teknike të Trupave të Vlerësimit të Konformitetit që kryejnë aktivitete si testim, kalibrim, certifikim, dhe inspektim vullnetare apo të detyrueshëm në sektorin publik e privat;
- Inspektorati i Tregut në kuadër të MINT-it, përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit, sigurinë e produkteve e shërbimeve, tregtimin e naftës e derivateve të saj, parandalimin e praktikave të padrejta tregtare, luftimin e ekonomisë joformale, shërbimeve hoteliere dhe turistike etj.
- Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS), organ kombëtar që miraton standarde, i harmonizon ato dhe kështu nxit zhvillimin ekonomik, duke krijuar bazë për konkurrencë në rajon dhe më gjerë;
- Agjencia për Metrologji e Kosovës (AMK), përgjegjëse të ruajë, zhvillojë dhe të përdorë etalonët kombëtarë të njësive të matjeve, sigurimin e ekuivalencës dhe njohjes së tyre ndërkombëtare, mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet kontrollit të instrumenteve matës për transaksione zyrtare dhe tregtare, mbrojtjen e shëndetit, mjedisit dhe sigurisë teknike, dhe kontrollin sasior të para-paketimeve;

Qasja e re dhe ajo globale:

- MINT, përgjegjëse për pajisjet e tensionit të ulët, përputhshmërinë elektromagnetike dhe sigurinë e lodrave, makinerive, ashensorëve, produkteve ndërtimore, etj.;
- ME, përgjegjëse për pajisjet e thjeshta nën presion, barkat rekreative, teleferikët
- MPB, përgjegjëse për eksplozivët për përdorim civil dhe produktet piroteknikë
- MSh, përfshirë Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), përgjegjëse për produktet dhe pajisjet mjekësore;
- Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), përgjegjës për përafrimin ligjor dhe mbikëqyrjen e tregut të radio-pajisjeve dhe pajisjeve terminale telekomunikuese (R&TTE);

Qasja e vjetër:

- MMPHI, përkatësisht Departamenti i Automjeteve (me kompetenca të autoritetit aprovues), ndërsa ato të 'shërbimeve teknike' ushtrohen nga trupat privatë të autorizuar nga kjo ministri. Ky departament është autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut të automjeteve motorike, ndërsa departamentet e MMPHI në fushën e mjedisit janë përgjegjëse për kimikatet dhe detergjentet, përfshirë për transpozimin e Rregullores (KE) 1907/2006.
- MINT, përgjegjëse për transpozimin e *acquis*-së për emërtimet e ndotësve nga motorët e makinerive të lëvizshme jo-rrugore;
- MBPZhR, përgjegjëse për legjislacionin për plehrat;
- Inspektorati Fitosanitar, përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për plehrat;
- MSh, përgjegjëse për legjislacionin për prekursorë të barnave, përfshirë Agjencinë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Mjekësore (AKPPM), përgjegjëse për zbatim, dhe Inspektorati Shëndetësor, përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut;

Masat procedurale:

- Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Mjekësore (AKPPM), përgjegjëse për transparencën në lidhje me çmimet dhe riimbursimin e produkteve mjekësore;
- MINT, përgjegjëse për transpozim dhe zbatim për qelq të kristaltë, tekstilë dhe Këpucë.

Objektivat prioritarë afatmesme:

Masat horizontale:

- Miratimi i rregullores për grupet e produkteve dhe rregulloreve teknike që janë subjekt i mbikëqyrjes së inspektimeve në përputhje me ligjin për përputhshmërinë e produkteve;
- Themelimi i njëjësive përkatëse (Zyrën Ndërlidhëse dhe Pikës së Kontaktit për Produkte) bazuar në KD për përputhshmërinë e produkteve;
- Hartimi i Strategjisë për mbikëqyrjen e inspektimeve të përputhshmërisë së produkteve;
- Anëtarësimi i plotë i DAK-së në EA, nënshkrimi i MLA me EA-në;
- Zhvillimi i më tejme i politikave në fushën e Metrologjisë;
- Anëtarësimi i plotë/asociuar të Agjencisë së Metrologjisë në BIPM, OIML dhe Euramet;
- Krijimi i hapësirave të reja laboratorike – ndërtimi i aneks objektit të objektit të metrologjisë
- Funksionalizimi i laboratorit të kohës dhe frekuencës, dhe fuqizimi i laboratorëve ekzistues të metrologjisë;
- Organizimi i aktiviteteve për vetëdijesimin e bizneseve në lidhje me rolin e infrastrukturës së cilësisë;
- Zgjerimi i aktivitetit të akreditimit – përgatitja e laboratorëve kalibruese për akreditim sipas standardit ISO/IEC 17025:2017 (forca, termometria dhe gjatësia)
- Realizimi i një studimi për vlerësimin e nivelit të informimit të bizneseve për infrastrukturë të cilësisë, përfshirë MSA-në;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit përgjegjës për infrastrukturën e cilësisë;
- Transpozimi i Rregullores së BE-së 2019/1020 për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Përputhshmërinë e produkteve dhe Rregullores BE-së 2019/515 për Njohjen e Ndërsjellë të Mallrave në legjislacionin primar (Hartimi i Ligjit të ri për Mbikëqyrjen e Produkteve në Treg);
- Zbatimi i Programit për eliminimin e barrierave në tregti 2021-2025 (sipas neneve 34-36 TFBE).

Qasja e re dhe ajo globale:

- Miratimi i legjislacionit sekondar për zbatimin e ligjit për produktet e ndërtimit;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit përgjegjës për infrastrukturën e cilësisë dhe rregulla teknike.

3.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punonjësve

Acquis në këtë kapitull parashihet që qytetarët e një shteti anëtar BE-së të kenë të drejtën për të punuar në një Shtet tjetër Anëtar. Punëtorët migrantë duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si punëtorët vendas në lidhje me kushtet e punës, kushtet sociale dhe avantazhet e taksave. *Acquis* gjithashtu përfshinë një mekanizëm për të koordinuar dispozitat e sigurimeve shoqërore kombëtare për personat e siguruar dhe anëtarët e familjeve të tyre që lëvizin në një Shtet tjetër Anëtar.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 thekson se Kosova ka një nivel të përgatitjes në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve dhe ka bërë progres të kufizuar gjatë periudhës raportuese, veçanërisht në koordinimin e sigurimeve shoqërore. Kosova është në negociata të vazhdueshme për marrëveshje bilaterale për sigurimet shoqërore me vende të ndryshme të BE-së dhe jo vetëm. Në nëntor 2023 është miratuar Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes shoqërore me Holandën. Kosova është në negociata me Austrinë dhe Kroacinë dhe marrëveshjet pritet të arrihen në pjesën e dytë të këtij viti. Gjithashtu jemi në fillim të negociatave me Slloveninë dhe Turqinë.

Korniza legjislative, institucionale dhe e politikave

Legjislacioni në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore: Ligji nr. 04/L219 për të Huaj, Ligji nr. 03/L-212 i Punës, Ligji nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, dhe Ligji nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja. Këto akte normative kanë transpozuar aktet e *acquis*-së në vijim:

- Direktivën 96/71/KE në lidhje me dërgimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe ndryshimit të Rregullores (BE) nr. 1024/2012 për bashkëpunimin administrativ nëpërmjet Sistemit Informativ të Tregut të Brendshëm ('Rregullorja IMI').
- Direktivën 96/71 më 2014 e cila direktive rregullon më hollësisht çështjen e inspektimit të punëtorëve të huaj dhe procesin e bashkëpunimit ndërkombëtar nga organet kompetente në

fushën e sigurimit social të vendeve nga janë dërguar punëtorët e huaj, përkatësisht punëdhënësi i huaj i vendosur në Kosovë për një kohë të caktuar.

- Direktivën e cila rregullon çështjen e inspektimit të punëtorëve të huaj është Direktiva 2014/67/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 maj 2014, për zbatimin e Direktivës 96/71/KE në lidhje me ricaktimin e të punësuarve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe ndryshimit të Rregullores (BE) nr. 1024/2012 për bashkëpunimin administrativ nëpërmjet Sistemit informativ të tregut të brendshëm ('Rregullorja IMI') (Tekst, kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në).
- Rregulloren 883/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, 29 prillit 2004, për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore;
- Rregulloren 987/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, e 16 shtatorit 2009, që përcakton procedurën për zbatimin e Rregullores 883/2004 për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore.

Institucionet: korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione kryesore: Ministria e Ekonomisë; Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Negocimi dhe arritja e marrëveshjeve lidhur me sigurimet shoqërore për qytetarët e saj që jetojnë dhe punojnë jashtë Kosovës si edhe për punëtorët e shteteve anëtare të BE-së të punësuar në Kosovë, në zbatim të rekomandimeve të KE-së;
- Rishikimi i kornizës ligjore për rregullimin dhe menaxhimin e pensioneve dhe beneficioneve përfshirë administrimin më të mirë të pensioneve të financuara nga shteti përmes një organi të vetëm në MFPT;
- Përafrimi i legjislacionit me *acquis*, duke transpozuar:
 - Direktivën 79/7/KEE për trajtimin e barabartë sa i përket aspekteve sociale në harmoni me mundësitë dhe kapacitetet e vendit;
 - Direktivën 2014/67/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 15 majit 2014, për zbatimin e Direktivës 96/71/KE në lidhje me ri-caktimin e të punësuarve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe që amendamenton Rregulloren (BE) nr. 1024/2012 për bashkëpunimin administrativ nëpërmjet Sistemit Informativ për Tregun e Brendshëm (Rregulloren IMI);
- Rishikimi i kornizës ligjore për shërbime sociale dhe familjare dhe formulës së financimit të shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe reformimi i plotë i skemës së asistencës sociale.

3.3. Kapitulli 3: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve

Legjislacioni i BE-së në këtë kapitull kërkon nga shtetet anëtare të sigurojnë të drejtën e themelimit e shtetasve të BE-së dhe personave juridikë në çdo shtet anëtar, dhe që liria për të ofruar shërbime ndërkufitare, e definuar në nenin 49 dhe 56 të TFBE-së, të mos pengohet nga legjislacioni kombëtar, përveç përjashtimeve të parapara në traktat. *Acquis* gjithashtu harmonizon rregullat në lidhje me profesionet e rregulluara për të siguruar njohjen reciproke të kualifikimeve dhe diplomave ndërmjet shteteve anëtare; për disa profesione të rregulluara duhet të ndiqet një kurrikulë e përbashkët minimale e trajnimit në mënyrë që kualifikimi të njihet automatikisht në një shtet anëtar të BE-së. Lidhur me shërbimet postare, *acquis* gjithashtu synon hapjen e sektorit të shërbimeve postare ndaj konkurrencës në mënyrë graduale dhe të kontrolluar, brenda një kuadri rregullator që siguron një shërbim universal.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 thekon se Kosova ka arritur një status të moderuar të përgatitjes në këtë fushë dhe ka bërë disa përparime. Kosova ka filluar zbatimin e planit të saj pesëvjeçar të veprimit për t'i bërë ligjet e saj sektoriale në përputhje me Direktivën e Shërbimeve të BE-së. Pika e kontaktit të vetëm nuk është plotësisht funksionale. Tregu postar i Kosovës tashmë është hapur për konkurrencë në vitin 2022 dhe korniza ligjore është duke u përafruar me *acquis* postare të BE-së. Mirepo nevojitet më shumë përpjekje për ta harmonizuar Kosovën me *acquis* të BE-së për njohjen e kualifikimeve profesionale. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Heqjen e barrierave të identifikuar të së drejtës së themelimit dhe lirisë për të ofruar shërbime dhe të zbatojë PV që harmonizojë ligjet sektoriale me Direktivën për Shërbime;
- Kompletimin e përputhshmërinë me *acquis* postare të BE-së sa i përket Rregullores për shërbimet postare ndërkufitare dhe të forcoj kapacitetet institucionale për të monitoruar dhe të siguroj përshtatshmëri me rregullat e reja në tregun postar;
- Rritjen e përputhshmërinë me *acquis* në fushën e njohjes reciproke të kualifikimeve, përfshirë me Direktivën mbi njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën mbi testin e proporcionalitetit para miratimit të një rregullore të re për profesione të rregulluara.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: akti kryesor legjislativ në fushën e shërbimeve është Ligji nr. 05/L-130 për Shërbime, në fuqi nga prilli 2017. Në harmoni me kërkesat e *acquis*-së, ai përcakton parimet themelore e kriteret që mundësojnë të drejtën e themelimit dhe të ushtrimit të aktivitetit për ofruesit e shërbimeve në Kosovë, duke garantuar njëkohësisht siguri dhe cilësi të lartë të shërbimeve për përfituesit e tyre. Gjithashtu janë në fuqi dy (2) akte nënligjore, në të cilën është transpozuar pjesërisht *acquis* relevante. *Politikat:* për përmbushjen e obligimeve të MSA-së në fushën e shërbimeve, PRE 2022-2024, në kuadër të reformës 18, synon rritjen e konkurrueshmërisë në sektorin e tregtisë së shërbimeve.

Institucioni kryesor përgjegjës në nën-këtë fushë është Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Departamenti i Tregtisë. Ai propozon, harton, analizon dhe zbaton politikat tregtare në pajtim me legjislacionin dhe dokumentet përkatëse strategjike të Republikës së Kosovës.

Shërbimet postare

Akti kryesor legjislativ në këtë fushë është Ligji nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare, në fuqi nga janari 2019. Në harmoni me kërkesat e *acquis*-së, ai vendos rregulla për sigurimin e ofrimit të shërbimit postar e shërbimit universal postar në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përcakton kushtet për qasje në rrjetin postar, nxit konkurrencën e lirë, përcakton parimet për tarifën, siguron transparencën e llogarive të ofrimit të shërbimit universal postar, përcakton standardet për shërbimin universal postar, dhe vendos një sistem për të siguruar respektimin e këtyre standardeve. Gjithashtu janë në fuqi 2 akte nënligjore.

Institucionet kryesore në këtë fushë janë: Ministria e Ekonomisë, e cila është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit primar në këtë fushë, dhe Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), si organi rregullator që zbaton dhe mbikëqyr kornizën rregullative dhe politikat e zhvillimit të kësaj fushe.

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Akti kryesor legjislativ në këtë fushë është Ligji nr. 05/L-066 për Profesionet e Rregulluara, në fuqi nga nëntori 2016. Në harmoni me kërkesat e *acquis*-së, ai përcakton kushtet dhe kriteret për ushtrimin e profesionit të rregulluar që ka të bëjë me mbrojtjen e interesit publik. Gjithashtu janë në fuqi 4 akte nënligjore të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante.

Institucioni kryesor përgjegjës për këtë fushë është Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, përkatësisht Divizioni për Ekzaminimin e Profesioneve të Rregulluara në kuadër të Departamentit të Arsimit të Lartë, Shkencës dhe Teknologjisë. Divizioni për Profesionet e Rregulluara ka hartuar aktet nënligjore që dalin nga Ligji për Profesionet e Rregulluara të cilat janë miratuar dhe nënshkruar dhe po i paraqesim si në vijim:

- UA (MASHT) nr. 21/2018 Përbërja, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Këshillit Shtetëror për Profesionet e Rregulluara
- UA (MASHT) nr. 103/2020 Rregullat për Funkcionimin e Komisionit të Provimit Shtetëror, Kompensimin e Anëtarëve të saj si dhe Procedurat dhe Mënyra e Zhvillimit të Provimit Shtetëror
- UA (MASHT) nr. 18/2020 Kriteret dhe Procedurat për Fitimin e të Drejtës për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar
- UA (MASHTI) nr. 10/2021 Për Organizimin dhe Funkcionimin e Organit Profesional

- UA (MASHTI) nr. 07/2022 Për Profesionistin që ka Fituar të Drejtën e Ushtrimit të një Profesionit në një Shtet të Huaj dhe Lirohet nga Detyrimi për Provimin Shtetëror në Republikën e Kosovës.

Objektivat prioritarë afatmesme:

E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime:

- Zbatimi i PV për Transpozimin i Direktivës së Shërbimeve në Tregun e Brendshëm (2006/123/KE);
- Zbatimi i UA nr. 04/2018 për Mënyrën e Funkcionimit të Pikës së Vetme të Kontaktit, ;
- Zbatimi i PV për themelimin e Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK);
- Zbatimi i UA nr. 05/2018 për Procedurën e Njoftimit dhe Vlerësimin e Përputhshmërisë së Projekt Akteve Normative me Ligjin për Shërbime përmes mekanizmit koordinues për shërbime;
- Hartimi i analizës mbi diagnostikimin e sektorëve të rëndësishëm të tregtisë së shërbimeve si bazë për zhvillimin e politikave të përshtatshme;
- Vazhdimi i funksionalizimit të Pikës së Vetme të Kontaktit për Shërbime përmes digjitalizimit gradual të shërbimeve;
- Vazhdimi i përafrimit të legjislacionit kombëtar me Direktivën e Shërbimeve;
- Rritja e aftësive profesionale të stafit të Departamentit Ligjor dhe atij të Tregtisë për vlerësimin e harmonizimit të draft akteve normative me Ligjin për Shërbime;
- Rritja e ndërgjegjësimit të bizneseve, shoqatave profesionale dhe Komunave për thjeshtimin e procedurave administrative që lidhen me zbatimin e PV pesëvjeçar;
- Zbatimi i Ligjit për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike;

Shërbimet postare:

- Vazhdimi i përafrimit me *acquis* për shërbimet postare;
- Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të institucioneve që merren me shërbime postare për të siguruar një proces të suksesshëm të shqyrtimit dhe përafrimit;

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale:

- Hartimi dhe publikimi i listës së profesioneve të rregulluara;
- Kompletimi i legjislacionit sekondar për zbatimin e Ligjit për Profesionet e Rregulluara;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit në fushën e profesioneve të rregulluara.

3.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

Ky kapitull kërkon që shtetet anëtare të heqin të gjitha kufizimet ndaj lëvizjes së kapitalit e pagesave brenda BE-së, ndërmjet shteteve anëtare dhe me vendet e treta, me disa përjashtime. *Acquis* përfshin edhe rregullat për pagesa ndërkufitare dhe ekzekutimin e urdhrave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë. Direktiva për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit kërkon që entitetet që janë subjekt saj të identifikojnë klientët dhe të raportojnë transaksionet e dyshimta, sidomos kur bëhet fjalë për objekte me vlerë të lartë e transaksione me para në dorë me vlera të mëdha. Ajo gjithashtu kërkon që entitetet e tillë të ndërmarrin hapa shtesë, si mbajtja e evidencës, trajnimet dhe krijimi i procedurave të brendshme. Kërkesë kyçe në luftën kundër krimit financiar është krijimi i kapaciteteve efektive administrative e zbatuese, përfshirë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve që merren me mbikëqyrjen, zbatimin dhe ndjekjen penale.

Gjendja aktuale

Sipas vlerësimit të BE-së në *Raportin e KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova ka arritur njëfarë niveli të përgatitjes në këtë fushë. Raporti thekson se është arritur progres me miratimin e Ligjin për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të synuara dhe Ligjin për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificuar. Ndonëse janë ndërmarrë hapa fillestarë, rekomandimet e raportit paraprak mbeten të vlefshme. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në

- Përafrimin e mëtejshëm të kornizës ligjore me Direktivën 2 të BE-së për Shërbimet e Pagesave;
- Shtimin e përpjekjeve për të luftuar krimet ekonomike dhe financiare dhe harmonizimin me *acquis* të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;
- Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar dhe të forcoj efektivitetin e konfiskimeve të aseteve dhe procesimit të krimeve.

Më tej, në konkluzionet e NK VI për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika janë identifikuar disa aspekte për t'u adresuar:

- Miratimi i ligjit të ri për shërbimet e pagesave, duke transpozuar Direktivën II të Shërbimit të Pagesave;
- Pas miratimit të ligjit për të drejtat pronësore të të huajve, miratimi i të gjitha akteve të nevojshme nënligjore, duke përfshirë të drejtat reciproke;
- Miratimi i koncept dokumentit për pastrimin e parave.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Liberalizimi i lëvizjes së kapitalit

Akti kryesor legjislativ në këtë fushë është Ligji nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, në fuqi nga gushti 2009. Në harmoni me kërkesat e *acquis*-së, ai rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen dhe shuarjen e të drejtave sendore. Gjithashtu janë në fuqi 2 akte nënligjore, të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante. *Institucioni* kryesor në këtë fushë është Ministria e Drejtësisë, përgjegjëse për kornizën legjislative dhe politikën për të drejtat pronësore në Kosovë.

Sistemi i pagesave

Akti kryesor legjislativ në këtë fushë është Ligji nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave, në fuqi nga maji 2013. Në harmoni me kërkesat e *acquis*-së, ai përcakton rregullat për autorizimin e institucioneve të pagesave që ofrojnë shërbime të pagesave dhe për licencimin e operatorëve të sistemeve të pagesave, kliringut dhe shlyerjes së letrave më vlerë nga BQK, kushtet dhe standardet për ofrimin e shërbimeve të tilla dhe funksionimin e sistemeve të pagesave, kliringut dhe shlyerjes së pagesave, si dhe mjetet dhe procedurat sipas të cilave BQK ushtron kompetencat e saja mbikëqyrëse. Gjithashtu janë në fuqi 3 akte nënligjore, të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante. Dokumenti kryesor i *politikave* në këtë fushë është Plani Strategjik i BQK-së 2022- 2024. BQK është institucion publik i pavarur, me objektiv parësor nxitjen e ruajtjen e një sistemi të qëndrueshëm financiar dhe një sistemi efikas të pagesave.

Parandalimi dhe luftimi i shpëlarjes së parave

Akti kryesor legjislativ në këtë fushë është Ligji nr. 05/L-96 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, në fuqi nga viti 2016. Ai përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Në harmoni me kërkesat e *acquis*-së. Ky ligj gjithashtu përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin e parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Gjithashtu janë në fuqi 12 akte nënligjore, të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante. Dokumenti kyç i politikave në këtë fushë është Strategjia dhe PV për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2021-2024.

Njësia për Inteligjencë Financiare në kuadër të MFPT-së (NJIF) është institucioni kryesor në këtë fushë. NJIF është institucion qendror i pavarur në ushtrimin e funksioneve të saj, e cila është përgjegjëse për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente, dhe bërjen publike të informatave lidhur me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.

Objektivat prioritare afatmesme:

Liberalizimi i lëvizjes së kapitalit:

- Forcimi i sistemit të të drejtave pronësore;
- Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit në fushën e të drejtave pronësore të shtetasve të huaj, në veçanti të shtetasve të BE-së në harmoni me MSA.

Sistemi i pagesave:

- Miratimi i ligjit të ri për shërbimet e pagesave (për transpozimin e direktivave të BE-se, si, PSD2, EMD, PAD), si dhe përgatitja e legjislacionit sekondar bazuar në kërkesat që dalin nga ky Ligji për Shërbimet e Pagesave;
- Miratimi i legjislacionit sekondar për aplikim në SEPA;

- Ngritja e kapaciteteve njerëzore në BQK-së për zhvillimin e legjislacionit sekondar;
- Implementimi i një sistemi të pagesave të shpejta në vend me standarde dhe infrastrukturë teknike të gatshme për ndërlidhje me TIPS (Sistemin e Pagesave të Shpejta-Instant në BE);
- Zhvillimi i kapaciteteve për vlerësimin e rrezikut për sistemet e pagesave me rëndësi sistematike dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, bazuar në Direktivat e BE-së dhe parimet CPSS-IOSCO;
- Krijimi i standardit për ndërveprimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave përmes “QR Codet”

Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit:

- Transpozimi i Direktivës 2015/849 dhe Direktivës 2018/843 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, përmes plotësimit të Ligjit 05/L-O96 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;
 - Ngritja e cilësisë së informatave që NJIF pranon nga ana e subjekteve raportuese;
 - Vlerësimi III i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
 - Anëtarësimi i Kosovës në Moneyval;
 - Rritja e numrit të stafit të NJIF;
 - Ofrimi i udhëzimeve specifike subjekteve raportuese për përgatitjen dhe kryerjen e vlerësimeve të rrezikut;
 - Fuqizimi i strukturës së përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse dhe zhvillimi i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik dhe sektorët më të cenueshëm;
 - Fuqizimi i aftësive për identifikimin e pronësisë përfutuese dhe për kufizimin e keqpërdorimit të personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike për qëllime të PP/FT;
 - Rishikimi i metodologjisë së vlerësimit të rrezikut të PP/FT dhe fuqizimi i vlerësimit të rrezikut, menaxhimit të rrezikut dhe kornizës strategjike;
 - Hetimi dhe ndjekja penale e financimit të terrorizmit;
- Fuqizimi i aftësive për masat parandaluese për financim të terrorizmit dhe sanksionet financiare.

3.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik

Ky kapitull bazohet në parimet e përgjithshme të transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe mos-diskriminimit që dalin nga TFBE, pjesa III, titulli IV dhe titulli VII, dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së. Këto parime të përgjithshme janë të zbatueshme për të gjitha procedurat e prokurimit, përfshirë ato jashtë fushëveprimit të direktivave të BE-së për prokurimin, si për shembull ato nën vlerën minimale të BE-së. Legjislacioni i BE-së gjithashtu përbëhet nga direktiva për shqyrtimin e ankesave dhe disponueshmërinë e mjeteve juridike (Direktiva e 2007/66/KE e PE-së dhe e Këshillit, e 11 dhjetorit 2007). Ajo vendos dispozitat për vendosjen e procedurave të pavarura dhe efektive të shqyrtimit mbi vlerat e caktuara kundrejt vendimeve të marra nga autoritetet kontraktuese. Institucionet për shqyrtim duhet të jenë të pavarura dhe me kapacitete adekuate për të garantuar efektivitetin dhe efikasitetin e sistemit të prokurimit. Në harmoni me parimin e mbrojtjes juridike që del nga rendi ligjor i BE-së, mekanizmat për shqyrtim të ankesave kërkohet të veprojnë edhe jashtë fushëveprimit të zbatimit të direktivës përkatëse.

Gjendja aktuale

Sipas vlerësimit të BE-së në *Raportin e KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova ka arritur njëfarë niveli të caktuar dhe të moderuar të përgatitjes në këtë fushë. Është arritur progres i kufizuar në këtë fushë. Janë mbajtur trajnime për të përmirësuar kapacitetet e autoriteteve kontraktuese për të përdorur raportin ndërmjet çmimit dhe cilësisë më të mirë si kriter për dhënien e kontratës si dhe mbi përdorimin e moduleve për menaxhimin e kontratave dhe për vlerësimin e performancës së kontraktorëve. Prokurimi publik mbetet i prirur ndaj parregullsive dhe i cenueshëm ndaj korrupsionit si gjatë vetë procesit të prokurimit ashtu edhe në zbatimin e mëvonshëm të kontratës. Nuk është arritur progres në miratimin e ligjit të ri të prokurimit publik. Pasi që rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë zbatuar, ato mbeten kryesisht të vlefshme. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Miratimin e ligjit të ri për prokurimin publik dhe ligjin e ri për koncesionet në përputhje me *acquis* të BE-së; të përgatisë legjislacionin përkatës zbatues dhe të sigurojë zbatimin e duhur të tyre;

- Ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet të gjitha institucioneve të prokurimit publik dhe autoriteteve kontraktuese;
- Sigurimin që Organi Shqyrtues i Prokurimit të jetë plotësisht funksional dhe të mbetet funksionalisht i pavarur; duhet gjithashtu të forcojë kapacitetin e Organit dhe të sigurojë që procesi i tij i rishikimit të jetë në kohë, efektiv dhe transparent

Më tej, në konkluzionet e NK VI për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë janë identifikuar këto aspekte për t'u adresuar:

- Miratimi i ligjit për prokurimin publik dhe atij për koncesionet në përputhje me *acquis*-në përkatëse, dhe zbatimi i duhur i tyre, si dhe përgatitja e legjislacionit përkatës zbatues;
- Ngritja e kapaciteteve të të gjitha institucioneve të prokurimit publik dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm të kornizës rregullative të prokurimit publik;
- Sigurimi që Organi Shqyrtues i Prokurimit të jetë plotësisht funksional dhe i pavarur, adresimi i kufizimeve të kapaciteteve të tij dhe sigurimi që procesi i tij i rishikimit të jetë në kohë, efektiv dhe transparent.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni është i harmonizuar pjesërisht me standardet e BE-së dhe bazohet në parimet kryesore të për këtë fushë. Me plotësim-ndryshimin e LPP është eliminuar trajtimi preferencial për ofertuesit vendorë. Ligji kryesor është Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i plotësuar-ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092. Gjithashtu janë në fuqi disa akte nënligjore e procedurale për zbatimin e ligjit, përfshirë, Rregulloren nr. 001/2022 për prokurimin publik, Udhëzuesin Operativ për prokurimin publik Nr-002/2023, formularët standardë për secilin lloj të njoftimit, dosje të tenderëve, kodin e etikës, formularët për raportimin e kontratave të nënshkuara, formularin për parashtrim të ankesave për OShP dhe udhëzimet për procedurat me vlerë minimale. Gjithashtu janë përgatitur dhe publikuar Manuale e Doracake në lidhje me çështje të caktuara në prokurim publik, në funksion të mbështetjes së zbatimit në mënyrë të duhur të prokurimit publik dhe të e-prokurimit, si: Doracaku për përdorimin e kriterit të dhënies - Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm (TEMF), në prokurim publik, Manuale për përdorimin e e-prokurimit si dhe Manuale për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktorëve përmes e-prokurimit për autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik.

Ende nevojitet një përafrim i kornizës legjislative të prokurimit publik në Kosovë me *acquis*-në e BE-se, sidomos me aktet në vijim:

- Direktivën 2014/24/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të 26 shkurtit 2014, për prokurimet publike mbi koordinimin e procedurave për caktimin e fituesit në kontratat publike të punës, shërbimit dhe furnizimit, që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE, të cilat Shtetet Anëtare duhet të përputhet me të brenda 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi;
- Direktivën e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2014/25/KE, të 26 shkurtit 2014, në prokurimin nga subjektet që operojnë në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/KE;
- Direktivën e Parlamentit Evropian 2007/66/KE mbi Mjetet Juridike, të 11 dhjetorit 2007.

Dokumenti kryesor i politikave të prokurimit publik është Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2022-2026 dhe PV për zbatimin e saj. Objektivi kryesor i saj për prokurim publik synon përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të proceseve të prokurimit përmes ndryshimeve në kornizën legjislative, trajnimeve, zhvillimit të mjeteve zbatuese dhe avancimit të sistemit të e-prokurimit. *Institucionet* kryesore përgjegjëse në këtë kapitull janë: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRrPP); Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) në kuadër të MFPT-së.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Përafrimi i mëtejshëm i kornizës legjislative të vendit me kornizën ligjore të BE-së bazuar në kërkesat e MSA-së, dhe duke shfrytëzuar përvojën dhe praktikën më të mira të shteteve anëtare të BE-së në fushën e prokurimit publik;

- Përgatitja e legjislacionit dytësor në fushën e prokurimit publik në harmoni me ndryshimin e Ligjit për Prokurim Publik duke përfshirë edhe doracakë të prokurimit, udhëzues, formularë dhe modele standarde për dokumentet e tenderit dhe të kontratave;
- Trajnimi dhe rritja e cilësisë së trajnimeve për Prokurim Publik me qëllim të zhvillimit të kuadrove profesionale në fushën e prokurimit publik, për tu përballuar me një treg në rritje dhe rolin e tij të pritur në zhvillimin ekonomik kombëtar;
- Miratimi i legjislacionit sekondar/akteve nënligjore, brenda një viti pas miratimit të projektligjit për PPP, ashtu edhe siç është paraparë në projektligj.

3.6. Kapitulli 6: E drejta e kompanive

Ky kapitull vendos rregulla mbi formimin, regjistrimin, bashkimin e ndarjen e kompanive dhe kërkesat për raportim financiar në të cilat mbështetet e drejta e themelimit të kompanive. Pra, kjo fushë përfshin rregullat që u mundësojnë bizneseve të themelohen dhe të kryejnë veprimet e tyre kudo brenda BE-së. Normat e BE-së gjithashtu ofrojnë mbrojtje për aksionarët dhe palët e tjera të interesit, me theks të veçantë kompanitë, punëtorët dhe kreditorët. Ky kapitull synon rritjen e efikasitetit, konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë afatgjate të të bërit biznes, me qëllim që të inkurajohen bizneset e vendosura në shtete të ndryshme të BE-së të rrisin bashkëpunimin ndërmjet vete.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 thekson se Kosova ka njëfarë niveli të përgatitjes në fushën e së drejtës së kompanive. Kosova ka bërë përpunim të kufizuar në përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të BE-së për të drejtën e kompanive dhe është duke përgatitur një ligj të ri për shoqëritë tregtare për t'u përafruar më gjerësisht me *acquis* të BE-së. Meqenëse rekomandimet e vitit 2022 u adresuan vetëm pjesërisht, ato mbeten kryesisht të vlefshme. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Miratimin e projektligjit për shoqëritë tregtare për t'u përafruar më tej me *acquis* të BE-së për të drejtën e kompanive, duke përfshirë *acquis* më të fundit të BE-së (inkurajimi i angazhimit të aksionarëve afatgjatë, Direktiva për përdorimin e mjeteve dhe proceseve digjitale në kompani dhe Direktiva mbi operacionet ndërkufitare të kompanisë);
- Harmonizimin e mëtejshëm me *acquis* të BE-së për raportimin e kompanive dhe forcimin e strukturave institucionale të mbikëqyrjes së auditimit dhe pavarësisë/objektivitetit profesional të auditorëve dhe firmave të auditimit, si dhe financimin e tyre të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm.

Më tej, në konkluzionet e NK për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë janë identifikuar këto aspekte për t'u adresuar:

- Përafrimi i zhvillimeve të ardhshme në legjislacionin për të drejtën e shoqërive tregtare me Direktivën BE/2017/1132 (kodifikimi) dhe dispozitat e tjera të BE-së në fushat ku kishte boshllëqe ose përafrim të pjesshëm në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, duke përfshirë kërkesat minimale për kapital, aspektet e zbulimit të informacionit në lidhje me kompanitë dhe degët e tyre, bashkimet ndërkufitare, mbrojtjen e aksionarëve dhe ofertat për blerje;
- Miratimi i projektligjit për shoqëritë tregtare duke përfshirë përafrimin e tij me *acquis* më të fundit të BE-së (Direktiva 2017/828, Direktiva 2019/1151 dhe Direktiva 2019/2121);
- Të sigurohet se janë plotësuar kushtet për ndërlidhjen e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës me infrastrukturën teknike të Sistemit të Ndërlidhjes së Regjistrave të Bizneseve (BRIS);
- Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve të sigurojë publikimin e informatave të përditësuara të kompanisë duke përfshirë pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit që do të çojnë në rritjen e transparencës dhe rritjen e besueshmërisë së regjistrimit të të dhënave;
- Sigurimi i burimeve adekuate për ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse, për të kryer inspektime për mbikëqyrjen e kontrollin e cilësisë së shoqatave profesionale, firmave të auditimit dhe auditorëve ligjorë dhe për funksionalizimin e softuerit për marrjen e përpunimin e pasqyrave financiare;
- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit me *acquis* të BE-së për kontabilitetin dhe auditimin e korporatave dhe ndani draftin përfundimtar për të vlerësuar progresin e bërë.

E drejta e kompanive

Legjislacioni: akti kryesor ligjor për këtë fushë është Ligji nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, në fuqi nga viti 2018. Ai është pjesërisht i harmonizuar me kërkesat e *acquis*-së dhe vendos rregullat për llojet e ndërmarrjeve, organizimin, regjistrimin dhe funksionimin e tyre. Në funksion të zbatimit të legjislacionit primar, janë në fuqi 8 akte nënligjore të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante. *Politikat:* Dokumenti kryesor i politikave në këtë fushë është Programi i Qeverisë dhe Plani Kombëtar për Zhvillim, i cili përcakton politikat prioritare për zhvillimin e sektorit privat dhe ndërmarrjeve.

Institucioni kryesor përgjegjës për këtë fushë është ARBK në kuadër të MINT-it. Ajo është i vetmi institucion përgjegjës për regjistrimin e bizneseve në Kosovë në Regjistrin e Bizneseve. Ky sistem elektronik të dhënash sipas konceptit 'one-stop shop' mundësin një proces të thjeshtë, të shpejtë dhe pa shpenzime përmes lidhjes ndërmjet 29 qendrave komunale të regjistrimit (me mundësi të shtimit të tyre) me Zyrën Qendrore të ARBK-së. Ky sistem ka ndikuar në rritjen e transparencës dhe të standardeve e përpjekjeve për të harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e BE-së.

Raportimi financiar dhe auditimi

Legjislacioni: kjo fushë rregullohet nga Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, në fuqi nga janari 2019, pjesërisht i harmonizuar me aktet e *acquis*-së. Ai rregullon sistemin e kontabilitetit dhe i raportimit financiar i shoqërive tregtare, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF), kërkesat për auditim, kualifikimet për kontabilistë profesionalë, licencimin e auditorëve dhe firmave vendore e të huaja të auditimit, si dhe organizatat profesionale të kontabilitetit.

Institucionet kryesore përgjegjëse në këtë fushë janë MFPT dhe KKRF, ky i fundit organ profesional dhe autoritet kompetent për zhvillimin dhe adoptimin e standardeve të kontabilitetit dhe licencimin e auditorëve dhe firmave/shoqatave të auditimit dhe për zhvillimin e standardeve të etikës profesionale siç përcaktohet me dispozitat e ligjit. Ky këshill përbëhet nga shtatë (7) anëtarë: 1 nga BQK, 1 nga universitetet që ofrojnë arsimim të lartë në kontabilitet dhe auditim, 1 nga MFPT, 1 nga shoqatat profesionale të kontabilitetit të licencuar nga KKRF, dhe 3 anëtarë nga komuniteti i biznesit të cilët kanë njohuri dhe përvojë në financa dhe administrim biznesi. Funksionet administrative të KKRF-së i kryen Divizioni Administrativ i KKRF-së në kuadër të MFPT-së.

Objektivat prioritare afatmesme

E drejta e kompanive:

- Hartimi i legjislacionit sekondar për zbatimin e Ligjit të ri për Shoqëritë Tregtare;
- Përgatitja e Regjistrimit të Bizneseve që të jetë kompatibil me sistemin e ndërlidhjes së BRIS;
- Zbatimi i kodit të qeverisjes korporative;
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore e teknike të qendrave *One Stop Shop* dhe i shërbimeve të biznesit dhe ndërmarrja e masave afirmative për të inkurajuar përfaqësimin gjinor në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore;
- Trajnimi i stafit për përdorimin e softuerit dhe platformës së re elektronike;

Raportimi financiar dhe auditimi:

- Miratimi i akteve nënligjore të harmonizuara me Ligjin e plotësuar-ndryshuar për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim;
- Zhvillimi dhe zbatimi i standardeve të auditimit dhe raportimit financiar dhe rregullave për arsimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional në fushën e kontabilitetit dhe auditimit; Zhvillimi dhe zbatimi i metodologjisë së inspektimit të kualitetit të auditimeve, në harmoni me rregulloren e auditimit.

3.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale

Ky kapitull është fushë e zhvilluar mirë në BE, me rregulla të harmonizuara për të gjitha vendet anëtare, ku *acquis* vendos rregullat për mbrojtje ligjore të markave tregtare, dizajnit industrial, patentave, treguesve geografikë dhe emërtimeve të origjinës, sekreteve tregtare e të topografisë që qarqeve të integruara. Për

sistemin e patentave në BE është me rëndësi anëtarësimi në Konventën Evropiane të Patentave dhe Organizatën Evropiane të Patentave. E drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta përfshijnë krijimet ose veprat letrare, muzikore, filmat, programet kompjuterike dhe transmetimet televizive radiofonike. Këto rregulla përfshijnë procedurat për regjistrimin e palëve private ose operatorëve ekonomikë për të mbrojtur 'krijimet' dhe që të bëhen bartës të të drejtave ose të patentave.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova është mesatarisht e përgatitur për të drejtat e pronësisë intelektuale. Është bërë ca progres për të harmonizuar legjislacionin vendor me *acquis* të BE-së. Qeveria ka miratuar ligjet e reja për: patentat, markat tregtare, dizajnin industrial, topografitë e produkteve gjysmëpërçues dhe sekretet tregtare. Qeveria ka miratuar Ligjin e ri për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta (dhe legjislacionin përkatës në lidhje me sistemin e menaxhimit të të drejtave kolektive në fushën e të drejtës së autorit për veprat letrare dhe vizuale). Ligji i ri synon gjithashtu të përafrohet me Direktivën për transmetimin e caktuar online të organizatave transmetuese dhe ritransmetimet e programeve televizive dhe radiofonike për të mbuluar transmetimet online si dhe me Direktivën për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta në tregun e vetëm. Kosova gjithashtu ndërmoi hapa për të zbatuar më mirë të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale duke themeluar Gjykatën Komerciale, me mandatin për të zgjidhur rastet dhe kontestet në këtë fushë. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Krijimin e një sistemi funksional të menaxhimit kolektiv duke forcuar organizatat ekzistuese të menaxhimit kolektiv në fushën e muzikës dhe audiovizuale dhe duke mbështetur krijimin e një organizate të menaxhimit kolektiv në fushën e veprave letrare dhe vizuale;
- Miratimin e legjislacionit zbatues si rezultat i miratimit të ligjeve të pronësisë industriale (patentat, markat tregtare, dizajni industrial, topografitë e produkteve gjysmëpërçuese dhe sekretet tregtare).

Më tej, në konkluzionet e *NK për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë* janë identifikuar këto aspekte për t'u adresuar:

- Të vazhdohet me ndërgjegjësimin për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale, duke kontribuar në rritjen e numrit të aplikimeve për pronësi intelektuale. Rritja e ndërgjegjësimit të bartësve të të drejtave për të kërkuar mbrojtje ligjore përmes rritjes së numrit të kërkesave drejtuar institucioneve të zbatimit të ligjit për të vepruar;
- Të vazhdohet me rritjen e kapaciteteve administrative dhe profesionale të Agjencisë së Pronësisë Industriale;
- Të miratohet Strategjia e re e Pronësisë Industriale me një afat kohor dhe PV të qartë;
- Të ndërmerren hapa konkret, duke përfshirë vënien në funksionim të një platforme elektronike, për të rritur kapacitetin dhe koordinimin e institucioneve politikë-bërëse dhe agjencive të zbatimit të ligjit – në veçanti efektivitetin e Task Forcës dhe Këshillit Shtetëror të Pronësisë Industriale – për të fuqizuar të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe komerciale dhe luftimin e mallrave të falsifikuara dhe të piraterisë. Te përgatiten raporte për aktivitetet e përbashkëta.

Në aspektin horizontal, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2022* thekson se për të zbatuar në mënyrë efektive të drejtat e pronësisë industriale, Kosova duhet të rrisë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe atyre për zbatim. Për më tepër, raporti thekson se procedurat e gjata për trajtimin e aplikacioneve dhe mungesa e zbatimit të vendimeve të marra janë kufizimet kryesore për zbatim efektiv të ligjeve në fushën e pronësisë intelektuale.

Korniza legjislative, institucionale dhe e politikave

E drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta

Këtë fushë e rregullon Ligji nr. 08/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, i harmonizuar plotësisht me *acquis*. Ky ligj përcakton, rregullon dhe mbron të drejtave të autorit përkatësisht të drejtave të autorëve në lidhje me veprat e tyre nga fusha letrare, shkencore dhe artistike. Gjithashtu, mbron dhe rregullon edhe të drejtat e përafërta me të drejtën e autorit, përkatësisht të drejtat e interpretuesve, prodhuesve të fonogrameve, prodhuesve të filmave, organizatave transmetuese, të drejtat mbi veprat e

pabotuara më parë, të drejtat e botuesve, të drejtat e botuesve të shtypit në lidhje me përdorimet në internet (në tekstin e mëtejme: të drejtat e përafërta) dhe të drejtat *sui generis* të krijuesve të bazave të të dhënave. Ligji është në përputhshmëri të plotë me direktivat të BE-së.

Institucioni kryesor në këtë fushë është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Zyra për të Drejtat e Autorit ka për detyrë zhvillimin dhe brenda kompetencës së saj zbatimin e strategjisë dhe politikës adekuate për mbrojtjen, dhe zbatimin e të drejtës së autorit, të drejtave të përafërta dhe të drejtave të tjera të mbrojtura nga ky ligj, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, legjislacionin kombëtar dhe interesat përkatëse kombëtare të Republikës së Kosovës; përfaqësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale që merren me të drejtën e autorit, të drejtat e përafërta dhe të drejtat tjera të mbrojtura me këtë Ligj; vendosjen dhe mbajtjen e bashkëpunimit për arsyeje të përfitimit reciprok me zyrat qeveritare, agjencitë dhe institucionet kërkimore dhe organizatat tjera të vendeve të tjera që merren me të drejtën e autorit, të drejtat e përafërta dhe të drejtat e tjera të mbrojtura me këtë ligj, në përputhje me politikën ndërqeveritare të Republikës së Kosovës; në bashkëpunim me autoritetet kompetente gjyqësore, administrative dhe aty ku është e nevojshme inicimin e kërkesave për fillimin e procedurave për aplikimin e masave zbatuese, merr pjesë aktivisht në luftën kundër shkeljeve të të drejtave dhe në veçanti piraterisë; udhëheq dhe koordinon Task Forcën kundër Piraterisë; propozon ministrit përkatës për Kulturë licencimin e organizatave të menaxhimit kolektiv, Zyra bën mbikëqyrjen e aktiviteteve të organizatave të menaxhimit kolektiv.

E drejta e pronësisë industriale

Ligjet që rregullojnë këtë fushë janë: Ligji nr. 08/L-059 për Patenta; Ligji nr. 08/L-075 për Marka Tregtare; Ligji nr. 08/L-055 për Dizajnin Industrial; Ligji nr. 05/L-051 për Treguesit Gjeografikë dhe për Emërtimet e Origjinës; Ligji nr. 06/L-015 për Masat Doganore dhe Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale; Ligji për Inspektoratin e Tregut; Ligji nr. 08/L-053 për Topografitë e Gjysmëpërçuesve, Ligji nr. 08 L-076 për Mbrojtjen e Sekretin Tregtar. Secili mbulon njërin nga komponentët e kësaj fushe. Përmes tyre Kosova ka arritur një nivel të kënaqshëm harmonizimi me *acquis*, por duhet të sigurojë kapacitete adekuate për të zbatuar këto ligje. Gjithashtu ekzistojnë 9 akte nënligjor që lidhen me aktet primare në këtë sektor.

Institucioni kryesor administrativ për këtë fushë është Agjencia për Pronësi Industriale (API) në kuadër të MINT-it, përgjegjëse për mbrojtjen ligjore të shpikjes, markës tregtare, dizajnit industrial, emërtimit të origjinës, treguesve gjeografikë dhe topografive të qarqeve të integruara, dhe për çështje të tjera që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Kosovës është palë. Ajo gjithashtu luan rolin e një arkivi ku ruhen të gjitha elementet e mbrojtura. Institucionet e tjera në këtë fushë, përgjegjëse për zbatimin e ligjit, janë: Dogana e Kosovës, Inspektorati i Tregut, Policia e Kosovës (Njësia për Krime Ekonomike dhe Njësia për Krime Kibernetike). Për këtë qëllim gjithashtu funksionon Task Forca kundër Piraterisë Fizike dhe Digjitale, e cila kryesohet nga ZDAPD dhe me anëtarë nga të gjitha institucionet e lartpërmendura dhe Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

Objektivat prioritarë afatmesme:

E drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta:

- Miratimi i akteve nënligjore në përputhje me Ligjin e ri për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;
- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për fuqizimin e zbatimit të së drejtës së autorit;
- Ngritja e kapaciteteve dhe krijimi i divizionit të promovimit dhe divizionit të mbikëqyrjes së Organizatave të Menaxhimit Kolektiv;
- Angazhimi për zbatimin e duhur të marrëveshjeve kolektive të licencimit, për të garantuar riimbursimin e mbajtësve të së drejtës, vetëdijesimi i mbajtësve të të drejtave lidhur me rëndësinë e themelimit të Shoqatave të reja të Menaxhimit Kolektiv të të drejtës së autorit dhe promovimi i rëndësisë së menaxhimit kolektiv të të drejtave;
- Bashkëpunimi efikas ndërmjet Task Forcës kundër Piraterisë dhe pikave kontaktuese të krijuara për luftimin e piraterisë në shtatë (7) rajonet, dhe ngritja e njohurive për luftimin e formave të ndryshme të piraterisë, sidomos asaj digjitale;

- Promovimi i respektimit të drejtës së autorit në institucionet arsimore dhe në grupe të ndryshme të interesit;

E drejta e pronësisë industriale:

- Forcimi i burimeve njerëzore të Agjencisë për Pronësi Industriale dhe themelimin i divizionit për promovimit dhe atij për çështje ligjore;
- Intensifikimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me institucionet zbatuese dhe ato për zhvillimin e politikave në fushën e pronësisë industriale;
- Ngritja e vetëdijes së NVM-ve mbi rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë industriale;
- Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare dhe evropiane (WIPO dhe EPO).

3.8. Kapitulli 8: Politikat e konkurrencës

Mbrojtja e konkurrencës së lirë në treg është një nga kompetencat kryesore të BE-së dhe prandaj ky kapitull është prioritar në kuadër të MSA-së. Ai përfshin rregullat antitrust, kundër marrëveshjeve kufizuese ndërmjet kompanive, si dhe ato kundër abuzimit të pozitës dominuese dhe përqendrimit të kompanive që pengojnë ose mund të pengojnë konkurrencën. Ky kapitull gjithashtu kërkon vendosjen e një sistemi kontrolli të ndihmës shtetërore i cili i lejon Qeverisë të japë ndihmë shtetërore në përputhje me kushtet kufizuese, me qëllim të parandalimit të ndikimit në konkurrencë ndërmjet operatorëve ekonomikë në treg.

Gjendja aktuale

Sipas vlerësimit të BE-së, Kosova përgjithësisht ka arritur nivelin të kufizuar përgatitjeje në këtë kapitull. Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, legjislacioni për konkurrencën është përafëruar deri diku me *acquis*, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të miratuar legjislacionin zbatues dhe për të përmirësuar zbatimin në këtë fushë. Ngjashëm, ai vlerëson se Kosova duhet të vazhdojë të harmonizojë kornizën për antitrustin dhe të sigurojë zbatimin e saj. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Përbushjen e obligimeve të MSA-së, përfshirë funksionalizimin e Komisionit për Ndihmë Shtetërore;
- Harmonizimin e mëtejshëm të kornizës legjislative për kartelet, përqendrimet dhe ndihmën shtetërore dhe të sigurohet zbatimi i tyre;
- Sigurimin e kapaciteteve për funksionimin e institucioneve të konkurrencës e ndihmës shtetërore dhe pavarësinë e tyre funksionale, dhe rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet të gjitha palëve të interesuara, përfshirë ministrinë, rregullatorë dhe gjyqësorin;

Më tej, në konkluzionet e *NK për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë* janë identifikuar disa aspekte për t'u adresuar në të dyja fushat e këtij kapitulli:

Konkurrenca:

- Rritja e kapaciteteve administrative dhe rritja e numrit të stafit të Komisionit të Konkurrencës për të realizuar hetime dhe të arrijë kuorumin e nevojshëm prej pesë (5) anëtarëve, siç e parasheh ligji;
- Rritja e hetimeve të karteleve, publikimi më i shpeshtë i 'mjetit të lehtësimit' dhe inkurajimi për përdorimin e tij;
- Vazhdimi i përafrimit të legjislacionit, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e KE-së;
- Të merren hapa për të siguruar që ndërmarrjet publike dhe private të trajtohen në baza të barabarta, duke ndjekur parimet e përcaktuara në Traktatet e BE-së, për të mundësuar kushte të barabarta dhe për të shmangur konkurrencën e pandershme;
- Zbatimi i legjislacionit për homologimin e veturave (UA nr. 02/2018, Ligji për Vetura, nëntor 2018), në linjë me praktikën më të mirë të BE-së për të eliminuar barrierat jo-tarifore;

Ndihma shtetërore:

- Emërimi i anëtarëve të Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe funksionalizimi i Komisionit;
- Miratimi i akteve nënligjore, duke transpozuar përmbajtjen e Rregullores për Ndihmë Rajonale dhe Rregullores për Ndihmë Horizontale;
- Të vazhdohet me progresin e mirë të arritur në zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore, me fokus në ankesat dhe hetimet *ex officio*;
- Ngritja e kapaciteteve të Departamentit për Ndihmë Shtetërore;

- Të rritjet bashkëpunimi me rregullatorët dhe vetëdijesimi për ndihmën shtetërore;
- Krijimi i një autoriteti të vetëm dhe të pavarur të ndihmës shtetërore me kapacitetin funksional, burimet dhe kompetencat e nevojshme për të kryer funksionet e tij dhe që mund të grumbullojë njohuri dhe ekspertizë;
- Të merren hapa për të siguruar që ndërmarrjet publike dhe private të trajtohen në baza të barabarta, duke ndjekur parimet e përcaktuara në Traktatet e BE-së, në fushën e ndihmës shtetërore, për të mundësuar kushte të barabarta loje.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Konkurrenca

Sa i përket legjislacionit, Ligji kryesor në këtë fushë është Ligji nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, në fuqi nga qershori 2022. Në harmoni me kërkesat e *acquis*-së, ai vendos rregullat dhe masat për mbrojtjen konkurrencës së lirë dhe efektive në treg; kompetencat e organizimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK), dhe procedurat për zbatimin e tij. Gjithashtu janë në fuqi 13 akte nënligjore, të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante. Dokumenti kryesor i politikave në këtë fushë është Strategjia e Autoritetit të Konkurrencës 2020-2023.

Institucioni kryesor në këtë fushë është AKK, përgjegjës për parandalimin dhe ndalimin e praktikave kundër konkurrencës, përfshirë marrëveshjet e ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese, përqendrimet ose shitjen e blerjen e aksioneve në ndërmarrje, inicimin e procedurave hetimore, mbikëqyrjen e tregut e propozimin e masave për sigurimin e vendosjen e konkurrencës në treg si dhe për avokim. Organi vendimmarrës administrativ është Komisioni Kosovar i Konkurrencës. Ai përbëhet nga pesë (5) anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi, me propozim të Qeverisë. Përveç këtyre, gjykatat janë përgjegjëse për vendime gjyqësore për mbrojtjen e konkurrencës.

Ndihma shtetërore

Ligji kryesor në këtë fushë është Ligji nr. 05/L-100 për Ndihmën Shtetërore, në fuqi nga janari 2017, pjesërisht në harmoni me *acquis*. Ai vendos parimet e procedurat për dhënien e ndihmës shtetërore, mekanizmin e kornizën për kontrollin e saj, dhe krijon bazën për themelimin e inventarit gjithëpërfshirës të ndihmës shtetërore e sistemin e raportimit. Gjithashtu janë në fuqi katër (4) akte nënligjore, të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante.

Institucionet përgjegjëse për këtë fushë janë: Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSh), organ vendimmarrës, dhe Departamenti për Ndihmë Shtetërore (DNSh). KNSh përbëhet nga pesë (5) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, me propozim të Qeverisë. DNSh është përgjegjës për hartimin e legjislacionit zbatues, kontrollin e ndihmës shtetërore në nivel vendi, si dhe zhvillimin e mirëmbajtjen e regjistrit/inventarit gjithëpërfshirës dhe hartës rajonale të ndihmës shtetërore.

Objektivat prioritarë afatmesme

Konkurrenca:

- Përafrimi i mëtejshëm me *acquis*;
- Arritja e memorandumeve e bashkëpunimit me institucionet relevante;
- Hartimi i strategjisë për ngritjen e ndërgjegjësimit për politikën e konkurrencës;
- Organizimi i seminareve me gjykatat, asociacionet afariste, avokatët dhe shoqërinë civile;
- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore, përfshirë kapacitetet për analizën *ex ante* dhe vlerësimin *ex post*, dhe programe të trajnimit profesional të stafit të AKK-së.

Ndihma shtetërore:

- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit me *acquis*, përkatësisht transpozimi i Rregullores së Komisionit (KE) nr. 794/2004 të 21 prillit 2004 që transponon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 659/1999 që definojnë rregullat detale për aplikimin e Nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian;
- Hartimi dhe miratimi i rregullores për ndihmë sektoriale;
- Zhvillimi i legjislacionit tjetër dytësor;

- Finalizimi i inventarizimit të skemave të ndihmës shtetërore dhe harmonizimi i tyre me kërkesat e MSA-së;
- Mbajtja e aktiviteteve të vetëdijesimit për institucionet dhënëse të ndihmës shtetërore dhe trajnimet për stafin të DNSh-së;
- Zhvillimi i sistemit informativ për monitorimin e ndihmës shtetërore.

3.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare

Ky kapitull vendos rregullat e BE-së për bankat, sigurimet, pensionet shtesë, shërbimet e investimeve dhe tregjet e letrave me vlerë, me synimin për të siguruar konkurrencë të ndershme ndërmjet institucioneve financiare dhe stabilitetin e tyre. Ato përfshijnë rregullat për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e tyre. Së fundmi, *acquis* ka vendosur një kornizë gjithëpërfshirëse rregullative dhe mbikëqyrëse për investimet alternative, fondet kapitale dhe ato shoqërore, me qëllim të rritjes së transparencës ndaj investitorëve dhe autoriteteve publike.

Gjendja aktuale

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023* Kosova është mesatarisht e përgatitur në fushën e shërbimeve financiare, progres të kufizuar bëri në zbatimin e rekomandimeve të vitit të kaluar për shkak të mungesës së kapaciteteve. Gjithashtu, duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të përafuar me *acquis* për shërbimet financiare, duke u fokusuar në prioritetet e identifikuar. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Vazhdimin e zbatimit të udhërrëfyesit për zbatimin e masave të aftësisë paguese (Solvenca II) dhe rritjen e rolit mbikëqyrës në sektorin e sigurimeve;
- Avancimin e mëtejshëm të zbatimit të kornizës Bazeli III dhe miratimin e ndryshimeve në kornizën ligjore për institucionet mikrofinanciare e ato financiare jobankare, në përputhje me praktikat më të mira.

Më tej, në konkluzionet e *NK për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika* janë identifikuar këto çështje kyçe për t'u adresuar:

- Zbatimi i plotë të masave të Solvencës I dhe miratimi i udhërrëfyesit për transpozimin e ardhshëm të Solvencës II;
- Miratimi i projektligjit për bankat dhe krijimi i një funksioni të pavarur brenda BQK-së për zgjidhje/vendimmarrje për rastet e bankave komerciale;
- Vazhdimi i përafrimit me kornizën e Bazelit.

Korniza ligjore, institucionale dhe ajo e politikave

Korniza ligjore në fushën e bankave përbëhet nga Ligji nr. 05/L-150 për amendamentimin e Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK); Ligji nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe Ligji nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave. BQK është duke rishikuar Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, me qëllim të hartimit të një ligji të ri vetëm për bankat. Gjatë këtij procesi është punuar në veçanti në harmonizimin me Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit 2014/59/BE (direktivën BIRD). Në vitin 2022 është miratuar Rregullorja për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet (LCR) dhe Rregullorja për Treguesin e Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR), në pajtim me Rregulloren e BE-së 2015/61 mbi kërkesën e mbulimit me likuiditet, të datës 10 tetor 2014, Rregulloren e BE-së 2018/1620 mbi plotësimin e rregullores 2015/61 mbi kërkesën e mbulimit me likuiditet, të 13 datës korrik 2018, dhe Rregulloren e BE-së 2019/876 për Treguesin e Financimit të Qëndrueshëm Neto. Po ashtu në fuqi janë Rregullorja për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit, e cila është plotësuar-ndryshuar për t'u harmonizuar me Parimet e Komitetit të Bazelit për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e rrezikut të likuiditetit, dhe Rregullorja për Qeverisjen Korporatave të Bankave është finalizuar mirëpo ende nuk është miratuar.

Sigurimi i depozitave është e rregulluar nga Ligji nr. 03/L-216 për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, plotësuar-ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-133 për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-216 për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për

Institucionet Financiare në Kosovë. Ai rregullon sigurimin e depozitave të personave fizikë dhe juridikë, si dhe themelimin, qeverisjen dhe autoritetin e Fondit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë. Fusha e sigurimeve është e rregulluar nga Ligji për BQK-në, Ligji nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe Ligji nr. 05/L-045 për Sigurimet.

Në fushën e pensioneve, Ligji për BQK-në i përkufizon fondet pensionale si institucione financiare, prandaj përcakton kompetencën ekskluzive të BQK-së për të licencuar, rregulluar dhe mbikëqyrur Fondet Pensionale të Kosovës. Gjithashtu është në fuqi Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale dhe rregulloret e BQK-së për Fondet Pensionale, pjesërisht të harmonizuar me Direktivën e BE-së 2003/41/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 3 qershorit 2003, për aktivitetet dhe mbikëqyrjen e institucioneve e pensioneve të punësimit, me anë të cilit janë përcaktuar bazën për harmonizimin e plotë të kërkesave të kësaj direktive. Në fushën e tregut financiar është zhvilluar tregu i borxhit të brendshëm, me emetimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës përmes platformës elektronike të tregtimit të letrave me vlerë. Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës është i rregulluar me Ligjin nr. 04/L-175 mbi Borxhin Publik, në fuqi nga nëntori 2009 dhe me aktet nënligjore, përkatësisht Rregulloren MF-BQK nr. 01/2014 për tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, të vitit 2012 (plotësuar-ndryshuar në vitin 2014).

Institucioni kyç pjesëmarrës dhe rregullativ në sistemin financiar të vendit është BQK. Ajo gëzon pavarësi dhe autonomi administrative, financiare e menaxhuese. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) është institucion publik i pavarur i themeluar nga Kuvendi, aktiviteti i të cilit rregullohet nga Kuvendi dhe mbikëqyret nga BQK. I themeluar në dhjetor 2001 e i funksionalizuar në gusht 2002, ai është përgjegjës për administrimin e menaxhimin e kontributeve të obligueshme pensionale e vullnetare të të punësuarve në Kosovë. Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë i jep atij, përmes Bordit Drejtues, kompetencat dhe të drejtat e administruesit të besuar për fondet pensionale dhe përcakton të drejtat e tij lidhur me fondet pensionale. FKPK e ka selinë në Prishtinë, kurse shërbime për kontribuuesit dhe përfituesit ofrohen edhe në gjashtë qendrat e tjera të ATK-së në gjithë vendin. Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) është themeluar në vitin 2011 nga 10 kompanitë e sigurimit të licencuara për të operuar në Republikën e Kosovës sipas Ligjit nr. 04/L-018 mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. BKS është organizatë profesionale me statusin e personit juridik, e themeluar për qëllime jofitimprurëse. Qeveria e Republikës së Kosovës e njëj statusin e saj me të drejta të pakufizuara, në cilësi të byrosë paguese dhe trajtuese, që garanton përmbushjen e të gjitha detyrimeve nga sistemi i kartonit ndërkombëtar të sigurimit. BKS financohet nga anëtarët e saj, mbikëqyret nga BQK, dhe në kuadër të saj funksionon Fondi i Kompensimit, Sigurimi Kufitar, Qendra Informative e Sigurimit dhe Kartoni i Gjellbër.

Objektivat prioritare afatmesme:

Sektori bankar:

- Adoptimi i kërkesave për Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të mjaftueshmërisë së Likuiditetit;
- Zhvillimi i rregullativës dhe rregullimi i rrezikut kreditor të kundërpalës, rrezikut të kimit kibernetik, dhe rreziqet e ndryshimeve klimatike;
- Forcimi i praktikave mbikëqyrëse prudente dhe i proceseve të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik;
- Avancimi i kornizës së raportimit nga institucionet financiare;
- Përpilimi i Strategjisë lidhur me ndryshimet klimatike dhe rreziqeve të lidhur me klimën;
- Ngritja e kapaciteteve për administrimin e situatave emergjente në rast të krizave dhe zgjidhja e bankave me probleme;
- Ngritje e kapaciteteve të stafit në funksion të harmonizimit të rregullativës së BQK-së me rregulloret, direktivat dhe standardet e reja të Bazelit dhe aspekte të tjera;

Fondi i sigurimit të depozitave:

- Avancimi i bashkëveprimit me partnerët e rjetit të sigurisë e anëtarët dhe forcimi i bashkëpunimit me partnerët në sektorin financiar;
- Ngritja e vetëdijes publike përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe efektiv;
- Avancimi i sistemit diferencial të premive dhe të raportimit nga bankat anëtare;

Sektori i sigurimeve:

- Përafrimi i mëtejshëm i rregulloreve kombëtare të sigurimeve me direktivat përkatëse të BE-së;

- Fillimi i zbatimit të standardeve të aftësisë paguese (Solvencës II) dhe trajnimi e kualifikimi i stafit përgjegjës për mbikëqyrjen e sigurimeve për aplikimin e tyre;
- Aprovimi i ndryshimeve të plotësimit të Manualit të Mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, dhe përmasimin e mëtejshëm të treguesve të paralajmërimit të hershëm, me qëllim të vlerësimit më adekuat të profilit të rrezikut në nivel të siguresve dhe tregut në përgjithësi;
- Forcimi i zbatimit të kornizës rregullative të qeverisjes korporatave;
- Forcimi i mëtejshëm i mbikëqyrjes së sjelljes në treg duke zhvilluar dhe plotësuar një kornizë rregullative për mbikëqyrjen e sjelljes në treg, së bashku me zhvillimin e instrumenteve mbikëqyrëse;
- Zhvillimi një kornizë të përshkallëzimit të veprimeve mbikëqyrëse për sektorin e sigurimeve nga masat parandaluese dhe korrigjuese;
- Rishikimi i Ligjit për Sigurimet në pajtim me Solvencën II të BE-s si dhe fillimin e përgatitjeve në zbatimin e Solvencës II, konkretisht elementeve kualitative në funksion të përmirësimit të qeverisjes korporatave dhe transparencës;
- Rishikimi i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia;
- Rishikimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjeve në fuqi;
- Zhvillimi përkatësisht përmirësimi i kornizës rregullative në aspektin e sigurisë kibernetike;
- Rishikimi i metodologjisë së tarifimit të MTPL;
- Vazhdimi i asistimit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve dhe organeve tjera relevante për t'u anëtarësuar në Këshillin e Byrosë së Kartonit të Gjellbër;
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë e sigurimeve;
- Mbështetja e inovacionit dhe zhvillimit të teknologjisë/digjitalizimit për të bërë shërbimet më të arritshme dhe të lehta për t'u qasur;
- Zhvillimi i metodologjive specifike për parandalimin dhe adresimin e sfidave të institucioneve me performancë të pakënaqshme në sektorin e sigurimeve.

Sektori i pensioneve

- Rishikimi dhe hartimi i manualeve e udhëzuesve për mbikëqyrjen e fondeve pensionale mbi qasje të bazuar në rrezik, caktimi i parametrave/standardeve për vlerësimin e performancës së tyre dhe menaxhimin e rrezikut të fondeve pensionale plotësuese.

3.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe mediat

Ky kapitull synon zhvillimin e komunikimeve elektronike, shërbimeve të shoqërisë së informacionit dhe politikave audiovizuale që promovojnë dhe inkurajojnë konkurrencën, zhvillimin dhe qasjen më të gjerë në shërbimet bashkëkohore dhe teknologjitë e reja. Legjislacioni dhe standardet në këtë kapitull ndërlihen me kornizën rregullative të BE-së për ofrimin e shërbimeve brezgjere, sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, për të nxitur dhe mbrojtur konkurrencën efikase përmes zbatimit të mekanizmave adekuatë dhe garantimit të shërbimeve të duhura e të përshtatshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Gjendja aktuale

Sipas vlerësimit të BE-së, Kosova ka arritur njëfarë niveli të përgatitjes në këtë kapitull. Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova ka bërë progres në këtë kapitull, duke përafuar më tej kornizën e saj legjislative me *acquis* të BE-së, veçanërisht me miratimin e ligjit për sigurinë kibernetike. Gjithashtu, në fushën e komunikimeve elektronike, Kosova ka miratuar Agjendën Digjitale 2030. Për më tepër, Kosova është angazhuar në mënyrë konstruktive në dialogun rajonal të nivelit të lartë për transformimin digjital dhe për zbatimin e Marrëveshjes Rajonale për Roaming si dhe ka organizuar në mënyrë të suksesshme Samitin Digjital të Ballkanit Perëndimor në Prishtinë.

Megjithatë, ende nevojitet përafrim dhe zbatim i mëtejshëm legjislacionit në fushën e komunikimeve elektronike, shoqërisë informative dhe politikave audiovizuale. Në anën tjetër, sipas këtij raporti, Kosova duhet të gjejë një zgjidhje të qëndrueshme për financimin e transmetuesit publik dhe sigurojë pavarësinë editoriale. Gjithashtu Kosova duhet të miratojë Strategjinë e qeverisjes elektronike, dhe strategjinë dhe PV

për sigurinë kibernetike dhe të avancohet transmetimi digjital nga transmetimi analog në atë digjital. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Përafrimin e legjislacionit me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike, Direktivën e BE-së për Sigurinë e Rrjetit dhe Informacionit (NIS2) dhe Kutinë e Veglave të BE-së për sigurinë kibernetike 5G;
- Rishikimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, në përputhje me Direktivën e Shërbimeve Mediale Audiovizuale (AVMS);
- Sigurimin e burimeve të duhura që ARKEP dhe KPM të përmbushin mandatet e tyre në mënyrë të pavarur si dhe të zhvillojnë një zgjidhje të qëndrueshme për financimin e transmetuesit publik;
- Të zbatojë bartshmërinë e numrave për të siguruar përdorim efektiv të burimeve të resurseve numerike dhe nxitur konkurrencën.

Më tej, në NK VII *Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politika Sociale* Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

- Të zgjerohen shërbimet elektronike të ofruara nga Platforma e-Kosova për qytetarët dhe bizneset;
- Të miratohet Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe PV përkatës, duke siguruar që të ndahen burime të mjaftueshme për zbatimin e saj;
- Të përafrohet legjislacioni vendor plotësisht me Direktivën NIS të BE-së;
- Të përafrohet legjislacioni vendor me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike (Direktiva (BE) 2018/1972) (KEE);
- Të sigurohen sinergji bazë në mes politikave të gjelbra dhe atyre digjitale;
- Të ndërmerren hapa për të siguruar zbatimin e suksesshëm të Memorandumeve të Mirëkuptimit për Ballkanin Perëndimor të ndërveprueshëm dhe rrjedhën e lirë të të dhënave në rajonin e Ballkanit Perëndimor, nënshkruar në Samitin Digjital të Ballkanit Perëndimor në tetor 2021 në Podgoricë;
- Të zbatohen masat për të ulur koston e vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë;
- Të përdoren fondet e BE-së (€30 milionë) në dispozicion për asistencë teknike për projektet me brez të gjerë nën Kornizën e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF);
- Të zbatoj bartshmërinë e numrave për të siguruar përdorim efektiv të burimeve të resurseve numerike dhe nxitur konkurrencën;
- Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të ketë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të kryer plotësisht detyrat e tyre;
- Përafrimi i legjislacionit me Direktivën për Shërbimet e Mediave Audiovizuale, duke përfshirë rishikimin më të fundit të vitit 2018. Veçanërisht:
 - Të amendamentohet Ligji për RTK-në me qëllim që të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për financimin e transmetuesin publik dhe të sigurohet pavarësia editoriale, në përputhje me dispozitat e Direktivës për Shërbimet Mediale Audiovizuale dhe standardet e rekomandimet tjera relevante evropiane;
 - Të rishikohet Ligji për KPM-në për ti përditësuar kompetencat, siguruar transparencë dhe për të forcuar pavarësinë e KPM-së, duke përfshirë mediat audio-vizuale, në përputhje me Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale. Përfshini të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë shoqërinë civile dhe ekspertët e medias.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: Akti kryesor në fushën e komunikimeve elektronike është Ligji nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike. Ai rregullon aktivitetet e komunikimeve elektronike sipas parimit të neutralitetit teknologjik dhe kornizës rregullative të BE-së, duke promovuar konkurrencën e infrastrukturën efikase dhe garantimin e shërbimeve të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës. Akti kryesor në fushën e shoqërisë së informacionit është Ligji nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike. Ai krijon mundësi e rrethana të favorshme për zhvillimin e tregtisë elektronike, përdorimin e transaksioneve elektronike e nënshkrimit elektronik nga Qeveria, bizneset e qytetarët, si dhe zvogëlimin e problemeve të keqpërdorimeve gjatë

transaksioneve elektronike dhe adresimin e sigurisë së sistemeve informatike. Akti kryesor në fushën e politikave audiovizuale është Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), i cili përcakton kompetencat e KPM-së, me qëllim të promovimit të zhvillimit të një tregu të shëndoshë të shërbimeve mediale audiovizuale në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Në këtë kapitull zbatohen edhe këto ligje në fuqi: Ligji nr. 08/L-007 për Masat për Uljen e Kostos së Shtirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë, Ligji nr. 08/L-022 për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike;; Ligji nr. 03/L-166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik; Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative; Ligji për Organet Qeveritare të Shoqërisë së informacionit, dhe Korniza e Interoperabilitetit të Republikës së Kosovës. Ato rregullojnë fusha specifike dhe janë pjesërisht në harmoni me *acquis*. Gjithashtu janë në fuqi një numër i konsiderueshëm i akteve nënligjore, të cilët kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante.

Politikat: dokumentet kryesor për këtë kapitull janë: Agjenda Digjitale për Kosovën2030 (e miratuar nga Qeveria më 29.06.2023), Strategjia e Kosovës për Teknologji Informative dhe PV për periudhën 2016-2019; Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe PV 2016-2019; dhe Atlasi Elektronik për Infrastrukturën Telekomunikuese Brezgjerë.

Institucioni kryesor në fushën e komunikimeve elektronike është Ministria e Ekonomisë (ME), përgjegjëse për politikën për nxitjen e rritjes e stabilitetit ekonomik, mundësimin e zhvillimit të biznesit vendas, inkurajimin e bashkëpunimit ekonomik për tërheqjen e investimeve të huaja, dhe nxitjen e konkurrencës dhe tregut të qëndrueshëm. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) është organ rregullativ që zbaton dhe mbikëqyr kornizën rregullative të përcaktuar nga ligjet në fushën e komunikimeve elektronike dhe shoqërisë së informacionit, si dhe atë të shërbimeve postare. Institucioni kryesor në fushën *shoqërisë së informacionit* është MPB, përkatësisht Agjencia për Shoqërinë e Informacionit, përgjegjëse hartimin dhe koordinimin e politikave të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në institucionet e Republikës së Kosovës. Institucioni kryesor në fushën e politikave audio-vizuale KPM, përgjegjës për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit, përkatësisht të të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisve të personave fizikë e juridikë që ofrojnë shërbime mediale audio dhe audiovizuale.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Hartimi dhe miratimi i ligjeve dhe akteve nënligjore në fushën e komunikimeve elektronike, për të transpozuar Direktivën 2018/1972 që vendos Kodin e Komunikimeve Elektronike;
- Hapja e brezave frekuencorë me vlerë të posaçme ekonomike për ofrimin e shërbimeve IMT, duke përfshirë brezet frekuencore 700MHz dhe 26GHz;
- Shtirja e rrjetave me kapacitet të lartë (VCHN), duke përfshirë rrjetat 5G në të territorin e vendit;
- Krijimi i infrastrukturës së qëndrueshme dhe sigurtë në rrjetet fikse dhe mobile;
- Nxitja e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike brezgjërë, për të ngritur efikasitetin e rregullimit të tregut dhe për t'u ofruar të ofruar qasje në internet me shpejtësi më të lartë në Kosovë;
- Ulja e tarifave të roamingut me shtetet e BE-së;
- Rishikimi i Strategjisë së Kosovës për Teknologji Informative dhe zbatimi i saj;
- Avancimi i platformës së interoperabilitetit dhe ndërlidhja shumicës së sistemeve elektronike ekzistuese përmes kësaj platforme;
- Rritja e numrit të shërbimeve elektronike për qytetarët, institucionet e entitetet e tjera në Portalin e Shërbimeve "e-Kosova";
- Krijimi i Qendrës së Rimëkëmbjes nga Fatkeqësitë;
- Hartimi i pakos së licencës për multipleks në nivel shtetëror dhe rajonal;
- Amendamenti i akteve nënligjore të KPM-së, në pajtim me Ligjin e plotësuar-ndryshuar për KPM-në, i cili do të harmonizohet me Direktivën 2018/1808 për Shërbimet Mediale Audiovizuale;
- Plotësim-ndryshimi i Ligjit për RTK-në;
- Zbatimi i procesit të kalimit në transmetim digjital tokësor.

3.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Ky kapitull përfshin një numër të madh rregullash të detyrueshme, shumica prej të cilave zbatohen në këtë fazë të zhvillimit. Zbatimi i duhur dhe efektiv i tyre dhe kontrolli më efikas nga administrata publike janë thelbësore për funksionimin e Politikave të Përbashkëta Bujqësore (PPB). Funksionimi i tyre kërkon avancimin e menaxhimit dhe cilësisë së sistemeve të tilla si Agjencia e Pagesave, Sistemi i Integruar i Kontrollit të Bujqësisë si dhe kapacitetet për të zbatuar masat e zhvillimit rural.

Gjendja aktuale

Në *Raportin e KE-së për Kosovën – 2023* thuhet se Kosova ka një nivel të përgatitjes për bujqësi dhe zhvillim rural. Në vitin 2022, buxheti për pagesat direkte dhe zhvillimin rural u rrit në €58.1 milionë, 59% më i lartë se në vitin 2021. Në vitin 2022, programi i bujqësisë dhe zhvillimit rural i dha prioritet investimeve në diversifikimin rural. KE, thekson së ka pasur progres të kufizuar me miratimin e Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural, ndërsa programi për bujqësi dhe zhvillim rural 2022-2027 mbetet për t'u miratuar. Është duke u zhvilluar sistemi për zbatimin e politikës së zhvillimit bujqësor dhe rural. KE thekson se Kosova duhet të miratojë programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural 2022-2027 dhe Ligjin për tokën bujqësore, ndërsa kapaciteti administrativ i ministrisë dhe agjencive duhet të forcohet ndjeshëm me burime adekuate njerëzore dhe financiare. Një dialog politik me BE-në për orientimin strategjik të bujqësisë së Kosovës duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Sa i përket masave për konsolidimin e tokës, KE, thekson së janë të pamjaftueshme. Sa i përket Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (SIAK), Kosova është ende në proces të krijimit të këtij sistemi bujqësor i cili përfshin Sistemin e Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (SIAK), rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (DhKF) dhe sistemin e informacionit të tregut bujqësor. Ndërsa, sa i përket politikës së cilësisë, Kosova ka shënuar progres me regjistrimin e parë të një treguesi gjeografik. Sa i përket mbrojtjes së tokës bujqësore, KE nënvizon së ende nuk është miratuar një PV për mbrojtjen e tokës bujqësore, që përfshin Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe autoritetet lokale, për të adresuar humbjen dhe degradimin e vazhdueshëm të tokës bujqësore. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Kryerjen e një vlerësimi cilësor të pagesave direkte dhe programeve të zhvillimit rural në kuadrin financiar 2014-2020;
- Miraton Ligjin për tokën bujqësore;
- Programin për zhvillim bujqësor dhe rural 2022-2027;
- Të marrë masa urgjente dhe efektive për ndalimin e humbjes së tokës bujqësore dhe zbatimin e legjislacionit për planifikimin hapësinor;
- Të ndërmerren veprime efektive drejt zhvillimit të bujqësisë organike dhe sektorëve të politikave të cilësisë;
- Të fillohet më një dialog politik me BE-në për orientimin strategjik të bujqësisë së Kosovës;
- Masat mbështetëse duhet të sillen në përputhje me *acquis* të BE-së;
- Të ndërmerren masa të mjaftueshme për inkurajimin e konsolidimit të tokave.

Në *NK VII për Bujqësi dhe Peshkatari* KE vlerësoi përpjekjet për të harmonizuar legjislacionin që rregullon bujqësinë dhe zhvillimin rural, si dhe vendosjen e procedurave të duhura të monitorimit dhe kontrollit. Në këtë NK Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

- Të vazhdohet me publikimin e emërtimit të djathit Sharri me origjinë të mbrojtur dhe të finalizohet procedura për verën Rahoveci si tregues gjeografik;
- Miratimi i programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2022-2028;
- Fillimi i zbatimit të masave reformuese, veçanërisht konsolidimi i tokës, të përcaktuara në ERP aktuale;
- Finalizimi dhe miratimi i Ligjit të ri për Verërat;
- Hartimi i UA të ri për kriteret dhe procedurat e regjistrimit të pijeve alkoolike;
- Miratimi i Ligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Shërbimet Këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
- Miratimi i Ligjit për Tokën Bujqësore;

- Projektligji për Turizmin Rural;
- Finalizimi dhe miratimi i Ligjit për Organizimin e Tregut (Të Përbashkët) të Produkteve Bujqësore;
- Fillimi i projektit FADN për 2021-23 për mbledhjen e të dhënave;
- Përdorimi në mënyrë efektive rezultatet e arritura me ndihmën e BE-së, pasi ato janë prodhuar me qëllim të sigurimit të zhvillimit efektiv dhe të qëndrueshëm të sektorit agro-rural të Kosovës;
- Miratimi i rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale:

Legjislacioni: akti kryesor në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural është Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i cili ka transpozuar pjesërisht Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 73/2009 dhe rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1217/2009. Gjithashtu janë në fuqi rreth 50 UA në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, vreshtarisë dhe shërbimeve këshillimore, të cilët kanë transpozuar pjesërisht me aktet relevante të *acquis*-së.

Sa i përket *politikave*, dokumentet kryesore në këtë kapitull janë: Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028; Programi për Masat e Zhvillimit Rural 2022, Raporti i Gjelbër 2022, PV për Bujqësi Organike 2018-2021, Plani Strategjik i Sistemit Këshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027; PV për Bujqësi Organike i Republikës së Kosovës 2023 – 2026 dhe Strategjia për Sektorin e Vreshtarisë dhe Verërave 2018-2022. Programi një vjeçar për Pagesa Direkte dhe për Grante Rurale 2023.

Institucioni kryesor përgjegjëse për këtë kapitull është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), përkatësisht këto departamente: Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural/Autoriteti Menaxhues, përgjegjës për hartimin e politikave për zhvillim rural dhe masave për përkrahje të zhvillimit rural; Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve, përgjegjës për politikat bujqësore dhe Programin për Pagesat Direkte; Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e politikave për verërat, Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore, përgjegjës për analiza ekonomike dhe mbledhjen e përpunimin e statistikave për zhvillimin e zbatimin e politikave në të gjitha fushat e këtij kapitulli; dhe Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agjencia e Pagesave, përgjegjëse për zbatimin e programit për pagesa direkte dhe masave për zhvillimin rural.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Vlerësimi ex-post i programit të PZHR dhe PPD 2022-2027;
- Krijimi i një sistemi bujqësor, i cili përfshin Sistemin e Integruar të Informacionit Bujqësor (SIIS), Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave (RrDhKF) dhe Sistemin e Informacionit të Tregut Bujqësor, dhe garantimi i funksionalitetit dhe ndërveprimit të tyre;
- Hartimi i një plani veprimi për mbrojtjen e tokës bujqësore, duke përfshirë Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe autoritetet lokale, për të adresuar humbjen dhe degradimin e vazhdueshëm të tokës bujqësore;
- Ngritja e kapaciteteve për zbatim e legjislacionit për Organizimin e Tregut të Përbashkët (OTP);
- Ndërmarrja e veprimeve efektive drejt zhvillimit të bujqësisë organike;
- Ndërmarrja e veprimeve efektive drejt zhvillimit të politikave të cilësisë;
- Përmirësimi i politikave për menaxhimin dhe ruajtjen e tokës bujqësore.

3.12. Kapitulli 12: Politikat e sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë

Qasja e integruar e BE-së për sigurinë e ushqimit synon sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë së ushqimit, shëndetit e mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve brenda BE-së, përmes masave koherente nga ferma-në tryezë dhe monitorimit të duhur, duke siguruar funksionimin efektiv të tregut të brendshëm. *Acquis* në këtë kapitull mbulon sigurinë e ushqimit, përfshirë politikat e përgjithshme që sigurojnë higjienës në prodhimin e ushqimit; veterinarinë, me synim mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, mirëqenies së tyre dhe sigurisë së ushqimit me origjinë shtazore në tregun e brendshëm; dhe fitosanitarinë, përfshirë çështje si cilësia e farës, materiali për mbrojtjen e bimëve, organizmat e dëmshëm dhe ushqyeshmëria e kafshëve.

Gjendja aktuale

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova ka njëfarë niveli deri në një nivel mesatar të përgatitjes në këtë kapitull. Gjatë periudhës raportuese Kosova ka avancuar më tej sistemin e menaxhimit të kontrollit dhe gjurmueshmërisë së ushqimit dhe sistemin për menaxhimin e informatave laboratorike, të menaxhuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. AUV gjithashtu ka përgatitur e miratuar aktet e nevojshme nënligjore, si dhe ka hartuar programet e mbikëqyrjes dhe çrrënjësjes së sëmundjeve të kafshëve dhe programet e kontrollit për qentë endacakë. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Sigurimin me kohë të mjeteve dhe resurseve të nevojshme për funksionimin efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Kontrollit dhe Gjurmueshmërisë të Ushqimit dhe Sistemit të Menaxhimit të Informatave Laboratorike, të zhvilluar me mbështetjen e BE-së;
- Marrjen e vendimit mbi modelin e funksionimit të fabrikës për trajtimin e nënprodukteve shtazore dhe sistemit për grumbullimin e tyre, si dhe të fillojë me operimin e kësaj fabrike;
- Përmirësimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të sëmundjeve të kafshëve, përveç tjerash përmes miratimit dhe zbatimit të programit shumëvjeçar të kontrollit e mbikëqyrjes së sëmundjeve të kafshëve, duke përfshirë edhe marrjen e përgjegjësisë për financimin e plotë të fushatës së vaksinimit oral kundër tërbimit, që do të kryhet nga vjeshta 2023 e në vazhdim;
- Akreditimin ndërkombëtar për laboratorin e ushqimit dhe të veterinarisë;
- Zbatimin e programeve për zhdukjen e sëmundjeve endemike në Kosovë, përfshirë kontrollin e shëndetit të kafshëve në nivel ferme, transportin e kafshëve dhe tregjet e bagëtive;
- Përmirësimin e raportimit për lëvizjet e kafshëve dhe ndërmarrjen e masave për zbatimin e rregullores përkatëse në nivel të tregjeve të kafshëve, thertoreve dhe transportit të tyre.

Më tej, në *NK VII për Bujqësi dhe Peshkatari* Kosova ka marrë përsipër të zbatojë reformat, si në vijim:

- Të sigurojë resurset e nevojshme financiare dhe njerëzore, në mënyrë që të ketë numër adekuat të inspektorëve për zbatimin efektiv të legjislacionit në fuqi;
- Të përmirësojë kornizën ligjore që rregullon fushën e nën-produkteve shtazore, përmes miratimit të akteve nën-ligjore që zbatojnë rregullat shëndetësore për nënproduktet shtazore;
- Të zbatojë aspektet e Strategjisë së Zhvillimit Rural 2022-2028 lidhur me avancimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore;
- Të marrë vendim mbi mënyrën e operimit dhe ta vendosë në funksion fabrikën për trajtimin e nën-produkteve shtazore.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale: Ligjet kryesore në këtë kapitull janë: Ligji për Ushqimin, Ligji për Veterinarinë dhe Ligji për Mbrojtjen e Bimëve. Dokumentet kryesore të politikave janë: Plani Vjetor Kombëtar i Kontrolleve dhe Mostrimit dhe Plani Vjetor Kombëtar i Kontrolleve Zyrtare. *Institucionet* kryesore në këtë fushë janë: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjëse për hartimin e legjislacionit dhe politikave, dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Miratimi dhe zbatimi i strategjisë dhe planit për hartimin e legjislacionit që mungon dhe transpozimi i *acquis*-së së BE-së;
- Ngritja e mëtejme e kapaciteteve njerëzore, përmes rekrutimit të personelit të ri dhe ofrimit të trajnimeve, dhe sigurimi i burimeve të domosdoshme financiare për zbatimin e plotë të *acquis*-së në këto fusha;
- Miratimi i planit kombëtar shumëvjeçar të kontrollit dhe sigurimi i burimeve adekuate financiare dhe njerëzore për zbatimin e tij;
- Funksionalizimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i Sistemit të Menaxhimit të Kontrollit të Ushqimit (SMKU) dhe Sistemit për Menaxhimin e Informatave Laboratorike (SMIL);
- Përmirësimi i infrastrukturës në pikat inspektuese veterinarë kufitare dhe sigurimi i objekteve karantinore për kafshët e gjalla;
- Funksionalizimi i impiantit për përpunimin e nënprodukteve shtazore dhe ngritja e një sistemi për grumbullimin dhe asgjësimin e këtyre produkteve;
- Identifikimi dhe përfshirja e masave kyçe ndër-sektoriale (*cross-compliance*) në politikat e sigurisë së ushqimit dhe shëndetit e mirëqenies së kafshëve në kuadër të programit të bujqësisë;

- Marrja e akreditimit ndërkombëtar për Laboratorin e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Hartimi dhe miratimi i legjislacionit për ushqimin e ri (*novel food*) dhe organizmat gjenetiksht të modifikuar (OGjM), në harmoni me *acquis*.

3.13. Kapitulli 13: Peshkataria

Ky kapitull vendos rregulla për ruajtjen e burimeve ujore të gjalla dhe menaxhimin e kapacitetit të flotës së peshqve, përfshirë kontrollin, zbatimin e veprimet strukturore për operatorët e tregut, zbatimin e standardeve të marketingut, organizimin e tregut, përfshirjen e organizatave të prodhuesve, vlerësimi i rezervave të peshkut, dhe mbledhja e të dhënave të besueshme. Zbatimi në këtë kapitull kërkon masa për të përgatitur administratën dhe operatorët për pjesëmarrje në politikën e përbashkët të peshkimit të BE-së.

Gjendja aktuale

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova duhet të bëjë më shumë përpjekje për të zbatuar *acquis* përkatëse për peshkimin dhe akuakulturën. KE gjithashtu thekson se duhet të zhvillohen politika të tregut dhe mbledhjen të dhëna në përputhje me *acquis* të BE-së si dhe një inventar të llojeve të peshqve. Kosova, gjithashtu duhet të përforcojë ndjeshëm kapacitetet administrative për menaxhimin e politikave, inspektimet dhe kontrollat. KE, thekson se duhet të miratohet Strategjia shumëvjeçare kushtuar akuakulturës dhe legjislacionit për akuakulturën më *acquis*. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Miratimin e strategjisë shumëvjeçare kushtuar akuakulturës;
- Përafrimin e politikave të tregut me *acquis*;
- Krijimin e inventarit të llojeve të peshqve;
- Përforcimin e kapaciteteve administrative për menaxhimin e politikave, inspektim dhe kontroll.

Në *NK VII për Bujqësi dhe Peshkatari* KE vlerësoi përpjekjet për inventarizimin e peshqve në bashkëpunim me sektorin publik dhe shkencor dhe inkurajoj Kosovën që të përmirësoj kapacitetet administrative në këtë fushë. Në këtë NK Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

- Rritja e përpjekjeve për të forcuar kapacitetet administrative për të siguruar përafrimin e duhur legjislativ dhe për të kapur mundësitë ekonomike;
- Të harmonizojë më tej kontrollin e saj të peshkimit, si dhe të akuakulturës, politikës së tregut dhe mbledhjes së të dhënave me *acquis*;
- Përgatitja e aplikacioneve TAIEK për metodologjinë e mbledhjes së të dhënave dhe avancimit të legjislacionit dhe politikave të peshkimit;
- Përfundimi i procesit për të krijuar një inventar të llojeve të peshqve në një zonë pilot;
- Hartimi i koncept dokumentit për peshkimin dhe akuakulturën.

Korniza ligjore dhe ajo institucionale: Ligji kryesor në këtë kapitull është Ligji për Peshkatari dhe Akuakulturë, i cili nuk është i përafëruar me *acquis*, ndërsa gjithashtu janë në fuqi katër (4) UA për peshkimin e pajisjet për peshkim sportiv-rekreativ, licencimin e aktiviteteve në akuakulturë, përcaktimin e rajoneve/zonave të peshkimit dhe mbrojtjen e peshkut në ujërat e peshkimit. Dokumentet kryesore të *politikave* në këtë kapitull është Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028. *Institucioni* kryesor përgjegjës në këtë kapitull është MBPZHR, përkatësisht Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje, përgjegjës për legjislacion dhe politika, në bashkëpunim me Federatën e Peshkatarëve Sportivë të Kosovës (FPSRK). Institucion zbatues në fushën e akuakulturës është Inspektorati i bujqësisë.

Objektivat prioritare afatmesme:

- Miratimi i strategjisë shumëvjeçare për akuakulturë;
- Përforcimi i ndjeshëm i kapaciteteve administrative për menaxhimin e politikave, inspektimin dhe kontrollin;
- Harmonizimi i mëtejshëm i politikave të tregut me *acquis*;
- Inventarizimi i llojeve të peshqve.

3.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit

Acquis dhe politikat e BE-së në këtë kapitull synojnë funksionimin e tregut të brendshëm përmes shërbimeve të sigurta, efikase dhe ekologjikisht të qëndrueshme me një sistem të integruar të transportit sa më miqësor ndaj mjedisit. Ato ndërlidhen me standardet teknike, të sigurisë dhe ato sociale, përfshirë kontrollin e ndihmës shtetërore dhe liberalizimin e tregut të transportit.

Gjendja aktuale

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova është në fazë të hershme të përgatitjes në këtë fushë dhe ka bërë progres të kufizuar me miratimin e Strategjisë së Transportit Multimodal. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Investimin në mirëmbajtjen dhe inspektimin e rrugëve, organizoj fushata parandaluese dhe të krijoj një mekanizëm monitorues sistematik për mbledhjen e të dhënave të aksidenteve, dhe të vazhdoj harmonizimi me *acquis* të tregut hekurudhor të BE-së, në veçanti, Ligjin për sigurinë dhe ndërveprueshmërinë;
- Miratimin e PV 2023-2025 të Strategjisë së Transportit Multimodal;
- Përafrimin e legjislacionit të aviacionit me Marrëveshjen për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit;
- Miratimin e strategjisë dhe PV për sistemin inteligjent të transportit (ITS);
- Sigurimin e kapaciteteve dhe burimeve të mjaftueshme për zbatimin e kësaj strategjie;
- Vazhdimin e harmonizimit me *acquis* të BE-së sa i përket të drejtave të pasagjerëve në të gjitha llojet e transportit;

Më tej, në NK VII për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

Konektiviteti:

- Të miratojë dhe zbatoj PV 2023-2025 të Strategjisë së Transportit Multimodal, në përputhje me Strategjinë për Qëndrueshmëri dhe Mobilitet të Mençur të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor;
- Të miratojë Ligjin e ri për Transportin, i cili përfshin transportin multi-modal;
- Të miratojë UA mbi kornizën për vendosjen e sistemeve inteligjente të transportit (SIT);
- Të miratojë Ligjin për rrugët;
- Të miratojë Strategjinë së Sistemeve Inteligjente të Transportit;

Rrugët:

- Të zbatojë *acquis* e BE-së sipas PV rrugor të Komunitetit të Transportit;
- Të zbatojë plotësisht veprimet e përcaktuara në PV rajonal për Sigurinë Rrugore të miratuar në tetor 2020;
- Të zhvillojë një PV gjithëpërfshirës kombëtar për sigurinë rrugore për 2023-2030;
- Të vendosë për strukturën institucionale për menaxhimin e sigurisë rrugore duke përfshirë themelimin e një Agjencie udhëheqëse për sigurinë rrugore;
- Të identifikojë akset rrugore me rrezikshmëri të lartë dhe të zbatoj plotësisht i rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së rrjetit rrugor;
- Të miratojë Koncept Dokumentin për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme;
- Të miratojë versionin e rishikuar të Ligjit për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme;

Hekurudhat:

- Të transpozojë *acquis* e BE-së për tregun hekurudhor dhe në veçanti, harmonizimi i Ligjit për Hekurudhat me Direktivën 2012/34, të ndryshuar me Direktivën 2016/2370;
- Të përafrojë Ligjin për Sigurinë dhe Ndërveprueshmërinë me Direktivat (BE) 2016/797 dhe (BE) 2016/798;
- Të sigurojë nënshkrimin e marrëveshjes financiare 2024-2028, të dorëzuar nga INFRAKOS në tetor 2019, ndërmjet Menaxherit të Infrastrukturës dhe autoriteteve kompetente;

Aviacioni:

- Të plotësojë transpozimin e kërkesave të mbetura nga Faza I e Marrëveshjes për Hapësinorë e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA) (2024);

Të drejtat e udhëtarëve:

- Të vazhdojnë përpjekjet për të transpozuar *acquis* e BE-së të drejtave të udhëtarëve në të gjitha llojet e transportit.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: Ligjet kryesore në këtë kapitull janë: Ligji nr. 04/l-179 për Transportin Rrugor, Ligji nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar, dhe Ligji nr. 04/l-063 për Hekurudhat e Kosovës. Ligji për Transportin Rrugor synon rregullimin dhe zhvillimin e transportit rrugor të udhëtarëve e mallrave, ofrimin e shërbimeve, qasjen e hapur e jo-diskriminuese në treg dhe rregullimin e regjimit të ngasjes dhe pushimit. Ligji për Aviacionin Civil synon rregullimin e sigurisë dhe aspektit ekonomik të aviacionit dhe promovimin e aviacionit civil dhe nxitjen e zhvillimit të tij në përputhje me normat ndërkombëtare. Ligji për Hekurudhat synon rregullimin e zhvillimin e transportit hekurudhor, përmirësimin e sigurisë, qasjen e hapur e jo-diskriminuese të operatorëve dhe ofrimin e shërbimeve në treg. Kosova gjithashtu ka ratifikuar Traktatin e Komunitetit të Transportit ndërmjet BE-së dhe shteteve të EJT, ndërsa gjithashtu janë në ligje të tjerë (Ligji mbi Rrugët, Ligji për Patentë Shofer; Ligji për Automjete; Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugor; Ligji për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme) dhe një numër i konsiderueshëm aktesh nënligjore, të harmonizuara pjesërisht me *acquis*. *Politikat:* Dokumenti kryesor në këtë kapitull është Strategjia Sektoriale dhe e Transportit Multimodal 2022-2030.

Institucioni kryesor në këtë fushë është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI), e cila harton dhe zbaton legjislacionin dhe politikën, përcakton standardet e detyrueshme për të gjitha llojet e transportit, në harmoni me *acquis* dhe ligje ndërkombëtare. Institucionet e tjera përgjegjëse në këtë kapitull janë: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC), Komisioni për Hetimin e Aksidenteve edhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA); Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH); dhe Infrakos.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Miratimi i ligjit për transportin multimodal/të kombinuar;
- Fillimi i zbatimit të Pakos IV Hekurudhore, e cila përfshin standarde teknike specifike e procedura autorizimi për mjetet lëvizëse, kërkesa specifike për trajnim të fuqisë punëtore, si dhe kërkesa shtesë për pavarësi për menaxherin e infrastrukturës dhe liberalizimin e plotë të tregut vendor për shërbimet e transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave;;
- Rehabilitimi i përgjithshëm dhe modernizimi i Linjës X hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut);
- Përgatitja e projekt-dizajnit për linjën hekurudhore jugperëndimore (Klinë – Prizren);
- Përgatitja e projekt-dizajnit për linjën hekurudhore Prishtinë – Pejë;
- Përgatitja e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e linjës hekurudhore Kosovë – Shqipëri;
- Rehabilitimi i Linjës VII Hekurudhore (Fushë Kosovë – Podujevë – Merdarë);
- Zbatimi progresiv i obligimeve që dalin nga Faza II e Marrëveshjes HPEA;
- Zbatimi i Programit Shtetëror të Sigurisë dhe Planit Shtetëror të Sigurisë së Aviacionit që e përcjellë atë, në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 300/2008.

3.15. Kapitulli 15: Energjia

Aftësia konkurruese, siguria e furnizimit dhe qëndrueshmëria janë objektivat kryesore të politikave të BE-së në këtë kapitull. Ato përfshijnë rregullat lidhur me konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, kushtet për qasje të barabartë në resurset për eksplorim dhe për prodhimin e hidrokarbureve dhe të tregut të brendshëm të energjisë, si dhe promovimin e burimeve të ripërtëritshme (BRE), eficiencës së energjisë dhe mbrojtjen nga rrezatimi e sigurinë bërthamore.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova ka bërë disa përparime, veçanërisht me miratimin e Strategjisë së Energjisë në mars 2023, me lansimin e ankandit për parkun e parë me energji diellore prej 100 MË në maj 2023, dhe me investime sa i përket masave të eficiencës së energjisë në ndërtesat publike dhe rezidenciale në përputhje me PV të Paketës për Mbështetje Energjetike, ndërsa ka pasur disa përparime në sigurinë e furnizimit, por sa i përket tregut të brendshëm të energjisë, nuk ka progres me hapjen e mëtejshme të tregut. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Vazhdimin e përmirësimit mjedisor të TC Kosova B dhe punimeve për dekomisionimin e pjesëve jofunksionale të TC Kosova A;
- Vazhdimin e shpërndarjes së fondit të eficiencës së energjisë dhe zbatoj mbështetjen për ndërtesat rezidenciale dhe ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme;
- Miratimin e Ligjit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë dhe të nënshkruajë një marrëveshje të drejtpërdrejtë me ofruesin e shërbimit për përdorimin e regjistrit elektronik kombëtar për lëshimin, anulimin dhe tregtimin e garancive të origjinës.

Më tej, në NK VII për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal, Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

Siguria e furnizimit:

- Të adresohet çështja e devijimeve të paqëllimshme në mënyrë që ato të mbeten në nivel të pranueshëm dhe të sigurohet që marrëveshjet financiare ndërmjet KOSTT-it dhe OST-ve të tjera nga Zona Sinkrone e Evropës Kontinentale të bëhen në kohën e duhur sipas Marrëveshjes për Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale;
- Në përputhje me tranzicionin e qëndrueshëm të gjelbër në Evropë, të finalizohet faza e tretë e studimit gjithëpërfshirës mbi burimet alternative të qëndrueshme të energjisë;
- Të miratohet Ligji për stoqet e detyrueshme të naftës si dhe udhëzimet administrative për bio-lëngjet dhe bio-karburantet dhe zbatohen kriteret e qëndrueshmërisë për biokarburantet dhe lëngjet bio;
- Të përgatitet dekomisionimi i pjesëve jofunksionale të Kosovës A, të bëhet finalizimi i vendimit për financimin e depozitimit të mbetjeve të rrezikshme dhe të përgatitet një vlerësim i ndikimit mjedisor dhe social me konsultim të duhur publik me qëllim për marrjen e një vendimi përfundimtar;
- Të përfundohen punët shtesë në mbështetje të projektit të financuar nga BE-ja për Termocentralin Kosova B në mënyrë që Punimet e Reduktimit të Emisioneve të financuara nga BE-ja të mund të fillojnë në prill 2024 në të dy njësitë, B1 dhe B2.

Tregu i brendshëm i energjisë:

- Të adresohet urgjentisht çështja e mungesës së alokimit të kapaciteteve ndërkufitare ndërmjet KOSTT-it dhe EMS-së për të lehtësuar shkëmbimet komerciale në rajonin e Ballkanit Perëndimor;
- Të përcaktohen kufizimet kryesore që duhet të adresohen në maksimizimin e vlerave të Kapaciteteve Neto të Transferimit në të gjithë kufijtë me synimin për të arritur objektivin 70%;
- Të miratohen masave zbutëse për konsumatorët e cenueshëm dhe zbatimi i hapjes së tregut me pakicë, pasi të bëhet lirimi i vëllimit të detyrimit të shërbimit publik nga marrëveshja e furnizimit me shumicë ndërmjet KEK-ut dhe KESCO-s, përfundimi i marrëveshjes për furnizim me shumicë ndërmjet KEK-ut dhe KESCO-s gjithashtu është i rëndësishëm për të siguruar likuiditet pasi ALPEX të hyjë në fuqi;
- Të sigurohet zbatimi i marrëveshjes ndërmjet KEDS-it dhe Elektroserver për shërbimin e komunave veriore.

Energjia e ripërtëritshme:

- Të realizohet lancimi i ankandit të parë të BRE-ve dhe miratimi i Ligjit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë në përputhje me Direktivën (BE) 2018/2001 për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme;
- Të bëhet vlerësimi i duhur i projekteve të propozuara të hidrocentraleve, duke përfshirë kryerjen e Vlerësimeve të nevojshme të Ndikimit në Mjedis (të vazhdueshme);
- Të bëhet anëtarësimi pa vonesë në regjistrin rajonal të garancive të origjinës.

Eficiencyca e energjisë:

- Të zbatohen masat e Eficiencycës së Energjisë si pjesë e PV të Paketës së Mbështetjes së Energjisë;
- Të ndërmerren masa për të planifikuar rimbushjen e Fondit të Eficiencycës së Energjisë në baza vjetore dhe shtrirja e tij në ndërtesat e banimit dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM);
- Të miratohen stimujt të efikasitetit të energjisë për sektorin privat dhe familjet duke u fokusuar në aspektet sociale dhe familjet me të ardhura të ulëta (stimujt shtetërorë) dhe shfrytëzimin e programeve ekzistuese të BE-së në Kosovë.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: Ligji nr. 05/1-085 për Energjinë Elektrike dhe Ligji nr. 06/L-079 për eficiencycë të energjisë janë dy ligjet kryesore në këtë kapitull. Ligji për Energjinë Elektrike përcakton rregulla e masa për funksionimin e sektorit të energjisë elektrike; si dhe garantimin e furnizimit të sigurt, të besueshëm, të rregullt dhe cilësor me energji elektrike me çmime reale duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin efikas të energjisë. Ligji për eficiencycë të energjisë synon promovimin dhe përmirësimin e eficiencycës së energjisë në Kosovë përmes përcaktimit dhe arritjes së caqeve të eficiencycës së energjisë, si dhe zhvillimin e tregut të shërbimeve energjetike dhe masave të tjera të eficiencycës së energjisë. Gjithashtu janë në fuqi disa ligje (Ligji për Rregullatorin e Energjisë, Ligji për Energjinë Termike, Ligji për Gazin Natyror) dhe një numër i konsiderueshëm aktesh nënligjore, të cilat kanë transpozuar pjesërisht aktet relevante të *acquis*-së. *Politikat:* dokumenti kryesor në këtë kapitull është Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031, dhe Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2022-2025.

Institucioni kryesor në këtë kapitull është Ministria e Ekonomisë (ME), përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave, përfshirë atyre për konkurrencë dhe një treg të qëndrueshëm dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve energjetike dhe minerare. Institucionet e tjera përgjegjëse në këtë kapitull janë: MMPHI, MINT, MFPT, ZRrE, KOSTT, KESCO (përgjegjëse për shpërndarje dhe furnizimin me energji elektrike) dhe Fondi Kosovar për Eficiencycë të Energjisë (FKEE), dhe Agjencia Kosovare për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (AKMRrSB).

Objektivat prioritare afatmesme:

- Rishikimi i legjislacionit zbatues;
- Hartimi dhe miratimi i rregullave të reja të balancimit ndërkufitar;
- Dekomisionimi i objekteve të gazifikimit, azotikut, ngrohtores dhe objekteve të tjera përcjellëse të cilat nuk e pengojnë operimin normal të njërive aktive të TC *Kosova A*;
- Anëtarësimi i plotë i KOSTT-it në ENTSO-E (Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit);
- Anëtarësimi i ZRrE-së në ACER (Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë);
- Miratimi i politikave të stimujve dhe zbatimi i masave të eficiencycës së energjisë në amvisëri dhe biznese;
- Zbatimi i planit të investimeve kapitale për forcimin, zgjerimin e rrjetit dhe projektet e tensionit të mesëm për të zvogëluar humbjet teknike dhe komerciale;
- Finalizimi i planit kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me konsum afër zero energji (NZEB);
- Zhvillimi i aktiviteteve për instalimin e elektro-filtrave dhe reduktimin e oksideve të azotit (NOx) në TC *Kosova B*;
- Zhvillimi i aktiviteteve për ndërtimin e parkut solar;
- Ndërmarrja e aktiviteteve për ndërtimin e sistemit të baterive për ruajtjen e energjisë me kapacitet prej 170 MË;
- Përgatitjet e nevojshme për Projektin "*Prishtina Solar District Heating*";
- Përgatitjet e nevojshme për realizimin e Projektit "*Dyfishimi i kapaciteteve të koogjenerimit për Termokos nga 140 në 280 MË*";
- Mbështetja e konsumatorëve të amvisërive individuale, përfshirë konsumatorët e cenueshëm, duke rritur efikasitetin energjetik të njërive të banimit dhe ndërtesave;

- Mbështetja e konsumatorëve shtëpiakë, përfshirë konsumatorët e cenueshëm në investimin e pajisjeve shtëpiake me efikasitet energjetik dhe sisteme të energjisë së ripërtëritshme;
- Stimulimi i kursimit të energjisë nga NVM-të.

3.16. Kapitulli 16: Tatimet

Acquis në këtë kapitull përbëhet nga legjislacioni për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSh), akcizat dhe tatimin në korporata, përfshirë bashkëpunimin ndërmjet administratave tatimore, shkëmbimin e informatave për të parandaluar evazionin fiskal, me synim trajtimin e barabartë tatimor të transaksioneve vendore e të huaja (nga importi). Legjislacioni për akcizën është i harmonizuar për produktet e energjisë përfshirë produktet e derivateve të naftës dhe produktet elektrike, produktet e duhanit dhe alkoolin. Legjislacioni i BE vendos strukturën e akcizave të aplikueshme dhe sistemin e tarifave minimale për secilin grup të produkteve. Sidoqoftë akciza është e pagueshme vetëm në shtetin anëtar në të cilin produkti lirohet në qarkullim sipas normave të aplikueshme në atë shtet anëtar të BE-së. Legjislacioni i BE gjithashtu përmban provizione për prodhimin, mbajtjen, lëvizjen dhe monitorimin e mallrave për të cilat aplikohet akciza dhe provizione për lejimet për udhëtarët.

Në fushën e tatimit direkt, *acquis* përfshin disa aspekte të tatimit në fitim dhe shmangien e tatimit në dyfishtë. Në këtë fushë, fokusi është në eliminimin e çrregullimeve në qarkullimin ndër-shtetëror të aktiviteteve ekonomike në BE. Po ashtu, ekziston *acquis* në fushën e digjitalizimit dhe kapacitetit operacional ku bëjnë pjesë disa sistemi për shkëmbimin e informacionit (për TVSH, akcizave, riimbursimit etj.) midis shteteve anëtare si Sistemi për shkëmbimin e informacionit për TVSH, sistemi për shkëmbimin e të dhënave të akcizës (SEED) etj.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova ka një nivel të përgatitjes në fushën e tatimeve. Është bëri njëfarë progresi me zbatimin e inspektimeve tatimore të bazuara në rrezik në disa sektorë me rrezik të lartë dhe digjitalizimin e shërbimeve. Rritja e masave të pajtueshmërisë dhe formalizimit kanë çuar në rritjen e të ardhurave tatimore. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Vazhdimin e përafrimit të legjislacionit tatimor duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat personale (TAP) dhe tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) me *acquis* të BE-së;
- Sigurimin e zbatimit më sistematik të kontrolleve tatimore të bazuara në rrezik dhe finalizimin e strategjisë së re për luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar (2023-2026);
- Rritjen e bashkëpunimit me organet ligj-zbatuese dhe ato gjyqësore për të garantuar gjykimin në kohë të rasteve të evazionit fiskal dhe mashtrimit, me theks në sektorët me rrezik të lartë.

Më tej, në konkluzionet e *NK për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime Kosova* ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

- Të ndërmarrë hapa drejt një rishikimi të plotë e gjithëpërfshirës të politikave tatimore, veçanërisht në lidhje me digjitalizimin e shërbimeve tatimore;
- Të zbatojë masa kundër korrupsionit të parapara në Planin e Integritetit të ATK-së dhe publikimi i raportit të zbatimit të tij;
- Të miratojë Ligjin për ATK-në dhe Procedurat, Ligjin për TVSh-në, Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave dhe Ligjin mbi Tatimin mbi të Ardhurat Personale, në përputhje me praktikat e mira evropiane;
- Të përshpejtojë veprimet për përmirësimin e regjistrat të tatimpaguesve duke krahasuar të dhënat me regjistrat e tjerë, me qëllim të administrimit më efikas dhe përmirësimit të menaxhimit të pajtueshmërisë së tatimpaguesve;
- Të forcojë më tej funksionet e Menaxhimit e Rrezikut të Përputhshmërisë dhe kontrollet e vazhdueshme tatimore në sektorët e bazuar në rrezik dhe të publikojë rregullisht raportet mbi zbatimin e kësaj metodologjie dhe të Strategjisë së Përmirësimit të Auditimit 2020-2022;

- Të vazhdojë dhe të forcojë përafrimin e sistemit/juridiksioneve tatimore me standardet e kornizës të OECD për erozion të bazës tatimore dhe zhvendosjes së fitimit (BEPS), dhe shkëmbimin automatik të informatave gjatë hartimit dhe shqyrtimit të legjislacionit përkatës;
- Të hartojë dhe miratojë UA për përcaktimin se cilat ngastra të tokës bujqësore kultivohen dhe të ndërlihdë regjistrin e parcelave të kultivuara me sistemin e tatimit në pronë.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Ligjet kryesore në këtë kapitull janë: Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale, Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Ligji për TVSh-në, Kodi Doganor dhe i Akcizave, Ligji për Akcizën në Produktet e Duhanit, Ligji për Tarifat e Veçanta të Akcizës për Prodhimin Fillestar dhe Prodhimin e Vogël të Produkteve Alkoolike të prodhuara në Kosovë, Ligji për Faljen e Borxheve Publike, dhe Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës. Këto ligje kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në përkatëse. Gjithashtu janë në fuqi akte nënligjore të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në përkatëse. *Politikat*: Dokumentet kryesore në këtë kapitull janë: Plani Strategjik i ATK-së 2021-2025 dhe Strategjia e Përbushjes 2021-2025 (e cila synon ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së shërbimeve që ofrohen për tatimpaguesit që përbushin vullnetarisht detyrimet e tyre ligjore).

Institucionet kryesore në këtë kapitull janë dy agjencitë ekzekutive të MFPT-së Administrata Tatimore (ATK) dhe Dogana (DK). ATK është agjencia kryesore për mbledhjen e tatimeve në Republikën e Kosovës dhe ka të drejtë të zbatojë ligjet fiskale, të administrojë taksat dhe tarifat ndërkombëtare, me mision të veçantë ofrimin e ndihmës tatimpaguesve për përbushjen e detyrimeve tatimore në përputhje me ligjin dhe sigurimin që të ardhurat nga taksat të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, dhe vendosjen e një sistemi efektiv pagesash. Dogana e Kosovës është përgjegjëse për mbledhjen e TVSh-së në kufi, për të gjitha importet dhe për mbledhjen e të hyrave nga akciza.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit për TVSh, tatimin e korporatave dhe tatimin në të ardhura personale, në harmoni me *acquis*, përfshirë Kodin e Mirësjelljes për Tatimin e Biznesit dhe direktivat përkatëse;
- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të ligjeve për TVSh, TAK, dhe TAP, me qëllim të përafrimit të tyre me *acquis*, përfshirë Kodin e Mirësjelljes për Tatimin e Biznesit dhe direktivat përkatëse;
- Rritja e inkasimit të borxheve tatimore;
- Zbatimi i modernizimit të teknologjisë informative në ATK;
- Vazhdimi i përmirësimit të përbushjes tatimore bazuar në vlerësimin e rrezikut;
- Zbatimi i Strategjisë së ATK 2022-2026;
- Përmirësimi i funksionit të kontrollit tatimor sipas praktikave të mira ndërkombëtare;
- Modernizimi i Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj;
- Luftimi i evazionit tatimor, shmangies tatimore dhe zgjerimi i bazës tatimore;
- Rritja e përbushjes së deklarimit në kohë;
- Rritja e inkasimit të borxheve tatimore.

3.17. Kapitulli 17: Politikat ekonomike dhe monetare

Ky kapitull vendos rregulla specifike që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore, duke ndaluar financimin e drejtpërdrejtë të sektorit publik nga bankat qendrore dhe qasjen e privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Shtetet anëtare pritët të bashkërendojnë politikat e tyre ekonomike dhe të respektojnë Paktin e Stabilitetit dhe Rritjes për mbikëqyrjen fiskale. Deri në plotësimin e kushteve për adoptimin e Euros, ato marrin pjesë në Unionin Ekonomik dhe Monetar si shtete anëtare me shmangie nga përdorimi i euros dhe do i trajtojnë kurset e tyre të këmbimit si çështje me interes të përbashkët. *Acquis* në këtë kapitull rrjedh nga Kreu VIII (nenet 119-144) i TFBE dhe nga legjislacioni zbatues përkatës.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova është mesatarisht e përgatitur në fushën e politikave monetare. Duke konstatuar se janë bërë përpjekje në mbledhjen dhe transmetimin e të dhënave tek Eurostat, Raporti kërkon që të trajtohen mospërpjekjet sa u përket llogarive kombëtare. Aty gjithashtu theksohet që BQK ka pasur sfida në ushtrimin e funksioneve të saj bazike dhe realizimin e përgjegjësisë. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Forcimin e qeverisjes së Bankës Qendrore duke përfunduar procedurat e përzgjedhjes së Zëvendës-Guvernatorit;
- Përmirësimin e kapaciteteve raportuese për statistikën financiare qeveritare sipas ESA 2010 dhe të sigurohet monitorimi i rregullt i standardeve;
- Përmirësimin e cilësisë së parashikimeve makroekonomike në procesin buxhetor.

Edhe në konkluzionet e *NK më të fundit për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika* Kosova ka marrë përsipër të zbatojë masa të ngjashme me aspektet e sipër-përmendura.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Akti kryesor në fushën e politikave monetare është Ligji për BQK-në, i cili është pjesërisht në përputhje me *acquis*. Janë edhe disa ligje tjera që pjesërisht janë relevante për këtë fushë dhe të cilat janë prezantuar tek kapitulli 9 dhe 4 respektivisht. Në vitin 2002 Kosova ka adoptuar në mënyrë të njëanshme Euron si valutë të saj legale, e cila është de facto valuta në Kosovë, prandaj politika monetare e Kosovës është mjaft e kufizuar. I vetmi instrument tradicional i politikës monetare që disponon BQK është kërkesa për rezervë bankare. Marrë parasysh këto kufizime, Qeveria dhe BQK kanë themeluar Ndhimën Emergjente të Likuiditetit (ELA), si fond emergjent që do të aktivizohet në rast të mungesës së likuiditetit në sektorin bankar. BQK, e transformuar nga Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës, është person juridik publik i rregulluar me Kushtetutë (nenet 11 dhe 140) dhe dispozitat e ligjit, që gëzon autonomi administrative, financiare dhe menaxheriale. Sipas nenit 6 (pavarësia dhe autonomia) të Ligjit për BQK-në, anëtarët e organeve vendimmarrëse apo personeli i BQK-së nuk marrin udhëzime nga ndonjë person apo subjekt tjetër, pra as nga entitetet qeveritare. *Politikat ekonomike* rregullohen nga këto ligje: Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji nr. 03/L-175 për Borxhin Publik, ligjet për buxhetin vjetor të Republikës së Kosovës, dhe Ligji nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomik Social. Gjithashtu është në fuqi Rregullorja nr. 01/2015 për punën e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës.

Politikat në këtë kapitull i përcaktojnë dokumentet strategjike nacionale, sektoriale dhe Programi i Qeverisë (si një nga dokumentet kryesore që orienton zhvillimin e politikave të Qeverisë në planin afatmesëm). Në përgjithësi, ka konsensus për thelbin e politikave nacionale ekonomike, me fokus të veçantë në orientimin drejt krijimit të kushteve për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe gjenerimin e punësimit të qëndrueshëm. Janë krijuar mekanizma ligjorë që kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit të përgjithshëm makro-ekonomik, përfshirë rregullat fiskale dhe tavanin për borxhin publik. Gjithashtu është zhvilluar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), për të mbështetur planifikimin dhe zbatimin e prioritetëve dhe reformave. KASH është mekanizmi që ka Qeveria për të vendosur politikën e saj fiskale dhe shërben si dokument kryesor për planifikimin e politikave në vend. Korniza fiskale përfshin planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve për tre vitet e ardhshme, përcakton kufijtë e shpenzimeve për të gjitha organizatat buxhetore, të përcaktuara në bazë të prioritetëve të Qeverisë, si dhe financimit të deficitit dhe nivelit të bilancit bankar.

Qeveria është organi vendimmarrës sa u përket politikave në nivel vendi, përfshirë kornizën strategjike dhe atë të financimit. Në kuptim të politikave sektoriale, ministritë përgjegjëse për aspekte të caktuara të politikave ekonomike janë: MFPT, për kornizën e menaxhimit të financave publike, ME, për politikën e ndërmarrjeve publike; MINT, për politikën ekonomike për zhvillimin e industrisë, sektorit privat, tregtisë dhe investimeve strategjike dhe institucione tjera sipas mandatit të tyre ligjor.

Për objektivat prioritarë afatmesme, shihni bllokun 2 dhe kapitujt 4 dhe 9 të këtij blloku.

3.18. Kapitulli 18: Statistikat

Acquis në këtë kapitull kërkon një infrastrukturë statistikore të bazuar në parimet e paanshmërisë, besueshmërisë, transparencës, konfidencialitetit të të dhënave individuale dhe shpërndarjes së statistikave

zyrtare. Ajo përfshin rregulla të përbashkëta për metodologjinë, klasifikimet dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave statistikore në fusha si statistikat makro-ekonomike dhe të çmimeve, statistikat demografike dhe sociale, statistikat rajonale, statistikat e biznesit, të transportit, të tregtisë së jashtme, të bujqësisë, të mjedisit, të shkencës e teknologjisë, etj. Ky legjislacion konsiston në numër të madh aktesh direkt të zbatueshme për vendet anëtare, si dhe manuale e udhëzues metodologjikë.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova ka arritur njëfarë niveli të caktuar të përgatitjes në këtë kapitull. Raporti thekson se janë arritur përparime në përmirësimin e metodologjisë së mbledhjes së të dhënave dhe transmetimit të tyre në Eurostat, dhe zbatimit të rekomandimeve nga vlerësimi homolog i vitit 2017. Është arritur progres në ndërveprimin dhe komunikimin ndërinstitucional, megjithatë ka sfida në nivel teknik, gjegjësisht në qasjen dhe përdorimin e të dhënave administrative në dispozicion. Kosova gjithashtu ka përmirësuar shpeshësinë e publikimeve statistikore, p.sh., statistikat për energjinë, statistikat sociale dhe statistikat afatshkurtra në sektorin e shërbimeve tani dërgohen në Eurostat çdo muaj, ndërsa më parë dërgoheshin çdo tre muaj. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Finalizimin e përgatitjeve për regjistrimin e popullsisë e banesave dhe zbatimin e tij duke siguruar detaje operacionale të regjistrimit të popullsisë dhe mbulim të plotë të territorit;
- Shtimin e numrit të produkteve statistikore dhe dërgimin e tyre më shpesh në Eurostat;
- Plotësimin e vendeve të zbrazëta të punës në ASK dhe ngritjen e kapaciteteve të saj.

Më tej, në konkluzionet e *NK për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika* kërkohet vazhdimi i forcimit të pavarësisë profesionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), për të siguruar zbatimin e Ligjit për Statistikat Zyrtare. Gjithashtu rekomandohet të vazhdohet me zhvillimin e statistikave sektoriale, të zbatohet PV për zbatimin e rekomandimeve të Eurostatit dhe të rritet roli koordinues i ASK-së në sistemin kombëtar statistikor duke siguruar që ASK të ketë rol aktiv në krijimin dhe modifikimin e të dhënave administrative që përdoren për statistikat zyrtare.

Korniza legjislative, institucionale dhe ajo e politikave

Ligji bazë në këtë kapitull është Ligji i plotësuar-ndryshuar nr. 04/1-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës e Kosovës, në fuqi nga viti 2011, Ligji nr. 06/1-058 (janar 2019) për plotësim-ndryshimin e ligjit nr. 04/1-036 për statistikat zyrtare të republikës e Kosovës. Me 26 prill 2023, janë miratuar nga qeveria, UA për Mbrojtjen e të Dhënave Statistikore dhe Qasjen në të Dhënat Mikro si dhe UA për Shitjen e të Dhënave Statistikore. Ndërsa zbatohen edhe këto ligje e akte nënligjore: Ligji nr. 03/1-209 për BQK-në, Ligji nr. 03/1-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar-ndryshuar me Ligjin nr. 03/1-221, Ligjin nr. 04/1-116 dhe Ligjin nr. 04/1-194, Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore (i cili kërkon mbledhjen, mbajtjen, dhe procesimin e të gjitha të dhënave zyrtare të ndara në baza gjinore); Rregullorja mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, Rregullorja mbi Statistikat Monetare-financiare dhe Llogaritë Financiare, dhe Rregullorja MF-nr. 01/2017 për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore. Për zbatimin e Ligjit për Statistikat Zyrtare gjithashtu është në fuqi UA për Ruajtjen e Lëndës Statistikore dhe për Përpunime të Veçanta Statistikore), Rregullorja nr. 11/2013 për Zbatimin e Standardit për Klasifikimin e Veprimtarive Ekonomike në Versionin NACE-Rev. 2 (në harmoni me Rregulloren nr. 1893/2006 të Parlamentit Evropian) dhe klasifikimi i rajoneve statistikore në Kosovë sipas NUTS (i miratuar nga institucionet përkatëse të Kosovës dhe nga Eurostat).

Programi i Statistikave Zyrtare 2023-2027, është dokument planifikues afatmesëm që përmban fushat dhe aspektet prioritare të prodhimit të statistikave. Pas publikimit nga KE të raportit vlerësues për sistemin statistikor të Kosovës, ASK ka hartuar një plan për zbatimin e rekomandimeve të tij dhe është duke e zbatuar atë.

Sa i përket kornizës institucionale, bazuar në legjislacionin në fuqi, sistemin statistikor e përbëjnë ASK (në kuadër të ZKM-së), MFPT, BQK dhe institucionet e tjera të autorizuara. Si institucion koordinues i sistemit shtetëror statistikor dhe prodhuesve të statistikave, ASK siguron koherencën e pajtueshmërinë e sistemit statistikor me standardet në fuqi. ASK është përgjegjëse për metodologjinë statistikore; harmonizimin e të

dhënave zyrtare statistikore dhe identifikimin e prioritizimin e nevojave të përdoruesve të tyre; si dhe krijimin, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe freskimin e regjistrave të popullsisë, ekonomive familjare, shtëpive e banesave, bizneseve, njësive hapësinore, ekonomive bujqësore dhe regjistrave të tjerë, pajtim me planet dhe vendimet. BQK është përgjegjëse për statistikave monetare-financiare dhe ato të sektorit të jashtëm, të cilat janë në përputhje me standarde të zhvilluara nga FMN, BB, BQE, Eurostati, etj. MFPT është përgjegjëse për parashikime dhe analiza në mbështetje të vendimmarrjes lidhur me politikave ekonomike, nxjerrjen e publikimit të statistikave të sektorit fiskal e atyre të borxhit publik, si dhe për të ofruar informata për numrin e punëkërkesve, numrin e shërbimeve që ofron, përfitimet nga papunësia, subvencionet për familjet në nevojë etj. Ofruesit e tjerë kryesorë të të dhënave administrative, sipas mandatit të tyre ligjor, që përdoren për përpilimin e statistikave zyrtare janë: MASHTI, MBPZhR, MMPHI, MINT dhe MPB. Ka edhe një varg institucionesh të tjera që gjenerojnë, përpunojnë dhe publikojnë të dhëna të ndryshme administrative. Të dhënat administrative i përdor ASK në periudha të caktuara për të informuar publikun për gjendjen në fushat përkatëse, të cilat përpiqet t'i kombinojë me të dhëna nga anketimet që i kryen.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Forcimi i burimeve njerëzore dhe kost-efektiviteti në ASK;
- Forcimi i menaxhimit të cilësisë dhe metodologjisë, përfshirë, ndër të tjera:
 - Modernizimin e tërë sistemit për mbledhjen e të dhënave përmes zbatimit të metodës CAPI, CAËI dhe CATI;
 - Zhvillimin dhe avancimin i mëtejshëm i Sistemit të Metadave SIMS dhe ngritja e cilësisë së përshkrimit të metadave për të gjitha hulumtimet statistikore dhe hulumtime të tjera të parashtruara nga statistikave prodhuese;
 - Arkitekturën e sistemit të TI-së me bazë në procese të përbashkëta dhe të dokumentuara;
- Rritja dhe përmirësimi i statistikave zyrtare, përfshirë:
 - Harmonizimin e mëtejshëm me Sistemin Evropian për zbatimin e plotë të Metodologjisë të Llogarive Kombëtare (ESA) 2010;
 - Publikimin e llogarive rajonale në vitin 2025 si të rregulla, ndërsa në fund të vitit 2023 do të bëhet një raport përmbledhës si eksperimental.
 - Përpilimin e GDP sipas qasjes së të ardhurave- është eksperimentale në fund të vitit 2023, ndërsa me "Programin e statistikave zyrtare" publikimi është planifikuar për vitin 2025;
 - Shtimin e numrit të tabelave të BPV-së për programin e transmisionit, të cilat do t'i dërgohen Eurostatit;
 - Përmirësimin e mëtejshëm të Llogarive Kombëtare dhe Statistikave të Financave Qeveritare, në përputhje me ESA 2010, manualin e FMN dhe të GFSM 2014;
 - Përpilimin dhe publikimin e tabelave ofruese-përdoruese (SUT), duke përdorur të gjitha burimet e të dhënave, për të balancuar SUT me çmime aktuale dhe konstante (duke shfrytëzuar të gjithë deflatorët);
 - Integrimi i të dhënave të ekonomisë joformale në BPV behet në vitin 2025 kur do të behet revidimi I GDP;
 - Përllogaritjen e BPV-së sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PFB/PPP);
 - Përmirësimin e vazhdueshëm të të dhënave të llogarive qeveritare sipas COFOG-ut;
- Zbatimin e Klasifikimit Ndërkombëtar të Krimin për qëllime statistikore (ICCS);
- Zbatimin e Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit ISCED 2011;
- Zbatimin e ESSPROS në statistikave të mbrojtjes sociale, ku ;
- Zhvillimin e përmirësimin e statistikave të transportit, hotelarisë e turizmit, ndërtimitarisë, investimeve, dhe atyre mbi përdorimin e TIK nga bizneset;
- Llogaritjet e ndotjes së ajrit, taksa mjedisore;
- Zgjerimin e statistikave të blektorisë dhe prodhimeve blegtorale me indikatorë të rinj (mishit, qumështit, vezëve, etj., si anketa të veçanta;
- Krijimi i depozitave të dhënave;
- Zhvillimi i platformës WebGIS;

- Zbatimi i një sistemi monitorimi duke shfrytëzuar teknologjinë e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS);
- Përgatitja e infrastrukturës CAPI për regjistrimin e bujqësisë. Përshtatja e metodave të mbledhjes së të dhënave, vendosjen e parametrave përkatës dhe integrimin e të dhënave bujqësore në kornizën më të gjerë të regjistrimit.

BQK do t'i pasurojë aktivitetet statistikore e kërkimore lidhur me ekonominë në përgjithësi dhe sistemin financiar në veçanti përmes këtyre veprimeve strategjike:

- Përpilimit dhe publikimit të statistikave për Llogaritë Financiare për Kosovën, konform metodologjisë së ESA 2010;
- Avancimit të mëtejshëm gjithëpërfshirës të statistikave monetare dhe financiare;
- Përpilimit të statistikave të bilancit të pagesave në baza mujore për raportim tek Eurostati;
- Zhvillimit të platformës online për raportim nga korporatat jo-financiare.

3.19. Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi

Acquis në këtë kapitull përfshin standardet minimale lidhur me punën, barazinë, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe mosdiskriminimin. Shtetet Anëtare marrin pjesë në dialogun social në nivel evropian dhe në proceset e politikave të BE-së në fushat e politikave të punësimit dhe ato të përfshirjes e mbrojtjes sociale.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova është në fazë të hershme të përgatitjes në këtë kapitull, ndërsa është bërë progres me përgatitjen e Planit për Punësimin e Garantuar të të Rinjve dhe sigurimin e fondeve për shërbimet sociale. Gjithashtu vlerësohet se Kosova ka harmonizuar me *acquis* legjislacionin për siguri dhe shëndet në punë dhe kërkohet zbatimi i tij dhe ngritja e kapaciteteve të Inspektoratit të Punës (IP). Më tej, sipas BE-së, theksohet se Kosova vazhdon të përballet me sfida strukturore të tregut të punës, si rezultat i rritjes së shpejtë të popullsisë në moshë pune në shpërputhje me krijimin e qëndrueshëm të vendeve të punës, me pjesëmarrje vazhdimisht të ulët të grave në tregun e punës, dhe me mundësi të pasigurta të punësimit. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Sigurimin e pilotimit të Skemës për Garantimin e të Rinjve;
- Miratimin e Ligjit të Punës, në përputhje me *acquis*-në;
- Intensifikimin e inspektimeve të punës, sidomos në sektorët me rrezikshmëri të lartë;
- Reformim gjithëpërfshirës të skemave të ndihmës sociale, për të garantuar shënjestrim dhe ndikim më të mirë mbi varfërinë dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve sociale në Komuna.

Më tej, në konkluzionet e *NK VI për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale* kërkohet:

- Miratimi e zbatimi i Ligjit të Punës dhe legjislacionit për shëndet dhe siguri në punë;
- Ngritja e kapaciteteve të IP-së dhe Agjencisë së Punësimit;
- Plotësim-ndryshimi Ligjit për Financa Lokale dhe gjetja e një formule më adekuate financimi.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni kornizë në këtë kapitull përbëhet nga dy ligje kryesore: Ligji i Punës dhe Ligji për Sigurinë e Shëndetin në Punë. Legjislacioni për siguri dhe shëndet në punë është përafëruar në masë të madhe me *acquis*: janë transpozuar 25 direktiva (direktivat individuale sipas nenit 16 (1) të Direktivës Kornizë 89/391 dhe të tjera) në 19 rregullore kombëtare. Sa u përket *politikave*, në kohën e përgatitjes së këtij dokumenti ishte duke u finalizuar Strategjia e Punësimit dhe Tregut të Punës 2023-2028. *Institucionet* kryesore përgjegjëse në këtë kapitull janë: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Ministria e Ekonomisë (ME), Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). MFPT harton dhe zbaton legjislacionin dhe politikat horizontale të punësimit, përfshirë masat aktive për zvogëlimin e papunësisë përmes nxitjes së punësimit dhe masave pasive për të përmbushur nevojat për ndihmë sociale për qytetarët nevojtarë. Ajo gjithashtu vendos standarde për sigurinë dhe mbrojtjen e të punësuarve në vendin e punës dhe mbikëqyr zbatimin e tyre, udhëheq dhe mbikëqyrë institucionet administrative publike të punësimit e ato të përkujdesjes sociale, të personave në nevojë dhe bashkëpunon me Komunitat e institucione të tjera relevante në zbatimin

politikave të punësimit dhe mirëqenies sociale, nxitë dhe inkurajon dialogun ndërmjet partnerëve socialë (organizatave të punëtorëve, sindikatave, organizatave të punëdhënësve dhe Qeverisë), dhe administron e përkrah sistemin e sigurimit social, përfshirë edhe sistemin pensional dhe benefitet e papunësisë. Pjesë e MFPT-së është edhe IP dhe APRK.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Zbatimi i punësimit të garantuar, dhe ndërlidhur me këtë edhe forcimi i kapaciteteve të qendrave të punësimit dhe reforma e arsimit dhe aftësimin profesional (AAP);
- Miratimi i ligjit të ri për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Miratimi i ligjit të ri për siguri dhe shëndet në punë dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij;
- Reformimi i skemave të asistencës sociale, përfshirë:
 - Miratimin e ligjit të ri për skemën e ndihmave sociale;
 - Miratimin e ligjit të ri për sigurime sociale dhe pensionet e financuara nga shteti.

3.20. Kapitulli 20: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë

Politika industriale në BE synon të promovojë strategjitë që forcojnë konkurrueshmërinë duke përsheptuar përshtatjen strukturore, inkurajuar një mjedis të favorshëm afarist dhe rritje të investimeve të brendshme e të jashtme në të gjithë BE-në. Ky kapitull kryesisht përmban parime dhe instrumente si komunikata, rekomandime dhe konkluzione të Këshillit, të cilat në masë të madhe zbatohen përmes Programit për Konkurrueshmëri dhe Inovacion për tërë BE-në, si dhe nga politikat sektoriale për industri dhe mbështetje të NVM-ve. Këto parime politikash përmes të cilëve BE synon të promovojë dhe forcojë konkurrueshmërinë dhe strategjinë industriale, burojnë nga fryma e nenit 173 të TFBE-së që synon përsheptimin e ndryshimeve strukturore, inkurajimin e ambientit të favorshëm afarist dhe për NVM-të, për investime të huaja hyrëse dhe dalje dhe për inkurajimin dhe mbështetjen e inovacionit dhe ndërmarrësisë.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova është mesatarisht e përgatitur në fushën e ndërmarrjeve dhe politikave të industrisë. Ajo ka bërë progres të mirë, pasi Qeveria ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin e Industrisë dhe Mbështetjen të Bizneseve 2030, e para e këtij lloji. Raporti thekson se Kuvendi miratoi Ligjin për investime të qëndrueshme dhe Ligjin për parqet teknologjike dhe industriale. Ligjet parashikojnë ngritjen e dy agjencive të reja të dedikuara për investimet dhe nxitjen e eksportit dhe mbështetjen e biznesit dhe sipërmarrjes. KIESA ka përmirësuar fuqishëm performancën e saj në vitin 2022, duke rritur investimet e huaja direkte (IHD) me 43.6% gjatë periudhës janar-shtator 2022 dhe duke rritur pjesëmarrjen e firmave kosovare në panairin ndërkombëtar të tregtisë. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Zbatimin e Strategjisë për zhvillimin industrial dhe përkrahje të biznesit, dhe shtyllën e rritjes së qëndrueshme ekonomike të strategjisë kombëtare të zhvillimit 2021-2030;
- Përmirësimin e kapaciteteve të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Përfundimin e ristrukturimit të KIESA-s në agjenci të veçanta për promovimin e investimeve dhe mbështetjen e NVM-ve, si dhe të sigurojë që të dyja të kenë burime të mjaftueshme.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Ligjet kryesore në këtë kapitull janë: Ligji nr. 04/L-220 për Investime të Huaja, Ligji nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Ligji për Parqet Industriale dhe Teknologjike, Ligji nr. 08/L-074 për Turizmin, Ligji nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i plotësuar-ndryshuar nga Ligji nr. 06/L-023. *Dokumentet kryesore të politikave* në këtë kapitull përfshijnë Programin e Qeverisë 2021-2025, i cili përmban prioritetet kryesore të Qeverisë në këto fusha; Programin për Reformave Ekonomike, i cili është një dokument afatmesëm që rishikohet në baza vjetore dhe përmban prioritetet dhe masa për vitin në vijim dhe dy vitet pasuese, Strategjia për zhvillim industrial dhe mbështetje të bizneseve 2030 dhe Strategjia Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi 2019-2023.

Institucionet: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), si institucioni kryesor përgjegjës në këtë kapitull, ushtron mandatin e saj përmes KIESA-s, Departamentit të Industrisë, Departamentit të

Ndërmarrësisë, Departamentit të Inovacionit dhe Departamentit për Investime Strategjike. MINT është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit e politikave, në harmoni me *acquis*, dhe instrumenteve relevante ndërkombëtare, si dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e tregtisë, industrisë, turizmit, mallrave strategjike, zonave ekonomike, sektorit privat, inovacionit, ndërmarrësisë, investimeve të huaja e atyre strategjike dhe mbështetjen e NVM-ve. Edhe MASHTI ka përgjegjësi në këtë kapitull, ndërsa Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime funksionon si strukturë koordinuese ndërinstitucionale. MASHTI është përgjegjëse për kërkime dhe inovacion dhe për ofrimin e mbështetjes për përfshirjen e aspekteve relevante të këtij kapitulli në kuadër të kurrikulave përkatëse të arsimit dhe aftësisë profesionale.

Objektivat prioritare afatmesme:

Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë:

- Zbatimi i strategjisë për zhvillim industrial dhe mbështetje të bizneseve 2030;
- Përmirësimi i mjedisit afarist dhe zhvillimi i turizmit;
- Promovimi dhe përkrahja e investimeve;
- Mbështetja e bizneseve në certifikimin e produkteve sipas standardet evropiane e ndërkombëtare përmes granteve të vogla dhe subvencioneve për NMVM për blerjen e makinerive prodhuese/përpunuese, duke siguruar, aty ku është e mundur, përfaqësim të barabartë gjinor;
- Zhvillimi i industrisë përmes forcimit të kornizës së politikave dhe mbështetjes së sektorëve kyç, me qëllim të rritjes së produktivitetit dhe eksportit;
- Promovimi i eksportit përmes përgatitjes së NVM-ve për eksport dhe identifikimit/zhvillimit të tregjeve potenciale;
- Avancimi i mëtejshëm i politikave për NMVM-të përmes zhvillimit të instrumenteve të reja për mbështetjen e NMVM-ve dhe bizneseve fillestare (p.sh skema për start-up, skema për zejtarë);

Inovacioni:

- Hartimi i politikave dhe krijimi i mekanizmave të përshtatshëm për zhvillimin e inovacionit;
- Miratimi i ligjeve dhe akteve nënligjore për ekosistemin e inovacionit;
- Krijimi i Fondit të Inovacionit;
- Funksionalizimi i plotë i Qendrave të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe shfrytëzimi efikas i Parkut të Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren.

3.21. Kapitulli 21: Rrjetet trans-evropiane

Ky kapitull mbulon rrjetet e domosdoshme rrugore, energjetike dhe të telekomunikimeve që lidhin shtetet evropiane, me mundësi përfshirjeje edhe të shteteve të treta. Prandaj, politikat e BE-së në këtë kapitull fokusohen në krijimin e një infrastrukture moderne e cila lidh rrjetet rajonale e nacionale, për të mundësuar katër liritë ekonomike të BE-së. Qëllimi i politikave në këtë kapitull është integrimi i një infrastrukture evropiane ndërvepruese të transportit, energjisë dhe telekomunikacionit, dhe identifikimin e standardeve teknike dhe projekteve prioritare me interes të përbashkët, si dhe zhvillimin e instrumenteve të financimit për zbatimin e tyre.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova ka arritur një nivel mestar përgatitjeje në këtë kapitull. Kosova ka bërë përparim të kufizuar në zhvillimin e rrjeteve të transportit dhe energjisë me zbatimin e PV-ve të Komunitetit të Transportit, duke përfshirë sigurinë rrugore, hekurudhore dhe transportit, si dhe funksionalizimin e një shkëmbimi të përbashkët të energjisë me Shqipërinë. Në anën tjetër, duhet vazhduar me përafrimin e legjislacionit me *acquis*. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Zbatimin e projekteve në pritje të konektivitetit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative për zbatimin e projekteve strategjike të infrastrukturës;
- Përmirësimin e kapaciteteve të autoritetit rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare, për të zbatuar rregulloret e tregut të telekomunikacionit.

Në kuadër të NK VII për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal nga Kosova kërkohen përpjekje të mëtejshme dhe masa konkrete për të zbatuar veprimet e parapara në PV-të e Komunitetit të Transportit –

për transportin hekurudhor, rrugor, siguri rrugore, ujore dhe multimodalitet si dhe masat dhe obligimet që rrjedhin nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Rrjetet e transportit: Ligjet kryesore në këtë fushë janë: Ligji për Ratifikimin e Traktatit të Komunitetit të Transportit, Ligji për Hekurudha, Ligji për rrugët, Ligji mbi transportin rrugor, Ligji për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme. Këto ligje janë në masë të konsiderueshme në harmoni me *acquis* e instrumente të ngjashme e reflektojnë standardet e praktikave të mira ndërkombëtare. Dokumenti kryesor i politikave në këtë fushë është Strategjia Sektoriale dhe e Transportit Multimodal 2023-2030 (SSTMM). Institucioni kryesor në këtë fushë është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit e politikave, përcaktimin e standardeve të detyrueshme, përfshirë përafrim me *acquis* të BE-së dhe instrumentet, standardet e praktikave të tjera të mira ndërkombëtare. Institucionet e tjera përgjegjëse janë: AAC, KHAIA ARH dhe Infrakos.

Rrjetet e energjisë: Ligji nr. 05/L- 085 për Energjinë Elektrike, Ligji nr. 05/L-082 për Gazin Natyror janë dy ligjet kryesore në këtë fushë. Dokumenti kryesor i politikave është Strategjia e Energjisë 2022-2031. Institucioni kryesor në këtë fushë është Ministria e Ekonomisë (ME), përgjegjëse për miratimin dhe zbatimin e legjislacionit e politikave, përfshirë zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve energjetike dhe minerare. Institucionet e tjera përgjegjëse në këtë fushë janë: FKEE, KOSTT, KEDS dhe ZRRë.

Objektivat prioritare afatmesme:

Rrjetet e transportit:

- Ndërtimi i Autostradës R7 Morinë-Prishtinë-Merdarë, segmenti Besi-Merdarë;
- Përfundimi i segmentit të zgjerimit të rrugës Nacionale N9, Kijevë – Zahaq;
- Ndërtimi i rrugës nacionale N2 Prishtinë – Mitrovicë;
- Përfundimi i ndërtimit të Autostradës Prishtinë – Gjilan – Konçul;
- Rehabilitimi gjeneral dhe modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut);
- Rehabilitimi gjeneral dhe modernizimi i Linjës së 7-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Podujevë – Prishtinë – Fushë Kosovë);

Rrjetet e energjisë:

- Anëtarësimi i KOSTT në ENTSO-E;
- Harmonizimi i Kodit të Rrjetit me Kodin e Rrjetit të ENTSO-E-së;
- Zhvillimi dhe modernizimi i mëtuqeshëm i rrjetit transmetues, për të lehtësuar tranzicionin e energjisë (diversifikimi i gjenerimit) sipas objektivave të Strategjisë së Energjisë 2022-2031;
- Pjesëmarrja e KOSTT-it në platformën evropiane PICASO për shërbimet ndihmëse (rregullim sekondar – aFRR) dhe MARI (rregullim terciar – mFRR).

3.22. Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Ky kapitull mbulon fondet strukturore dhe të kohezionit të BE-së në kuadër të pakos së zgjerimit, për harmonizimin e nivelit dhe konvergencës së zhvillimit të vendit përkatës në tërë territorin e tij. Kjo është e domosdoshme që shteti i ardhshëm anëtar të mund të funksionojë në përputhje me *acquis* dhe standardet e BE-së. Ky kapitull përfshin përpilimin, miratimin dhe zbatimin e programeve për këto fonde. Meqë ato negocohen me KE-në dhe zbatohen nga shteti përkatës pas anëtarësimit, gjatë këtij procesi kërkohen parapërgatitje. *Acquis* në këtë kapitull përbëhet kryesisht nga rregullore kornizë dhe zbatuese që nuk kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar, por zbatohen drejtpërsëdrejti përmes tij, për zbatimin e instrumenteve financiare të BE-së në përputhje me rregullat e vendosura nga ajo.

Gjendja aktuale

Sipas vlerësimit të BE-së, Kosova gjendet në fazë të hershme të përgatitjeve në këtë kapitull. Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2023*, Kosova akoma nuk ka harmonizuar rajonet statistikore me ato ekonomike. Ky raport thekson se nevojitet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative dhe resurseve njerëzore, në veçanti për planifikimin dhe menaxhimin e fondeve të BE-së, përfshirë fondet IPA. Për të përmbushur

obligimet e MSA-së, Kosova duhet të sigurohet që bashkëpunimi financiar të vazhdojë të mbështesë reformat demokratike, ekonomike dhe institucionale në kuadër të procesit të stabilizim-asociimit. Më konkretisht, BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në përmirësimin e kapaciteteve administrative dhe teknike në të gjithë strukturat operative të IPA-s, miratimin e PV për Zhvillim Rajonal 2023-2025 dhe zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve që rrjedhin nga Ligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar si hap drejt parimeve të politikave rajonale dhe të kohezionit të BE-së.

Korniza legjislative dhe ajo institucionale, programimi dhe monitorimi

Legjislacioni: *acquis* në këtë kapitull konsiston kryesisht në rregullore kornizë dhe rregullore zbatuese, por zbatimi i duhur i fondeve strukturore dhe të kohezionit kërkon transpozim të *acquis*-së në fusha të ndërlidhura, si ndihma shtetërore, mjedisi dhe prokurimi publik, të cilat mbulojnë në kapitujt përkatës të këtij Programi. Që nga viti 2007 Kosova përfiton nga ndihma financiare e BE-së në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA), në përputhje me legjislacionin e BE-së për fondet IPA, përfshirë së fundmi Rregulloren (BE) 2021/1529 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 15 shtator 2021, për krijimin e Instrumentit për Ndhimën e Paraanëtarësimit (IPA III) dhe Rregulloren Zbatuese të KE-së (BE) 2021/2236 mbi rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) 2021/1529 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e një Instrumenti për Ndhimën e Para-anëtarësimit (IPA III).

Institucionet: ky kapitull mbulohet nga ZKM, përkatësisht Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim, që shërben si Zyrë e Koordinatorit Kombëtar për IPA (NIPAC). Përgjegjësitë për zbatimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar IPA i janë deleguar nga NIPAC te Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZhR) është ministri përgjegjës për zhvillimin rajonal të balancuar, ku përfshihen edhe rajonet zhvillimore në kuptimin e grupimit për qëllime statistikore të komunave aktuale, pa krijuar nivel të tretë administrativ.

Programimi: në shtator 2022 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Partneritetit të Kornizës Financiare ndërmjet Kosovës dhe BE-së, e cila rregullon zbatimin e ndihmës financiare IPA III (2021-2027) për Kosovën. Më tej, pas nënshkrimit në shtator dhe ratifikimit nga Kuvendi, në nëntor 2022 ka hyrë në fuqi Marrëveshja Financiare për Programin IPA 2021, që mundëson fillimin e zbatimit të mbi €83 milionë: €67.7 milionë nga BE dhe donatorët e tjerë dhe €16 milionë bashkëfinancim nga Kosova.

Në dhjetor 2022 Bordi Operacional ka miratuar tri aplikime: grantin për përgatitjen e projektit për banimin social, në vlerë prej €2.08 milionë, si pjesë e rëndit 28 të asistencës teknike, ndërsa si pjesë e raundit 7 të granteve investuese janë miratuar granti investues për parkun solar në KEK, në vlerë prej €33.07 milionë, dhe granti investues për ngrohjen qendrore në kryeqytet, në vlerë prej €22.47 milionë.

Më 24 shkurt 2023, Kosova nënshkroi Marrëveshjen Financiare IPA 2023, e cila hyri në fuqi në datën e nënshkrimit, duke mundësuar zbatimin e mbështetjes buxhetore të paketës së energjisë prej €75 milionë nga BE dhe deri më 16 mars 2023 kësti i parë, (90% ose €67.5 milionë) është disbursuar në buxhet dhe janë duke u zbatuar masat konkrete nga institucionet e Kosovës. Në korrik 2023 ka hyrë në fuqi Marrëveshja Financiare IPA 2022, e cila do të mundësojë zbatimin e pakos prej €91.83 milionë: €62.25 nga BE-ja, €24.88 nga partnerët e tjerë dhe €4.7 bashkëfinancim nga Kosova.

KE ka miratuar Programet Shumëvjeçare (IPA 2021-2027) për bashkëpunim ndërkufitar me shtetet e rajonit: Programi Kosovë – Shqipëri, Programi Kosovë – Mali i Zi dhe Kosovë – Maqedoni e Veriut. Në shtator 2023, ka hyrë në fuqi Marrëveshja trepalëshe ndërmjet Kosovës, Malit të Zi dhe BE-së, ndërsa në dhjetor 2023 ka hyrë në fuqi Marrëveshja trepalëshe ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe BE-së. Po të njëjtin muaj, ka përfunduar nënshkrimi i Marrëveshjes trepalëshe ndërmjet Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe BE-së, e cila pritet të hyjë në fuqi. Marrëveshjet mundësojnë ofrimin e shumës prej €8.4 milionë për zonat kufitare të Kosovës dhe tri vendeve fqinje, duke mundësuar që për periudhën 2021-2027 të ofrohen gjithsej €25.2 milionë.

Monitorimi: Komiteti i Përbashkët Monitorues i IPA-s siguron monitorimin e realizimit të programeve dhe projekteve të financuara nëpërmjet burimeve të IPA-s, i cili takohet mbi baza vjetore. Monitorimi i përgjithshëm i asistencës së donatorëve dhe në veçanti i asistencës së BE-së bëhet në dy mënyra: shfrytëzimi

i raportimit të rregullt të donatorëve dhe pjesëmarrja e zyrtarëve në kuadër të takimeve të komiteteve drejtuese të projekteve.

3.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Ky kapitull mbulon këto fusha: sistemin gjyqësor, politikat kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore. Politikat e BE-së në këtë kapitull synojnë ruajtjen dhe zhvillimin e BE-së si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Një gjyqësor i pavarur dhe efikas është i një rëndësie të madhe, ndërsa paanshmëria, integriteti dhe një standard i lartë i gjykimeve nga gjykatat është i një rëndësie thelbësore për ruajtjen e sundimit të ligjit. Kjo kërkon një gjyqësor pa ndikim politik dhe me kapacitete të mjaftueshme financiare e njerëzore, si dhe garanci ligjore për procedurat e gjykimit të drejtë. Nga shtetet anëtare gjithashtu kërkohet luftimi i korrupsionit në mënyrë efektive, pasi që kërcënon stabilitetin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit. Kjo gjithashtu kërkon kornizë solide ligjore e institucionale për të mbështetur një politikë koherente për parandalimin e pengimin e korrupsionit. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë edhe respektimin e të drejtave themelore, siç garantohet me legjislacionin e BE-së dhe me Kartën e të Drejtave Themelore.

Sistemi gjyqësor

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova është në fazë të hershme në zhvillimin e një sistemi gjyqësor funksional. Pavarësisht ngritjes së numrit të seancave produktive gjyqësore, konsiderohet se ka progres të kufizuar pasi që nevojitet një ritëm më i shpejtë i caktimit të seancave gjyqësore dhe përmirësimit të procesit të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Burimet njerëzore dhe organizimi i administratës në tërë gjyqësorin mbeten joefikase. Është krijuar Sistemi Qendror Kombëtar i Evidencës Penale, plotësisht i digitalizuar, dhe qytetarët e Kosovës kanë mundësi të qasen në të online nga dhjetori 2022, duke u mundësuar të marrin certifikatat e gjendjes penale *online*. Vendimi i Qeverisë për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe Ligji për Pagat, i miratuar më pas, kanë ngritur shqetësime në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit; ky vendim është sfiduar në gjykatë themelore dhe Ligji në Gjykatën Kushtetuese. Në mars 2023, Ministria e Drejtësisë dhe krerët e institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë nënshkruan një deklaratë të përbashkët zotimi për reformat në drejtësi, e cila pasqyron çështjet më të rëndësishme që duhen trajtuar dhe gjithashtu fuqizon mekanizmat ekzistues. Për të arritur rezultate të prekshme nevojitet një ndjekje e shpejtë. Në shtator 2022 Qeveria i dorëzoi Kuvendit dosjen lidhur me kontrollin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili ka ngritur një komision *ad hoc* për të finalizuar ndryshimet kushtetuese dhe legjislacionin përkatës për kontrollin e integritetit të pozitave të larta në sistemin e drejtësisë, në përputhje me Opinionin e Komisionit të Venedikut, të qershorit 2022.

Më tej, institucionet e vendit duhet të sigurohen që gjatë finalizimit të projekt-amendamenteve kushtetuese dhe legjislacionit përkatës në lidhje me reformën në drejtësi të rikonsultohet Komisioni i Venedikut. Është thelbësore që reforma në drejtësi të fokusohet në forcimin e mjeteve ekzistuese për të mbrojtur integritetin, përgjegjshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venedikut dhe standardet evropiane. Kosova duhet të sigurojë që rekomandimet e këtij komisioni të inkorporohen gjatë plotësim ndryshimit të Ligjit për KPK-në. Në pajtim me nenin 113 paragrafi 9, nenin 144 paragrafi 1 të Kushtetutës dhe nenin 87 të Rregullores së Kuvendit, në shkurt 2023 Kryetari i Kuvendit ka referuar amendamentet e propozuara në Gjykatë Kushtetuese, për të shqyrtuar nëse amendamentet e propozuara i zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës. Është thelbësore që reforma në drejtësi të fokusohet në forcimin e mjeteve ekzistuese për të mbrojtur integritetin, përgjegjshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venedikut dhe standardet evropiane.

Kosova duhet të sigurojë që rekomandimet e Komisionit të Venedikut të inkorporohen gjatë plotësim ndryshimit të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Komisioni i Kuvendit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, më 20 korrik 2023 ka shqyrtuar në parim dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin në parim të projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 06/L-056 për KPK-në, dhe në korrik 2023 e ka referuar në Komisionin e Venedikut

për t'u siguruar që i njëjti është në pajtim rekomandimet e tij. Më 18 dhjetor 2023, ky komision, në seancën e tij të 137-të plenare, ka miratuar Opinionin për Ligjin për KPK-në dhe amendamentet e tij.

Duhet të vazhdojnë përpjekjet për të përdorur plotësisht Sistemin elektronik për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), për të promovuar më tej mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, si dhe për të siguruar të dhëna statistikore të besueshme. Rekomandimet e Komisionit nga viti paraprak janë përmbushur vetëm pjesërisht dhe prandaj mbeten të vlefshme. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Ndërmarrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga deklaratat e përbashkët e angazhimit të nënshkruar nga drejtuesit e institucioneve të sistemit të drejtësisë, me fokus të veçantë në përmirësimin e integritetit, llogaridhënies dhe efikasitetit të gjyqësorit;
- Shtimin e përpjekjeve për të reduktuar numrin e rasteve të mbetura, bazuar në një PV të qartë me auditime dhe kontroll të brendshëm të mbështetur nga një strategji digjitalizimi. Për këtë qëllim, Kosova duhet të reformojë administratën e gjykatës dhe prokurorisë dhe të forcojë funksionet menaxhuese në gjyqësor dhe prokurori për të siguruar përdorimin efikas të burimeve;
- Përmirësimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të trajtuar rastet e dhunës me bazë gjinore në përputhje me ligjet, strategjinë 2022-2026 kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe Protokollin e ri të Shtetit për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.

Më tej, në kuadër të *NK VI për Drejtësi, Liri dhe Siguri*, Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore të mbetura:

- Të vazhdojë me zbatimin efektiv dhe pa vonesa të Strategjisë dhe PV për Sundimi e Ligjit, përmes një procesi të rregullt dhe të strukturuar që përfshin koordinimin e duhur ndër-institucional;
- Të sigurojë që emërimet e ardhshme në KGJK dhe KPK të bëhen në kohën e duhur

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: Ligjet kryesore në fushën e sistemit gjyqësor janë: Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës (i rishikuar dhe i miratuar në tetor 2023), Ligji për Gjykatat, Ligji për KGJK-në, Ligji për KPK-në, Ligji për Prokurorin e Shtetit (i rishikuar në prill 2023), Ligji për Prokurorinë Speciale (i rishikuar në tetor 2023), Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligji për Mjekësinë Ligjore, Ligji për ekspertë Gjyqësorë. Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të shërbimeve të profesioneve të lira duke është miratuar Ligji për plotësim-ndryshimin e ligjit për Noterinë (i rishikuar në nëntor 2022) dhe Ligji për Procedurën Përmbarimore (i rishikuar në korrik 2023). *Politikat:* Dokumenti kryesor strategjik në këtë fushë është Strategjia dhe PV për Sundimin e Ligjit 2021-2026, që synon fuqizimin e gjyqësorit dhe prokurorisë, drejtësisë penale, qasjes në drejtësi dhe luftës kundër korrupsionit. Institucionet e pavarura kanë miratuar këto dokumente politikash në këtë fushë: Planin Strategjik të Sistemit Prokurorial 2022-2024, Strategjinë dhe PV për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra, PV për Menaxhimin e Krizës në Gjyqësor dhe Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025. *Institucionet* më të rëndësishme në këtë fushë janë: Ministria e Drejtësisë (MD), përgjegjëse për hartimin e politikave; KGJK dhe KPK, përgjegjësit kryesorë për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive, përfshirë procedurat e emërimit, disiplinimit dhe vlerësimit të gjyqtarëve e prokurorëve; dhe Akademia e Drejtësisë, përgjegjëse për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Politikat kundër korrupsionit

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se është arritur njëfarë progresi në këtë fushë me miratimin e Kodit të ri të Procedurës Penale, Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), Ligjit të ri për Deklarimin e Pasurisë dhe Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike. Megjithatë, nevojiten përpjekje të vazhdueshme për hetime më proaktive, vendime gjyqësore përfundimtare dhe konfiskim përfundimtar të aseteve. Dënimet plotësuese që ndalojnë ushtrimin e funksioneve publike ose të profesioneve të tjera, veçanërisht për personat e dënuar për vepra të lidhura me korrupsionin, nuk zbatohen si duhet. Ndonëse është përmirësuar performanca e APK-së, mjetet parandaluese kundër korrupsionit të përcaktuara në

legjislacion nuk janë zbatuar ende plotësisht, veçanërisht miratimi i planeve të integritetit në institucionet publike. Në përgjithësi, korrupsioni mbetet çështje shqetësuese serioze. Ekziston nevoja për një përgjigje të fuqishme të drejtësisë penale ndaj rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Në këtë drejtim, shkarkimi i shefit të Njësisë së Hetimeve Speciale të Policisë së Kosovës është shkak për shqetësim, duke dërguar një sinjal negativ për përkushtimin e Kosovës për të luftuar korrupsionin. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të APK-së në aspektin e stafit dhe ekspertizës, për të siguruar që të mund të përmbushë në mënyrë efektive mandatin e saj; institucionet përkatëse duhet të miratojnë dhe zbatojnë planet e integritetit dhe procedurat e brendshme të sinjalizuesve (përfshirë sektorin privat);
- Forcimin e mëtejshëm të efikasitetit të sistemit të konfiskimit përmes promovimit të përdorimit sistematik të konfiskimit të zgjatur dhe atë të “rregullt” nga prokuroria dhe policia; ngritjen e nivelit të specializimit dhe ekspertizës për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë; krijimin e një fondi të konfiskimit;
- Forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë, dhe inkurajimin e bashkëpunimit multidisiplinar dhe qasjes së bazuar në objektiv për të siguruar hetime proaktive dhe për të luftuar në mënyrë efektive rastet e korrupsionit të nivelit të lartë; kryerjen në mënyrë sistematike të hetimeve financiare gjatë hetimeve penale; garantimin e sigurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve;

Më tej, në kuadër të *NK VI për Drejtësi, Liri dhe Siguri* Kosova ka marrë përsipër të tregojnë përkushtim për progres të vazhdueshëm në rastet e shënjestruara të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar, veçanërisht në kontekstin e liberalizimit të vizave.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni kundër korrupsionit është rishikuar në vitin 2022, në harmoni me rekomandimet e Komisionit të Venedikut dhe standardet evropiane. Ligjet kryesore në këtë fushë janë: Kodi Penal, Kodi i ri i Procedurës Penale, Ligji për APK-në, Ligji i amendamentuar për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave Zyrtare dhe Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Dokumentet e politikave në këtë fushë janë: Strategjia dhe PV kundër Korrupsionit 2018-2022, Strategjia e Sistemit Gjyqësor për Zgjidhjen e Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar 2022-2024 dhe Strategjia për Sundimin e Ligjit, e cila përfshin një pjesë për politikën kundër korrupsionit. Më 22 shkurt 2023 Qeveria ka themeluar grupin punues për hartimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit. Institucionet kryesore në këtë fushë janë: MD dhe ZKM, përgjegjëse për hartimin e politikave; APK, përgjegjëse për iniciimin dhe zhvillimin e procedurës së zbulimit e hetimit paraprak të korrupsionit dhe përcjelljen e kallëzimeve penale për rastet e dyshuara për korrupsion dhe zbatimin e legjislacionit për deklarimin e pasurisë, parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe mbrojtjen e sinjalizuesve; Koordinatorin Nacional për Luftimin kundër Korrupsionit në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Shtetit.

Të drejtat themelore, mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se korniza ligjore garanton mbrojtjen e të drejtave themelore në përputhje me standardet evropiane. Kjo kornizë është avancuar me miratimin e Ligjit për AKKVP-në, Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore dhe Protokollin për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale. Kapacitetet e autoriteteve për të monitoruar zbatimin e politikave dhe legjislacionit për të drejtat themelore janë përmirësuar dhe shkalla e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit është rritur. Pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, nevojiten përpjekje shtesë për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin për mbrojtjen e të drejtave themelore, përfshirë ato për të drejtat e pakicave, në përputhje me kornizën ligjore. Çështjet e të drejtave themelore duhet të prioritetizohen më lart në agjendën politike dhe institucioneve përkatëse duhet t’u ndahen më shumë burime njerëzore dhe financiare. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Forcimin e mbrojtjes së të drejtave civile dhe themelore të grave përmes miratimit të Kodit Civil, zbatimit të ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, fuqizimit të zbatimit të ligjit për barazi gjinore dhe strategjisë kundër dhunës me baza gjinore;
- Forcimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës përmes miratimit në mënyrë urgjente të gjitha aktet nënligjore të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe forcimit të kapaciteteve për zbatimin e ligjit;
- Përmirësimin e zbatimit të legjislacionit për të drejtat e komuniteteve jo-shumicë (p.sh. kuotave për përfaqësim në shërbimin civil; emërimin e Drejtorit të Zyrës për Çështje të Komuniteteve), dhe miratimit të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe ligjit për liritë fetare;
- Mbrojtjen dhe promovimin e një fryme të tolerancës dhe dialogut ndërkulturor, në përputhje me preambulën e MSA-së, si dhe në frymën dhe sipas nenit 6 të Konventës Kornizë të KiE-së për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e zbatueshme drejtpërdrejt sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Më tej, në kuadër të *NK VI për Drejtësi, Liri dhe Siguri* Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore të mbetura:

- Të ndërmerë hapa konkretë për të forcuar koordinimin e mekanizmave ekzistues për të drejtat e njeriut në nivel qendror dhe atë lokal dhe fuqizimin e rolit të zyrtarëve kundër diskriminimit në ministri dhe komuna;
- Të miratojë aktet nënligjore për Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, të ndërmerë hapa më konkretë për zbatimin e Ligjit për Personat Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë dhe Ligjit për Personat e Verbër, dhe potencialisht të bëjë unifikimin e skemave në një ligj të vetëm; të miratojë me prioritet Kodin Civil dhe tërë legjislacionin e specializuar përkatës për të siguruar zbatim të qëndrueshëm dhe të harmonizuar të legjislacionit të ri civil;
- Në fushën e lirisë së shprehjes, të sigurojë, pa vonesa të mëtejshme, financimin e qëndrueshëm të RTK-së, duke ruajtur pavarësinë e saj; të amendamentojë dhe miratojë Ligjin për KPM-në, për të përditësuar kompetencat e tij në lidhje me shërbimet e mediave audiovizuale online që rregullohen nga Direktiva e vitit 2010 për Shërbimet Mediale Audiovizuale.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: Ligjet kryesore në fushën e të drejtave themelore janë: Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligji për Avokatin e Popullit dhe Ligji për Barazi Gjinore, në fuqi nga viti 2015 si pako e ligjeve për këtë fushë, në harmoni me standardet evropiane. Gjithashtu janë në fuqi Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, në harmoni me Direktivën e BE-së për luftën kundër abuzimit seksual, shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë. Ligjet kryesore në fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore janë: Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, Ligji për Trashëgiminë Kulturore dhe Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.

Ndonëse Republika e Kosovës akoma nuk është shtet anëtar i OKB-së, neni 22 i Kushtetutës shprehimisht parasheh se të drejtat e liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, përveç të garantuara me këtë Kushtetutë, janë drejtpërdrejt të zbatueshme në vend dhe kanë përparësi, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve e akteve të tjera të institucioneve. Kjo kornizë është në përputhje me standardet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Republika e Kosovës akoma nuk është ende palë në konventë, por më 13 dhjetor 2022 Qeveria ka marrë vendimin për t'i propozuar Kuvendit amendamentimin e Kushtetutës për përfshirjen e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në nenin 22 të saj. Ministria e Shëndetësisë i ka propozuar Qeverisë të miratojë aktin nënligjor për llojet e pajisjeve ndihmëse falas për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që shërbejnë për lëvizje, parandalim dhe asistim, i cili bazohet në Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë në Kosovë. Më 09.11.2022 Qeveria ka miratuar UA për Caktimin e Listës, Llojeve dhe Pajisjeve Ndihmëse që Ofrohen Falas për Personat Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë që shërbejnë për lëvizje, Parandalim dhe Asistim. Sa i përket zbatimit të këtij ligji, ZKM/ZQM ka marrë përsipër inicimin e procesit

për hartimin e koncept dokumentit për Ligjin për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në mënyrë që të avancoj të drejtat e personave të komunitetit të shurdhër në Kosovë.

Politikat: dokumentet kryesore të politikave në këtë fushë janë: Programi për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut, Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore, Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2023, Strategjia Kombëtare kundër Dhunës në Familje (miratuar në janar 2022), dhe Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës (e miratuar në korrik 2022).). Në kuadër të hartimit të politikave në fushën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, duke qenë se Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023 skadon në vitin 2023, ZKM/ZQM gjatë vitit 2023 ka filluar hartimin e Strategjisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2024-2029 dhe PV për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2024-2026 dokumente këto të cilat janë në proces të hartimit ende dhe parashihen të finalizohen në gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 si dhe të aprovohen në qeveri.

Institucionet: Mekanizmat e të drejtave të njeriut janë krijuar bazuar në një qasje holistike, me zyrtarë të të drejtave të njeriut në çdo institucion qendror dhe lokal, të koordinuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZKM). Zëvendëskryeministrja përgjegjëse për të drejtat e njeriut është përgjegjëse për prioritizimin, zhvillimin dhe koordinimin e politikave të Qeverisë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi. Kosova gjithashtu ka Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Komisionerin e Gjuhëve, Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Institucionin e Avokatit të Popullit si mekanizëm i pavarur ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë, dhe vepron edhe si Mekanizëm Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria.

Mbrojtja e të dhënave personale

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është gjerësisht në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Direktivën për Zbatimin e Ligjit. Agjencia ka vazhduar të përmirësojë kapacitetet e saj duke avancuar kornizën ligjore me miratimin e rregulloreve dhe udhëzuesve për organizimin, sistemimin dhe procedurën operative për kontrollorët dhe inspektimet. Edhe pse me buxhet dhe burime njerëzore të kufizuara, Agjencia po i përpunon ankesat për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave në mënyrë të pavarur dhe efikase.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale: Ligji në këtë fushë është Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjerësisht në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Direktivën për Zbatimin e Ligjit, dhe rregulloret që rrjedhin nga ky ligj. Korniza e politikave përbëhet nga Plani i inspektimeve dhe kontrolleve të rregullta për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i miratuar nga AIP. *Institucioni* përgjegjës në këtë fushë është Agjencia për Informim dhe Privatësi, si agjenci e pavarur përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të personave fizikë lidhur me të dhënat personale dhe lidhur me garantimin e qasjes së publikut në dokumente publike.

Objektivat prioritare afatmesme:

Sistemi gjyqësor:

- Reformimi i sistemit të drejtësisë përmes finalizimit të ndryshimeve legjislative, duke siguruar përmirësimin e mekanizmave llogaridhënës, integritetit dhe efikasitetit për gjyqtarë dhe prokurorë si subjekt i shqyrtimit paraprak, në harmoni me rekomandimet e Opinionit të Komisionit të Venedikut dhe masave nga Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026;
- Zhvillimi i kornizës ligjore për vettingun në sistemin e drejtësisë;
- Avancimi i legjislacionit për të siguruar zbatim unik dhe kodifikues të së drejtës civile;
- Avancimi i mëtejshëm i kapaciteteve për noteri përmes rritjes së numrit të noterëve konform ndryshimeve në Ligjin e ri të Noterisë;

- Avancimi i mëtejshëm i sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve në gjykata dhe prokurori, përfshirë aplikimin e treguesve të performancës CEPE] në programin SMIL;
- Avancimi i mëtejshëm i sistemit qendror të evidencës penale (NCCR) duke siguruar verifikimin e saktë të të dhënave për rastet penale;
- Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore e infrastrukture për të siguruar një sistem efikas e të mirëfilltë të procedurave disiplinore dhe vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit të drejtësisë në çështjet e kontesteve administrative dhe ato të punës nëpërmjet themelimit të Gjykatës Administrative dhe të Punës;
- Ngritja e kapaciteteve administrative në gjykata përmes rritjes së numrit të stafit mbështetës për të siguruar administrim efektiv të drejtësisë;
- Promovimi i mëtejshëm i mekanizmave alternativë për zgjidhjen e kontesteve (ndërmjetësimit) në gjykata dhe prokurori, me qëllim të uljes së mbingarkesës së rasteve;
- Avancimi i mëtejshëm i mekanizmave për zgjidhjen alternative të kontesteve përmes ndërmjetësimit, përmbartimit dhe falimentimit;
- Përmirësimi i kornizës institucionale për të fuqizuar procesin e hartimit të politikave të reja bazuar në të dhëna;
- Miratimi i planit të ri strategjik të sistemit prokurorial 2025-2027;

Politikat kundër korrupsionit:

- Avancimi i kornizës ligjore dhe organeve mbikëqyrëse me qëllim të rritjes së shkallës së zbatimit të rasteve të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë, përfshirë administrimin e tyre;
- Avancimi i mëtejshëm i mekanizmave koordinues ndërinstitucionalë për trajtimin efikas dhe efektiv të rasteve të korrupsionit, krimit ekonomik dhe krimit të organizuar;
- Avancimi i mëtejshëm i institucioneve të zbatimit të ligjit në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar dhe të forcojë efektivitetin e konfiskimeve të aseteve dhe produkteve të krimit;
- Avancimi i mëtejshëm i kapaciteteve profesionale në Prokurorinë Speciale (PSRK), për të siguruar zbatim efikas të strukturës organizative në këtë prokurori;
- Avancimi i mëtejshëm i kapaciteteve në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), për të siguruar zbatimin efektiv dhe efikas të procedurës së kontrollit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, konfliktit të interesit dhe vlerësimeve të rrezikut të korrupsionit në sektorë të ndjeshëm dhe në legjislacion;
- Avancimi i mëtejshëm i kapaciteteve në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK), për të siguruar zbatimin efektiv dhe efikas të procedurës administrative të sinjalizimit.
- Krijimi i mekanizmave monitorues në APK për zbatimin e planeve të integritetit;
- Zbatimi i Strategjisë dhe PV kundër korrupsionit 2024-2030

Të drejtat themelore, mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore:

- Krijimi i mekanizmave adekuatë për monitorimin e vazhdueshëm të rekomandimeve nga Avokati i Popullit, me qëllim të rritjes së mëtejshme të shkallës së zbatimit;
- Funkcionalizimi i plotë i mekanizmave institucionale për mbrojtjen nga diskriminimi dhe fuqizimi i zyrtarëve për barazi gjinore në ministri dhe komuna;
- Ngritja e kapaciteteve të mekanizmave institucionale për barazi gjinore, mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave nëpërmjet fuqizimit të rolit të grave dhe vajzave në vendimmarrje dhe fuqizimit ekonomik, me qëllim të eliminimit të dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje;
- Miratimi i akteve nënligjore me qëllim të zbatimit efektiv të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore;
- Krijimi dhe zhvillimi i politikave përkatëse për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor, krahas kornizës aktuale rregullative;
- Avancimi i mëtejshëm i kornizës ligjore për të drejtat pronësore, me qëllim të përkufizimit më të qartë dhe ofrimit të mekanizmave më efikasë, të qasshëm dhe të përballeshëm përmes të cilëve qytetarët do të mund të fitojnë njohjen juridike të të drejtave të tyre;
- Avancimi i kornizës ligjore dhe të politikave për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;

- Mbështetja financiare e strehimoreve për viktimat e dhunës me bazë gjinore;
- Përmirësimi i politikave për ekzekutimin e sanksioneve penale, si dhe sensibilizimi i gjykatave për rritjen e numrit të rasteve të shqiptimit të dënimeve alternative kundrejt dënimeve me burg;
- Përmirësimi i koordinimit ndërinstucional për të siguruar hetime efektive dhe gjykim në kohë të rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve, dhunës seksuale dhe dhunës në familje, si dhe rasteve të krimeve dhe gjuhës së urrejtjes;
- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm të transmetuesit publik;
- Avancimi i kornizës ligjore dhe të politikave për mbrojtjen e trashëgimisë, përfshirë krijimin e mekanizmave për konservim dhe zhvillim të integruar;
- Krijimi i mekanizmave ligjorë për eksportin/importin dhe parandalimin e trafikimit të objekteve kulturore, në harmoni me direktivat përkatëse të BE-së;
- Avancimi i mekanizmave për monitorim dhe mirëmbajtjen sistematike të monumenteve të trashëgimisë kulturore;
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të të gjithë trupave koordinues në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, dhe mbështetja financiare e institucioneve për trashëgimi kulturore dhe riorganizimi i skemës organizative të tyre;

Mbrojtja e të dhënave personale:

- Avancimi i politikave;
- Përmirësimi i mekanizmave inspektues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Krijimi i infrastrukturës së TI-së për menaxhimin elektronik të ankesave dhe lëndëve inspektuese.

3.24. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

Ky kapitull përfshin këto fusha: menaxhimin e kufirit, politikat e vizave dhe sigurisë së dokumenteve, migrimin, azilin, luftën kundër shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, luftën kundër narkotikëve, luftën kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimin policor, luftën kundër terrorizmit, dhe bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale dhe civile. Politikat e BE-së në këtë kapitull dinamik synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej BE-në si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë dhe të garantojnë sigurinë, të drejtat dhe lëvizjen e lirë brenda saj. *Acquis* në këtë kapitull bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga TFBE dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së. Në këtë kapitull kërkohet edhe harmonizimi i së drejtës ndërkombëtare private, marrëveshjet e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare dhe politikat në të gjitha fushat e tjera. Kosova duhet të transpozojë gradualisht *acquis*-në, të zhvillojë e zbatojë një kornizë adekuate politikash dhe të ngritë institucione me kapacitete për të zbatuar *acquis*-në e transpozuar. Shtetet anëtare gjithashtu duhet të kenë kapacitetet e nevojshme administrative të agjencive të zbatimit të ligjit dhe organeve të tjera relevante për të arritur standardet evropiane në këto fusha. Politikat e BE-së në këtë kapitull janë pjesë e *acquis*-së së Schengenit, përfshirë atë që parasheh heqjen e kontrolleve të brendshme kufitare në BE, për vendet e reja anëtare pjesët thelbësore të kësaj *acquis*-e zbatohen pas vendimit të veçantë të Këshillit të marrë pas anëtarësimit.

Menaxhimi i kufirit

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se infrastruktura në pikat e kalimit kufitar është përmirësuar dhe sistemi i menaxhimit të kufirit vazhdon të funksionojë në mënyrë të kënaqshme. Megjithatë, disa nga objektet kanë nevojë për renovim. Mungesa e qasjes së drejtpërdrejtë online në disa baza të të dhënave ndërkombëtare është pengesë për punën efektive të parandalimin e krimit. Gjithashtu është arritur progres në zbatimin e planit zhvillimor të rishikuar të Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit 2020-2025. Megjithatë, ka ende nevojë për një vlerësim më të mirë strategjik dhe analizë rrishtur me kufirin dhe për bashkëpunim më të mirë me autoritetet e tjera kufitare. Efektiviteti i një bashkëpunimi të tillë ndikohet nga mungesa e lidhjes me rrjete të rëndësishme ndërkombëtare si I-24/7 e Interpolit. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Vlerësim më të mirë strategjik dhe analizë të rreziqeve që lidhen me kufirin, përfshirë sigurinë;

- Fuqizimin e bashkëpunimit me autoritetet e tjera kufitare.

Më tej, në NK VI për Drejtësi, Liri dhe Siguri Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

- Të sigurojë potencial të plotë të QKMK-së përmes zbatimit të plotë të PV për këtë institucion;
- Të forcojë sistemin e menaxhimit të kufijve të ndjeshëm ndaj mbrojtjes përmes bashkëpunimit ndër-rajonal, përfshirë shkëmbimin e rregullt të informatave, si dhe me agjencitë e BE-së që luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e menaxhimit të kufijve të ndjeshëm ndaj mbrojtjes, si Agjencia e Azilit e BE-së (EUAA) dhe Frontex.

Korniza ligjore dhe ajo institucionale: kjo fushë rregullohet nga Ligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror dhe Ligji për Bashkëpunim ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit (sipas konceptit të MIK, që zbatohet në Kosovë dhe vende të tjera në proces të aderimit në BE). Ligji për Kontrollin e Kufirit Shtetëror është duke u plotësuar-ndryshuar. Gjithashtu janë në fuqi pesë (5) akte nënligjore, të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante, dhe 12 marrëveshje për bashkëpunim doganor. *Institucionet* në këtë fushë janë: PK, DK dhe AUV.

Politikat e vizave

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova akoma nuk e ka harmonizuar plotësisht legjislacionin e saj me politikën e vizave të BE-së. Kosova aktualisht kërkon viza për shtetasit e 110 vendeve, përfshirë 22 shtete që nuk kanë regjim pa viza me zonën Schengen. Institucionet që lëshojnë viza kanë kapacitete për të mbledhur në mënyrë digjitale identifikuesit biometrikë nga aplikantët për vizë, ndonëse ka nevojë për përmirësim të pajisjeve. Kosova ka vazhduar të përmbushë kriteret e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, ndërsa më 18 prill 2023 PE ka miratuar Rregulloren (BE) 2023/850, për plotësim-ndryshimin e Rregullores (BE) 2018/1806 për të shtuar Kosovën në listën e vendeve shtetasit e të cilëve janë të përjashtuar nga posedimi i vizës. Bazuar në këtë, nga 1 janari 2024 shtetasit e Republikës së Kosovës udhëtojnë pa viza në shtetet e Zonës Schengen, për udhëtime afatshkurtra deri në 90 ditë brenda një periudhe 180-ditore.

Më konkretisht, BE rekomandon që gjatë vitit 2024, Kosova duhet të fokusohet në zhvillimin e një fushatë informuese për të drejtat dhe detyrimet që lidhen me statusin e udhëtimit pa viza në zonën Schengen, për të parandaluar keqpërdorimet e mundshme.

Korniza legjislative dhe ajo institucionale: kjo fushë rregullohet nga Ligji për të Huajt dhe gjashtë (6) akte nënligjore të cilat kanë transpozuar pjesërisht *acquis*-në relevante. *Institucionet* përgjegjëse në këtë fushë janë: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përkatësisht Departamenti për Çështje Konsullore dhe misionet e Shërbimit të Jashtëm; Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DShAM) dhe Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC); si dhe Departamenti i Kufirit i Policisë së Kosovës.

Migrimi

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson së korniza ligjore është kryesisht në përputhje me *acquis*-në e BE-së, por duhet të ndërmerren hapa për të harmonizuar më tej legjislacionin, përfshirë Ligjin për të Huajt, me *acquis* dhe standardet ndërkombëtare. Pavarësisht përpjekjeve të Qeverisë, rrjetet transnacionale të kontrabandës vazhduan lehtësimin e lëvizjeve dytësore të migrantëve të parregullt nga pika hyrjeje përgjatë rrugës së Ballkanit Perëndimor. Mangësitë mbeten në zbatimin e ligjeve, kryesisht për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet agjencive qeveritare. Duhet të forcohen më tej kapacitetet e Policisë në fushën e migracionit të ndjeshëm ndaj mbrojtjes. Në përgjithësi, ekziston nevoja për koordinim më të mirë ndër-institucional, duke përfshirë me komunat, si dhe për përmirësim të monitorimit dhe vlerësimit sistematik. Ofrimi i kujdesit dhe sigurisë së duhur për grupet më të cenuara të migrantëve mbeten një sfidë. Duhet të merren masa për të rritur sigurinë për azilkërkuesit në objekte, veçanërisht për të parandaluar dhunën me bazë gjinore. Më konkretisht, BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova duhet të rrisë dhe forcojë më tej kapacitetet e autoriteteve për të evidentuar migrimin e parregullt dhe për të ofruar shërbime

më cilësore të mbrojtjes. Gjithashtu, rekomandohet që Kosova të harmonizojë legjislacionin me Direktivën 2008/115/KE (Direktiva e Kthimit), të përfshijë një kategori të mbrojtjes humanitare dhe të zgjasë periudhën e kthimit vullnetar.

Më tej, në *NK VI për Drejtësi, Liri dhe Siguri* Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

- Të forcojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional, veçanërisht ndërmjet institucioneve të ndryshme të politikës dhe sigurisë, përfshirë ndërveprueshmërinë e sistemeve të TI-së;
- Të përmirësojë sistemet e menaxhimit të të dhënave, përfshirë futjen në funksion të një mekanizmi të harmonizuar dhe të qëndrueshëm të regjistrimit dhe mbledhjes së të dhënave biometrike, në harmoni me standardet e zbatueshme ndërkombëtare dhe të BE-së, si dhe që garanton ndërkomunikueshmëri/ndërveprim të sistemeve të menaxhimit të informacionit dhe bazave të të dhënave, përfshirë në nivel rajonal, nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të sistemit informativ për menaxhimin e migracionit.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale: Ligjet në këtë fushë janë: Ligji për Shtetësinë, Ligji për të Huajt, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Ligji për Azilin, dhe 23 marrëveshje bilaterale për ripranim. Gjithashtu janë në fuqi aktet nënligjore që rrjedhin nga këto ligje. Dokumentet e *politikave* në këtë fushë janë: Strategjia për Migrim 2021-2025, Profili i Lehtë i Migrimit (si dokument gjithëpërfshirës me të dhëna standarde për migrimin dhe me fushat e tjera të cilat potencialisht ndikojnë në fenomenin e migrimit, si gjendja ekonomike dhe sociale, tregu i punës, kapitali njerëzor, arsimimi, tregtia etj.) dhe Udhëzuesi për Interesin më të Mirë të Fëmijës. *Institucionet* përgjegjëse në këtë fushë janë: MPB, përkatësisht Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion; Policia e Kosovës, përkatësisht Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria për Hetimin e Trafikimit, Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riadhesuar; si dhe Autoriteti Qeveritar për Migrim dhe Komunitet.

Azili

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se korniza ligjore dhe institucionale në këtë fushë është kryesisht në përputhje me *acquis*. Mirëpo nevojitet që të krijohet një sistem i hyrjeve plotësisht efektiv me bazë të qartë ligjore, duke përfshirë identifikimin, shqyrtimin dhe referimin e personave që kërkojnë mbrojtjen ndërkombëtare dhe ata/ato me nevoja specifike. Ligji i ri për të huajt është një mundësi për të dhënë përkufizime të qarta; ai duhet gjithashtu të përcaktojë dispozita për integrimin e lehtësuar. Kosova vazhdon të jetë një rrugë tranziti për shumicën e njerëzve që arrijnë me lëvizje të përziera. Kapaciteti i kufizuar në aspektin e pajisjeve biometrike dhe mungesa e ndërveprimit të të dhënave ndikojnë në efikasitetin e regjistrimit dhe përpunimit të mëtejshëm të kërkesave për azil. Për të përmbushur mandatin, Policia Kufitare ka nevojë për pajisje adekuate dhe më shumë ekspertizë. Praktika aktuale e dhënies së “Certifikatës për akomodim në Qendrën e Pritjes së Përkohshme të Emigrantëve” që lejon të drejtat e akomodimit për 15 ditë, pa dhënë asnjë status ligjor gjatë kësaj periudhe nuk është në përputhje me *acquis* të BE-së në këtë fushë. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Përfshirjen e refugjatëve në skemat e mbrojtjes sociale;
- Themelimin e një sistemi plotësisht efektiv të hyrjes;
- Përmirësimin e kapaciteteve të zyrtarëve të linjës së parë për identifikimin dhe referimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare dhe personave me nevoja specifike;
- Ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve të Policisë Kufitare për mbrojtje të ndjeshme ndaj migrimit.

Më tej, në *NK VI për Drejtësi, Liri dhe Siguri* Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

- Të përmirësojë sistemet e menaxhimit të të dhënave, përfshirë futjen në funksion të një mekanizmi të harmonizuar dhe të qëndrueshëm të regjistrimit dhe mbledhjes së të dhënave biometrike, në harmoni me standardet e zbatueshme ndërkombëtare dhe të BE-së;
- Të rrisë gradualisht stafin ekspert/të specializuar të institucioneve përkatëse, me procedura transparente të punësimit, me fokus në kompetencën dhe ekspertizën teknike të kërkuar;

- Lidhur me procedurat, ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve të menaxherëve për përcaktimin e statusit të refugjatit (RSD), për të siguruar standarde cilësore të menaxhimit dhe vendimmarrjes për azilin, aplikimin e standardizuar të informatave të vendit të origjinës (COI) dhe përdorimin e përshpejtuar e procedura të thjeshtësuara për rastet qartazi të bazuara dhe ato të pabazuara gjatë procedurave të para-pranimit/kontrollimit në kufi.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale: Ligji që rregullon këtë fushë është Ligji për Azil, i cili ka transpozuar pjesërisht gjashtë (6) akte të *acquis*-së, dhe UA për Procedurën dhe Kriteret e Përcaktimit të Statusit të Personit pa Shtetësi, Mënyrën e Fitimit të Shtetësisë për Personin pa Shtetësi dhe Personin me Status të Refugjati. *Institucioni* përgjegjës në këtë fushë është MPB, përkatësisht Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (në kuadër të së cilit funksionon edhe Qendra për Azilkërkues).

Luftimi i shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se lufta kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit nuk është duke sjellë rezultatet e duhura. Nevojiten më shumë përpjekje për të arritur një nivel të konsiderueshëm të hetimeve proaktive, vendimeve gjyqësore përfundimtare dhe konfiskimit të aseteve. Duhet të forcohen kapacitetet e policisë dhe prokurorisë. Shpëlarja e parave dhe financimi i terrorizmit nuk hetohen si vepër penale në vete, por vetëm në lidhje me vepra të tjera penale, dhe se hetimet paralele financiare nuk zhvillohen në mënyrë sistematike për rastet e krimet të organizua. *Raporti rekomandon* që bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet agjencive duhet të përmirësohet ndjeshëm. Miratimi i procedurave standarde operative të policisë për të centralizuar të gjitha aspektet e hetimeve financiare në përputhje me rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) ende nuk ka dhënë rezultate konkrete. Ligji për Luftimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit duhet të plotësohet-ndryshohet për t'u harmonizuar me Direktivën IV dhe V për AML dhe CFT dhe të mos vendosë kufizime të panevojshme në qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve me rrezikshmëri të ulët.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale: ligjet kryesore në këtë fushë janë: Kodi Penal, Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, Ligj për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara, Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe të Dhuratave Zyrtare. Gjithashtu janë në fuqi një numër aktesh nënligjore që burojnë nga ligjet që rregullojnë këtë fushë. *Institucionet* kryesore përgjegjëse në këtë fushë janë: Njësia e Inteligjencës Financiare; MFPT, DK dhe ATK; PK; Prokurori i Shtetit; dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.

Lufta kundër narkotikëve

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova ende nuk ka miratuar një strategji të re dhe PV për luftimin e narkotikëve. Nuk janë ndërmarrë as hapat e nevojshëm për të siguruar kapacitetin operacional të Observatorit të drogave dhe për të krijuar një sistemi të paralajmërimit të hershëm. Mbetet të rishikohet legjislacioni në këtë fushë, në mënyrë që të jetë më gjithëpërfshirës dhe në harmoni me legjislacionin e BE-së. Prokuroria vazhdon të ketë mungesë të kapaciteteve profesionale për të trajtuar në mënyrë efikase veprat penale të lidhura me drogën. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Të kuptuarit e tregut të drogës nga institucionet e zbatimit të ligjit dhe prokuroria, përmes punës analitike. Të përmirësohet edhe më tutje bashkëpunimi ndër-institucional dhe shkëmbimi i informacionit në luftën kundër trafikut të drogës.
- Përmirësimin dhe priorizimin e ngritjes së bashkëpunimit, koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.
- Funksionalizimin e plotë të Observatorit Nacional të Narkotikëve.

Më tej, në NK VI për Drejtësi, Liri dhe Siguri Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

- Agjencitë e zbatimit të ligjit të vazhdojnë të rrisin konfiskimet e drogave të paligjshme, veçanërisht kokainës dhe heroinës, dhe të punojnë me një koncept nga inteligjenca në burgosje;
- Të përmirësojë bashkëpunimin ndërinstitucional e shkëmbimin e informatave, në të gjitha nivelet, në luftën kundër trafikimit të drogës;
- Të funksionalizojë Observatorin Nacional të Narkotikëve në kuadër të MPB-së.

Korniza legislative, e politikave dhe ajo institucionale: Ligjet kryesore në këtë fushë janë: Kodi Penal; Kodi i Procedurës Penale; Ligji për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorët, i cili bazohet në Konventat e OKB-së për: droga narkotike, për substanca psikotrope, dhe kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope. Në fuqi është edhe UA për Administrimin dhe Përdorimin e Metadonit për Programe Mbjajtëse. Institucionet përgjegjëse në këtë fushë janë: PK, përkatësisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Drogave (e mbështetur nga departamente të tjera); DKl AKI; MSh, përkatësisht Inspektorati Shëndetësor, Agjencia e Kosovës për Pajisje dhe Produkte Medicinale; Agjencia Kosovare për Forenzikë; Prokurori i Shtetit; MD, përkatësisht Departamenti i Mjekësisë Ligjore; dhe KGJK. Gjithashtu funksionon Koordinatorin Nacional dhe Sekretariati përgjegjës për këtë fushë në kuadër të MPB-së.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimi policor

Gjendja aktuale

*Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova ka njëfarë niveli të përgatitjes në këtë fushë. Përmirësimet në kornizën legislative për të luftuar krimin e organizuar ende nuk kanë dhënë rezultate të prekshme. Numri i ulët i aseteve kriminale të konfiskuara mbetet shqetësim kyç. Nevojiten përpjekje të qëndrueshme për të siguruar hetime proaktive, vendime gjyqësore përfundimtare dhe që përfshijnë konfiskimin e pasurisë. Pavarësia operationale e institucioneve të zbatimit të ligjit duhet të jetë e garantuar. Ligji për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit duhet të ndryshohet për të qenë plotësisht në përputhje me Direktivat e 4-të dhe të 5-të të BE-së për luftën kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit dhe me standardet ndërkombëtare në zhvillim. Legjislacioni për trafikimin e qenieve njerëzore është gjerësisht harmonizuar me *acquis* përkatëse të BE-së, por zbatimi mbetet i kufizuar. Zbatimi efektiv i mekanizmave të mbrojtjes së dëshmitarëve vazhdon të përballet me sfida, pasi pak dëshmitarë të mundshëm kanë besim të mjaftueshëm në aftësinë e institucioneve të Kosovës për t'i mbajtur ata të sigurt. Pavarësisht progresit, përfshirja e grupeve të organizuara dhe të armatosura në trafikun e armëve mbetet një shqetësim serioz. Kontrabanda e cigareve dhe duhanit është një shqetësim në rritje. Kosova është një vend kyç transit për kontrabandën e cigareve të falsifikuara dhe për produktet e duhanit të prodhuara në mënyrë të ligjshme të transportuara në mënyrë të paligjshme përmes vendeve fqinje në Ballkanin Perëndimor. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:*

- Hetime proaktive, vendime gjyqësore të formës së prerë dhe konfiskim përfundimtar të aseteve;
- Përforcimin e kapaciteteve të Prokurorisë Speciale dhe hetimin e ndjekjen penale të rasteve të krimit të organizuar të profilit të lartë;
- Të shfrytëzojë më mire mjetet ekzistuese të fuqishme të parapara me Kodin Penal dhe Ligjin për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit. Ligji i ri për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të synuara përdoret si mjet efektiv në luftimin e krimit të organizuar.
- Të zbatojë në mënyrë efektive strukturën e re organizative të policisë dhe të vazhdojë zbatimin e qasjes së udhëhequr nga inteligjenca dhe policimi në komunitet si modele kryesore të policisë;
- Në mënyrë proaktive dhe të përbashkët të targetojë dhe vlerësojë/shkallëzojë grupet e organizuara kriminale dhe të vazhdojnë në mënyrë sistematike me hetime financiare në të gjitha fazat e hetimeve penale në të gjitha rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe të fillojë hetime të pavarura për pastrim parash;
- të rrisë përpjekjet për të parandaluar dhe luftuar rrjetet kriminale të përfshira në kontrabandën e migrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe në identifikimin dhe referimin e viktimave tek shërbimet e asistencës; të sigurojë qëndrueshmëri financiare të strehimoreve dhe ndihmë për viktimat e trafikimit.

Më tej, në NK VI për Drejtësi, Liri dhe Siguri Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

- Të forcojë bashkëpunimin multi-disiplinor në procedurat hetimore përmes komunikimit dhe shkëmbimit të informatave ndërmjet institucioneve, inspektiveve të përbashkëta dhe ekipeve hetimore shumë-disiplinore;
- Të zbatojë një qasje të përbashkët (polici – prokurori) të bazuar në objektiva për të luftuar krimin e rëndë dhe të organizuar si pjesë e parimit të policisë së udhëhequr nga inteligjenca;
- Autoritetet e prokurorisë dhe të zbatimit të ligjit të përcaktojnë prioritete konkrete strategjike për trajtimin e fenomeneve të veçanta të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë;
- Të kryejë sistematikisht hetime financiare në të gjitha fazat e hetimeve penale për të gjitha rastet e rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale: Ligjet kryesore në këtë fushë, në të cilët janë transpozuar një sërë aktesh të *acquis*-së, janë: Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetikë, Ligji për Sigurinë Kibernetike (i miratuar në shkurt 2023), Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve, Ligji për Policinë, Ligji për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë, Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Ligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, Ligji për Gjykatat, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligji për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike.

Dokumentet e *politikave* në këtë fushë janë: Strategjia Kombëtare dhe PV kundër Krimit të Organizuar, Strategjia Kombëtare dhe PV kundër Narkotikëve, Strategjia për Kontrollimin dhe Mbledhjen e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore e miratuar në qershor 2022 dhe Strategjia Kombëtarë për Siguri Kibernetike 2023 – 2027 e miratuar në tetor 2023.

Institucionet përgjegjëse në këtë fushë janë: MPB, përkatësisht PK; MFPT, MD; AKI; KGjK; KPK; Prokuroritë; dhe Gjykatat.

Lufta kundër terrorizmit

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se pavarësisht përpjekjeve të konsiderueshme, vendi vazhdon të përballë me sfida në luftën kundër terrorizmit dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Rritja e incidenteve të dhunshme të ekstremizmit fetar në familje dhe ndikimi i formave të tjera të ekstremizmit është shqetësues. Autoritetet e Kosovës duhet të balancojnë përpjekjet për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm në të gjitha format e tij, me masa rehabilituese dhe riintegruese. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Krijimin e një Qendre Kombëtare Kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm, ose të përforcohet Zyra e Koordinatorit Kombëtar me burime adekuate financiare dhe njerëzore dhe të sigurojë praktikën e rregullt të kryerjes së vlerësimeve të përbashkëta të kërcënimeve;
- Autoritetet e Kosovës duhet të përmirësojnë kapacitetet e tyre për të adresuar përmbajtjen terroriste në internet, duke përfshirë rritjen e përpjekjeve të tyre për t'iu referuar përmbajtjeve terroriste ofruesve të internetit, si dhe rritjen e përpjekjeve për të fuqizuar shoqërinë civile për të zhvilluar kundër-narrativa efektive.
- Vazhdimin e rishikimit të strategjive, PV-ve dhe programeve për riintegrim e rehabilitim.

Më tej, në *NK VI për Drejtësi, Liri dhe Siguri* Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

- Të krijojë zyrën e koordinatorit kombëtar me burime të duhura financiare dhe njerëzore;
- Të funksionalizojë një strukturë/mekanizëm në kuadër të MPB-së për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, me buxhet dhe burime të nevojshme, duke filluar nga trajnimi i stafit dhe hartimi i akteve nënligjore dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për këtë.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale: Ligjet kryesore në këtë fushë janë: Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit,

Ligji për Ndalimin e Bashkimit në Konflikte të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit, Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Dokumentet e *politikave* në këtë fushë janë: Strategjia për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit e miratuar në qershor 2023. Gjithashtu është përditësuar dhe miratuar Programi i Rehabilitimit dhe riintegritimit për individët e radikalizuar. *Institucionet* përgjegjëse në këtë fushë janë: MPB; AKI; MFPT, përkatësisht DK dhe ATK; NjIF; ZKM; dhe PSRK. Gjithashtu funksionon Sekretariati përgjegjës për këtë fushë, në kuadër të MPB-së.

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se ndonëse Kosova nuk është palë në shumicën e traktateve shumëpalëshe për bashkëpunimin e ndërsjellë juridik, ajo zbaton njëanshëm standardet e traktateve të njohura ndërkombëtare. Bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Eurojust-it ka avancuar më tej. Dy traktate të reja bilaterale për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile kanë hyrë në fuqi dhe Kosova ka ndërmarrë hapa për të lidhur traktate shtesë dypalëshe. Autoritetet kosovare akoma nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim për të bashkëpunuar me Prokurorinë Publike Evropiane.

Më tej, në konkluzionet e *NK VI për Drejtësi, Liri dhe Siguri* rekomandohet që të kompletohet korniza ligjore në këtë fushë dhe të vazhdojnë përpjekjet për të negociuar marrëveshje të reja dypalëshe mbi bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile.

Korniza legislative dhe ajo institucionale: Kjo fushë rregullohet nga Ligji për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale dhe Ligji për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile, të cilët kanë transpozuar një sërë aktesh të *acquis*-së. *Institucioni* përgjegjës në këtë fushë është MD, përkatësisht Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.

Objektivat prioritarë afatmesme:

Menaxhimi i kufirit:

- Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritete si Frontex, Selec etj.;
- Hapja e pikë-kalimeve të reja kufitare me vendet fqinje;
- Avancimi i pajisjeve për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit;

Politika e vizave:

- Shtirja e SIVK-ut në misionet e tjera diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës;

Azili:

- Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të bashkëpunimit qendror dhe lokal për azilkërkues që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare;
- Ndërtimi i një objekti për grupet e cënueshme brenda Qendrës së Azilit;

Migrimi:

- Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në luftimin e migrimit të parregullt;
- Promovimi i migrimit të rregullt dhe atij qarkor;
- Ngritja e kapaciteteve të akomodimit alternativ të migrantëve, të qendrës së mbajtjes për të huajt.

Luftimi i shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit:

- Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës ligjore dhe të politikave në fushën e luftës kundër shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, përfshirë përmes plotësim-ndryshimit të Ligjit për Luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, me qëllim të përafrimit me Direktivën IV dhe Direktivën V të BE-së në këtë fushë dhe zbatimin e tyre;
- Fuqizimi i kapaciteteve të Njësisë së Inteligjencës Financiare (NjIF), në luftimin e financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave;
- Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional, përfshirë bashkëpunimin ndër-institucional me autoritetet për zbatimin e ligjit dhe subjektet raportuese, përmes themelimit të mekanizmave të Përbashkët multi-diciplinar të Inteligjencës dhe hetimit të Pastrimit të Parave;
- Zhvillimi i përpjekjeve për të arritur një nivel të konsiderueshëm të hetimeve proaktive, vendimeve përfundimtare të gjykatës dhe konfiskimit përfundimtar të aseteve;

- Zhvillimi i Udhëzuesve të avancuar për agjencitë e zbatimit të ligjit për hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave si vepër e vetme dhe hetimet financiare paralele;
- Fuqizimi i vlerësimit të rrezikut, menaxhimit të rrezikut dhe kornizën strategjike;
- Përforcimi i masave parandaluese të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Fuqizimi i strukturës së përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse;
- Fuqizimi i aftësive për identifikimin e pronësisë përfituese dhe për të kufizuar keqpërdorimin e personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike për qëllime të PP/FT;
- Fuqizimi i Hetimeve dhe ndjekjes penale të PP/FT;
- Të përforcohen reformat e iniciuara me synim decentralizimin e rasteve të Pastrimit të Parave të prokurorët që nuk janë të PSRK-së por duke mbajtur rastet e profilit të lartë dhe me vëllim të lartë për t'u mbikëqyrur dhe ndjekur penalisht nga PSRK-ja;
- Të ndërmerren masa sistematike për të promovuar hetimin dhe ndjekjen penale në mënyrë autonome të Pastrimit të Parasë (pa pasur nevojë për ndjekjen penale të veprave penale të ndërlihdura) në bazë të praktikës gjyqësore të kohëve të fundit;
- Zhvillimi i mekanizmave për adresimin e informatave kthyesë për qëllim të rritjes së kualitetit të raportimeve, analizave dhe hetimeve të rasteve të pastrimit të parave.

Lufta kundër narkotikëve:

- Avancimi i bashkëpunimit me EMCDDA;

Lufta kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimi policor:

- Krijimi i një bazë të dhënash për regjistrat penalë, përfshirë evidencën për personat e dënuar;
- Rritja e numrit të gjyqtarëve dhe përmirësimi i specializimit të prokurorëve e gjyqtarëve kundër krimit të organizuar;
- Ngritja e kapaciteteve teknike të laboratorëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë;
- Rritja e numrit të urdhrave për konfiskim të pasurisë dhe në përgjithësi përmirësimi i rezultateve në konfiskimin e përhershëm të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme;
- Forcimi i ekipeve multidisiplinore për të targetuar dhe identifikuar në mënyrë proaktive grupet e organizuara kriminale;

Lufta kundër terrorizmit:

- Ngritja e kapaciteteve teknike, logjistike dhe teknologjike në fushën e terrorizmit dhe parandalimit të përhapjes së ekstremizmit përmes internetit dhe mediave sociale;
- Ngritja e kapaciteteve teknike, logjistike dhe teknologjike në fushën e terrorizmit;
- Ngritja e kapaciteteve kibernetike kundër terrorizmit;
- Fuqizimi i kapaciteteve dhe qasjes për de-radikalizim dhe ri-integrim;
- Rritja e përfshirjes së autoriteteve komunale në planifikimin dhe zbatimin e rehabilitimit dhe riintegritimit, si dhe në punën parandaluese, përfshirë krijimin e ekipeve multi-disiplinore nëpër komuna;
- Forcimi i rolit të shërbimeve sprovuese në mbikëqyrjen e sanksioneve dhe masave të komunitetit dhe në mbështetjen e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm të liruar me kusht;
- Forcimi i kapaciteteve të prokurorëve dhe gjyqtarëve në identifikimin e formave të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm;
- Forcimi i kapaciteteve për përcaktimin dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike;

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile

- Avancimi i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje të ekstradimit dhe ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet penale dhe civile;
- Anëtarësimi (aderimi) në Konventën e Hagës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe komerciale;
- Anëtarësimi në Konferencën e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

3.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimet shkencore

Në këtë kapitull kërkohet kapacitete për të zbatuar *acquis*-në dhe politikat e BE-së për kërkime shkencore dhe zhvillim teknologjik dhe për të ndjekur objektivat e saj në këto fusha. Kapacitetet e tilla janë parakushte

për pjesëmarrjen në programet e BE-së për kërkime shkencore dhe inovacion, me qëllim të lehtësimit të integritimit në Zonën Evropiane për Kërkime Shkencore.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 thekson se Kosova është në fazën e hershme të përgatitjes në fushën e shkencës dhe kërkimit. Është arritur njëfarë progresi gjatë periudhës raportuese ku Kosova ka përmirësuar ndjeshëm performancën e saj në programin kornizë të BE-së për kërkim dhe inovacion. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Zbatimin e plotë të Programit Kombëtar të Shkencës, përfshirë prioritizimin dhe promovimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit, sigurimin e shpenzimeve më të larta për kërkim dhe inovacion, dhe përpjekjen për të stimuluar investimet nga sektori privat duke zhvilluar strategjinë e specializimit inteligjent;
- Vazhdimin e përpjekjeve për rritjen e pjesëmarrjes në Programin e BE-së *Horizon Europe*.

Më tej, në *NK për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale* Kosova ka marrë përsipër të zbatojë këto reforma kryesore:

- Të përgatiten të dhëna statistikore (sipas Manualit Frascati të OECD-së) mbi shpenzimet e Qeverisë për kërkime shkencore dhe inovacion si përqindje e BPV dhe performancën në lidhje me prioritetet e Zonës Evropiane për Kërkime Shkencore;
- Të ofrohen treguesit e nevojshëm statistikorë që Kosova të mund të marrë pjesë në Metrikun Evropian të Inovacionit (*European Innovation Scoreboard*);
- Të forcohet dhe përmirësohet pjesëmarrja në Programin *Horizon Europe*, me qëllim që të arrihen të paktën nivelet e vitit 2019 dhe të merret pjesë në iniciativat kryesore të këtij programi (ESS, EOSC, EuroHPC), në veçanti në ndërmarrjen e përbashkët EuroHPC, dhe t'i bashkohet raundit XI të Anketës Sociale Evropiane;
- Të kompletohet procesi i analizës së ndërmarrësisë për Strategjinë e Specializimit të Mençur.

Korniza legjislative dhe ajo institucionale

Ligji që rregullon kërkimet shkencore është Ligji nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, i cili parasheh praktikat e mira evropiane në mbështetje të kërkimeve shkencore, me fokus në zhvillimin ekonomik e social, si dhe përmban dispozita që rregullojnë lidhjen e kërkimeve shkencore me ekonominë dhe industrinë. Institucioni kryesor në këtë kapitull është Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHII), përgjegjëse për zhvillimin e politikave në fushën e shkencës dhe kërkimeve shkencore. MASHII, së bashku me MINT-in, gjithashtu është institucioni kryesor përgjegjës për kërkime shkencore dhe inovacion, e para mbulon kryesisht kornizën shkencore dhe e dyta anën industriale dhe atë të politikave si koncepte të ndërmarrësisë. Përveç këtyre, Këshilli Kombëtar i Shkencës është struktura përgjegjëse për administrimin e prioriteteve kombëtare të kërkimeve shkencore. Kosova është vend anëtar i asocuar, me të drejta të plota si partner ndërkombëtar i bashkëpunimit në Programin Kornizë të BE-së për Kërkime Shkencore dhe Inovacion *Horizon 2020*, ku ka arritur një shkallë pjesëmarrjeje prej 20.01%, me 21 projekte të financuara.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Sigurimi i financimit për veprimtarinë kërkimore-shkencore;
- Integrimi i Kosovës në hapësirën Kërkimore Evropiane (ERA);
- Përmirësimi i inovacionit shkencor dhe industrial në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

3.26. Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura

Fushat e arsimit dhe trajnimeve, rinisë, sportit dhe kulturës janë kryesisht kompetencë e shteteve anëtare. TFBE parasheh që BE të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare dhe u ofron atyre mbështetje plotësuese, duke respektuar plotësisht përgjegjësitë e tyre për përmbajtjen e mësimin, organizimin e sistemit arsimor dhe të trajnimeve profesionale, si dhe diversitetin kulturor kombëtar dhe rajonal. *Acquis* në këtë

kapitull përbëhet kryesisht nga një kornizë bashkëpunimi, përmes programeve dhe metodës së hapur të koordinimit, për të arritur konvergencën e politikave kombëtare dhe objektivat e përbashkëta.

Gjendja aktuale

Në *Raportin e KE-së për Kosovën – 2023* BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Hartimin e një udhërrëfyese për zbatimin e reformave kyçe të sistemit arsimor, duke përfshirë rekomandimet në kuadër të Diagnostikimit të Arsimit të Shpejtë të ETF-së;
- Finalizimin e zbatimit të kornizës së re kurrikulare për arsimin bazë, të bëjë rishikimin e teksteve ekzistuese dhe të ofrojë trajnime të qëndrueshme për mësimdhënësit; të zbatojë sistematikisht mekanizmat e sigurimit të cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit;
- Përmirësimin e qeverisjes së AAP-së dhe të rrisë cilësinë e arsimit dhe aftësimin profesional për profesionet e kërkuara në funksion të Garancisë Rinore;
- Zhvillimin e kurrikulës për edukimin në fëmijërinë e hershme;
- Përmirësimin e arsimit dhe aftësimin profesional (AAP);
- Ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit të Arsimit;

Më tej, në konkluzionet e *NK për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale* janë identifikuar disa aspekte për t'u adresuar në periudhën në vijim, përfshirë:

- Përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet përmes aplikimit sistematik të mekanizmave ekzistues të sigurimit të cilësisë, siç janë koordinatorët e cilësisë, inspektimet e shkollave në arsim, përfshirë AAP, dhe sigurimi i monitorimit të rreptë të kushteve të Agjencisë Kosovare të Akreditimit për akreditimin e programeve të arsimit të lartë;
- Miratimin e Ligjit për Tekstet dhe Materialet Mësimore,
- Sigurimin e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit;
- Vazhdimi i publikimit të të dhënave të sakta në baza të rregullta në të gjitha fushat e arsimit dhe rinisë (përfshirë shpenzimet e PBB-së në arsim), të cilat duhet të jenë të matshme, të gjurmueshme dhe të krahasueshme me kalimin e kohës. Sigurohuni që Sistemi Informativ i Menaxhimit të Arsimit të zhvillohet më tej për të përmbushur nevojat aktuale dhe të ardhshme në këtë fushë;
- Rritja e administrimit, rritja e pjesëmarrjes dhe zbatimi i vlerësimeve ndërkombëtare;
- Rritja e shkallës së regjistrimit në fëmijërinë e hershme në nivelin 02 të ISCED 2011;
- Vazhdimi i përpjekjeve për rritjen e shkallës së regjistrimit të nxënësve me nevoja të veçanta dhe parandalimin e braktisjes
- Rritja e pjesëmarrjes në Programin *Erasmus*.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Korniza ligjore në fushën e arsimit përbëhet nga Ligji nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, Ligji nr. 05/L-018 për Provimin Shtetëror të Maturës; Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 02/L-52 për Arsimin Parashkollor, dhe Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar. Në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional, ligjet kryesore janë: Ligji nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Ligji nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve, dhe Ligji nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare. Korniza ligjore në fushën e kulturës përfshin Ligjin nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës, Ligjin nr. 2003/24 për Sportin, Ligjin nr. 04/L-056 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota", Ligjin nr. 04/L-59 për Filarmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Ligjin nr. 2004/22 për Kinematografinë, Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore dhe Ligjin nr. 04/L-106 për Teatrot. Më tej, në fillim të vitit 2023 Kuvendi ka miratuar Ligjin nr. 08/L-111 për Arkivat Shtetërore dhe Ligjin për Antidoping në Kosovë, si dhe ka plotësuar aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore. Përveç këtyre, Qeveria ka miratuar projektligjin për kinematografinë dhe projektligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Dokumentet kryesore të politikave në këtë kapitull janë: Strategjia e Arsimit 2022-2026, Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027, dhe Strategjia për Rininë 2019-2023.

Institucioni kryesor në këtë kapitull është MASHTI, përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit e politikave në të gjitha nivelet e arsimit, menaxhimin e sistemit të certifikimit e trajnimit të mësimdhënësve dhe promovimin e politikave për kërkime shkencore. Në kuadër të saj funksionon edhe Qendra për Njohje të Diplomave, përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë vendit. Gjithashtu funksionojnë institucione përgjegjëse lidhur me kornizën e kurrikulave, licencimin, akreditimin dhe certifikimin e niveleve të ndryshme të arsimit, përfshirë Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional të të Rriturve. Komunitat janë përgjegjëse në arsimin para-universitar lidhur me ndërtimin e objekteve shkollore; regjistrimin e nxënësve; punësimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër; regjistrimin, licencimin dhe inspektimin e institucioneve parashkollore; tarifat e pjesëmarrjes në institucionet parashkollore; mekanizmat e komunikimit me prindër; etj.

Institucioni kryesor në fushën e kulturës është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave, ndërsa Inspektorati për Trashëgimi Kulturor mbikëqyr zbatimin e Ligjit për Trashëgiminë Kulturorë dhe legjislacionit tjetër relevant, ndërsa gjithashtu funksionojnë institucione të tjera për kulturë, art dhe kinematografi. Përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit për zonat e veçanta të mbrojtura janë: MMPHI, MAPL dhe Komunitat.

Objektivat prioritarë afatmesme

- Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës dhe zbatimi i Kornizës së Kurrikulës;
- Menaxhimi efektiv i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet;
- Përmirësimi i cilësisë dhe integritetit të arsimit të lartë, në harmoni me standardet ndërkombëtare;
- Forcimi i kapaciteteve të Inspektoratit të Arsimit, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare;
- Zhvillimi profesional i mësimdhënësve;
- Rritja e kapaciteteve për përfshirje në arsimin para-fillor.

3.27. Kapitulli 27: Mjedisi

Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit janë objektivat e politikave të BE-së në këtë kapitull. Ato bazohen në veprimin preventiv sipas parimit “ndotësi paguan”, me qëllimin për të luftuar dëmin mjedisor në burim, ndarjen e përgjegjësisë dhe integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera. *Acquis* në këtë kapitull përfshin mbi 200 akte, përfshirë legjislacionin horizontal dhe aktet zbatuese. Pajtueshmëria me *acquis* kërkon investime të konsiderueshme, ndërsa për aplikimin dhe zbatimin e saj është e domosdoshme një administratë e fortë dhe e pajisur mirë, në nivelin kombëtar dhe atë lokal.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova është në fazë të hershme të përgatitjes në këtë kapitull, mirëpo gjatë kësaj periudhe raportuese është bërë një progres i limituar, veçanërisht me miratimin e Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes në mars 2023, gjithashtu ka pasur disa përparime në harmonizimin e legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave, për ujërat dhe për ndotjen industriale dhe menaxhimin e rrezikut, ndërsa nuk ka pasur përparime në mbrojtjen e natyrës, në lidhje me kimikatet dhe në rregullimin e zhurmës. Më tej, Kosova duhet të rrisë përkushtimin politik dhe kapacitetet administrative për të adresuar çështjet që kanë të bëjnë me degradimin e mjedisit dhe sfidat e ndryshimeve klimatike dhe për të përmirësuar dukshëm zbatimin e legjislacionit, në harmoni me objektivat e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Rritjen e mbulimit të grumbullimit të mbeturinave, të aplikoj në masë të gjerë reduktimin, ndarjen, riciklimin dhe ripërdorimin e mbeturinave;
- Trajtimin në mënyrë efektive të çështjes së deponive të paligjshme dhe prezantimin e masave të ekonomisë qarkore për reduktimin e mbeturinave, zhvillimin dhe miratimin e planeve nderkomunalë për menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe të krijoj sistemin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesve;

- Intensifikimin e punës për uljen e ndotjes industriale përmes zbatimit dhe ndërmarrjes së masave për mos zbatim të ligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes;
- Harmonizimin dhe fillimin e zbatimit të dispozitave ligjore për përgjegjësinë mjedisore, dëmin dhe krimin;
- Zbatimin e parimit “ndotësi paguan” dhe vetëdijesimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit;
- Zbatimin e Strategjisë dhe PV për Ndryshimet Klimatike;
- Përgatitjen e një udhërrëfyese për përafrimin me Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe *acquis* për klimën, miratimin e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë, në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë, dhe finalizimi i strategjisë afatgjate për dekarbonizim;
- Përgatitjen për harmonizim me Sistemin e Tregtimit të Emetimeve të BE-së (ETS).

Konkluzionet e NK VII për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal janë deri diku në harmoni me rekomandimet e Raportit të KE-së për Kosovën – 2023, me disa aspekte për t’u adresuar, përfshirë:

- Miratimin e PV për Cilësinë e Ajrit dhe të planit për cilësinë e ajrit për Prishtinën;
- Hartimin e masave për kontrollin e ndotjes së ajrit për Prishtinën dhe aglomeratet e tjera relevante dhe zonat e ndjeshme;
- Zhvillimin dhe fillimin e zbatimit të një plani gjithëpërfshirës për zhvillimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave;
- Ndryshimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbeturinave për të përfshirë objektivat e riciklimit, masat për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme dhe bashkëpunimin ndër-komunal;
- Miratimin e planit të menaxhimit “Drini i Bardhë”;
- Finalizimin e hartimit të planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore për trupat ujorë të mbetur;
- Miratimin e Projektligjit për Ujërat e Kosovës;
- Hartimin e PV për Biodiversitetin në përputhje me Strategjinë e Mjedisit;
- Finalizimin dhe miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës;
- Miratimin e Planit hapësinor për parkun kombëtar ‘Sharri’;
- Lëshimin e lejeve të integruara për reduktimin e emetimeve të dëmshme industriale, veçanërisht për kompanitë shtetërore;
- Pjesëmarrjen në mënyrë më aktive në aktivitetet nën Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Unionit;
- Vazhdimin e përafrimit të ligjeve dhe miratimin e dokumenteve strategjike për ndryshimet klimatike, mbrojtjen nga zhurma, ndotjes industriale, dhe të vlerësimit të nevojave dhe rimëkëmbjes duke siguruar koherencë me parimet dhe prioritetet e Marrëveshjes së Gjellbër dhe Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: Ligjet kryesore për mjedisin janë: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, që synon harmonizimin e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, promovimin e një mjedisit të shëndetshëm dhe përafrimin gradual me standardet mjedisore të BE-së; Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, që rregullon vlerësimin strategjik mjedisor të planeve e programeve, për të siguruar shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut; Ligji për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis, që synon parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit negativ të projekteve të propozuara publike e private, me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të mjedisit, mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe përmirësimit të cilësisë së jetës. Gjithashtu janë në fuqi ligje që rregullojnë fusha specifike në këtë kapitull: Ligji për Mbeturinën, Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, Ligji për Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna, Ligji për Parkun Kombëtar Sharri, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji për Kimikatet, Ligji për Produktet Biocide, Ligji për Ndryshime Klimatike, Ligji për Pyjet e Kosovës, Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, Ligji për Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave, Ligji për Mbrojtje nga Zjarri; Ligji për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Ligji për Gjuetinë dhe Ligji për Tokën Bujqësore. Këto ligje janë të përafuara në masë të madhe me *acquis*, ndërsa edhe një numër i madh aktesh nënligjore në fuqi kanë transpozuar pjesërisht aktet relevante të *acquis*-së.

Dokumentet kryesore të politikave në këtë kapitull janë: Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit, Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019- 2028 dhe PV për Ndryshime Klimatike, Strategjia Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe PV 2023-2025. Gjithashtu zbatohen një numër dokumentesh për fusha specifike: Strategjia 2021-2030 dhe PV 2021-2023 për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave, Strategjia dhe PV për Biodiversitetin, Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (PKZE) 2018-2027, Strategjia e Pyjeve, Strategjia Kombëtare për Sektorin e Produkteve Pyjore Jodrusore, Plani i Reagimit Kombëtar, dhe Strategjia Shtetërore dhe PV për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera 2023-2028. Edhe këto dokumente politikash janë në masë të madhe të përafuara me synimet e BE-së.

Institucioni kryesor në këtë kapitull është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), përgjegjëse për hartimin e zbatimin e legjislacionit dhe politikave, përfshirë përafrimin me *acquis* dhe standardet e BE-së dhe me konventat ndërkombëtare, dhe vendosjen e standardeve të detyrueshme.

Në këtë kapitull gjithashtu përfshihen institucionet tjera në politik bërje dhe zbatim MBPZhr, ME, MSh (përfshirë IKShP-në), MINT, MAPL, MPJD, ARrU.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Miratimi i UA për transpozimin e Direktivës Kombëtare të Tavanëve të Emisioneve;
- Transpozimi i direktivave të BE-së në legjislacionin e Kosovës për rrjedhën e mbeturinave;
- Hartimi i UA për transpozimin e plotë të Direktivës për Nitratet;
- Harmonizimi me Sistemin e Tregimit të Emetimeve të BE-së (ETS);
- Miratimi dhe fillimi i zbatimit të strategjisë për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike;
- Transpozimi i Direktivës nr. 2004/35/KE mbi Përgjegjësitë Mjedisore, Direktivës nr. 2003/04/KE për Qasje në Informata, Direktivës nr. 66/2010/KE për Eko-etiketë;
- Ngritja e Sistemit të Rikuperimit të Depozitave (SRD) për shishet e qelqit, plastikës dhe aluminit;
- Transpozimi i Direktivës së BE-së për Trajtimin e Ujërave të Zeza Urbane (UWWTD) dhe Direktivës së BE-së për Përmbytjet;
- Fillimi i zbatimit të Planit të Menaxhimit të Lumit Drini i Bardhë;
- Miratimi i Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri;
- Monitorimi nga afër i lejeve të integruara për reduktimin e shkarkimeve të dëmshme industriale, veçanërisht për kompanitë shtetërore;
- Hartimi i programit të monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Rehabilitimi i deponisë sanitare në Pejë, ndërtimi i celulës së re dhe mbyllja e deponisë ilegale në Istog;
- Avancimi i mëtejshëm i legjislacionit kombëtar për biodiversitetin, në përputhje me Direktivën e BE-së për Zogjtë, Direktivën për Habitatet dhe Rrjetin NATURA 2000;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale për përcaktimin e vendeve të NATURA 2000;
- Miratimi i Rregullores për Energjinë dhe Klimën;
- Inventarizimi nacional i pyjeve III;
- Funksionalizimi i kadastrit pyjor-regjistri i fondit pyjor të Kosovës;
- Zhvillimi i ueb-aplikacionit për meta të dhëna mjedisore të Kosovës;
- Përmirësimi i kapaciteteve për inspektimet mjedisore.

3.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit

Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik është shumë e rëndësishme, me shtrirje në të gjithë sektorët dhe ndikim në të gjithë operatorët ekonomikë produktet e të cilëve publiku i konsumon ose përdor. Aktet e *acquis*-së në këtë kapitull mbrojnë interesat ekonomike të konsumatorëve në lidhje me sigurinë e produkteve, imitimet e rrezikshme dhe përgjegjësinë për produktet me defekt. Në BE gjithashtu sigurohen standarde të larta të përbashkëta për kontrollin e duhanit, gjakut, indeve, qelizave e organeve dhe medikamenteve për përdorim njerëzor dhe veterinar, si dhe standarde të larta të përbashkëta për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar dhe trajtimin e kërcënimeve serioze shëndetësore ndërkufitare, përfshirë sëmundjet ngjitëse.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova është në fazë të hershme të përgatitjes në këtë fushë. Ka pasur përgjithësisht progres të kufizuar me miratimin e Ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve, por ligji për mbrojtjen e konsumatorit ende nuk është miratuar. Kosova ka arritur pajtueshmërinë me Certifikatën Digjitale të BE-së për COVID. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Të miratojë ligjin për mbrojtjen e konsumatorit;
- Të rris kapacitetet njerëzore dhe financiare dhe të sistemeve të nevojshme për zbatimin e reformave në sektorin shëndetësor, veçanërisht duke zbatuar sistemin elektronik të informacionit të shëndetit publik dhe përmirësuar qasjen dhe gjendjen shëndetësore për ata që janë në situatat më të cenueshme;
- Të sigurojë zbatimin rigoroz të kontrollit të duhanit, në përputhje me *acquis* përkatëse të BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare.

Më tej, në konkluzionet e *NK Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë* janë identifikuar disa aspekte për t'u adresuar:

- Ndryshimi i ligjit për mbrojtjen e konsumatorit për të hequr elementet e diskutueshme (veçanërisht neni 16.8 flamujt dhe 81 garancitë), dhe defektet teknike;
- Miratimi i legjislacionit zbatues të Ligjit për Sigurinë e Produkteve;
- Vazhdimi dhe përmirësimi, me palët e tjera të interesit, i aktiviteteve vetëdijësuese për të drejtat e konsumatorëve dhe detyrimet e tregtarëve, veçanërisht në lidhje me blerjet *online*;
- Rritja e kapaciteteve njerëzore të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, veçanërisht sa i përket inspektorëve, për të mbrojtur më mirë konsumatorët.
- Miratimi i ligjeve bazë për shëndetin publik: ligjit për shëndetësi, ligjit për sigurime shëndetësore dhe ligjit për promovimin dhe edukimin shëndetësor;
- Miratimi i legjislacionit dhe PV për kontrollin e duhanit;
- Vendosja e masave për ofrimin e shërbimeve adekuate të kujdesit shëndetësor parësor dhe sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, dhe zbatimi i masave të mëtejshme për të përmirësuar standardet e cilësisë në kujdesin shëndetësor, përfshirë investime në aktivitetet e promovimit të shëndetit dhe trajnime;
- Puna në përgatitjen e pakos bazike dhe realizimi i konsultimeve dhe vetëdijësimit para fillimit të mbledhjes së premimeve për Fondin për Sigurime Shëndetësore;
- Miratimi dhe zbatimi i PV për sëmundjet ngjitëse;
- Përafrimi i legjislacionit me Rregulloren e BE për kozmetikë, për t'u mundësuar bizneseve kosovare të eksportojnë në tregun e BE-së.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Mbrojtja e konsumatorit: Ligji që rregullon këtë fushë është Ligji nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, pjesërisht i harmonizuar me *acquis*, i cili rregullohen raportet dhe kushtet e tregut në marrëdhëniet e bizneseve me konsumatorë, përfshirë etiketimin e produkteve, treguesit e çmimeve, shërbimet publike dhe praktikatat e padrejta tregtare, të drejtat e konsumatorëve lidhur me kontratat, mbrojtjen administrative dhe gjyqësore të interesave të konsumatorëve dhe kornizën institucionale. Gjithashtu janë në fuqi gjashtë (6) akte nënligjore për zbatimin e tij. Dokumenti i politikave në këtë fushë është Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2021-2025, i cili orienton politikatat dhe prioritetet. *Institucioni kryesor* në këtë fushë është MINT, përkatësisht Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit, në rol koordinues dhe administrativ, i cilit gjithashtu pranon ankesat e konsumatorëve ndaj shkeljes së të drejtave të tyre dhe ua përcjell ato institucionet relevante rregullative. Gjithashtu funksionon Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit, si strukturë koordinuese ndër-institucionale dhe këshillëdhënëse për politikatat në këtë fushë. Në të bëjnë pjesë AUV, BQK, ZRrE, dhe OShC-të dhe shoqatat afariste.

Mbrojtja e shëndetit: korniza ligjore në këtë fushë përbëhet nga këto ligje: Ligji për Shëndetësi, Ligji për Sigurime Shëndetësore, Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse, Ligji për Transfuzionin e Gjakut, Ligji për Produktet dhe Pajisjet Medicinale, Ligji për Odat e Profesionistëve

Shëndetësorë, Ligji për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave, Ligji për Kryqin e Kuq të Kosovës, Ligji për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht të Gjirit, Ligji për Shëndetin Riprodhues, Ligji për Kujdesin Shëndetësor Emergjent, dhe Ligji për Inspektoratin Shëndetësor

Dokumenti kryesor i politikave në këtë fushë është Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë, ndërsa me qëllim të vazhimit të përmirësimit të shëndetit të nënës, fëmijës, adoleshentit dhe shëndetin riprodhues është miratuar Plani Strategjik, si kornizë gjithëpërfshirëse e synimeve për zvogëlimin e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së nënave dhe fëmijëve në Kosovë. Institucioni kryesor në këtë fushë është Ministria e Shëndetësisë, përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit e politikave dhe vendosjen e standardeve të detyrueshme në këtë fushë. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore është i organizuar në tri nivele të sistemit publik: kujdesin primar, sekondar dhe terciar/i specializuar. Institucioni kryesor përgjegjës për kontrollin e pirjes së duhanit është Inspektorati Shëndetësor i MSh-së, ndërsa inspektoratet qendrore dhe organet e tjera të ministrive të linjës – si Inspektorati Sanitar (AUV), Inspektorati i Tregut (MINT), Inspektorati i Punës (MFPT), Inspektorati i Arsimit (MASHTI), Inspektorati i Transportit (MMPHI), Policia e Kosovës (MPB), dhe Inspektoratet komunale, janë institucione dytësore për këtë qëllim.

Objektivat prioritarë afatmesme:

Mbrojtja e konsumatorit:

- Zbatimi i Programit për Mbrojtje të Konsumatorit 2021-2025;
- Forcimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit;
- Realizimi i vazhdueshëm i aktiviteteve të vetëdijesimit për mbrojtjen e konsumatorit;
- Rritja e vazhdueshme e nivelit të përfshirjes dhe mbështetjes së shoqatave të konsumatorëve dhe akterëve të tjerë në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.
- Implementimi i ligjit të ri për mbrojtjen e konsumatorit.
- Zhvillimi i politikave në fushën e shërbimeve digjitale.
- Përditësimi i platformës së integruar elektronike 'konsumatori.rks-gov.ne'.

Mbrojtja e shëndetit:

- Vazhdimi i harmonizimit të legjislacionit me *acquis* për të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkuftar, shëndetin mendor, transplantimin e organeve, parandalimin e lëndimeve, mbrojtjen nga duhani, ushqyeshmërinë, aktivitetin fizik dhe psikik;
- Funkcionalizimi i autoritetit shtetëror, përkatësisht Divizionit për Biomjekësi, në baze të Ligjit për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave;
- Zhvillimi i strategjisë së re shëndetësore dhe zbatimi i strategjive ekzistuese, përfshirë kornizën strategjike për kontrollin e kancerit; promovim dhe edukim shëndetësor; kujdesin parësor shëndetësor; shëndetin mendor; rezistencën antimikrobike; programin e imunizimit; shëndetin e nënës, fëmijës, adoleshentit dhe shëndetin riprodhues; vaksinimin, dhe HIV-AIDS;
- Përgatitjet për funksionalizimin e fondit të sigurimeve shëndetësore përmes plotësimit të kornizës ligjore për fillimin e mbledhjes së kontributeve për skemën e sigurimit shëndetësor të detyrueshëm.

3.29. Kapitulli 29: Unioni Doganor

Acquis në këtë kapitull përbëhet thajse ekskluzivisht nga legjislacioni direkt detyrues për shtetet anëtare. Ai përfshin Kodin Doganor të BE-së dhe dispozitat e tij zbatuese, nomenklaturën e kombinuar, tarifën e përbashkët doganore, si dhe dispozitat për klasifikimin tarifor, lirim nga detyrimet doganore, pezullime doganore dhe kuota të caktuara tarifore. Pjesë e këtij legjislacioni janë edhe dispozitat e tjera si ato për kontrollin doganor të mallrave të falsifikuara e prekursorëve të drogës, eksportin e mallrave kulturore dhe ndihmën reciproke administrative në çështjet doganore dhe të transitit. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë kapacitetet e nevojshme për zbatim, përfshirë lidhjet me sistemet përkatëse të kompjuterizuara doganore të BE-së, dhe për të zbatuar rregulla të veçanta të përcaktuara në fushat e lidhura me *acquis* si tregtia e jashtme.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova është mesatarisht e përgatitur në fushën e doganave. Sa i përket legjislacionit doganor, Raporti thekson se Kodi i Doganave dhe Akcizave, i sapo-hartuar, në përputhje me Kodin Doganor të Unionit, ende mbetet për t'u miratuar nga Qeveria. Gjatë periudhës që mbulon ky raport theksohet se Kosova ka hapur zyrën doganore në Portin e Durrësit dhe Porto Romano (Shqipëri), ka rritur numrin e operatorëve të autorizuar ekonomikë dhe ka zbatuar masat doganore, për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI). Dogana e Kosovës (DK) ka vazhduar luftën kundër narkotikëve dhe aktiviteteve tjera të kontrabandimit. Për shkak të çështjes së njohjes, nuk është arritur progres në aplikimin e Kosovës për t'u bërë vëzhguese sipas Konventës të Transitit të Përbashkët. Sa u përket rregullave të origjinës, Kosova vazhdon të zbatojë Konventën Pan-Euro Mesdhetare (PEM). DK vazhdon të shkëmbejë sistematikisht të dhëna për lëvizjen ndërkufitare të mallrave ndërmjet ekonomive të Ballkanit Perëndimor. Kosova merr pjesë në programin e BE-së për bashkëpunim në fushën e doganave. DK ka qenë aktive edhe gjatë vitit 2023 në luftimin e aktiviteteve të paligjshme ndërkufitare dhe së bashku me Policinë ka zbuluar dhe konfiskuar sasi të konsiderueshme të narkotikëve në vlerë prej disa milionë eurosh. DK, autoritetet e tjera të zbatimit të ligjit dhe institucionet e linjës bashkëpunojnë mirë për të luftuar ekonominë joformale dhe mashtrimin doganor. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Vazhdimin e përafrimit me Kodin Doganor të Bashkimit dhe *acquis* për akcizën, duke përfshirë miratimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave;
- Forcimin e kapaciteteve administrative dhe profesionale të Doganës dhe të sigurojë që të zbatohen proceset e transferimeve dhe përzgjedhjes të bazuara në merita dhe transparencë.
- Të heq të gjitha tarifatat që u ngarkohen eksportuesve/importuesve në терминаlet doganore publike dhe private të brendshme.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Ligji kryesor në këtë kapitull është Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109, në masë të madhe në përputhje me *acquis* dhe kornizën doganore të BE-së. Gjithashtu janë në fuqi 24 akte nënligjore të cilat e kompletojnë kornizën ligjore për fushëveprimin e doganës. *Politikat* në këtë kapitull përcaktohen pjesërisht nga marrëveshjet dhe marrëdhëniet ndërkombëtare tregtare të Kosovës, si MSA dhe marrëveshjet tjera multilaterale e bilaterale tregtare dhe nga korniza strategjike për menaxhimin e financave publike. Dogana operon bazuar në Strategjinë Operative, e cila përcakton qëllimet dhe objektivat e parapara nga Qeveria në këtë kapitull, ndërsa në tremujorin e katërt të vitit 2023 ka filluar rishikimi i Planit Strategjik 2024-2028 dhe PV. Nga viti 2020 Kosova merr pjesë në Programin e BE-së për doganat i cili mbështet zhvillimin dhe operimin e sistemeve doganore të IT-së dhe bashkëpunimin midis shërbimeve doganore.

Institucioni kryesor në këtë kapitull është Dogana e Kosovës (DK), agjenci ekzekutive në kuadër të MFPT-së përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe vendimeve, ndërsa MFPT, në emër të Qeverisë, është institucioni bartës për hartimin e legjislacionit dhe politikave. Përveç për mbledhjen e të hyrave doganore, Dogana është institucioni kyç edhe për mbledhjen e TVSh-së nga importi, taksave të akcizës dhe për mbrojtjen e shoqërisë nga evazoni fiskal dhe kontrabandimi i mallrave të ndaluara dhe me efekt të dëmshëm në formën e krimit ekonomik. DK përdor versionin më të fundit të sistemit doganor ASYCUDA Eorld 4.3.2, i cili mundëson që shumë moduleve t'u shtohen disa veçori që në versionin paraprak kanë munguar. Institucionet e tjera me të cilat bashkëpunon DK në këtë kapitull janë: MINT, MPB (kryesisht PK), dhe MBPZhR (kryesisht AUV).

Objektivat prioritarë afatshkurta dhe afatmesme

- Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave;
- Rekrutimi i zyrtarëve të rinj doganorë;
- Modernizimi i vazhdueshëm i DK-së sipas standardeve të Udhërrëfyesit Doganor të BE-së;
- Forcimi i mëtejshëm i koordinimit ndërmjet Doganave, agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të tjera relevante për luftimin e ekonomisë joformale dhe mashtrimeve doganore;
- Finalizimi i shkëmbimit të informatave në nivel rajonal, ndërmjet vendeve të CEFTA-s, përmes sistemit SEED+;
- Aplikimi për statusin joformal të vëzhguesit në Konventën e Përbashkët të Transitit të BE-së.

3.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë

Acquis në këtë fushë përbëhet kryesisht nga aktet e zbatueshme drejtpërsëdrejti nga shtetet anëtare të dala nga zotimet shumëpalëshe e dypalëshe të BE-së në fushën e tregtisë dhe nga një numër masash tregtare autonome. Disa direktiva për kredi të eksportit dhe mallrave me përdorim të dyfishtë kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar. Vendeve aderuese u kërkohet harmonizimi progresiv i politikave të tyre komerciale ndaj vendeve të treta dhe brenda organizatave ndërkombëtare (p. sh. OBT, OECD) me politikën dhe pozicionet e miratuara nga BE dhe shtetet anëtare të saj. Në fushën e politikave humanitare dhe zhvillimore, vendet anëtare duhet t'i përmbahen legjislacionit të BE dhe zotimeve ndërkombëtare të BE dhe të sigurojnë kapacitetet e duhur për të marrë pjesë në politikën zhvillimore dhe humanitare të BE-së.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova është në fazë të hershme të përgatitjes në këtë kapitull dhe ka arritur progres të kufizuar gjatë periudhës raportuese. Kosova ka bërë progres në zbatimin e PV të Tregut të Përbashkët Rajonal, veçanërisht duke ratifikuar tre “marrëveshjet e procesit të Berlinit” për lëvizjen e lirë dhe njohjen reciproke të kualifikimeve. Kosova duhet të përmbahet nga marrja e masave të mëtejshme të njëanshme tregtare pa arsyetim dhe konsultim paraprak me Komisionin, në përputhje me zotimet e saj të MSA-së. Mosmarrëveshjet në lidhje me përfaqësimin e Kosovës kanë bërë që qeveria të bllokojë mekanizmat vendimmarrës në CEFTA. Kosova ende nuk ka krijuar një politikë humanitare dhe zhvillimore. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Zbatimin e zotimeve në kuadër të PV për Tregun e Përbashkët Rajonal 2021-2024;
- Ratifikimin dhe zbatimin e Protokollit Shtesë 5 të CEFTA-s për lehtësimin e tregtisë dhe Protokollit Shtesë 6 për tregtinë e shërbimeve; dhe kryerjen e negociatave dhe miratimin e Protokollit Shtesë 7 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- Miratimin e rregullores për themelimin e Pikës së Hetimit për Lehtësimin e Tregtisë;
- Fillimin e procesit për krijimin e një politike zhvillimi dhe ndihme humanitare.

Marrëveshjet dypalëshe me vendet e treta

Kosova ka një numër të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë me vendet e treta. Kosova ka arritur marrëveshje për partneritet tregtar dhe bashkëpunim me Mbretërinë e Bashkuar dhe takimi i parë i Këshillit të Partneritetit është mbajtur në dhjetor të vitit 2022.

Në qershor 2022, shtetet e EFTA dhe Kosova nisën zyrtarisht negociatat për tregtinë e lirë. Ndërmjet gushtit dhe dhjetorit 2022, pati dy raunde negociatash, me përparim të mirë në të gjitha fushat.

3.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS) dhe Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM) bazohen në akte ligjore, përfshirë marrëveshjeve ndërkombëtare ligjrisht të detyrueshme, dhe në dokumente politike. *Acquis* përbëhet nga deklaratat politike, vendime dhe marrëveshje. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë dialog politik në kuadër të PPJS-së, të lidhur me deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në veprimet e BE-së dhe të vendosin sanksione dhe masa kufizuese. Vendet aderuese duhet që në mënyrë progresive të harmonizojnë politikën e jashtme me deklaratat e BE-së dhe të vendosin sanksione dhe masa kufizuese, në rastet kur kërkohen ato.

Gjendja aktuale

Sipas MSA-së (neneve 5, 11 dhe 13), Kosova do të vazhdojë të harmonizojë politikën e saj të jashtme me masa të caktuara që burojnë nga PESM. Pjesë e obligimeve të MSA-së është edhe normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë, respektimi i parimeve të bashkëpunimit rajonal dhe bashkëpunimi efektiv me misionin e BE-së gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij. Duke zbatuar në mënyrë unilaterale sanksionet dhe masat e tjera kufizuese të vendosura nga BE kundër Rusisë dhe Bjellorusisë pas sulmit ushtarak kundër Ukrainës, Republika e Kosovës ka dëshmuar zotimin e saj për përafrimin e politikës së saj të jashtme me PPJS të BE-së.

Dialogu me Serbinë

Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar ndaj dialogut të ndërmjetësuar nga BE për normalizimin e marrëdhënieve me Serbisë, me synim arritjen e arritjes së marrëveshjes përfundimtare gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme, për normalizim të marrëdhënieve me në qendër njohjen e ndërsjellë. Kosova vlerëson seriozisht rëndësinë e këtij dialogu për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë ndërmjet dy shteteve dhe në dobi të paqes dhe stabilitetit në rajon. *Raporti i KE-së për Kosovën – 2022* vlerëson se përkundër takimeve të rregullta mujore në nivel të kryenegociatorëve dhe një takimi të nivelit të lartë (në gusht 2022), nuk janë arritur përparime drejt marrëveshjes përfundimtare. Palët kanë arritur dakordim për Udhërrëfyesin për zbatimin e Marrëveshjeve për Energjinë, në qershor 2022, dhe për udhëtim të qytetarëve ndërmjet dy vendeve vetëm me letërnjoftime, në gusht 2022.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale: Ligjet kryesore në këtë kapitull, në harmoni me parimet dhe objektivat e BE-së, janë: Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes, Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Gjithashtu është në fuqi Ligji për Policinë Ushtarake në FSK, Ligji për Komisionerin Parlamentar për FSK-në (të miratuar më 2022) dhe Ligji për Klasifikimin dhe Verifikimin e Sigurisë së Informatave, Ligji për AKI-në, Ligji për Dërgimin e FSK-së Jashtë Vendit, Ligji për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe Ligji për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit. Dokumentet e politikave në këtë kapitull janë: Strategjia e Sigurisë, Strategjia e Mbrojtjes dhe Plani Gjithëpërfshirës i Transicionit të FSK-së. Institucionet përgjegjëse në këtë kapitull janë: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (përfshirë Shërbimin e Jashtëm), ZKM, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Harmonizimi i vazhdueshëm i Politikës së Jashtme të Republikës së Kosovës me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS) të BE-së;
- Trajnimi i shërbyesve civilë në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë;
- Zbatimi nga MPJD i PV për zhvillimin sa më efikas të dialogut politik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE-së;
- Intensifikimi i lobimit për anëtarësim në organizata shumëpalëshe rajonale e globale, në veçanti në BE, NATO, OSBE dhe OKB.

3.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar

Ky kapitull mbulon kontrollin e brendshëm të financave publike (KBFP) dhe auditimin e jashtëm (AJ), si dhe mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe të Euros nga falsifikimi. BE nuk ka shumë legjislacion specifik për KBFP dhe auditimin e jashtëm, por bazohen në praktika të mira dhe standarde ndërkombëtare. Në këtë fushë vendet aderuese gjithashtu adoptojnë standardet ndërkombëtare të KBFP dhe auditim të jashtëm të vendosura nga Organizata Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe praktikat e mira të BE-së.

Gjendja aktuale

Raporti i KE-së për Kosovën – 2023 vlerëson se Kosova ka arritur njëfarë nivel të përgatitjes në këtë fushë. Aty theksohet se Kosova ka bërë përparime të kufizuara gjatë kësaj periudhe duke miratuar Strategjinë e re të Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2022-2026 dhe PV. Por zbatimi i të dyjave duhet të përshpejtohet. Në anën tjetër theksohet se Kosova duhet të harmonizojë më tej legjislacionin për kontrollin brendshëm financiar publik (KBFP) me praktikat më të mira të BE-së. Më tej Raporti prioritetizon zbatimin e llogaridhënies menaxheriale, përfshirë delegimin e përgjegjësisë vendim-marrëse; (ii) adresimin e masave efektive për kontroll të brendshëm; dhe (iii) përcjelljen sistematike të rekomandimeve të auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Gjithashtu theksohet se mbikëqyrja parlamentare e menaxhimit të fondeve publike nuk është efektive. BE rekomandon që gjatë vitit 2024 Kosova të fokusohet në:

- Zbatimin efektiv të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2022-2026 dhe aktivitetet relevante me KBFP dhe auditimin e jashtëm;
- Zhvillimin dhe miratimin e Ligjit të ri për Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënie bazuar në praktikat më të mira të BE-së dhe të harmonizojë këtë ligj me atë të KBFP;

- Përmirësimin e llogaridhënies menaxheriale të shfrytëzuesve të buxhetit në nivelin qendror dhe lokal;
- Përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet ZKA-së dhe Kuvendit duke: (i) përmirësuar kontrollin parlamentar e zbatimit të buxhetit, dhe (ii) zbatuar dhe përcjellë vazhdimisht dhe efektivisht rekomandimet e auditorëve të ZKA-së.

Më tej, në konkluzionet e *NK të MSA për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika* janë identifikuar disa aspekte për t'u adresuar, përfshirë përmirësimin e llogaridhënies menaxheriale dhe shkallës së zbatimit të rekomandimeve, forcimin e kapaciteteve të performancës së njërive të auditimit të brendshëm, sigurimin e cilësisë, vazhdimin e zgjerimit të komiteteve e të auditimit (përfshirë në nivelin lokal) dhe kryerjen e një analize të hollësishme për të identifikuar organizatat që merren me MFP me rrezik të lartë (të cilat mund të kenë nevojë për menaxhimin e rrezikut të detyrueshëm si funksion në organizatën buxhetore). Në kuadër të auditimit të jashtëm kërkohet plotësim-ndryshimi i Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, duke hequr detyrimin për kryerjen e auditimeve të rregullsisë çdo vit në të gjitha organizatat buxhetore, dhe fillimi i zbatimit të qasjes së auditimit të bazuar në rrezik. Raporti gjithashtu nënvizon nevojën që organizatat buxhetore të vazhdojnë monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve të AJ dhe të sigurohen resurset e nevojshme për këtë, dhe inkurajon rritjen e numrit të auditimeve të performancës nga ZKA, me fokus në temat e interesit publik. Në fushën e mbrojtjes së interesit financiar të BE-së, rekomandohet përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit penal për luftimin e mashtrimit dhe ndërmarrja e hapave për krijimin e një shërbimi koordinues kundër mashtrimeve.

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Legjislacioni: Kosova ka në fuqi një kornizë legjislative gjithëpërfshirëse në fushën e kontrollit të brendshëm të financave publike, përfshirë ligjet, udhëzimet, dhe rregulloret. Kjo fushë është e rregulluar nga Ligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij. Ky ligj rregullon sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike, që përfshin menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm, si dhe harmonizimin e tyre me standardet ndërkombëtare për kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm. Legjislacioni në fuqi për kontrollin e brendshëm të financave publike përmban parimet e përgjithshme dhe i referohet standardeve të INTOSAI-t, Kornizës COSO dhe Standardeve të Institutit të Auditimit të Brendshëm. Në këtë kapitull zbatohen edhe këto ligje: Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, ligjet për buxhetin vjetor të shtetit, Ligji për Prokurimin Publik, Ligji për Ndërmarrjet Publike; Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Ligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe ZKA-në, Ligji për Qasje në Dokumente Publike. Sa i përket mbrojtjes së Euros kundër falsifikimit, zbatohet UA i BQK-së mbi Shmangien e Kartëmonedhave dhe Monedhave Euro të Falsifikuara nga Qarkullimi, i cili zbatohet për të gjitha institucionet financiare të licencuar nga BQK që operojnë në Kosovë. BQK gjithashtu ka lëshuar dokumentin "Këshilla të Vlefshme për Operuesit me Para të Gatshme" me udhëzime për trajtimin e parave të dyshuara si të falsifikuara.

Politikat: dokumenti bazë në këtë kapitull është Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2022-2026 dhe PV për zbatimin e saj. ZKA ka zhvilluar Planin e ri Strategjik 2023-2026, për zbatimin e të cilit harton plane vjetore operacionale dhe plane vjetore të auditimit, si dhe plane vjetore të trajnimit dhe zhvillimit profesional. *Institucionet* përgjegjëse në këtë kapitull janë: MFPT, përgjegjëse për kontrollin e brendshëm; dhe Zyra Kombëtare e Auditimit, përgjegjëse për auditimin e jashtëm. Edhe organizatat buxhetore kanë përgjegjësi në këtë fushë, përmes njërive të auditimit të brendshëm, komiteteve të auditimit dhe strukturës së llogaridhënies menaxheriale.

Objektivat prioritarë afatmesme:

Kontrolli i brendshëm i financave publike:

- Zbatimi i Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike, pjesës për kontrollin e brendshëm të financave publike;
- Përgatitja dhe dërgimi i shkresës zyrtare SSP për themelimin e Komiteteve të Auditimit aty ku mungojnë;

- Finalizimi UA për certifikimin e auditorëve të brendshëm në sektorin publik;

Auditimi i jashtëm:

- Rishikimi i Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe ZKA-në, për të vendosur qasjen e auditimit të bazuar në rrezik në vend të auditimeve periodike të rregullsisë;
- Zhvillimi i mëtejshëm profesional për të rritur gradualisht auditimet e performancës, me fokus në temat me interes publik;
- Përcjellja më sistematike e zbatimit në kohë të rekomandimeve të auditimit të jashtëm;
- Vazhdimi i hartimit të Raportit Vjetor të Auditimit në kohë, me cilësi më të mirë dhe rekomandime efektive, me ndikim në përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike;
- Zhvillimi i mëtejshëm i auditimeve të TI-së;
- Përmirësimi i cilësisë së auditimeve të detyrueshme të rregullsisë e atyre jo-statutore të performancës përmes rritjes së kontrollit të cilësisë për fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit;
- Përbushja e misionit kushtetues e ligjor përmes auditimeve në përputhje me Kornizën e INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale të Auditimit;
- Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale në mbështetje të auditimit dhe qeverisjes korporative;
- Zhvillimi e ruajtja e marrëdhënieve me palët e jashtme, duke promovuar auditimin, rritur ndikimin dhe u integruar në organizata globale e rajonale për standardet e ndërkombëtare të auditimit.

3.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore

Ky kapitull mbulon rregullat lidhur me burimet financiare vetanake të buxhetit të BE-së, të cilat përbëhen kryesisht nga kontributet e shteteve anëtare, bazuar në burimet e veta tradicionale nga dogana dhe taksat bujqësore dhe të sheqerit, si dhe burime të bazuara në TVSh dhe në nivelin e të ardhurave kombëtare bruto. Shtetet anëtare duhet të kenë kapacitete administrative për të koordinuar në mënyrë adekuate dhe për të siguruar llogaritjen e saktë, mbledhjen, pagesën dhe kontrollin e burimeve të veta. *Acquis* në këtë kapitull është drejtpërdrejt e detyrueshme dhe nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar.

Korniza legjislative dhe ajo institucionale

Legjislacioni: aktet kryesore në këtë kapitull janë: Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji për Buxhetin 2022, Ligji nr. 05/L-037 për TVSh-në dhe UA MF-nr. 03/2015 për zbatimin e tij, Kodi Doganor dhe i Akcizave dhe UA MF-nr. 05/2014 për plotësim-ndryshimin e UA nr. 11/2009 për zbatimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, plotësuar-ndryshuar me UA nr. 05/2010 dhe me UA nr. 06/2013. TVSh ngarkohet me normën standarde prej tetëmbëdhjetë për qind (18%), ndërsa norma e reduktuar në llogaritjet dhe paguhet prej 8% për disa mallra dhe shërbime bazike, si dhe importit të tyre. Procedurat e mbledhjes dhe kontrollit për detyrimet doganore dhe taksat e importit kryhen nga Dogana e Kosovës. Kodi Doganor e i Akcizave është pjesërisht në harmoni me Kodin Doganor të BE-se, përkatësisht me Rregulloren e Këshillit (KEE) 2913/92 për Themelimin e Kodit Doganor të Komunitetit.

Institucioni kryesor në këtë kapitull është Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe agjencitë e saj, Dogana dhe Administrata Tatimore, si struktura kontribuuese.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve si bazë për zhvillimin e projeksioneve buxhetore vjetore;
- Konsolidimi i kornizës ligjore për menaxhimin e financave publike.

3.34. Kapitulli 34: Institucionet

Ky kapitull nuk mbulohet nga ky program në këtë fazë të aderimit në BE.

3.35. Kapitulli 35: Çështjet e tjera

Ky kapitull nuk mbulohet nga ky program në këtë fazë të aderimit në BE.

Shtojcë: Projektet aktuale mbështetëse relevante për zbatimin e PKIE 2024-2028¹⁷

Titulli	Fushëveprimi	Institucionet kryesore përfituese	Burimi/et e financimit dhe shuma/t	Zbatohet deri në:
0. Projektet horizontale				
<i>Programi për Qeverisje – komponenti për integrim evropian (proceset e reformave për integrim në BE)</i>	Zbatimi i MSA-së	ZKM, IL	Burimi: Qeveria e Gjermanisë Shuma: €5,000,000	2024
I. BLOKU I: KRITERET POLITIKE				
1.1. DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT				
1.1.2. Administrata publike				
<i>Projekti për decentralizim dhe përkrahje Komunave</i>	Vetëqeverisja lokale	MAPL	Burimi: Qeveria e Kosovës, BE, Qeveria e Suedisë, Qeveria e Zvicrës, Qeveria e Norvegjisë Shuma: €25,950,000	2025
III. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË				
3.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe mediat				
<i>Rritja e konkurrencës së sektorit të TIK-ut (IPA 2017)</i>	Shoqëria e informacionit	ME	Burimi: BE Shuma: €3,000,000	2024
<i>Projekti: Granti CED Operacional Kosova</i>	Mediat	MKRS	Burimi: BE dhe Qeveria e Kosovës Shuma: €205,280 (BE – €128,300, Qeveria e Kosovës – €76,980)	2024
3.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural				
<i>Mbështetje për përmirësimin dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes</i>	Bujqësia	MBPZHR	Burimi: BE Shuma: €10,000,000	2025
<i>Asistencë teknike për zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe operacionale lidhur me vreshtat dhe kantinat e verës</i>	Bujqësia	MBPZHR	Burimi: BE Shuma: €800,000	2025
<i>Mbështetje për përmirësimin e aranzhimeve të zbatimit dhe performancës së politikës agrorurale të Kosovës</i>	Bujqësia	MBPZHR	Burimi: BE Shuma: €7,000,000	2025
<i>Mbështetje për arritjen e një sektori të qëndrueshëm fitosanitar të përafuar gradualisht me standardet organizative, institucionale dhe rregullatore të BE-së</i>	Bujqësia	MBPZHR	Burimi: BE Shuma: €2,200,000	2025
3.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit				
<i>Rehabilitimi gjeneral i Linjës Hekurudhore X (kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut)</i>	Transporti	Hekurudhat e Kosovës /Infrakos Sh.A.	Burimi: WBIF, BERZH dhe BEI Shuma: €134,086,076	2024
3.15. Kapitulli 15: Energjia				
<i>Dekomisionimi i TC Kosova A</i>	Energjia dhe mjedisi	KEK	Burimi: BE/WBIF Shuma: €50,000,000	Vazhdon
<i>Zhvillimi i sektorit të energjisë VII – Përmirësimi i rrjetit të transmetimit</i>	Energjia	KOSTT	Burimi: KfW Shuma: €25,000,000 (kredi)	2027
<i>Ngruhja Qendrore Solare</i>	Energjia	Termokos	Burimi: KfW BERZh, BE/WBIF Shuma: €80,500,000	2030
<i>Eficienca në ndërtesat publike në Prishtinë</i>	Energjia	Komuna e Prishtinës	Burimi: BERZh Shuma: €5,350,000	2026
<i>Eficienca në ndërtesat publike në Prizren</i>	Energjia	Komuna e Prizrenit	Burimi: BERZh Shuma: €5,350,000	2026
<i>Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ngruhjes qendrore në qytetin e Prishtinës</i>	Energjia	NP Termokos	Burimi: Qeveria e Gjermanisë, Qeveria e Luksemburgut, KfW, NP Termokos, Sh.A. Shuma: €20,600,000	2024
<i>Projekti për instalimin e matësve individual të energjisë – kursimi i energjisë për ngruhje në Prishtinë</i>	Energjia	NP Termokos	Burimi: Qeveria e ShBA-së (MCC), Komuna e Prishtinës dhe NP Termokos Sh.A. Shuma: €9,900,000	2024
<i>Projekti për dyfishimin e kapaciteteve për prodhimin e energjisë termike nga 140 MË në 280 MË</i>	Energjia	NP Termokos	Burimi: BE, Komuna e Prishtinës dhe NP Termokos Sh.A. Shuma: €50,000,000	2028
<i>Bashkëpunimi i sektorit qeveri-me-qeveri me Agjencinë Daneze të Energjisë</i>	Energjia	ME	Burimi: Qeveria e Danimarkës Shuma: €2,500,000	2027
<i>Ekipi ekonomik i Gjermanisë në Kosovë</i>	Energjia	ME	Burimi: Qeveria e Gjermanisë Shuma: €112,348	2024
<i>Programi kompakt</i>	Energjia	ME	Burimi: Qeveria e ShBA-së/MCC Shuma: \$236,000,000	2029
<i>Përmirësimi mjedisor në TC Kosova B (instalimi i elektro-filtrave dhe pajisjeve për zvogëlimin e deNox) (IPA 2019)</i>	Energjia	KEK	Burimi: BE Shuma: €77,000,000	Vazhdon

¹⁷ Kjo listë e projekteve aktuale relevante të financuara nga BE dhe partnerët e tjerë zhvillimorë është hartuar bazuar në kontributet e institucioneve të linjës, dhe mund të mos i përfshijë të gjitha projektet aktuale relevante për fushat e politikave publike në kuadër të këtij programi.

<i>Solar4 Kosovo – Impianti fotovoltaik në KEK</i>	Energjia	KEK	Burimi: BE/WBIF Shuma: €100,000,000	Vazhdon
<i>Projekti i Kosovës për Energji (KEP 2)</i>	Energjia	MMPHI	Burimi: Qeveria e Gjermanisë Shuma: €150,000	2026
3.19. Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi				
<i>Projekti: EYE - Rritja e punësimit të rinjve (Faza 3)</i>	Punësimi; Arsimi dhe aftësimi profesional	MASHTI, APRK	Burimi: Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria e Kosovës Shuma: €4,776,980 (€4,700,000 + €76,980)	2024
<i>Projekti: ALLED2- Harmonizimi i edukimit dhe trajnimit me nevojat e tregut të punës</i>	Punësimi; Arsimi	MASHTI, MFPT, APRK, AKK, AKA, universitetet publike	Burimi: BE dhe Qeveria e Austrisë Shuma: €4,500,000 (€3,800,000 + €700,000)	2024
<i>Aktiviteti për zhvillimin e fuqisë punëtore përmes sektorit privat</i>	Punësimi; Arsimi dhe aftësimi profesional	MASHTI, MINT, ME, MBPZHR	Burimi: Qeveria e ShBA-së Shuma: \$10,000,000	2027
<i>Aftësimi për punësim</i>	Punësimi; Arsimi dhe aftësimi profesional	MASHTI, MFPT, APRK	Burimi: Qeveria e Gjermanisë Shuma: €7,200,000	2024
<i>Zhvillimi ekonomik për stabilizimin e tregut të punës</i>	Punësimi, zhvillimi rural dhe bujqësor	MINT, MBPZHR	Burimi: Qeveria e Gjermanisë Shuma: €6,000,000	2024
<i>Projekti për rritjen e punësimit</i>	Punësimi	MFPT, MFPT/APRK	Burimi: Qeveria e Zvicrës dhe Fondacioni Medicor Shuma: €2,000,000	2024
<i>Projekti për Fondin e Sfidave të Kosovës – Arsimi Profesional dhe Trajnimi</i>	Punësimi; Arsimi dhe aftësimi profesional	MASHTI	Burimi: KfW Shuma: €7,000,000	2025
<i>Aktiviteti për zhvillimin e fuqisë punëtore përmes sektorit privat</i>	Punësimi; Arsimi dhe aftësimi profesional	MASHTI, MINT, ME, MBPZHR	Burimi: Qeveria e ShBA-së/USAID Shuma: €10,000	2027
3.20. Kapitulli 20: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë				
<i>Projekti Promovimi i punësimit në sektorin Privat (PPSE)</i>	NVM-të, turizmi	MINT	Burimi: Qeveria e Zvicrës Shuma: CHF 5,500,000	2025
<i>Projekti Fondi për inovacion dhe ndërmarrësi C.V.-ENIF</i>	NVM-të	MINT	Burimi: BE (ENIF, EIF), BERZ, KfW Shuma: €40,000,000	2025
<i>Mbështetja e digjitalizimit të bizneseve përmes TIK-ut (IPA 2019)</i>	NVM-të	ME	Burimi: BE Shuma: €4,000,000	2024
3.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore				
<i>Qasja e barabartë në drejtësi</i>	Sistemi i drejtësisë	ANJF	Burimi: Qeveria e Gjermanisë Shuma: €49,014	Vazhdon
<i>Mbrojtja e fëmijëve të cenueshëm në Kosovë 2022-2024</i>	Të drejtat themelore	ZKM, MD/ShSK	Burimi: UNICEF Shuma: €2,500,000	2024
<i>Revitalizimi i Rrugës Marin Barleti dhe i Kinemasë Lumbardhi në Prizren (IPA II)</i>	Trashëgimia kulturore	MKRS	Burimi: BE dhe Qeveria e Kosovës Shuma: €3,400,000 (€2,000,000 + €1,400,000)	Vazhdon
<i>Trashëgimia kulturore si shtytëse e dialogut ndërmjet komuniteteve dhe kohezionit</i>	Trashëgimia kulturore	MKRS	Burimi: BE dhe Qeveria e Kosovës Shuma €2,369,654 (€2,000,000 + €369,654)	Vazhdon
<i>Trashëgimia kulturore si shtytëse e ringjalljes ekonomike të Janjevës (IPA II)</i>	Trashëgimia kulturore	MKRS	Burimi BE dhe Qeveria e Kosovës Shuma: €3,400,000 (€2,000,000 + €1,400,000)	Vazhdon
<i>Programi për zhvillim përfshirës</i>	Trashëgimia kulturore	MKRS	Burimi: UNHABITAT dhe Qeveria e Kosovës €638,662 (€172,890 + €465,772)	Vazhdon
3.24. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria				
<i>Mbështetje për punët e brendshme</i>	Punët e brendshme	MPB	Burimi: BE Shuma: €6,500,000	2026
3.26. Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura				
<i>Arsimi, punësimi dhe politikat sociale (IPA 2017)</i>	Arsimi	Institucionet e arsimit parauniversitar, Komunat, MASHTI	Burimi: BE Shuma: €7,000,000	2024
<i>Arsimi, punësimi dhe politikat sociale – arsimit prauniversitar (IPA 2018)</i>	Arsimi	Institucionet e arsimit parauniversitar, Komunat, MASHTI	Burimi: BE Shuma: €5,400,000	2024
<i>Përkrahje për arsimin në Kosovë (IPA II 2018)</i>	Arsimi	MASHTI, Komunat	Burimi: BE Shuma: €3,000,000	2025
<i>Vlerësimi i fizibilitetit dhe nevojave për institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë</i>	Arsimi	MASHTI	Burimi: BEI Shuma: €1,500,000	2024
<i>Përkrahje për arsimin në Kosovë (IPA 2016)</i>	Arsimi	MASHTI, Komunat, institucionet parashkollore	Burimi: BE dhe Qeveria e Kosovës Shuma: €7,000,000 (€5,000,000 + 2,000,000)	2024
<i>Zgjerimi i shërbimeve të integruara të kujdesit dhe zhvillimit gjatë fëmijërisë së hershme me bazë në komunitet në Kosovë</i>	Arsimi	MASHTI	Burimi: Save the Children Italia Shuma: €418,000	2024

Përmirësimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe punësimit për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në komuna të synuara në Kosovë	Arsimi	MASHTI, Komunat	Burimi: UNICEF Shuma: €519,265	2024
Mbështetje për qasje të vazhdueshme dhe vijimin e shkollës në 15 komuna në Kosovë	Arsimi	Komunat	Burimi: UNICEF Shuma: €145,826	2024
Forcimi i autonomisë universitare dhe rritja e llogaridhënies dhe transparencës së Universiteteve të Ballkanit Perëndimor (STAND)	Arsimi	MASHTI	Burimi: BE (Programi ERASMUS+) Shuma: €999,371	2024
Grant operacional për Programin Evropa Kreative	Diplomacia kulturore	MKRS		
3.27. Kapitulli 27: Mjedisi				
EU4Green: Mbështetje për zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (IPA II)	Mjedisi	MMPHI, MBPZHR, ME	Burimi: BE, Qeveria e Austrisë Shuma: €11,000,000 (€10,000,000 + €1,000,000)	2025
Projekti i zhvillimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Mitrovicë	Mjedisi	Komuna e Mitrovicës	Burimi: BERZh, BEI Shuma: €48,800,000	2025
Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza në TC Kosova B (IPA 2021)	Mjedisi	KEK	Burimi: BE Shuma: €8,000,000	Vazhdon
Mbështetja e BE-së për ajrin e pastër (dizajni për reduktimin e dyoksidit të squfurit (SO2) (IPA 2021)	Mjedisi	KEK	Burimi: BE Shuma: €2,000,000	Vazhdon
Menaxhimi i integruar i resurseve ujore në Kosovë	Mbrojtja e ujërave	MMPHI	Burimi: Qeveria e Zvicrës Shuma: €24,000,000	2031
Menaxhimi i integruar i resurseve ujore në Kosovë – Faza 1	Mbrojtja e ujërave	MMPHI	Burimi: Qeveria e Zvicrës Shuma: CHF 7,700,000	2027
Zhvillimi i sistemit të trajtimit të ujërave të zeza në Prishtinë	Mbrojtja e ujërave	KRU Prishtina	Burimi: KfW, BE Shuma: €48,800,000	2035
Zhvillimi i ujërave të zeza në Gjilan	Mbrojtja e ujërave	Komuna e Gjilanit	Burimi: BERZh, BEI, BE/WBIF Shuma: €23,500,000	2027
Nxjtja dhe lërimi i mundësive për sigurinë e ujit	Mbrojtja e ujërave	MMPHI, ME, KRU Hidromorava	Burimi: Banka Botërore Shuma: €25,100,000 (kredi)	2025
Sistemi i kanalizimit dhe ujërat e shiut në Prishtinë (IPA 2021)	Mbrojtja e ujërave	KRU Prishtina	Burimi: BE Shuma: €20,000,000	Vazhdon
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Gjakovë	Mbrojtja e ujërave	KRU Gjakova	Burimi: KfW, Qeveria e Kosovës, Qeveria e Zvicrës, Komuna e Gjakovës Shuma: €16,800,000	Vazhdon
Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve si dhe mbrojtja e burimeve ujore të KRU Gjakova	Mbrojtja e ujërave	KRU Gjakova	Burimi: BE/WBIF Shuma: €904,500	Vazhdon
Projekti për trajtimin e ujërave të zeza Prishtinë	Mbrojtja e ujërave	KRU Prishtina	Burimi: Qeveria e Francës Shuma: €66,000,000 (kredi)	Vazhdon
Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Gjilan	Mbrojtja e ujërave	KRU Hidro-Morava ShA	Burimi: BERZh, BEI Shuma: €23,558,965 (kredi)	2025
Diga e Firajës	Mbrojtja e ujërave	MMPHI, ME, KRU Ibër Lepenc, KRU Prishtina, KRU Hidromorava, KRU Bifurkacioni	Burimi: BE/WBIF Shuma: €1,800,000	2024
Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës – Faza II	Mbrojtja e ajrit	MMPHI, Komunat	Burimi: Qeveria e Japonisë Shuma: €2,800,000	2026
Programi për menaxhimin e mbeturinave të ngurta II – IV	Menaxhimi i mbeturinave	Kompania për Menaxhimin e Deponive	Burimi: KfW dhe BE Shuma: €20,000,000	2035
Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për mjedisin dhe zhvillimin ekonomik	Pylltaria	MBPZHR	Burimi: Qeveria e Suedisë Shuma: €3,359,995	2026
PËRSHTATJA – Zgjidhje të bazuara në natyrë për komunitetet e qëndrueshme të Ballkanit Perëndimor	Mbrojtja civile	MMPHI, MPB/AME, MBPZHR	Burimi: Qeveria e Suedisë Shuma: €2,480,202	2026
3.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit				
Projekti KSV/017: Programi për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë (Faza II)''	Shëndetësia	MSh, shoqatat e profesionistëve të shëndetësisë	Burimi: Qeveria e Luksemburgut Shuma: €17,350,000	2025

MATRICA E MASAVE AFATSHKURTA

MASAT LEGJISLATIVE

Nr.	Dispozitat e MSA-së	Aktet kombëtarë që do të harmonizohen	Aktet e acquis-së së BE-së që do të transpozohen	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Afatet kohore	Niveli i harmonizimit	Buxheti (në euro)		
								BRK	Donatorët	Gjithsej
1. BLOKU I: KRITERET POLITIKE										
1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit										
1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor										
1.1.1.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
1.1.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.1.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
1.1.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.2. Administrata publike										
1.1.2.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
1.1.2.1.	Neni 120	Projektligji për plotësim-ndryshim të ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimi i tyre me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, faza e tretë, i miratuar		MPB		K4 2024		500	0	500
1.1.2.2.	Neni 120	Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, i miratuar		MPB		K4 2024		5,000	0	5,000
1.1.2.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
1.1.2.3.	Neni 120	Rregullorja për pranim në shërbimin civil, e miratuar		MPB		K4 2024		5,000	0	5,000
1.1.2.4.	Neni 120	Rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil, e miratuar		MPB		K4 2024		5,000	0	5,000
1.1.2.5.	Neni 120	Rregullorja për transferimin në shërbimin civil, e miratuar		MPB		K4 2024		5,000	0	5,000
1.1.2.6.	Neni 120	UA për zbatimin e Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i miratuar		MAPL		K4 2024		10,440	3,500	13,940
1.1.2.7.	Neni 120	UA për zbatimin e Ligjit për Shqyrtim Administrativ të Akteve, i miratuar		MAPL		K4 2024		10,440	3,500	13,940
1.1.3. Avokati i Popullit										
1.1.3.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
1.1.3.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.3.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
1.1.3.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë										
1.1.4.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
1.1.4.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.4.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									

1.1.4.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare										
1.2.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
1.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.2.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
1.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
2. BLOKU II: KRITERET EKONOMIKE										
2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut										
2.1.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
2.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
2.1.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
2.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit										
2.2.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
2.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
2.2.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
2.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE - PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË										
3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së										
3.0.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.0.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.0.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.0.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave										
3.1.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.1.1.	Nenet 20, 80 dhe 74 pika 3	Projektligji për inspektimin e përputhshmërisë së produkteve, i miratuar	Rregullorja (BE) 2019/1020	MINT		K4 2024	P	4,000	0	4,000
3.1.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.1.2.	Nenet 20, 80 dhe 74 pika 3	UA për detyrimet e prodhuesve dhe shpërndarësve për njoftim, i miratuar		MINT		K4 2024		1,000	0	1,000
3.1.3.	Nenet 20, 80 dhe 74 pika 3	UA për shkëmbimin e informacionit për produktet e rrezikshme në Republikën e Kosovës, i miratuar		MINT		K3 2024		1,000	0	1,000
3.1.4.	Neni 20	UA për përcaktimin e rregullave për lëvizjen e lirë në treg të detergjenteve dhe substancave tension-aktive (surfaktantive), i miratuar	Rregullorja (KE) nr. 1272/2008, CLP, për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave e përzierjeve kimike që lëshohen në tregun e BE-së Rregullorja (KE) nr. 1907/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 18 dhjetor 2006, lidhur me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH), që krijon një Agjenci Evropiane të Kimikateve, që ndryshon Direktivën 1999/45/KE dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 793/93 dhe Rregulloren e Komisionit 2000/21/KE	MMPHI	ZKM MINT AUV MSH	K4 2024	P	18,900	0	18,900
3.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punonjësve										

3.2.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.2.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.3. Kapitulli 3: E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve										
3.3.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.3.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.3.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.3.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit										
3.4.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.4.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.4.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.4.1.	Neni 89	UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzues për zbatimin e sanksioneve nga subjektet raportuese dhe personat që kanë detyrime për raportim të drejtpërdrejtë), i miratuar	Rregullore e Këshillit (KE) nr. 580/2001 e 27 dhjetorit 2001 mbi masat specifike kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara me qëllim luftimin e terrorizmit Direktiva e BE 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 maj 2015, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, dhe që shfuqizon Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/KE	MFPT	MPJD BQK	K3 2024	P	13,485	16,000	29,485
3.4.2.	Neni 89	UA për sanksionet e shënjestruara (udhëzues për zbatimin e sanksioneve ndaj autoriteteve shtetërore), i miratuar	Rregullore e Këshillit (KE) nr. 2580/2001 të 27 dhjetorit 2001 mbi masat specifike kufizuese të drejtuara kundër personave dhe subjekteve të caktuara me qëllim luftimin e terrorizmit Direktiva e BE 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 maj 2015, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe që shfuqizon Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/KE	MFPT	MPB MINT ZKM	K3 2024	P	19,885	16,000	35,885
3.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik										
3.5.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									

3.5.1.	Neni 79	Projektligji për prokurimin publik (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 2014/24/BE për prokurimin në sektorin klasik Direktiva 2014/25/BE për shërbime/utilitete Direktiva 2009/81/KE Direktiva e Këshillit 89/665/KEE Direktiva e Këshillit 92/13/KEE	MFPT	KRrPP OShP MFPT/AQP	K2 2024	P	2,685	0	2,685
3.5.2.	Neni 79	Projektligji për partneritetin publiko-privat (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 2014/23/BE	MFPT		K2 2024	P	2,300	0	2,300
3.5.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.5.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.6. Kapitulli 6: E drejta e kompanive										
3.6.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.6.1.	Neni 51	Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (plotësim-ndryshim), i miratuar	Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, të Komitetit Ndërkombëtar të Interpretimeve për Raportim Financiar (KNIRP), si dhe interpretimet e lëshuara dhe të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe udhëzimet përkatëse të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS)	MFPT	KKRF	K4 2024	P	3,500	0	3,500
3.6.2.	Neni 51	Projektligji për shoqëritë tregtare, i miratuar	Direktiva (BE) 2017/1132 Direktiva (BE) 2017/828 Direktiva (BE) 2019/1151 Direktiva 2019/2121 Direktiva (KE) 2004/109 Direktiva (BE) 2013/50	MINT		K4 2024	P	6,000	0	6,000
3.6.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.6.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale										
3.7.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.7.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.7.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.7.1.	Nenet 77 - 78	Rregullorja për procedura, kriteret e licencimit të shoqatave për menaxhim kolektiv dhe funksionimin e tyre, e miratuar	Direktiva 2014/26/BE për menaxhimin kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqësuara dhe licencimin shumë-territorial të të drejtave në veprat muzikore për përdorim online në tregun e brendshëm	MKRS		K1 2024	P	2,000	3,000	5,000
3.8. Kapitulli 8: Politikat e konkurrencës										
3.8.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.8.	Konkurrenca									
3.8.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.8.	Ndihma shtetërore									

3.8.1.	Neni 74	Projektligji për ndihmën shtetërore (plotësim-ndryshim), i miratuar	Rregullorja e Këshillit (BE) 2015/1589 e datës 13 korrik 2015 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e nenit 108 të Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian Rregullorja (BE) 2015/1588, datë 13 korrik 2015, për zbatimin e neneve 107 dhe 108 të TFBE	MFPT	ZKM	K2 2024	P	18,700	0	18,700
3.8.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.8.	Konkurrenca									
3.8.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.8.	Ndihma shtetërore									
3.8.2.	Neni 74	Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës horizontale, e miratuar	Rregullorja e KE nr. 1588/2015 Rregullorja e KE nr. 651/2014	MFPT		K4 2024	P	33,800	0	33,800
3.8.3.	Neni 74	Rregullorja për procedurat dhe format e njoftimit (plotësim-ndryshim), e miratuar	Rregullorja e Këshillit (BE) 2015/1589 e datës 13 korrik 2015 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e nenit 108 të Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 794/2004, e 21 prillit 2004, që zbaton Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 659/1999 që definojnë rregullat detale për aplikimin e Nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian	MFPT		K4 2024	P	33,600	0	33,600
3.8.4.	Neni 74	Rregullorja për kushtet e dhënies së ndihmës sektoriale, e miratuar	Rregullorja e KE nr. 1588/2015 Rregullorja e KE nr. 651/2014 Rregullorja (BE) 2021/1237 e 23 korrikut 2021 Rregullorja (BE) 2023/1315 e 23 korrikut 2023 Komunikata nga Udhëzimet e Komisionit për ndihmën shtetërore për rjetet brezgjere 2023/KE 36/01	MFPT		K4 2024	P	77,400	0	77,400
3.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare										
3.9.	<u>Legjislati i kornizës</u>									
3.9.1.	Neni 96	Projektligji për bankat, i miratuar		MFPT	BQK	K4 2024		10,400	0	10,400
3.9.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.9.2.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit (ILAAP), e miratuar	Direktiva e BE-së 2013/36/BE	BQK		K4 2024	P	3,750	0	3,750
3.9.3.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja e rishikuar për ekspozimet e mëdha të bankave, e miratuar	Direktiva 2013/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 qershor 2013, për qasjen në veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe firmave të investimeve, që ndryshon Direktivën 2002/87/KE dhe shfuqizon Direktivat 2006/48 /KE dhe 2006/49/KE	BQK		K4 2024	P	3,750	0	3,750

			Rregullorja (BE) 2019/876 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 20 maj 2019, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 575/2013 në lidhje me raportin e levës, raportin neto të qëndrueshëm të financimit, kërkesat për fondet e veta dhe detyrimet e pranueshme, rreziku i kreditë së palës tjetër, rreziku i tregut, ekspozimet ndaj palëve qendrore, ekspozimet ndaj sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ekspozimet e mëdha, kërkesat për raportim dhe zbulim Rregullorja (BE) 648/2012 Rregullorja (BE) nr. 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 26 qershorit 2013 mbi kërkesat e kujdesshme për institucionet e kreditit dhe firmat e investimeve dhe ndryshimin e Rregullores (BE) nr. 648/2012							
3.9.4.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të sigurve, e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK		K4 2024	P	2,750	0	2,750
3.9.5.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për menaxhimin e rrezikut operacional të sigurve, e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK		K4 2024	P	3,200	0	3,200
3.9.6.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për persona të ndërlidhur me siguresit, e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK		K4 2024	P	3,230	0	3,230
3.9.7.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për kërkesat e mbajtjes së rrezikut dhe mbulimit përmes risigurimit, e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK		K4 2024	P	3,370	0	3,370
3.9.8.	Nenet 50, 96 aneksi 6	Rregullorja për qeverisjen korporatave të sigurve (rishikim), e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK		K4 2024	P	2,750	0	2,750
3.9.9.	Nenet 50, 96 aneksi 7	Rregullorja për sisteme të informacionit për siguresit, e miratuar	Direktiva Evropiane 2002/92/KE Parimet Kyçe të Sigurimeve (ICP)	BQK		K4 2024	P	3,820	0	3,820
3.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe mediat										
3.10.	<u>Legjislati kornizë</u>									
3.10.1.	Neni 110 dhe 111	Projektligji për komunikimet elektronike, i miratuar	Direktiva (BE) 2018/1972 për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike	ME	Kuvendi ARKEP KPM ZKM	K4 2024	T	17,730	8,000	25,730
3.10.	<u>Aktet nënllogore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.10.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural										
3.11.	<u>Legjislati kornizë</u>									

3.11.1.	Neni 102	Projektligji për agroturizëm, i miratuar	Rregullorja (BE) nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian	MBPZHR	MINT ZKM MFPT MMPHI MKRS	K4 2024	P	14,067	0	14,067
3.11.2.	Neni 102	Projektligji për tokën bujqësore, i miratuar	Karta Evropiane për Planifikim Hapësinor, e miratuar në Konferencën e 6-të e Ministrave Evropianë përgjegjës për Planifikimin Rajonal të mbajtur në Torremolinos në maj të vitit 1983 dhe miratuar nga Këshilli i Evropës dhe Perspektiva Evropiane për Planifikim Hapësinor (1999)	MBPZHR	MMPHI	K2 2024	P	9,378	0	9,378
3.11.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.11.3.	Neni 102	UA për sistemin e informacionit për çmimet e tregut, i miratuar	Rregullorja (BE) nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, për mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillim Rural (FBEZHR) dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1698/2005 Rregullorja (BE) nr. 1306/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, për financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 352/78, (KE) nr. 165/94, (KE) nr. 2799/98, (KE), nr. 814/2000, (KE) nr. 1290/2005 dhe (KE) nr. 485/2008 Rregullorja (BE) nr. 1307/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, që përcakton rregullat për pagesat direkte për fermerët sipas skemave të mbështetjes në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 637/2008 dhe Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 73/2009 Rregullorja (BE) nr. 1308/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, që themelon organizatën e përbashkët të tregjeve në produktet bujqësore dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 922/72, (KEE) nr. 234/79, (KE) nr. 1037/2001 dhe (KE) nr. 1234/2007 Rregullorja zbatuese e Komisionit (EE) nr. 447/2014, e datës 2 maj 2014, për rregullat specifike për zbatimin e Rregulores (BE) nr. 231/2014	MBPZHR	ASK	K1 2024	P	3,126	0	3,126

			<p>Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II) Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 21/2004, e datës 17 dhjetor 2003, që krijon sistemin për identifikimin dhe regjistrimin e dheneve dhe dhive dhe që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1782/2003 si dhe Direktivën 92/102/KEE dhe Direktivën 64/432/KEE</p> <p>Rregullorja (BE) nr. 1144/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 22 tetor 2014, për masat e ofrimit dhe promovimit të informacionit në lidhje me produktet bujqësore të zbatuara në tregun e brendshëm dhe në vendet e treta dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 3/2008 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 834/2007 të datës 28 qershor 2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe që shfuqizon Rregulloren (KEE) nr. 2092/91</p> <p>Rregullorja (BE) nr. 1151/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 21 nëntor 2012, për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore</p> <p>Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1217/2009, e datës 30 nëntor 2009, për krijimin e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit mbi të ardhurat dhe operimin e biznesit të fermave bujqësore në Komunitetin Evropian</p>							
3.11.4.	Neni 102	UA për kontabilitetin në fermë, i miratuar	<p>Rregullorja (BE) nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, për mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillim Rural (FBEZHR) dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1698/2005</p> <p>Rregullorja (BE) nr. 1306/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, për financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 352/78, (KE) nr. 165/94, (KE)</p>	MBPZHR	ASK	K1 2024	P	3,126	0	3,126

nr. 2799/98, (KE) nr. 814/2000, (KE) nr. 1290/2005 dhe (KE) nr. 485/2008 Rregullorja (BE) nr. 1307/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, që përcakton rregullat për pagesat direkte për fermerët sipas skemave të mbështetjes në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 637/2008 dhe Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 73/2009 Rregullorja (BE) nr. 1308/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, që themelon organizatën e përbashkët të tregjeve në produktet bujqësore dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 922/72, (KEE) nr. 234/79, (KE) nr. 1037/2001 dhe (KE) nr. 1234/2007 Rregullorja zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014, të datës 2 maj 2014, për rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 231/2014 Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II) Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 21/2004 të datës 17 dhjetor 2003 që krijon sistemin për identifikimin dhe regjistrimin e dheneve dhe dhive dhe që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1782/2003 si dhe Direktivën 92/102/KEE dhe Direktivën 64/432/KEE Rregullorja (BE) nr. 1144/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 22 tetor 2014, për masat e ofrimit dhe promovimit të informacionit në lidhje me produktet bujqësore të zbatuara në tregun e brendshëm dhe në vendet e treta dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 3/2008 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 834/2007 të datës 28 qershor 2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe që shfuqizon Rregulloren (KEE) nr. 2092/91 Rregullorja (BE) nr. 1151/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 21 nëntor 2012, për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe

			produktet ushqimore Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1217/2009 të datës 30 nëntor 2009 për krijimin e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit mbi të ardhurat dhe operimin e biznesit të fermave bujqësore në Komunitetin Evropian							
3.11.5.	Neni 102	UA për kriteret dhe procedurat e zbatimit për masat e programit të zhvillimit rural, i miratuar	Rregullorja (BE) nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013, mbi mbështetjen për zhvillimin rural nga Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural (EAFRD) dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1698/2005	MBPZHR		K4 2024	P	9,378	0	9,378
3.12. Kapitulli 12: Politikat e sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë										
3.12.	<u>Legjislati i kornizës</u>									
3.12.1.	Neni 102	Projektligji për veterinarinë, i miratuar	Rregullorja (BE) nr. 2016/429 për sëmundjet e transmetueshme të kafshëve (Ligji për shëndetin e kafshëve)	MBPZHR	AUV	K2 2024	P	6,252	0	6,252
3.12.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.12.2.	Neni 102	UA për luftimin e sëmundjes infektive zoonotike-tërbbimi, i miratuar	Rregullorja (BE) nr. 2016/429 për sëmundjet e transmetueshme të kafshëve (Ligji për shëndetin e kafshëve)	AUV	MBPZHR	K4 2024	P	10,000	0	10,000
3.12.3.	Neni 102	UA për luftimin e sëmundjes zoonotike të shpezëve-gripi i shpezëve (avian influenza), i miratuar	Rregullorja (BE) nr. 2016/429 për sëmundjet e transmetueshme të kafshëve (Ligji për shëndetin e kafshëve)	AUV	MBPZHR	K4 2024	P	10,000	0	10,000
3.12.4.	Neni 102	UA për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, i miratuar	Rregullorja (BE) nr. 2016/429 për sëmundjet e transmetueshme të kafshëve (Ligji për shëndetin e kafshëve)	AUV	MBPZHR	K4 2024	P	10,000	0	10,000
3.12.5.	Neni 102	UA për kontrollin veterinar të importimit, kalimit tranzit të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore me origjinë shtazore, të kafshëve të gjalla dhe materialit për mbarëshkrimin e kafshëve, i miratuar	Rregullorja (BE) nr. 2016/429 për sëmundjet e transmetueshme të kafshëve (Ligji për shëndetin e kafshëve)	AUV	MBPZHR	K4 2024	P	10,000	0	10,000
3.13. Kapitulli 13: Peshkataria										
3.13.	<u>Legjislati i kornizës</u>									
3.13.1.	Neni 102	Projektligji për peshkatarinë dhe akua-kulturën, i miratuar	Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (BE) nr. 1380/2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit Rregullorja 1005/2008, datë 29 shtator 2008 për krijimin e një sistemi komunitar për parandalimin, parandalimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar	MBPZHR	AUV ZKM MFPT	K4 2024	P	18,756	0	18,756

			dhe të pa rregulluar, duke ndryshuar rregulloret (KEE) nr. 2847/93, (KE) nr. 1936/2001 dhe (KE) nr. 601/2004 dhe shfuqizimin e rregulloreve (KE) nr. 1093/94 dhe (KE) nr. 1447/1999 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 423/2004, e datë 26 shkurt 2004 Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1342/2008, e datës 18 dhjetor 2008 Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 1243/2012, e datës 19 dhjetor 2012, që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1342/2008 për krijimin e planit afatgjatë për rezervat e peshkimit Rregullorja (BE) 2016/2094 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 nëntorit 2016 që ndryshon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1342/2008 për krijimin e Planit afatgjatë për rezervave dhe peshkimit që shfrytëzojnë ato rezerva							
3.13.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.13.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit										
3.14.	<u>Legjisllacioni kornizë</u>									
3.14.1.	Neni 113	Projektligji për automjete, i miratuar	Direktiva nr. 2007/46/KE për vendosjen e kornizës për homologimin e automjeteve, rimorkiove, sistemeve dhe pjesëve përbërëse të veçanta teknike të dedikuara për automjete dhe plotësim ndryshimet e kësaj direktive Direktiva nr. 2014/45/BE për kontrollimin teknik periodik të automjeteve dhe mjeteve bashkëngjitëse Direktiva nr. 2014/46/KE për ndryshimin e direktivës nr. 1999/37/KE për dokumentacionin e regjistrimit të automjeteve Direktiva nr. 1999/37/BE për dokumentacion për regjistrimin e automjeteve Direktiva nr. 2014/47/BE për kontrollim teknik në rrugë të automjeteve komerciale. Direktiva nr. 20/18/858 /BE për homologim dhe mbikëqyrje	MMPHI		K4 2024	P	18,900	0	18,900
3.14.2.	Neni 113	Projektligji për patentë shofer, i miratuar	Direktiva 2006/126/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 20 dhjetor 2006, për patentë shofer Direktiva 2003/59/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 15 korrik	MMPHI		K4 2024	P	18,900	0	18,900

			<p>2003, për kualifikimin fillestar dhe aftësimin periodik të shoferëve të kategorive të caktuara të automjeteve për transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, për ndryshimin e Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 3820/85 dhe Direktivën e Këshillit 91/439/KEE dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 76/914/KEE Direktiva e Komisionit 2013/47/BE, datë 2 tetor 2013 për ndryshimin e Direktivës 2006/126/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për patentë shoferi Direktiva e Komisionit 2012/36/BE, të datës 19 nëntor 2012 për ndryshimin e Direktiva 2006/126/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për patentë shoferi Direktiva 2002/24/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 18 mars 2002, në lidhje me miratimin e tipit të mjeteve motorike me dy apo tri rrota dhe me shfuqizimin e Direktivës 92/61/KEE</p>							
3.14.3.	Neni 113	Projektligji për hekurudhat, i miratuar	<p>Direktiva 2016/2370/BE që ndryshon Direktivën 2012/34/BE, mbi krijimin e një zonë të vetme evropiane hekurudhore e cila ka për qëllim rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të transportit hekurudhor duke hequr pengesat e ndryshme dhe duke nxitur kështu performancën dhe konkurrencën e sektorit hekurudhor Direktiva 2007/59/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 23 Tetor 2007 mbi certifikimin e makinistëve që drejtojnë lokomotiva dhe trena në sistemin hekurudhor në Komunitet, OJ BE L 315, 3.12.2007 Rregullorja (BE) 2021/782 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 prill 2021, mbi të drejtat dhe detyrimet e pasagjerëve hekurudhor</p>	MMPHI	INFRAKOS ZKM MFPT	K4 2024	P	18,900	0	18,900
3.14.4.	Neni 113	Projektligji për transportin rrugor, i miratuar	<p>Direktiva nr. 1071/2009/KE për qasje në profesion të operatoreve të transportit rrugor Direktiva nr. 1072/2009/KE për rregullat e përbashkëta në qasje në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave</p>	MMPHI	ZKM MPB	K1 2024	P	4,725	0	4,725

			Direktiva nr. 1073/2009/KE për rregullat e përbashkëta për qasje në tregun ndërkombëtar për ekuipazhin e automjetit dhe shërbimet e transportit të udhëtarëve Rregullorja 2016/68 mbi procedurat dhe specifikimet e përbashkëta të nevojshme për ndërlidhjen e regjistrave elektronikë të kartave të shoferëve Rregullorja 165/2014 e BE e cila rregullon kohën e ngasjes dhe pushimit							
3.14.5.	Neni 113	Projektligji për transportin e mallrave të rrezikshme, i miratuar	Direktiva 2008/68/ KE mbi transportin e brendshëm të mallrave të rrezikshme Direktiva 95/50/KE për procedurat uniforme për kontrollet në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme Direktiva 2022/1999 KE për plotësimin dhe ndryshimin e Direktivës nr. 95/50 për procedurat uniforme për kontrollet në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme Marrëveshja Evropiane për transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme (ADR)	MMPHI	ZKM MFPT MINT	K4 2024	P	4,725	0	4,725
3.14.6.	Neni 113	Projektligji për siguri hekurudhore, i miratuar	Direktiva 2016/2370/BE që ndryshon Direktivën 2012/34/BE, Mbi krijimin e një zone të vetme evropiane hekurudhore e cila ka për qëllim rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të transportit hekurudhor duke hequr pengesat e ndryshme dhe duke nxitur kështu performancën dhe konkurrencën e sektorit hekurudhor Direktiva (BE) 2016/797 mbi interoperabilitetin e sistemit hekurudhor brenda Bashkimit Evropian (Rishikimi i Direktivës 2008/57/KE) Direktiva (BE) 2016/798 për sigurinë hekurudhore (Rishikim i Direktivës 2004/49/KE)	MMPHI	INFRAKOS ZKM MFPT	K4 2024	P	18,900	0	18,900
3.14.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.14.7.	Neni 113	Rregullorja për specifikacionet teknike për interoperabilitet në lidhje me sigurinë në tunelet hekurudhore (STI SRT), e miratuar	Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 1303/2014, e datës 18 nëntor 2014	ARH	MMPHI	K4 2024	T	8,000	0	8,000
3.14.8.	Neni 113	Rregullorja për autorizim të nënsistemeve strukturore, e miratuar	Direktiva (BE) 2016/797 për Interoperabilitet Direktiva (BE) 2016/798 për Siguri	ARH	MMPHI	K4 2024	T	8,000	0	8,000
3.14.9.	Neni 113	Rregullorja për regjistrimin e infrastrukturës (plotësim-ndryshim), e miratuar	Rregullorja zbatuese të Komisionit (BE) 2019/777	ARH	MMPHI	K3 2024	T	8,000	0	8,000

3.15. Kapitulli 15: Energjia										
3.15.	Legjislacioni kornizë									
3.15.1.	Neni 114	Projektligji për energji, i miratuar	Direktiva mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (BE) 2019/944 Rregullorja për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (BE) 2019/943 Rregulloren për Gatishmërinë ndaj rrezikut në sektorin e energjisë elektrike BE 2019/941 Rregullorja mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimet klimatik (BE) 2018/1999	ME	MFPT MMPHI MINT MBPZhr ZRrE KEK KOSTT	K1 2024	P	13,500	0	13,500
3.15.2.	Neni 114	Projektligji për energjinë elektrike, i miratuar	Direktiva 2019/944 për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike Rregullorja 2019/943 për tregun e brendshëm të energjisë elektrike Rregullorja 2019/941 për gatishmërinë ndaj riskut në sektorin e energjisë elektrike Rregullorja e Komisionit (BE) 2015/1222 Krijimi i një udhëzuesi mbi caktimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionit Rregullorja e Komisionit (BE) 543/2013 mbi dërgimin dhe publikimin e të dhënave në tregjet e energjisë elektrike Rregullorja e Komisionit (BE) 838/2010 mbi përcaktimin e udhëzimeve lidhur me mekanizmin e kompensimit të operatorit të sistemit ndër-transmetues dhe një qasje të përbashkët rregullatore ndaj ngarkimit të transmetimit Direktiva 2012/27 për eficiencë të energjisë	ME	MFPT MMPHI MINT MBPZhr ZRrE KEK KOSTT	K1 2024	P	13,500	0	13,500
3.15.3.	Neni 114	Projektligji për Rregullatorin e Energjisë, i miratuar	Direktiva mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (BE) 2019/944 Rregullorja për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (BE) 2019/943 Rregullorja e BE-se 1227/2011 mbi Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me Shumicë (REMIT) Rregullorja 2019/941 për gatishmërinë ndaj riskut në sektorin e energjisë elektrike Rregullorja mbi Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (BE) 2019/942	ME	MFPT MMPHI MINT MBPZhr ZRrE KEK KOSTT	K1 2024	P	13,500	0	13,500

3.15.4.	Neni 114	Projektligji për eficiencën e energjisë, i miratuar	Direktiva 2018/2002/BE për Eficiencën e Energjisë	ME	MFPT MMPHI MINT MBPZhr ZRrE KEK KOSTT	K1 2024	P	13,500	0	13,500
3.15.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.15.5.	Neni 114	UA për caqet dhe trajektoren kombëtare për energjinë nga burimet e ripërtëritshme, i miratuar	Direktiva e Energjisë së Ripërtëritshme (BE) 2018/2001	ME	MFPT MINT KOSTT ZRrE	K4 2024	P	10,800	0	10,800
3.15.6.	Neni 114	UA për dizajnimin dhe përcaktimin e procedurës së procesit konkurrues të tenderimit, i miratuar	Direktiva e Energjisë së Ripërtëritshme (BE) 2018/2001	ME	MFPT MINT KOSTT ZRrE	K4 2024	P	10,800	0	10,800
3.16. Kapitulli 16: Tatimet										
